Pas katër viteve të anëtarësimit në CEFTA, asnjëra nga këto nuk ndodhi. Investimet e huaja u përgjysmuan, deficitin tregtar mbeti i njëjtë, prodhuesit vendor janë më të diskriminuar në krahasim me prodhuesit e vendeve tjera anëtare të CEFTA (qoftë si pasojë e mungesës së kuotave, por edhe si pasojë e pamundësisë për të eksportuar produktet në Bosnje dhe Serbi).

Për shkak të zhvillimit të ulët ekonomik, Kosova ka qenë e disfavorizuar në kuadër të CEFTA-s. Këtë e ka rënduar edhe më shumë bllokada e Serbisë dhe Bosnjës ndaj produkteve kosovare. Ky bllokim i produkteve vendore shënoi rënien e eksportit, duke e vështirësuar ekzistencën e kompanive vendore. Qeveria e Kosovës ndërroi vulat e doganeve, por nuk ishte e vendosur që ndërrimin e simboleve ta dërgoj deri në fund, duke insistuar në përfaqësim të institucioneve të Kosovës dhe jo përmes UNMIK-ut.

Të përballura me këtë krizë kompanitë vendore u detyruan të gjenin rrugë alternative për t'i eksportuar produktet e tyre. Kështu ato zgjodhën dy rrugë:

a) Eksportimin e mallrave përmes një shteti të ri (e cila i rrit shpenzimet prej 5-10%) apo kërkimin e tregjeve të reja.

b) E dyta ndikoi që eksporti me Bashkimin Evropian të rritet dukshëm, në të cilën ndikoi edhe marrëveshja për Masat Autonome Tregtare e nënshkruar më BE-në.

Megjithatë në fund të vitit 2010 edhe kjo marrëveshje përfundoi, ri-nënshkrimi i së cilës po pengohet nga 5 vendet anëtare të BE-së të cilat ende nuk e kanë njohur Kosovën si shtet të pavarur.

NDIKIMI I CEFTA-S NË EKONOMINË E KOSOVËS

Kosova po përballlet me deficite të jashtme shumë të mëdha, veçanërisht në tregtinë e mallrave. Fakti që Kosova ka nivelin më të ulët të eksporteve në rajon është shenjë e qartë e vështirësive me të cilat përballen kompanitë kosovare në tregtinë ndërkombëtare. Disa nga këto vështirësi kanë të bëjnë me barrierat tregtare. Në këtë drejtim, autoritetet serbe rregullisht po i përdorin barrierat në tregti tek produktet bujqësore dhe jo-bujqësore që eksportohen nga Kosova për në Serbi ose të cilat kalojnë nëpër territorin e Serbisë, si importe ose eksporte kosovare.

Kosova nënshkroi marrëveshjen e CEFTA pa asnjë kusht. Edhe pse me Marrëveshjen e CEFTA-s është e lejuar që palët negociuese të vendosin kuota për produkte të caktuara, me qëllim që të mbrojnë prodhuesit vendor, Kosova nuk ka bërë një gjë të tillë. Kjo që në fillim paraqiti problem tek prodhuesit vendor të cilët nuk ishin konkurrent në tregun e tyre, meqenëse produktet e importuara ofrojnë çmime më konkurruese. Për më tepër të gjitha vendet rajonale anëtare të CEFTA-s vendosën kuota për disa produkte specifike, duke ia vështirësuar produkteve kosovare të jenë konkurrente në ato tregje. Nëse analizojmë vlerat e eksportit me vendet anëtare të CEFTA-s mund të shohim se eksporti është rritur ngadalë pas anëtarësimit në CEFTA. Në vitin 2006 eksporti me vendet e CEFTA-s ishte 51.7 milion €, përderisa në vitin 2010 kjo vlerë arriti në 70.9 milion. Një rritje prej 37 % brenda 4 viteve, e që është një rritje jo e kënaqshme, kur marrim parasysh shkallën e vogël të eksportit në përgjithësi ¹.

Nga viti në vit, është vërejtur se institucionet e Kosovës kanë përfituar nga kjo marrëveshje, në kuptimin e themelimit të strukturave raportuese, që në një mënyrë ka ndihmuar edhe si model në krijimin e strukturave raportuese edhe Marrëveshja për Stabilizim-Asociim.

Ndërsa sa i përket aspekteve ekonomike dhe tregtare, siç dihet edhe nga ankesat dhe shqetësimet që ka pasur komuniteti i biznesit, nuk ka pasur rezultate në mënyrë të kënaqshme nga kjo marrëveshje.

Pra, bilanci negativ i Kosovës prej anëtarësimit deri më tani, ka qenë 6 miliardë e 400 milionë euro. Sipas këtij hulumtimi, importi i produkteve të vendeve anëtare të CEFTA-s në Kosovë, ka qenë mbi 7 miliardë euro, kurse Kosova ka arritur të eksportojë më pak se një miliard euro.

Gjatë periudhës 2005-2015 në Kosovë importi ka treguar rritje të theksuar, në përjashtim të vitit 2013 kur ka pas rënie, mirëpo përsëri kanë filluar të ngritët deri në 7 miliard euro. Po ashtu edhe gjatë kësaj periudhe eksporti ka treguar rritje deri në disa miliona.

Mirëpo përqindja e mbulimit gjate periudhës 2015 krahasuar me vitin paraprak (2014) ka shënuar rënie, deri sa ishte 17.6 % ne 16.1 %.

Nëse krahasojmë eksportin prej vitit 2013 ne 2014 ka pasur rritje për 22%, mirëpo nëse shihet 2015 dhe krahasohet me 2014 kemi rënie për -3%. Ndërsa importi krahasuar me këto vite kemi shifra konstante te rritjes prej 7%.

Ndërsa shkëmbimet tregtare me Shqipëri-Maqedoni-Serbi, ku bilanci tregtar me tri shtetet fqinje tregon një pasqyrim real ku Kosova rrit eksportin vetëm me Shqipërinë nga viti në vit në anën tjetër rrit edhe importin me miliona euro nga Serbia ndërsa Maqedonia në vazhdimësi në këto vite e humb tregun në Kosovë si pasojë e rritjes së pranisë së prodhimeve të Serbisë dhe përfaqësuesve të saj në Kosovë.

Bilanci tregtar me këto shtete nga vitit 2005- 2015 -Importi me Shqipëri 867 milionë euro, me Maqedoni 2. 796 milionë dhe me Serbi 2.815. Eksporti me Shqipëri ishte 320 milionë €, me Maqedoni 254 milionë dhe me Serbi 162 milionë.

¹ Instituti GAP, Kosova në CEFTA, 2011

Nga kjo shihet se bilancet tregtare më pozitive Kosova i ka me Shqipërinë rrethë 37 % eksport, kurse eimporti 63 %, kurse më negativ i ka me Serbinë ku importi është 94.2 %, në favor të Serbisë dhe vetëm 5.8 % në favor të Kosovës ².

Importi me vendet e CEFTA-s duke krahasuar vitin 2005 me vitin 2015 sipas strukturës së përqindjes shihet se në vitin 2005 nga Republika e Maqedonisë është importuar më së shumti mbi 53 %, dhe krahasuar me vitin 2015 e ka 18.7 %. Mandej importi me Republikën e Serbisë shikuar në vitin 2005 ka qenë 36.7% ndërsa gjatë vitit 2015 importi ka arritur ne 49.7%.

Ndërsa importet me Republikën e Shqipërisë gjatë vitit 2005 ka qenë 4.4 % dhe në vitin 2015 ka arritur në 19.7 % .

Eksporti 2005 – 2015: Një pasqyrë më reale e eksportit për vitin 2005 krahasuar me vitin 2015 e shteteve anëtare të CEFTA-s është mjaft disproporcionale. Eksporti me Republikën e Maqedonisë në vitin 2005 ka qenë 37.4 % ndërsa në vitin 2015 merr pjesë me 27 %.

Republika e Serbisë në vitin 2005 ka qenë 28.2 %, ndërsa në vitin 2015 merrë pjesë me 26.1 %, kurse eksporti me Republikën e Shqipërisë në vitin 2005 ka qenë 20 %, ndërsa në vitin 2015 merrë pjesë me 32.5 %, e kështu me radhë.

RREGULLAT E ORIGJINËS

Sipas Marrëveshjes së CEFTA-së. palët thjeshtësojnë dhe lehtësojnë procedurat doganore dhe reduktojnë, sa më shumë që të jetë e mundur, formalitetet e vendosura për tregti. Ata e zgjidhin çdo vështirësi që del nga zbatimi i këtyre dispozitave në përputhje me Nenin 42. Kështu, rregullat e origjinës në përgjithësi konsiderohen si një nga kriteret kryesore të cilat përcaktojnë vendin apo territorin e origjinës së produktit, dhe më shpesh detyrimet dhe kufizimet e importit varen nga origjina e importeve. Masat e kësaj natyre i ka ndërmarrë Serbia ndaj prodhuesve kosovarë. Nga pikëpamja ekonomike, masat e tilla patën efekt të drejtpërdrejt negativ në tregti. Rasti i zgjedhur mbulon masat, përfshirë edhe ato të cilat lidhen direkt me rregullat e origjinës, të cilat janë aplikuar në mënyrë të pajustificueshme ndaj eksportuesve kosovarë.

Për shkak të faktit se dokumentet zyrtare të Kosovës ende nuk pranohen plotësisht nga autoritetet serbe për shkak të mos-njohjes së pavarësisë së Kosovës, Kompanitë kosovare përballen me pengesa të papritura të ngritura nga dogana e Serbisë, duke rritur shpenzimet e kalimit të kufirit në aspektin e kohës së humbur dhe parave, gjë që i bëjnë produktet e Kosovës më pak konkurruese në tregjet serbe.

1. AVANTAZHET E KOSOVËS NË CEFTA

Me hyrjen në CEFTA Kosovës i është dhënë mundësia të ketë qasje në tregun e rreth 30 milion konsumatorëve.

² <http://www.ekonomia-ks.com/?page=2,3,388891>

- CEFTA jep mundësi që të eliminohen barrierat jo-tarifore.
- Diskutimi i çështjeve të ndryshme tregtare në forume rajonale.
- Anëtarësimi në CEFTA i ka dhënë Kosovës një shans që të mësohet me rregullat e tregtisë brenda kornizave të BE-së.
- CEFTA është e hartuar në bazë të rregullave të OBT-së ku Kosova synon të jetë anëtare.

2. DISAVANTAZHET E KOSOVËS NË CEFTA

Nëse shikojmë në periudhë afatshkurtër mund të thuhet që Kosova nuk ka përfituar sa është pritur për shkak të problemeve politike që kanë ekzistuar dhe vazhdojnë të jenë pengesë në zhvillimin e tregtisë me disa vende të rajonit.

Në përgjithësi, nëse shikohet në periudhë afatshkurtër Kosova nuk ka përfituar sa është pritur por nëse shikohet në periudhë afatgjatë atëherë mund të themi se jemi në rrugë të mirë për të përfituar edhe më shumë nga kjo marrëveshje.

Sektori i prodhimit në Kosovë po vazhdon të zgjerohet dhe produktet e saj janë duke u bërë konkurruese jo vetëm në vendet e CEFTAs por gjithashtu edhe në BE dhe më gjerë si p.sh në SHBA. Marrëveshja e CEFTAs përveç karakterit ekonomik dhe tregtar, konsiderohet edhe si marrëveshje politike dhe njëkohësisht përgatitë vendet për tu mësuar me rregullat e BE-së dhe WTO (Organizata Botërore e Tregtisë). Pra, CEFTA-n mund ta konsiderojmë si një instrument para-hyrës për anëtarësim në BE.

3. PËRFITIMET E KOSOVËS DHE VENDEVE ANËTARE NGA CEFTA

Përveq problemeve politike, organizata kishte edhe problem teknike dhe procedurale. Njëri prej problemeve kryesore ishte mospajtimi mes vendeve anëtare të krijimit të një baze të “të dhënave të përbashkëta” për qarkullimet tregtare mes këtyre vendeve. Pra shtetet anëtare nuk u pajtuan që të krijohet kjo bazë e veçantë e të dhënave ku mund të raportohet për shkëmbimet tregtare, prejardhjen e mallrave, cilësinë e tyre, dhe karakteristika tjera të nevojshme për tregëtinë e lirë të mallrave.

Në fakt vetëm dy shtete pranuan të kenë një bazë të tillë, dhe këto ishin Kroacia dhe Kosova e cila para pavarësisë së vendit tone ishte përgjegjëse për funksionimin e kësaj marrëveshje për tregëtinë e lirë. Maqedonia raportonte vetëm për tregëtinë e lirë me vendet e ballkanit perëndimor, Bosnia raportonte vetëm tek vendet evropiane në zhvillim, ndërsa Serbia nuk i raportonte askujt për shkëmbimet tregtare në kuadër të CEFTA-s.

Me këtë kuptojmë se vendet anëtare të CEFTA-s e donin organizatën vetëm për shkak të përfitimeve ekonomike që kishin prej saj, por nuk i respektonin në tërësi rregullat e saj të veprimit.

Problem tjetër ishte se nuk kishte një rregull të qartë të raportimit të hyrje daljeve të shkëmbimeve tregtare në një monedhë të caktuar, por disa shtete raportonin në euro, e disa tjera raportonin në dollarë amerikan.

Arsyeja tjetër se pse shtetet anëtare nuk pranoin të kenë një bazë të përbashkët të “të dhënave”, qëndronte në faktin se: Ekzistonte një mospërputhje e konsiderueshme në pasqyrat e evidencave statistikore të eksportit dhe flukseve të importit të vendeve anëtare të CEFTA-s, e cila shkaktonte dyshime në dallimet e mundshme të raportimeve nga rezultatet e vërteta të shkëmbimeve tregtare. Disa ekspert të ekonomisë tregojnë për një diskrepancë në mes të fakteve statistikore Brenda rajonit dhe mallrave të ardhura nga jashtë rajonit dhe që i janë ofruar publikut për shfrytëzim.

Përkundër këtyre sfidave dhe problemeve me të cilat u ballafaqua kjo organizatë, kjo marrëveshje krijoi një zonë të tregëtisë së lirë mes këtyre shteteve e cila pati një ndikim të menjëhershëm pozitiv në të gjitha shtetet rajonale, e cila ndihmoi me të madhe në krijimin e një zone të lirë të tregut që ishte e evidente deri në fillim të krizës ekonomike globale e cila filloi në vitin 2008, menjëherë pas pavarësimit të Kosovës. Sa për ilustrim të theksojmë se shkëmbimi tregtarë në mes të vendeve anëtare në vitin 2008 arriti vlerën e miliarda dollarëve amerikanë.

Për eksportuesit kosovarë në tregjet e CEFTA-s ishte i rëndësishëm eksporti i të gjitha produkteve bujqësore, vera e rrushit, mielli, produktet e qumshut dhe produktet tjera si cemento, qymyri, nikeli dhe metale tjera nga Trepça.

Sigurisht që Kosova akoma është vend importues i produkteve të ndryshme dhe ka nevojë për importe nga vendet e CEFTA-s dhe vende tjera të tregut botëror, për të plotësuar nevojat e Kosova importon edhe pajisje tjera makinerike nga rajoni, sidomos pajisje bujqësore nga Serbia, por edhe nga vendet e BE-së, sidomos nga Gjermania. Teknologjia më së shumti po sillet nga vendet e Bashkimit Evropian, sidomos tregu i makinave dhe teknologjisë së rëndë.

Është bërë praktikë që vendet e CEFTA-s të eksportojnë materiale të papërpunuara, ndërkohë që edhe importojnë material të tilla, të cilat më pastaj i përpunojnë në vendet e tyre. E mira e gjithë këtij bashkëpunimi është se vendet anëtare u angazhuan për një qarkullim të lirë të mallrave dhe njerëzve, të cilët mundën të kalojnë doganat dhe kufijtë me dokumente themelore pa ndonjë procedurë të vështirë kalimi, dhe kjo bëri që tregtia në mes të shteteve anëtare të pësojë një rritje gjatë tërë viteve që nga themelimi i CEFTA-s, përkundër ç’antaresimit të disa shteteve nga unioni, për shkak të antaresimit në UE, për të cilën kanë pretendime edhe shtetet e mbetura në CEFTA.

Vetë integrimi në Bashkimin Evropian, do të neglizhojë nevojën e ekzistimit të mëtejshëm të kësaj organizate, sepse atëherë nuk do të ketë kufinj dhe kufizime tregtare mes shteteve dhe popujve.

Kooperimi ekonomik rajonal nëpërmjet CEFTA, solli përfitime për të gjitha palët si:

- CEFTA është mënyra më e mirë për të mobilizuar mjetet ekonomike për të arritur stabilizimin e qëndrueshëm politik dhe ekonomik të të gjitha vendeve të rajonit,
- CEFTA është një mjet i fuqishëm ekonomik për rimëkëmbjen ekonomike të vendeve pjesëmarrëse. Tregtia rajonale ka provuar të jetë më elastike ndaj krizës ekonomike se sa tregtia me Bashkimin Evropian. Rënia e flukseve tregtare rajonale ishte më e ulët, rimëkëmbja erdhi më shpejt. Për më tepër, vetëm një treg që funksionon si CEFTA mund

të rrisë avantazhet konkurruese të rajonit si tërësi për të tërhequr me IHD (Investimet e Huaja Direkte),

- CEFTA përfaqëson një "fushë trajnimi" të shkëlqyer për pjesëmarrje të suksesshme në të ardhmen në tregun e BE-së.

KONSTATIME

Aktualisht ndër marrëveshjet e pakta tregtare e Kosovës e bërë në rangun ndërkombëtar, është Marrëveshja e Evropës Qendrore për Tregti të Lirë (CEFTA). Para ca vitesh u nënshkrua edhe marrëveshja për tregtinë e lirë në mes të Kosovës dhe Turqisë, si dhe vitin e kaluar u nënshkrua marrëveshja me Bashkimin Evropian në lidhje me Marrëveshjen e Stabilizim Asocimin, që siguron tregëti të lirë dypalëshe (shumica e eksporteve të Kosovës në Bashkimin Evropian aktualisht përfitojnë nga trajtimi pa doganë, sipas ATM programit të BE-së).

Kosova iu bashkëngjiti CEFTA-s në kohën kur ajo po përballej me një deficit të lartë tregtar dhe ekonomi jo të zhvilluar. Anëtarësimi në CEFTA u pas si rrugëdalje nga kjo krizë, pasi që besohej se me integrimin në një treg të lirë më të gjerë, investitorët e huaj do të investonin në Kosovë, prodhuesit vendor do të kishin mundësi të eksportonin më lehtë dhe Kosova do të bënte një hap para drejt anëtarësimit në BE. Pas katër viteve të anëtarësimit në CEFTA, asnjëra nga këto nuk ndodhi. Investimet e huaja u përgjysmuan, deficiti tregtar mbeti i njëjtë, prodhuesit vendor janë më të diskriminuar në krahasim me prodhuesit e vendeve tjera anëtare të CEFTA (qoftë si pasojë e mungesës së kuotave, por edhe si pasojë e pamundësisë për të eksportuar produktet në Bosnje dhe Serbi). Për shkak të zhvillimit të ulët ekonomik, Kosova ka qenë e disfavorizuar në kuadër të CEFTA-s. Këtë e ka rënduar edhe më shumë bllokada e Serbisë dhe Bosnjës ndaj produkteve kosovare. Ky bllokim i produkteve vendore shënoi rënien e eksportit, duke e vështirësuar ekzistencën e kompanive vendore. Qeveria e Kosovës ndërroi vulat e doganeve, por nuk ishte e vendosur që ndërrimin e simboleve ta dërgoj deri në fund, duke insistuar në përfaqësim të institucioneve të Kosovës dhe jo përmes UNMIK-ut.

Përkundër të mirave që Marrëveshja për Tregti të Lirë në Evropën Qendrore (CEFTA) i ka sjellë Kosovës në aspekt të integritimit në tregun rajonal, përfitimet në aspektin ekonomik nga kjo marrëveshje kanë qenë të vogla, marrë parasysh sfidave të shumta me të cilat janë ballafaquar prodhuesit vendor gjatë viteve.

CEFTA është vetëm një element i integritimit ekonomik rajonal. Elemente po aq të rëndësishme të këtij integritimi janë edhe iniciativat në fusha të tjera si Komuniteti i Energjisë, Zona e Përbashkët e Aviacionit, Memorandumi i Evropës Juglindore në fushën e Transportit, Iniciativa e Evropës Juglindore në fushën e Telekomunikacioneve dhe Internetit, Bashkimi i Investimeve, etj. Te gjitha këto iniciativa synojnë krijimin e një tregu të përbashkët rajonal që në një fazë të mevonshme do të integrohet në tregun e madh Evropian, atë të Unionit Evropian.

Më 22 nëntor 2018, Qeveria e Kosovës mori vendim për vendosjen e masës (taksës) 100 % për të gjitha produktet me origjinë nga Serbia dhe Bosnja dhe Hercegovina. Qeveria e Serbisë është duke insistuar për heqjen e kësaj mase, si përmes institucioneve ndërkombëtare ashu edhe përmes kërcenimeve për dërgimin e çështjes në Arbitrazh.

REKOMANDIME

Dhjetë vite pas anëtarësimit të Kosovës në CEFTA dhe po kaq vite pas shpalljes së pavarësisë, opinionin kosovar është i ndarë në ata që mendojnë se Kosova duhet të qëndrojë në CEFTA dhe ata që mendojnë se Kosova duhet të largohet nga CEFTA, për shkak të përfitimeve të pakta dhe obligimeve që ka Kosova ndaj kësaj organizate. Disa nga rekomandimet tona janë sin ë vijim:

- Vënia e masave provizore ri-balancuese. Deri në arritjen e një marrëveshjeje me Serbinë dhe Bosnjën, Kosova duhet t'i rris tarifat doganore përkohësisht për produktet nga Serbia dhe Bosnja. Kjo do t'i ribalanconte përkohësisht humbjet e shkaktuara nga këto dy shtete. Rritja e tarifave doganore do të duhej të ndodhte pasi Kosova të ketë lajmëruar paraprakisht Komitetin e Përbashkët dhe vetë autoritetet në Serbi dhe Bosnje.

- Aplikimi i kuotave. Qeveria e Kosovës duhet të përcaktojë kuotat për mbrojtjen e disa produkteve vendore, e cila do t'i sigurojë dhe do t'i bëjë më konkurrenë këto produkte në tregun vendor, përball atyre të importuara.

- Hapja e diskutimit në Komitetin e Përbashkët me Serbinë e Bosnjës, ashtu siç e parasheh edhe Marrëveshja e CEFTA-s në rast të mos-marrëveshjes mes 2 apo më shumë palëve. Meqenëse Kosova e ka radhën e udhëheqjes së Komitetit, institucionet vendore duhet me doemos ta shtojnë në agjendë diskutimin e mosmarrëveshjes dhe arritjen e një kompromisi të përbashkët. Nëse diskutimet nuk sjellin një marrëveshje të përbashkët brenda 90 ditëve Kosova duhet të procedojë çështjen në arbitrazh.

- Braktisja e CEFTA-s dhe nënshkrimi i marrëveshjeve bilaterale me shtetet veç e veç.

Statistikat tregojnë se Kosova nuk ka përfituar nga CEFTA ashtu siç është pritur në fillim. Nëse Kroacia do t'i bashkohet Bashkimit Evropian, dhe Bosnja e Serbia vazhdojnë t'i bllokojnë produktet kosovare në kufi, atëherë Kosova do të duhet të dilte nga marrëveshja e CEFTA-s dhe të nënshkruante marrëveshje bilaterale me Shqipërinë, Maqedoninë dhe Malin e Zi. Aplikimi i masave të reciprocitetit ashtu siç është kërkuar nga bizneset kosovare nënkupton shkeljen e marrëveshjes së CEFTA-s dhe si e tillë do të ishte e papranueshme, andaj dalja nga kjo marrëveshje do të ishte zgjidhja më e mirë në këtë rast. Sidoqoftë, kjo duhet të mbetet opsioni i fundit, pasi të provohen të gjitha rrugët tjera ligjore.

Literatura

1. Gashi P. dhe Linotte D., Manuali mbi Treguesit e Tregtisë Ndërkombëtare, Projekti për Politika Tregtare i BE, Prishtinë, 2015;

2. Berisha, S, “Integrimet Ekonomike Evropiane”, Prishtinë 2005 ;
3. Desmond Dinan: “Encyclopedia of the European Union”, Lynne, 2000 ;
4. GEGOUT, CATHERINE, 2010 : “European Foreign and Security Policy”, University of Toronto Press ;
5. Georg T.Friedlab, “Essentials of Financial Analysis”, ISBN 0-471-22830-3, USA;
6. Jakupi, A. “Metodologjia e punës kërkimore shkencore”, Prishtinë 2005 ;
7. Limani,M.” Integrimet Ekonomike Evropiane”, Prishtinë, 2004;
8. Qorraj, G. “Enterpreneurs and Self-Employees”, Gjermani,2010;
9. Qorraj, G.“INTEGRIMI EVROPIAN DHE KOSOVA”, Prishtinë, 2012;
10. Richard Baldwin & Charles Wyplosz : “The Economics of European Integration “, ISBN: 9780077121631, May-09 ;
11. Tali,D. “Integrimi i Evropës në UE”;
12. Instituti GAP, Kosovan në CEFTA; Prishtinë, 2011;
13. Marrëveshja e CEFTA-s, 2006;

Burimet tjera:

1. Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, Republika e Kosovës ;
2. Ministria e Integritit Evropian, Republika e Kosovës ;

ROLI I MIKROFINANCËS NË ZHVILLIMIN E SEKTORIT TË AGRIKULTURËS NË SHQIPËRI

Elia Botka

Universiteti “Mesdhetar i Shqipërisë”, Bulevardi Gjergj Fishta 52, Tirana 1023 Email:
elia.botka@umsh.edu.al

Abstrakt:

Në këtë punim analizohet roli i institucioneve të mikrofinancës në zhvillimin e sektorit të agrikulturës. Ky sektor, me gjithë rënien që ka pësuar prej vitit 1991, mbetet një nga më të rëndësishmit në Shqipëri për sa i përket nivelit të punësimit që shkon në rreth 40% të forcës së punës. Por sektori i agrikulturës është një sektor që karakterizohet nga një numër specifikash që e bëjnë të vështirë të kushtueshëm dhe me risk të lartë për t’u financuar. Në hyrje të këtij punimi analizohen specifikat e këtij sektori. Bazuar në këto specifika analizohet nëse bankat apo institucionet e mikrofinancës janë më të përshtatshmet për të përmirësuar aksesin financiar të bizneseve dhe në cilin aspekt secili institucion ka përparësitë e veta. Punimi mbështet rolin që kanë dhe mund të kenë institucionet e mikrofinancës në zhvillimin e agrikulturës dhe jep kokluzionet përkatëse se çfarë i nevojitet mikrofinancës në rrugët dhe mundësitë e zhvillimit që ky sektor ka në të ardhmen. Metoda kërkimore e përdorur është përshkruese dhe analizuese. Të dhënat kryesore janë marrë nga Banka Botërore, Banka e Shqipërisë, Shoqata Shqiptare e Mikrofinancës, nga vrojtime, nga punime shkencore individuale të autorëve të pavarur etj.

***Fjalë kyçe:** Struktura e financimit në sistemin bujqësor, mikrokredia, risku ekonomik, asistenca teknike, kostoja e financimit.*

Hyrje

Në fillim të viteve 90’ pas rënies së sistemit komunist, ekonomia shqiptare pësoi ndryshime rrënjësore në çdo fushë të ekonomisë. Sistemi i mëparshëm i bazuar në ekonominë e centralizuar u zëvendësua me ligjet e ekonomisë së tregut. Sektori i agrikulturës që dominonte ekonominë në periudhën e mëparshme pësoi transformim duke kaluar nga modeli ekonomik i kooperativave publike në ekonominë private të tregut. Ky sektor ka pësuar një rënie të ndjeshme nga fillimi i periudhës së tranzicionit por Shqipëria mbetet akoma sot vëndi më bujqësor i Europës. Njësoj si vëndet e tjera të Ballkanit Perëndimor, Shqipëria përballet me kufizime të rëndësishme në zhvillimin e agrikulturës, si produktiviteti i ulët, përdorimi e një teknologjie jo të avancuar, nivel të kufizuar të investimeve, falë

edhe mungesës së interesit për të investuar në këtë sektor, niveli ulët i aktiviteteve të biznesit, infrastruktura e pazhvilluar, dhe mungesa e llojeve alternative të financimit. Gjatë viteve janë hartuar programe të ndryshme strategjike me qëllim zhvillimin e sektorit, por akoma sot mund të thuhet se sektori i agrikulturës mbetet, i pa zhvilluar e me risk të lartë për të investuar. Te dhënat e fundit, tregojnë se në tre vitet e fundit kemi dhe një ulje të punësimit në këtë sektor ku pesha e tij bie në 40%.

Tabela 1. Të punësuarit sipas sektorëve

	2016	2017	2018
I. Sektori shtetëror	164635	164339	169865
Buxhetorë	129187	128954	129210
Jo-buxhetorë	35448	35385	40655
II. Sektori privat jo-bujqësor	412473	475019	508296
III. Sektori privat bujqësor	465702	456523	459778
Totali i sektorëve	1042810	1095881	1137939
% e të punësuarve në bujqësi	44.66%	41.66%	40.40%

Gjatë viteve 2007-2013 u hartua një strategji rurale zhvillimi e quajtur ISRDSA (Inter-sectoral Rural Development Strategy) për sektorin e agrikulturës në vendet e BP (Ballkanit Perëndimor). Një studim i FAO-s, (Food and Agriculture Organisation) mbi këtë strategji vinte në dukje se në përgjithësi, të gjithë vendet e BP theksin kryesor e vinin mbi sigurinë ushqimore, rritjen e të ardhurave bujqësore dhe në disa aspekte të konkurrencës së bizneseve. Por prioritetet dhe qëllimet për zhvillimin nuk u koordinuan midis vendeve, siç nuk u harmonizuan në secilin vënd politikat me programet kombëtare dhe dokumentat strategjike. Për më tepër, nuk pati një matje të rezultateve të arritura.

ISARD 2014-2020

Në fund të vitit 2014, Shqipëria krijoi një kornizë të re strategjike për zhvillimin e ardhshëm të bujqësisë dhe zonave rurale te quajtur Strategjia Ndërsektoriale për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural (ISARD) 2014-2020. Dokumenti i jep përparësi politikave që nxisin zhvillimin dhe rritjen e prodhimit bujqësor dhe synon përmirësimin e konkurrencës, harmonizimin e politikave dhe mjediseve institucionale me vendet e BE-së, përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe përfshirjen sociale të popullsisë rurale. Korniza strategjike gjithashtu përshkruan në mënyrë më të detajuar ndërhyrjen publike në tre fusha kryesore të politikave:

1. zhvillimi rural (me Instrumentin e Ndhmës së Para-Anëtarësimit në BE (Pre-accession Assistance) për zhvillimit rural;
2. mbështetja e infrastrukturës së fermerëve dhe e infrastrukturës në zonat rurale;

3. zhvillimi institucional dhe rregullator drejt standardeve të BE. Kuadri strategjik nuk përcakton masa specifike të politikave; përcaktonte vetëm mekanizmin e adoptimit të tyre nëpërmjet planeve vjetore të veprimit kombëtar.

Krahasuar me gjetjet e studimit të FAO, reformat e politikës bujqësore brenda kornizës strategjike janë më të theksuara në fushën e zhvillimit rural, ndërsa tregu dhe mbështetja e drejtpërdrejtë ndryshohen në një masë më të vogël.

Sektori i Agrikulturës, informaliteti dhe aksesit financiar

Sektori i agrikulturës është i ndryshëm nga sektorët e tjerë të ekonomisë në shumë mënyra. Ai karakterizohet nga një numër specifikash që e bëjnë të vështirë, të kushtueshëm dhe me risk të lartë për t'u financuar. Aktivitetet janë përgjithësisht të vendosura në zona të izoluara me dendësi të ulët të popullsisë dhe infrastrukturë të dobët. Ato janë të varur nga moti dhe ciklet e prodhimit; Të ardhurat janë të ardhura sezonale dhe të kufizuara. (Chalmers, 2005; Wampfler and Lapenu, 2002; Zeller, 2003)

Me specifikisht ai karakterizohet nga:

- Rreziqet e larta sistematike, ekonomike, sociale të lidhura me bujqësinë, të kombinuara me sezonalitetin, përfitueshmërinë e ulët dhe natyrën relativisht "të specializuar", që shpesh çojnë në të ardhura të vogla. Fitimi i ulët i sektorit e bën veçanërisht të vështirë huazimin me normat e interesit të praktikuara nga mikrofinancimi.
- Kufizimet rurale që lidhen me popullatat shumë të shpërndara, dhe infrastruktura e dobët e transportit dhe komunikimit e bëjnë aksesin në shërbimet financiare dhe në zhvillimin e rrjeteve rurale, sidomos në zonat veçanërisht të izoluara ku dendësia e popullsisë është e ulët.
- Mungesa e burimeve njerëzore si arsimimi i dobët, dhe mungesa e stimujve për të shkolluarit për të punuar në zonat rurale e bën edhe më të vështirë zhvillimin e shërbimeve financiare vendase.
- Mungesa e sistemeve të besueshme të drejtësisë apo të pronësisë së tokës dobësojnë transaksionet financiare gjithashtu dobësojnë aksesin financiar në agrikulturë.

Në këndvështrimin e AMA (Albanian Microfinance Assosiation) në sektorin e agrikulturës hasen disa vështirësi që mund t'i klasifikojmë si më poshte:

- Vështirësitë e identifikimit të kostove të veprimtarisë;
- Dimensioi i vogël i bizneseve;
- Informaliteti i bizneseve dhe mungesa e kolateralit;
- Kultura e dobët financiare mes popullatës së shërbyer;
- Abuzimi me marrëdhënien e mirëbesimit në terren etj.

Informaliteti.

Informaliteti është një karakteristikë e pranishme në të gjitha aktivitetet e biznesit për MSME-të, (micro,small and medium enterprice) por arrin veçanërisht nivele të larta në sektorin e agrikulturës. Ai është i pranishëm si në formën e ndërmarrjeve të parregjistruara dhe ndërmarrjeve të regjistruara, por që nuk i raportojnë të gjitha të ardhurat e tyre tek autoritetet tatimore. Me gjithë progresin e kryer në vitet e fundit në numrin e bizneseve të regjistruara në dimensionin mikro (shih tabelën 1), falë përpjekjeve të qeverisë për të rritur numrin e bizneseve të regjistruara dhe të punonjësve të deklaruar duke përmirësuar në këtë mënyrë dhe financat publike, bizneset vazhdojnë të mos deklarojnë taksat dhe punonjësit dhe operojnë kryesisht me para në dorë. Punonjësit vuajnë nga mungesa e mbrojtjes sociale, veçanërisht nga mungesat e sigurimeve dhe pensionet. Te ardhurat publike janë të reduktuara dhe kjo reflektohet në një ofertë të ulët të të mirave publike. Duke ju shmangur ekonomisë formale këto biznese humbasin mundësinë që të kenë një akses financiar formal në tregje dhe të mbrojnë ligjërisht pronën apo investimet e tyre.

Tabela 2. Sektori i agrikulturës sipas madhësisë së ndërmarrjeve, ndërmarrjeve aktive dhe të reja në vite.

Agrikultura, Pyjet e Peshkimi			2014	2015	2016	2017
		Ndërmarrje				
Ndërmarrjet mikro	1-4	Aktive	2121	21030	32493	37535
		Ndërmarrjet e reja	1001	19224	12268	5763
		Ndërmarrje				
Ndërmarrjet e vogla	5-9	Aktive	68	94	80	71
		Ndërmarrjet e reja	19	19	3	3
		Ndërmarrje				
Ndërmarrjet e mesme	10-49	Aktive	58	58	66	60

Burimi: INSTAT

Aksesi financiar

Mikro-ndërmarrjet e paregjistruara mund të kenë mundësi të marrin financim nga institucionet e mikrofinancës, por ndërmarrjet e paregjistruara më të mëdha se ato mikro, përgjithësisht nuk mund të marrin kredi bankare. Bankat zakonisht nuk marrin në konsideratë të ardhurat e padeklaruar në analizën e tyre financiare, që do të thotë se shumë ndërmarrje që nënvlerësojnë të ardhurat dhe fitimet e tyre kanë ulur aksesin financiar.

Në një Sondazh të Ndërmarrjeve të kryer nga Banka Botërore të 2013-ës të anketuarve të vëndeve të Ballkanit Perëndimor u kërkohet të tregojnë pengesat më të mëdha për biznesin e tyre. Mesatarisht në të gjithë rajonin e Ballkanit Perëndimor, praktikat e sektorit informal, normat e taksave, instabiliteti politik dhe aksesin në financiam janë vlerësuar si pengesat më të mëdha. Praktikrat e sektorit informal janë më shpesh të identifikuara si kufizimi kryesor në Shqipëri.

Edhe në Raportin Global të Konkurrueshmërisë 2017-2018 rezulton se aksesin financiar është faktori i tretë më problematik që influencon konkurrueshmërinë e ulët në Shqipëri që ndjek normat e taksave dhe korrupsionin.

Ndërmarrjet bujqësore përballen me vështirësi të madha në aksesin e burimeve financiare, pasi shumica e institucioneve financiare (kryesisht bankat) i konsiderojnë ato të me risk të lartë dhe të shtrenjta për t'u shërbyer. Kompanitë që operojnë në sektorin e agrikulturës kanë më pak aksesin financiar sesa kompanitë që operojnë në sektorë të tjerë. Hendeku i agrikulturës është përgjithësisht më i vogël për ndërmarrjet mikro se sa për ndërmarrjet e vogla, pasi shumë institucione mikrofinanciare konsiderojnë se ato janë një nga segmentet kryesore të tyre. Megjithatë, me disa përjashtime, bankat janë kryesisht të qëndrueshme duke pohuar se sektori i agrikulturës është më i rrezikshëm dhe më pak fitimprurës sesa sektorët e tjerë dhe ndonjëherë ato pranojnë se personeli i tyre nuk ka njohuri dhe përvojë për të vlerësuar siç duhet ndërmarrjet bujqësore. Shkaqet e vështirësisë në aksesin financiar ndaj bankave janë kërkesa e lartë për kolateral, aftësia e ulët e të bërit biznes, standartet strikte të kreditimit dhe informaliteti. Kredia bankare në sektorin e agrikulturës në raport me gjithë sektorët e tjerë të ekonomisë ishte vetëm 1% në vitin 2016 dhe 2017. Ndërsa kostot e financimit nuk përbëjnë një pengesë të rëndësishme. Në 2017-ën normat e interesit lëviznin nga 5.5% në 6%.

Ndërmarrjet start up kanë vështirësi të veçantë në gjetjen e fondeve pasi që shumë institucione kreditimi nuk do t'u japin hua atyre ose do ta bëjnë këtë vetëm në sasi shumë të vogla. Ndërmarrjet start up ballafaqohen kanë një vështirësi të mëdha në aksesin financiar në të gjithë rajonin - Mundësia e kufizuar e opsioneve të financimit të kapitalit si *privat equity funds* në disa vende heq një kanal të rëndësishëm financiar. Shumica e bankave por edhe institucionet mikrofinanciare nuk japin kredi për ndërmarrjet start up, duke e bërë të vështirë qasjen në financimin e kredive. Megjithatë disa banka dhe institucione mikrofinanciare e lejojnë kreditimin e sipërmarrjeve të reja, ato shpesh janë në sasi shumë të vogla dhe në kushte të pafavorshme, siç janë normat e interesit më të larta se mesataret dhe maturimet e shkurtra.

Administrimi i Institucioneve Financiare jo Bankare dhe e Shoqërive të Kursim-Kreditit.

Vitet e fundit, në këto institucione janë ndërmarrë masa modernizuese në përshtatje me legjislacionin e vendeve të zhvilluara dhe të nevojave e ekonomike shqiptare. Qëllimi i reformave të bëra në fushën e administrimit të riskut të kredisë për SHKK-të (Shoqëritë e Kursim-Kreditit) dhe IFBJ-të (Institucionet Financiare jo Bankare) ka qënë i njëjtë: mbrojtja e kapitalit të këtyre institucioneve nga risku i kreditimit. Kjo ka si efekt një kreditim nga ana e këtyre institucioneve shumë më të kujdesshëm, dhe ruajtja e kapitalit rrit mundësin e financimeve ndaj bizneseve që nuk operojnë në kushtë të një riskutë lartë, por nga ana tjetër do të humbisnin aksesin e fondeve financiare shumë ndërmarrje e sidomos start-up-e. Një objektiv i rëndësishëm, jashtë kësaj reforme do të ishte - siç pamë më lart - monitorimi i rrezikut të këtyre aktiviteteve të biznesit si për shëmbull përcjellja e ekspertizave ekonomiko-financiare por edhe matja e rezultateve të arritura.

Bankat, për të financuar në sektorin e agrikulturës, kanë nevojë për mjete teknike për ta bërë më të lehtë për stafin që të llogarisë aftësinë ripaguese të ndërmarrjeve dhe të analizojë shkallën e rrezikut. Institucionet financiare jo bankare kanë tendencë të jenë shumë më të fuqishme në kreditimin e këtij sektori sesa bankat. Agrikultura është sektori i tretë që përfiton nga kredidhënia që arrin 19,3% të fondeve, kundrejt tregëtisë 25,6% dhe kategorisë “Të tjera” 22,4%.

Tabela 3. Sektorët më të financuar nga IFBJ-të për vitin 2017

Tregetia dhe riparimi i automjeteve	25,60%
Bujqësia, gjuetia dhe silvikultura	19,30%
Të tjera	22,40%

Burimi: Banka e Shqiperise

Institucionet e mikrofinancës si pjesë e institucioneve financiare jo bankare zhvillojnë një aktivitet kredidhënës që ka tendencën në rritje, por që mbetet gjithësesi modest (rreth 1.35 Milion Lekë).

Tabela 4. Veprimtaria financiare (në mld Lek) 2017

Kredidhenie dhe mikrokrede	16.9
Qira financiare	6.56
Faktoring	0.74
Portofol bruto	24.2

Burimi: Banka e Shqipërisë

Por të marra së bashku me aktivitetin e kredidhënies, kreditimi kap një vlerë prej 70% të portofolit të kredive.




Figura 1. Portofoli i kredive të subjekteve financiare jobanka

Institucionet e mikrofinancës kanë aftësinë që t'i shërbejnë zonave rurale dhe kanë modele biznesi të orientuara drej një financimi frytshëm të bizneseve mikro. Kjo sepse përveç aspektit financiar, institucionet e mikrofinancës ofrojnë edhe asistencë teknike klientëve të tyre. Por nga ana tjetër siç thamë, ato institucione kanë fonde të kufizuara pasi nuk janë institucione që pranojnë depozita. Kapitali i tyre është kapitali i investuesve të vegjël, të donacioneve dhe të letrave me vlerë. Këto institucione kanë një përqindje të kredive të këqija relativisht të ulët rreth 12.5 % por fy institucionet kryesore kanë një përqindje të kredive të këqija nën 7%.

Kësisoj, programet që lehtësojnë bashkëpunimin midis bankave dhe institucioneve të mikrofinancës mund të çojnë në përmirësimin e aksesit financiar në sektorin e agrikulturës. Në veçanti, stafi i institucioneve mikrofinanciare ka njohuri për ciklin dhe kostot e prodhimit. Asistenca teknike për vetë ndërmarrjet në agrikulturë është gjithashtu shumë e nevojshme. Programet e hartuara për të inkurajuar dhe lehtësuar regjistrimin e fermave informale kanë potencial për të rritur furnizimin e përgjithshëm të kredisë bujqësore pasi që shumica e bankave nuk do të marrin në konsideratë huadhënien e ndërmarrjeve të paregjistruara. Trajnimi në menaxhimin e kontabilitetit dhe financat gjithashtu do të

bënte që fermat të kishim në shumë akses financimi prej bankave duke u dhënë huadhënësve më shumë besim në saktësinë e të dhënave financiare të përdorura për të analizuar biznesin.

Shoqëritë e kursim kreditit janë mjaft të pranishme në zonat rurale. Si shoqëri kooperativash ato ofrojnë kredi vetëm antarëve të tyre por depozitat e tyre kanë një tendencë në rritje. Falë ristrukturimit të sektorit dhe reformes ligjore të 2016-ës që vendosi kufij në dhënien e kredisë³ ato mundën të rrisnin nivelin e fitimeve dhe të zgjeroheshin. Gjithashtu kreditë e këqija në këtë sektor janë mjaft të ulëta rreth 4,8% në fund të 2017.Me prezencën e tyre të fortë në zonat rurale dhe njohuritë mbi sektorin e agrikulturës roli i tyre në financimin e sektorit duhet inkurajuar të forcohet më shumë në të ardhmen.

Mbështetja qeveritare skemat e garancive, donacionet

Qeveria ka ndërmarrë një sërë inisiativash në programe financiare nëpërmjet agjensisë AIDA (Albanian Investment Development Agency) agjensi nën vartësinë e Ministrisë së financës që nëpërmjet skemave mbështetëse dhe favorizuese të natyrës tatimore dhe të subvencioneve dhe skemave të hapura për kompanitë e huaja në bashkëpronësi me shtetasit shqiptarë, ka si objektiv zhvillimin e sektorit të agrikulturës. Megjithatë impakti i saj ka qënë i kufizuar pasi dhe programet e saj kanë qënë të vogla.

Financimi i SME-ve është lehtësuar nga programet e garantimit (guarantee schemes) në të gjithë rajonin megjithëse në vënde të ndryshme ka pasur masa të ndryshme suksesi. IFI-të, (International Financial Institutions) të tilla si USAID (United State Agency international development)dhe KfW ofrojnë garanci për portofolin, të cilat janë në kërkesë dhe kanë norma mesatare të shfrytëzimit të mirë. Ka patur dhe ka disa skema garancish në Shqipëri, si Fondin e Garancisë Shqiptare (2.5 milionë euro, në kuadër të Programit Italo-Shqiptar për Zhvillimin e SME-ve që nga viti 2009), Fondi për Garantimin e Kredive Rurale (4 milion Euro, mbështetur nga KfW), Marrëveshjet e USAID-it për Garantimin e Portofolit të Huasë me bankat tregtare dhe Fondin Kombëtar të Garancisë për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural (një program i ri qeveritar financimi në bashkëpunim me BERZH, i filluar në vitin 2015) dhe aktualisht, kemi Skemen Kombëtare të mbështetjes së Bujqësisë dhe Zhvillimin Rural, 2019. Programi i IPARD-it 2014-2020 për të cilin folëm më lart që ka një buxhet prej 71 Milion Euro nga Komunitetit Europian dhe 24 Milion Euro nga qeveria shqiptare për t'u investuar në zonat rurale deri më 2020.

The Rural Credit Guarantee Fund që operon që nga viti 2015 me qëllimin që të inkurajojë institucionet financiare të financiojnë fermerët dhe agrobiznesin. Fondi gjithashtu ofron edhe asistencë teknike institucioneve financiare që të rrisë aftësinë dhe dëshirën e tyre për të financuar zonat rurale.EBRD që është operative që nga 2016 që nëpërmjet një fondi prej 100 Milion Euro mbështet agrobiznesin shqiptar.

Çfarë i nevojitet sot mikrofinancës në sektorin e agrikulturës? Konkluzione

Zhvillimit i agrikulturës në shqipëri i nevojitet një bashkëpunim i gjërë dhe një koordinim i mirë midis instucioneve të huaja dhe vëndase, shtetërore dhe private, bankare dhe jo bankare duke patur parasysh kompleksitetin që paraqet ky sektor, karakteristikat dhe veçantitë e tij. Do t'i nevojiteshin edhe politika të koordinuara me vëndet e tjera të Ballkanit Perëndimor, me të cilat, ndan shumë aspekte të përbashkëta. Mikrofinanca e vetme nuk mund të ndikojë fuqishëm në zhvillimin e këtij sektori me gjithë karakteristikat e favorshme që ajo mbannë vetvete, si bashkëpunimi me institucionet e huaja nga të cilat janë formuar praktikatat më të mira, apo ekspertiza teknike që ajo ofron më së shumti.

Së pari, megjithëse mikrofinanca nuk mund të ndikojë ndjeshëm në uljen e informalitetit të bizneseve mund të jetë një zë më i fuqishëm brënda dhe jashtë vëndit si mbështetëse dhe këshilluese e politikave shtetërore dhe nëpërmjet vetëbesimit bazuar në cilësinë e aktivitetit të saj të kontribuojë për sigurimin e fondeve të tjera të investimit dhe për krijimin e shoqërive që ofrojnë fonde të kapitalit të vet.

Së dyti, ndërmarrjet që veprojnë në sektorin e agrikulturës kanë nevojë si për të patur më shumë akses financiar si edhe për asistencë teknike, por nevojat për asistencë teknike janë më të mëdha sidomos për ato ndërmarrje që operojnë në kushte të një rreziku të lartë. Institucionet e mikrofinancës, ndryshe nga bankat, kanë më shumë ekspertizë për t'u ofruar klientëve të tyre ndërsa bankat kanë burime financiare shume më të konsiderueshme se Institucionet e Mikrofinancës për t'i dedikuar agrikulturës. Si konkluzion, bashkëveprimi i bankave me institucionet e mikrokredisë në financime të përbashkëta do të ulte riskun e financimit të subjekteve me aktivitet bujqësor dhe do të rriste fonde e dedikuara në këtë fushë.

Së treti, do të nevojitej një bashkëveprim me programet shtetërore mbështesin zhvillimin e agrikulturës (si p.sh Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (AZHBR) dhe intitucioneve të mikrofinancës që kanë një shtrirje territoriale në të gjithë vëndin, dhe një njohje më të thellë të problematikave të klientëve të tyre me qëllim rritjen efikasitetit të këtyre programeve. Kjo do të çontë në përmirësimin e kushteve të biznesit, në ulje të riskut dhe për pasojë në rritjen e investimeve.

Së katërti, por jo nga rëndësia, sektori i mikro-kreditimit në agrikulturë duhet të njihet më në thellësi, nga ekspertet ekonomike dhe universitetet duke u orjentuar drej një qasjeje për zgjidhjen e problemeve (problem solving) Kjo duke mundësuar shkëmbimin e të dhënave periodike, kërkimeve shkencore, vizitave në terren, organizimin e sondazheve etj.

REFERENCAT

- Albania MSME Finance for Growth Assessment. World Bank Group 2018
- Banka e Shqipërisë. Vendim Nr. 2, datë 17.1.2013 Për Miratimin e Rregullores “Për Administrimin e Rrezikut në Veprimtarinë e Subjekteve Financiare Jobanka”

- Banka e Shqipërisë. Rregullore “Për administrimin e rrezikut në veprimtarinë e shoqërive të kursim kreditit dhe të Unioneve të tyre” Fletorja Zyrtare nr.196, datë 25 tetor 2016
- Chalmers, 2005;Wampfler and Lapenu, 2002; Zeller, 2003) në *What microfinance for agriculture in developing countries?* Document prepared by the French Microfinance Network Rural Finance Commission, 2007 <http://prospera-microfinance.org>
- (Chalmers, 2005;Wampfler and Lapenu, 2002; Zeller, 2003) në *What microfinance for agriculture in developing countries?* Document prepared by the French Microfinance Network Rural Finance Commission, 2007 <http://prospera-microfinance.org>
- Enterprise survey World Bank.2013.
- European Commission. JRC TECHNICAL REPORTS. *Analysis of the agricultural and rural development policies of the Western Balkans countries* 2016. <http://seerural.org>
- European Investment Bank Research Report. Albania. Assessment of financing needs of SMEs in the Western Balkans countries. 2016 (Hauser Peter, Dolgaya Tatyana, Revenko Sorin, Kortzenbusch Michael.)
- Inter-Sectorial Rural development Strategy of Albania ISARDA (2007-2013) <http://extwprlegs1.fao.org>
- (Stojadinović, Jovanović, Dašić, 2015). *The agriculture sector in Western Balkans: Some characteristics of development* www.researchgate.net
- World Economic Forum, The Global Competitiveness Report 2017-2018

APPENDIX

Tabela

Tabela 1. Të punësuarit sipas sektorëve

Tabela 2. Sektori i agrikulturës sipas madhësisë së ndërmarrjeve, ndërmarrjeve aktive dhe të reja në vite.

Tabela 3. Sektorët më të financuar nga IFBJ-të për vitin 2017

Tabela 4. Veprimtaria financiare (në mld Lek) 2017

Figura

Figura 1. Portofoli i kredive të subjekteve financiare jobanka

“E-PASURIA NË KUADËR TË SISTEMIT E-QEVERISJA, NË SEKTORIN PUBLIK NË KOSOVË”

Mr.Sc. Gazmend Morina Phd (c) 1, Prof.Dr.Armen Kadriu 2

¹International University of Struga , e-mail: gazmend_morina@hotmail.com

²International University of Struga , e-mail: a.kadriu@eust.edu.mk

ABSTRAKT

Qeverisja elektronike përfaqëson sistemet e Teknologjisë së Informacionit, përmes së cilës krijohen mundësi për të ofruar shërbime publike më të mira, më të shpejta dhe të disponueshme në kohë. Gjithashtu, përmirëson shërbimet, forcon llogaridhënien, rritë transparencën dhe përmirëson efikasitetin qeverisës.

Qeverisjes elektronike sjell përfitime të mëdha për shoqërinë kosovare. Përfitimet mund të jenë ekonomike dhe sociale, duke përfshirë modernizimin e administratës, arsimit, shëndetësisë, drejtësisë, sigurisë, zhvillimin e biznesit, zhvillimin e tregtisë, zhvillimin e bujqësisë, rritjen e buxhetit, rritjen e demokracisë, zhvillimin e kulturës, hulumtime shkencore, statistika të ndryshme, etj.

Në këtë punim e kemi trajtuar sistemin e-Pasuria në kuadër të sistemit e-Qeverisja në sektorin publik në Kosovë. Sistemi e-Qeverisja në sektorin publik në Kosovë, momentalisht e përfshinë aplikacionin e-Pasuria dhe e-Prokurimi. Ky sistem elektronik i qeverisjes ka qenë vazhdimisht insistim i Bashkimit Evropian për një transparencë të Qeverisë së Kosovës. Aplikacioni e-Pasuria fillimisht ka pasur shumë mangësi, mirëpo nga viti në vit është duke u zhvilluar dhe avancuar.

Në aspektin metodologjik të hulumtimit jemi bazuar në punën direkte që e bëjmë në këtë aplikacion, në legjislacionin e miratura nga Qeveria e Kosovës, si dhe në intervistat me Zyrtarët e Pasurive të disa institucione publike (organizata buxhetore) në Kosovë, lidhur me përdorimin dhe funksionalizimin e aplikacionit e-Pasuria.

Fjalët kyçe: Aplikacion, Qeverisje, Pasuri, Teknologji, Organizata

HYRJE

Në kontestin e pasurisë publike, kemi të bëjmë me ato asete me të cilat shteti i kryen funksionet e tij, si dhe me të cilat gjeneron të hyra, për mbushjen e buxhetit shtetëror, të tilla si investimet kapitale.

Një qasje e drejtë apo tjetër është e detyrueshme me ligj, që do të thotë se një ndërmarrje mund të përdorë burim ekonomik në diskrecionin e saj, dhe përdorimi i saj mund të përjashtohet apo të kufizohet nga një pronar.

Menaxhimi i pasurisë publike sidomos kohëve të fundit do të ishte thuajse i pamundur apo shumë i vështirë pa përdorimin e teknologjisë informative. Andaj teknologjia informative që përdoret në sektorin publik në Kosovë, për menaxhimin e pasurisë publike, është në nivel të mirë, edhe pse ka nevojë për përmirësime dhe avancime.

Deri në vitin 2015, institucionet publike kanë përdorur softuer të ndryshëm, secila sipas specifikave të tyre për menaxhimin e pasurisë, depos, logjistikës dhe kërkesave të personelit për pasuri (inventar, material shpenzues, pasuri kapitale etj).

Nga viti 2015, qeveria e Kosovës, respektivisht Ministria e Administratës Publike, ka obliguar të gjitha organizatat buxhetore që ta përdorin softuerin e-Pasuria, të kontraktuar nga ana e Ministrisë, për menaxhimin e pasurisë, depos dhe logjistikës.

Aplikacioni e-Pasuria, luan një rol mjaft të rëndësishëm në menaxhimin e pasurisë me vlerë nën 1,000.00 €, në organizatat e sektorit publik në Kosovë, edhe pse shumica e organizatave buxhetore e përdorin sistemin e e-Pasurisë edhe për edhe për pasuritë kapitale apo me vlerë mbi 1,000.00 €, në mënyrë që tërë pasurinë ta kenë në një vend për ta menaxhuar më mirë.

E-Pasuria

Sistemi i Menaxhimit të Pasurisë në kuadër të E-Qeverisjes është një projekt i realizuar nga DataProgNet për Ministrinë e Administratës Publike. Projekti është implementuar në të gjitha Ministrinë, Komunitet dhe Agjencitë. Sistemi i Menaxhimit të Pasurisë përbëhet prej ueb aplikacionit dhe bazës së të dhënave të vendosur në serverët qeverisës, si dhe prej pajisjeve përcjellëse të cilat janë të shpërndara nëpër institucione. Në aplikacion mund të qasemi duke vizituar linkun:

<https://epasuria.rks-gov.net>

Deri më tani në Sistemin e Menaxhimit të Pasurisë janë të regjistruar një numër i madh i përdoruesve prej institucioneve të ndryshme, me role të ndryshme dhe ky numër vazhdimisht rritet me përdorimin e aplikacionit. Përmes sistemi të menaxhimit të pasurisë menaxhohet me të gjitha hyrjet/daljet e aseteve dhe të materialit shpenzues në institucion, kryhet barkodimi i pajisjeve, përcillet amortizimi i pajisjeve, gjendja e stokut, si dhe kërkesa online për pajisje dhe për material shpenzues prej secilit punëtor të institucionit përkatës .



Figure 1. Ndërlidhja e aplikacionit me pajisje si dhe ndërlidhja e aktoreve kryesor ne aplikacion⁴
Aplikacioni përkrah transferimet e brendshme të aseteve si dhe transferimet ndërinstitucionale të tyre. Po ashtu përmes aplikacionit menaxhohen kërkesat e punëtorëve për pajisje dhe për material shpenzues, duke e përcjell gjendjen e kërkesës prej momentit të bërjes së saj, miratimit të saj prej niveleve të tjera më të larta e deri te ekzekutimi i saj.

Qasja në aplikacion

Për tu qasur në aplikacion, përdoruesi duhet të ketë lidhje interneti, dhe ndonjërin prej shfletuesve të internetit të instaluar në kompjuterin e tij. Përmes shfletuesit përdoruesi e shkruan adresën:

<https://epasuria.rks-gov.net>

dhe paraqitet figura e cila shihet më poshtë:



Figure 2. Dritarja hyrëse në sistemin e-Pasuria

Kjo formë paraqitet çdo herë kur të hapet programi, dhe përdoruesi identifikohet duke i dhënë emrin e përdoruesit të tij, zakonisht **emri.mbiemri** si dhe fjalëkalimin përkatës. Nga figura shihet qartë se forma është e thjeshtë dhe për kyçe në programin e-Pasuria duhet që të plotësohen fushat

- **Përdoruesi** – në këtë fushë shënohet përdoruesi me të cilin dëshirojmë të kyçemi,
- **Fjalëkalimi** – shënohet fjalëkalimi për përdoruesin përkatës.
Para se të implementohet plani i marketingut, kompania duhet të përcaktojë metodat me të cilat do të masë progresin në arritjen e qëllimeve të përcaktuara dhe është e nevojshme që të caktohen personat përgjegjës për këto matje. Për vetë procesin e menaxhimit të marketingut, është jashtëzakonisht e rëndësishme që të monitorohen rezultatet e zbatimit të planit për të qenë në gjendje, në afat të shkurtër, të bëjnë ndryshimet e nevojshme të planit. Monitorimi i rezultateve mund të bëhet

nga burimet e brendshme dhe me mbledhjen e të dhënave të jashtme përmes hulumtimit. Duhet të ndërmerren një sërë masash të ndryshme të brendshme dhe të jashtme për të vlerësuar progresin dhe për të propozuar modifikimet e nevojshme

6. Projektionet e rezultateve dhe buxhetit

Parashikimet financiare përfshijnë parashikimin e shitjeve, parashikimin e kostos dhe analizën e pikës së mbulimit. Financat luajnë një rol të rëndësishëm në formimin e një plani të marketingut, sepse ata përcaktojnë, ndër të tjera, buxhetin e marketingut, parashikimet e shitjeve që planifikojnë kostot, oraret dhe veprimet që lidhen me çdo program veprimi.

Buxheti i marketingut është shumë i rëndësishëm pasi duhet të përcaktohen dhe të zbatohen me shumë përpikmëri, pasi shpenzimet e marketingut në vehte përfshijnë shpenzime të larta. Krijimi i një buxheti për marketing është një ndër aspektet më të rëndësishme në të bërit biznes. Parashikimet financiare përfshijnë parashikimin e shitjeve, parashikimin e kostos dhe analizën e pikës së mbulimit. Buxheti duhet të tregojë kostot dhe fitimet e veprimeve të marketingut. Buxheti është bërë për të ndihmuar në kontrollimin e kostove të marketingut dhe për të vlerësuar përdorimin e domosdoshëm të burimeve për marketing. Pa një buxhet të përcaktuar mirë mund të reklamohen vetëm pjesërisht aktivitetet e duhura. Buxheti i marketingut mund të jetë shumë rigoroz ose mund të jetë shumë më fleksibil, varësisht nga eksperiencia e mëparshme nga kjo fushë.

7. Përfundimi

Plotësimi cilësor i nevojave të konsumatorëve është e mundur vetëm me intensifikimin e aplikimit të aktivitetit të marketingut. Për arritjen e këtij qëllimi janë të nevojshme botëkuptime të reja dhe reforma në marketing. Në reformat që pasojnë është e pamundur realizimi i tyre nëse nuk mendohen dhe implementohen me kujdes aktivitetet e marketingut.

Cilësia, dizajni dhe çmimi janë karakteristikat kryesore të produkteve dhe shërbimeve të prodhuesve dhe tregtarëve të mobilieve. Shfrytëzuesit e produkteve dhe shërbimeve presin shërbime dhe produkte cilësore. Mund të themi se shërbimi apo produkti është cilësor nëse i plotëson pritshmërinë e klientëve. Po ashtu cilësia kontrollohet nëpërmjet auditimit të ekipit punues, komunikimit të mirë dhe transparencës me klientët e kompanisë. Me qëllimet e saja, detyrave dhe implementimin e marketingut rritet besueshmëria për produktet aktuale. Tejkalimi i problemeve të shumta që rrjedhin nga organizimi i keq, mungesa e lëndëve të para dhe mjeteve financiare, standardi i ulët i shërbimit dhe prezenca gjithnjë më e madhe e konkurrencës, mundet të arrihet me orientim kah marketingu.

Rekomandimet

- Plani i marketingut duhet të udhëzon hap pas hapi për suksesin e kompanisë,
- Plani i biznesit duhet të jetë Kushtetuta e biznesit:
- Në planin e marketingut duhet të përfshihen shumë njerëz.
- Punonjësit e kompanisë të japin më shumë informacione të vlefshëm dhe realiste,
- Në plan më afatgjatë, nëse nuk planifikohet, do të dështohet – dhe një plan i keq është më mirë se pa plan fare.

Literatura e shfrytëzuar

- Ali Jakupi. Bazat e Marketingut. Prishtinë, Kosovë 2000,
- Baker, Michael; The Strategic Marketing Plan Audit; 2008.
- Burton F. Boëman & Frederick E. McCormick; Market Segmentation and Marketing Mixes; 1961.
- Drucker, P. The Practice of Management, Harper & Row, New York, 1954.
- Elmazi L.(Billa), Strategjia Marketing, Tiranë, 2010.
- Elmazi, Liliana, 2002. Strategjia Marketing – Strategjitë për rritjen e vlerës konsumatore dhe rentabilitetit. Tiranë, Shqipëri: Shtëpia Botuese e Librit Universitar.
- Freedman, Mike & Tregoe, B. Benjamin, 2003. The Art and Discipline of Strategic Leadership. New York, USA: McGraw-Hill
- https://ëëë.brainyquote.com/quotes/Dëight_d_Eisenhoëer_164720
- Kotler, Ph.. Marketing Management, Millennium Edition. 12th ed. Boston MA, USA: Pearson Custom Publishing, 2002.
- Kume.V.,Manaxhimi strategjik, Pegi, Tiranë 1999.
- Nail Reshidi, Menaxhimi i Strategjive të Marketingut, Prishtinë, 2012.
- Philip Kotler - Marketing Management, 1967.
- Philip Kotler “Marketing” Tiranë 2005.
- Renko, N. Strategjije Marketinga, Naklada Ljevak, Zagreb, Kroaci, 2005, fq.11
- S. Baohong Sun, Jinhong Xie dhe H. Henry Cao; Strategjia e Produkteve për Inovatorët në Tregjet me Efektet e Rrjetit;Shkenca e Marketingut, Vol. 23, Nr. 2; Pranvera 2004;
- S. Baohong Sun, Jinhong Xie dhe H. Henry Cao; Strategjia e Produkteve për Inovatorët në Tregjet me Efektet e Rrjetit;Shkenca e Marketingut, Vol. 23, Nr. 2; Pranvera 2004;
- Stanley F. Slater dhe Eric M. Olson; Kontributi i Marketingut në Zbatimin e Strategjisë së Biznesit: Një Analizë Empirike; Strategic Management Journal, Vol. 22, Nr. 11; Nëntor 2001;

- Sunny Crouch, Mattheë Housden; Marketing research for managers; The Marketing Series; Chartered Institute of Marketing; 2003; p. 19
- Susan Ward; Development International Marketing Strategy; 2009; p 101;

NDIKIMI I INTEGRIMIT FINANCIAR NË RITJEN EKONOMIKE “RAST VENDET NË TRANZICION “

PhD. Candidate Miranda Rahmani.

International University of Sraga E-mail: miranda.rahmani7@gmail.com

PhD.Candidate Elmedina Shuajibi

International University of Sraga E-mail: e.shuajibi@eust.edu.mk

Mr.Sc. Albulena Rahmani

rahmani.albulena@outlook.com

Mr.Sc. Hasime Durmishi

International University of Sraga E-mail: h.durmishi11@eust.edu.mk

ABSTRAKT

Qëllimi i këtij hulumtimi shkencorë është që të studjojë efektin e integritit financiar në rritjen ekonomike, rast vendet në tranzicion, ku përfshim analizën e nëntë vendeve për vitin (2000 – 2013) . Hulumtimi empirik është kryer duke përdorur tekniken e njohur si Panel data si dhe disa tregues të integritit financiar më të përdorur në literaturën shkencore siç janë: Kapitalizimi i tregut, Investime e huaja direkte (IHD), Detyrimet e borxhit. Gjithashtu, bazuar në literaturën e mëhershme, ne kemi përdorur edhe variabla të tjera shpjeguese, të tilla si PPB-ja për frymë, Kredia e brendshme dhe Norma e inflacionit.

Nga rezultatet ne arritëm në përfundim se midis integritit financiar dhe rritjes ekonomike ekziston një lidhje pozitive, pra integriti financiar do të rrisë rritjen ekonomike dhe ne gjithashtu do të mbështesim hipotezën tonë të parë dhe do të hudhim hipotezën tonë të dytë. Në këtë studim empirik ne gjithashtu gjetëm se niveli fillestar i PBB-së për frymë ka efekte pozitive në rritjen për frymë, poashtu edhe Ivestimet e Huaja Direkte dhe Kapitalizimi i tregut kanë tendenca më të mëdha për të krijuar rritje ekonomike, kurse nga ana tjetër inflacioni dhe detyrimet e borxhit kanë tendenca që të krijojnë ulje ekonomike.

***Fjalë kyçe:** Vendet në tranzicion, Integriti financiar, Rritja ekonomike, Panel data, PPB-ja për frymë, Investimet e huaja direkte, Inflacioni, Kapitalizimi i tregut, Detyrimet e borxhit, Kredia e brendshme.*

Hyrje

Rritja ekonomike vazhdon të jetë një nga çështjet më të debatuar deri sot dhe ne mund të themi se një ndër arsytet se përse hulumtimet empirike mbi integrimet financiare dhe rritjet mbetet jobindëse deri më sot, është se ekzistojnë qajse të ndryshme dhe teknikat ekonometrike që e bëjnë atë të vështirë për të arritur në rezultate korekte.

Shpeshherë parashtrahet pyetja se në ç'mënyrë integrimet financiare do të ndikojnë në rritjen ekonomike, këto pyetje ngrejnë çështje të rëndësishme dhe për këtë arsye paraqiten dilema si nga perspektiva teorike poashtu edhe praktike dhe për këtë arsye numri i kontributeve dhe debateve është i lartë dhe në rritje .

Gjatë hulumtimit tim, do të fokusohem në identifikimin e efekteve të integrimit financiar në rritjen ekonomike të vendeve në tranzicion, si dhe duke u bazuar në të dhënat vjetore nga viti 2000 deri në vitin 2013, me anë të regresionit me variabla, do të mundohem që të konstatoj se si integrimi financiar do të ndikojë në rritjen ekonomike dhe nga analiza do të arrijë në përfundim nëse duhet që të konfirmoj ose të hedh poshtë vlefshmërinë e hipotezës së dhënë, prandaj parashtrojmë pyetjet hulumtuese në lidhje me integrimin financiar dhe rritjen ekonomike.

H1/1: Integrimet financiare kanë ndikim pozitiv në rritjen ekonomike në vendet në

tranzicion

H2/2: Integrimet financiare kanë ndikim negative në rritjen ekonomike në vendet në tranzicion

1. Integrimi financiar në vendet në tranzicion.

1.1. Evoluimi i integrimit financiar

Integrimi financiar në Evropë ka filluar disa dekada më parë që nga viti 1957. Miratimi i monedhës së përbashkët në vitin 1999 ishte një shtysë e madhe për integrim të mëtejshëm financiar në Bashkimin Evropian (Liebscher et al., 2006).

Me të gjitha provat teorike dhe empirike, çështja e euros padyshim ofroi një bazë të fortë motivimi për procedurën, sepse një monedhë e vetme është një komponent i rëndësishëm i një sistemi të përbashkët financiar dhe një promotor i fuqishëm i integrimit financiar (Jikang dhe Xinhui, 2004). Futja e euros ishte një katalizator i fuqishëm për krijimin e tregjeve të integruara financiare duke hequr një nga pengesat më të rëndësishme në tregtimin ndërkufitar të shërbimeve financiare ⁹

⁹ Theory of financial integration and achievements in the European Union

Përkufizim i integritit të tregut financiar përmban tre karakteristika të rëndësishme. Së pari, ajo është e pavarur nga strukturat financiare brenda rajoneve, struktura financiare përfshinë të gjitha ndërmjetësit financiarë, institucionet apo tregjet dhe se si ato lidhen me njëri-tjetrin dhe respekti për rrjedhën e fondeve nga familjet, qeveritë dhe korporatat.

Së dyti, fërkime në procesin e ndërmjetësimit - dmth qasjes në investimin e kapitalit institucioneve apo tregjet mund të vazhdojnë pasi integrimi financiar është i përfunduar.

Përkufizimi i integritit të tregut financiar është i lidhur ngushtë me ligjin e një çmim, ligji i një çmim thotë se nëse aktivet kanë rreziqe të njëjta dhe kthim të njëjt, atëherë ata duhet të kenë çmim të njëjtë pavarësisht se ku ata janë transparente (Jappelli dhe Pagano, 2008) .

Sipas Bale et al.(2004) apo Komisioni Ekonomik për Afrkën (2008) ka marë në konsiderat tri përfitme nga integrimet financiare edhe atë: diversifikimi i riskut pra krijohen më shumë mundësi për ndarjen e riskut, shpërndarja më e mirë e kapitalit pra më tepër potencial për investim dhe disa studiuës e marrin në konsiderat edhe zhvillimin financiar të dobishëm.

Komisioni Ekonomik për Afrikën (2008) konfirmojnë se integrimi financiar kërkon eliminimin e disa ose të të gjitha kufizimet në institucionet e huaja financiare nga disa (ose të gjitha) vendeve.

Ho (2009) tregon se integrimi i tregut financiar do të mund të vazhdojë me zbatimin e një traktati formal ndërkombëtar. Kjo i referohet dy elementeve të ndryshme, njëra është dispozita për përgjigjet e bashkërenduara ose bashkëpunuese të politikave në trazirat financiare, tjetra është eliminimi i kufizimeve në operacionet financiare ndërkufitare nga ana e ekonomive anëtare duke përfshirë harmonizimin e rregullave të sistemeve financiare . Të dy elemente janë të nevojshme për të të arritur bashkimin e plotë të tregjeve financiare rajonale, si dhe taksat dhe rregulloret në mes ekonomive anëtare.

Politika, tregtia dhe integrimi financiar kanë qenë tri shtylla përcaktuese të ”zhvillimit modern” në dy dekadat e fundit në vendet në tranzicion. Deri në kohët e fundit ky model u konsiderua një sukses spekulator.

Integrimi financiar çon në rritjen e disponueshmërisë së mundësive për investime ndërmjetësuese, dhe si pasojë në rritje të lartë ekonomike. Autorët gjithashtu argumentojnë se procesi i integritit do të rrit konkurrencën brenda rajoneve më pak të zhvilluara dhe në këtë mënyrë për të përmirësuar efikasitetin e tyre sistemet financiare, për shembull, do të reduktojnë kostot e ndërmjetësimit.

Integrimi financiar mund të ndihmojë që vendet e kapitalit të varfër të diversifikohet më larg nga bazat e tyre të prodhimit që kryesisht varren nga aktivitete bujqësore ose nga burimeve natyrore; ky diversifikim duhet të zvogëlojë rrezikshmërinë makroekonomik (Kose et al., 2006)¹⁰

1.2 Sektorin financiar në vendeve në tranzicion.

¹⁰ Financial integration, Investment, and Economic Growth-Motritz Schularick and Thomas M. Steger

Sektori financiar ka përjetuar zgjerim të rëndësishëm së bashku me përshpejtimin e globalizimit financiar në vitet e fundit dhe ka kuptim të rëndësishëm pozitivë dhe negativë për të gjitha ekonomitë. Ka mendime të ndryshme se si sektori financiar do të nxisë rritje ekonomike Schumpeter (1911) ishte i pari i cili theksoi rolin e bankave në lehtësimin e risive teknologjike dhe rritjeve. Sipas tij shërbime financiare kontribuojnë në rritjen jo domosdoshmërisht ndikojnë normat e kursimit, por duke siguruar një shpërndarje të përshtatshme të kursimit.

Ekonomitë në tranzicion janë banka të dominuara, ku sistemi bankar universal mbizotëron. Në fillim të procesit të tranzicionit, vëzhguesit argumentuan nëse sistemi financiar bankar duhet të ndjekë një sistem Evropian, bankën universale – si një model dominues, apo një model amerikan në të cilën dominojnë tregjet e kapitalit.

1.3 Sektori Bankar në vendet në tranzicion

Sistemi bankar është ai që parandalon informacionet asimetrike ndërmjet huadhënësit dhe huamarrësit, redukton kostot e transaksionit, monitoron menaxherët dhe siguron burime financiare në një mjedis të pasigurt ekonomik.

Ndarja e bankave komerciale nga bankat qendrore në vendet në tranzicion si dhe heqjen e kufizimeve mbi konvertimet e brendshme të parave, liberalizimin e normave të interesit, privatizimin e bankave shtetërore, hyrjen e huamarrësve në ndërmarrje si dhe hyrjen e bankave të reja private ka ndodhur në konsensusin e Uashingtonit


Përveç anëve të mira dhe ndikimit pozitivë të sistemit financiar hasim edhe vështërsi dhe problem, një ndër to llogarisim mungesat e mekanizmave të zbatimit dhe udhëzimeve adekuate kolaterale të krijuara në një mjedis ku nuk ka pasur kufizime të buta buxhetore për firmat shtetërore, e ndjekur nga sjellja e rrezikut moral nga ana e menaxherëve.

1.4. Rritja mesatare vjetore e PBB-së për frymë tek vendet në tranzicion

Përmes të dhënave që i kemi poseduar nga Banka Botërore, Fondi Monetar Ndërkombëtar kemi arritur të bëjmë analizën empirike për llogaritjen e regresionit midis viteve 2000-2013 tek vendet në tranzicion¹¹ dhe në mënyrë figurative do të paraqesim evulimmin e “rritjes ekonomike” ku si indikator do të marrim PBB-në për banorë në vendet në tranzicion, flukset hyrëse të investimeve të huaja direkte, integrimet financiare, kapitalizimi i tregut, detyrimet e borxhit, inflacionin dhe kredia e brendshme.

Figura.1. Rritja mesatare vjetore e PBB-së për frymë tek vendet në tranzicion (2000-2013)

¹¹ Për më tepër vendet e përfshira në tranzicion mund ti shihni në Appendix A



Burimi: Të kalkuluar nga vet autori

GDP është masa kryesore e llogarive kombëtare, e cila përmbledh pozitën ekonomike të një vendi (ose rajonit). Një analizë e GDP-së për kokë banori bëhet për krahasime midis vendeve të ndryshme. GDP-ja për frymë është tregues i gjerë ekonomik dhe i standardeve të jetesës. Nga figura mund të shohim se rritja mesatare më e lartë e Produktit të Brendshëm Bruto për kokë banori, përgjat periudhës kohore prej 2000-2013 ka qenë në Lituania me 5.83% kurse më pas pason Shqipëria 5.31% ,Bullgaria me 4.69%,Polonia me 3.32%. Kjo ka të bëjë me nivelin më të lartë të Produktit të Brendshëm Bruto për banor kurse në nivel më të ulët të rritjes mesatare përfshihet Irlanda me 1.39% kurse më pas pason Islanda me një rritje mesatare prej 1.69%. Tendenca e rritjes së GDP-së ka vazhduar deri në vitin 2008, kur ndodhi kriza e pastaj kishte një rënie dhe ngecje, e cila ishte shkaktuar kryesisht nga recesioni në mbarë botën. Rritja e GDP-së u ngadalësua ndjeshëm në vitin 2008 dhe GDP u kontraktua në mënyrë të konsiderueshme në vitin 2009 si rezultat i krizës globale financiare dhe ekonomike. Në vitin 2010 kishte një rikthim në nivelin e GDP-së dhe ky zhvillim ka vazhduar megjithëse me një ritëm të ngadaltë në mënyrë progresive në 2011, 2012 dhe 2013.

Tabela.1. GDP për frymë në vendet në tranzicion

GDP për capita në vendet në tranzicion				
Vendet	2010	2011	2012	2013
Shqipëri	4.226	2.840	1.578	1.235
Maqedoni	3.182	2.169	-0.618	2.762
Bullgari	0.715	2.570	0.061	1.428
Hungari	0.904	2.028	-1.093	2.3987

Sërbi	0.989	2.205	-0.533	3.072
Lituani	3.793	8.467	5.237	4.597
Islanda	-3.449	1.677	0.645	2.917
Irlanda	1.479	-0.403	-1.320	0.848
Polanda	3.903	4.960	1.606	1.452

Burimi: IMF's IFS - via The World Bank¹²

Nga tabela shohim se Shqipëria në vitin 2010 ka pasur GDP për frymë më të madhe ne krahasim me vitet tjera edhe atë me 4.2% kurse nivel më të ulët të GDP-së ka pasur në vitin 2013 prej 1.2%

Maqedonia në vitin 2012 ka pasur GDP për frymë më të ulë edhe atë prej -0.6% kurse në vitin 2010 ka pasur GDP për frymë më të madhe prej 3.1%. Hungaria nivel më të lartë të GDP-së ka pasur në vitin 2013 me 2.3% kurse nivel më të ulët ka pasur në vitin 2012 me -1.9%.

Bullgaria që nga viti 2010 e derri në vitin 2013 ka pasur një luhatje të GDP për frymë, GDP më të lartë e ka arritur në vitin 2011 prej 2.5% dhe GDP më të vogël ka pasur në vitin 2012 prej 0.06%. Sërbia nivel më të lartë të GDP-së ka pasur në vitin 2013 edhe atë me 3% kuse nivel më të ulët ka pasur në vitin 2012 prej -0.5%. Lituania në vitin 2011 ka arritur një nivel më të lartë të GDP-së prej 8.4% kurse nivel më të ulët ka pasur në vitin 2010 edhe atë me 3.7%. Shteti i Islandës rritje më të madhe të GDP-së ka pasur në vitin 2013 me 2.9% kurse nivel më të ulët ka pasur në vitin 2010 prej -3.4%.


Irlanda nivel më të lartë të GDP-së ka pasur në vitin 2010 prej 1.4% kurse nivel më të ulët ka pasur në vitin 2011 prej -0.4% dhe gjithashtu në vitin 2012 ka pasur nivel të ulë të GDP-së prej -1.3%, kurse më pas në vitin 2011 shohim rritje të PPB-së për frymë. Islanda në vitin 2010 ka pasur nivel më të ulët të GDP-së edhe atë -3.4% dhe që nga viti 2011 e derri më vitin 2013 ka pasur

¹² Banka Botërore, GDP per capita growth (annual %), qershor 2015, <http://databank.worldbank.org>

një rritje të vazhdueshme të GDP-së ,nivel më të lartë të GDP-së ka pasur në vitin 2013 prej 2.9%. Polanda në vitin 2011 ka pasur nivel më të lartë të GDP-së me 4.9% dhe pastaj kjo rritje ka filluar që të ulet vazhdimisht derri në vitin 2013 ku kemi një ulje të GDP-së prej 1.4%.

1.5.Integrimi financiar tek vendet në tranzicion

Figura 2. Integrimet financiare të vendeve në tranzicion



Burimi: Llogaritjet nëpërmjet programit STATA të kalkuluar nga vet autori


Në figurën 2, kemi paraqitur integrimet financiare gjatë viteve 2000 deri në 2013. Nga këtu shihet se ka pasur ndryshime, integrimet financiare duke kaluar nga viti në vit dhe gjithashtu ka pasur ndryshime të dukshme nëpërmjet vendeve. Shohim Irlandë si një vend që nga viti 2000 e deri më vitin 2013 ka pasur një rritje të konsiderueshme të integritimit financiar gjithashtu edhe Islanda nga viti 2009 e deri në vitin 2013 shikojmë një rritje të madhe. Mirëpo vendet tjera si Shqipëri, Bullgaria, Maqedonia, Hungaria, Lituania, Sërbia nuk kanë treguar ndonjë rritje.

1.6.Investimet e Huaja Direkte tek vendet në tranzicion

Disa studime japin rezultatin që flukset hyrëse të IHD, të cilat ndoshta do të mund të stimulohen nga një sistem i hapur financiar, ato janë të lidhura pozitivisht me rritjen ekonomike kur vendet janë mjaft të pasura, të arsimuara apo financiarisht të zhvilluara (Blomstrom et al. 1994). IHD-të luajnë një rol vendimtar në kontestin e rritjes së produktivitetit të vendeve pritëse kompanitë e këtyre vendeve kanë mundësi të eksplorojnë tregje të reja, të huaja dhe në këtë mënyrë të gjenerojnë më shumë të ardhura dhe fitime.

Fluksi i investimeve të huaja direkte (IHD) është një faktor shumë i rëndësishëm për rritjen ekonomike, veçanërisht në ekonomitë e vogla dhe të pazhvilluara. Ato janë një burim shumë i rëndësishëm i të ardhurave, punësimit, zhvillimit teknologjik dhe modernizimit.

Figura3: Investimet e huaja direkte nga viti (2000-2013)



Burimi: Llogaritjet nëpërmjet programit STATA

Nga përlllogaritja në stata shohim se Investime të huaja direkte nga viti 2000 e derri në vitin 2013 më tepër ka pasur në Irlandë, Bullgari më pas pëson Hungaria

Investimet e huaja direkte me nivel më të ulët nga viti 2000 e derri në vitin 2013 ka pasur në Lituaninë dhe në Polonë.

Tabela2: Investimet e huaja direkte (2000-2013)

Vitet	Shqipëri	Bullgari	Maqedoni	Hungari	Sërbi	Lituanë	Irlandë	Islandë	Polonë
2008	9.63	18.83	6.17	47.69	8.23	3.98	8.46	-1.25	2.73
2009	11.15	7.52	2.76	-2.28	6.87	0.04	22.87	-2.97	3.18
2010	9.13	2.45	3.2	-16.07	4.29	2.33	17.06	-0.7	3.83
2011	8.14	3.65	4.83	7.49	10.6	3.53	9.83	0.93	3.49
2012	7.46	3.31	3.46	8.34	3.13	1.34	18.13	1.68	1.47

2013	9.8	3.56	3.72	-2.8	4.52	1.52	20.88	3.07	0.15
-------------	-----	------	------	------	------	------	-------	------	------

Burimi: IMF's IFS - via The World Bank¹³

Nga tabela shohim se gjatë krizës globale ekonomike janë prekur shumica e vendeve. Nën ndikimin e krizës ekonomike botërore, shumica e vendeve të Evropës kanë regjistruar rënie të IHD pas viteve 2007-2008 edhe atë rrënje drastike ka patur në Hungari nga 47.6% derri më -2.28% dhe në vitin 2010 një rrënie prej -16.07% pashtu pason edhe Islanda, Bullgaria Lituani, ku humbën disa miliona dollar si të hyra vjetore. Në Shqipëri vitet e fundit investimet e huaja direkte janë rritur në mënyrë të ndjeshme. Një ndër vendet më pak të prekura nga IHD-ja është Islanda me një rritje të ngadalshme të IHD-së. Megjithatë në vitin 2013 shohim një rritje të konsiderueshme të IHD-ve në pothuajse në të gjithë vendet në tranzicion. IHD më të lartë në vitin 2013 kemi në Irlandë me 20.88% kurse IHD më të ulta në këtë vit kemi në Hungari me -2.8%


1.7. Kapitalizimi i tregut

Kapitalizimi i tregut i cili në vete përfshin çmimin e aksioneve herë numri i aksioneve në qarkullim. Kapitalizimin e tregut ndryshe e njohim edhe si vlera e tregut.

Kalemli-Ozcan dhe Manganelli (2008) tregojnë se duke hapur qasje në tregjet e huaja, integrimi financiar do të japë agjentit mundësitë për një gamë të gjerë të burimeve të financimit dhe investimet dhe lejon krijimin e tregjeve më të thella. Kjo lejon grumbullimin dhe përpunimin e më shumë informata në mënyrë më efikase, dhe kapitalit të ndahen në një mënyrë më efikase.

Figura .4.: Detyrimet e kapitalit në % të PPB-së

¹³, <http://databank.worldbank.org>




Burimi: Të kalkuluar nga vet autori

Shkalla e detyrimeve të kapitalit të PBB-së është një tregues i madhësisë së sektorit financiar. Përqindje më të larta të këtij treguesi vërehen në Poland (100% në tërë vitet) të PBB-së, gjithashtu edhe Irlanda ka pasur një rritje të konsiderueshme ku nga 60% deri me vitin e fundit ka arritur një mesatare mbi 90% të PBB-së kurse nga ana tjetër Maqedonia ka shënuar një rënie të këtij raporti, ku tani ka një përqindje më të ulët në krahasim me vendet tjera në tranzicion. Bullgaria poashtu ka shënuar rënien, shtetet e tjera si Islanda, Lituania, Sërbia, Hungaria dhe Shqipëria nga një mesatare prej 30% kanë arritur në një mesatare prej 20%.

1.8. Detyrimet e borxhit

Figura .5. Detyrimet e borxhit në % të GDP-së




Burimi: Të kalkuluar nga vet autori

Përqindje më të lartë të këtij treguesi vërejmë në Poloni (100%) në tërë vitin. Gjithashtu edhe Irlanda ka pasur një rritje të konsiderueshme ku nga 75% deri në vitin e fundit ka arritur në mbi 95%. Kurse nga ana tjetër kemi Maqedonin e cila ka shënuar rënie në vazhdimësi të këtij raporti dhe gjithashtu ka një përqindje më të ulët në krahasim me vendet tjera në tranzicion. Shtetet e tjera si Islanda, Lituania, Hungaria, Sërbia, Shqipëria, Bullgaria në vitin 2000 kanë pasur një rritje deri më 13% kurse më pas kjo rritje ka filluar që vazhdimisht të bjer për vite me radhë dhe në vitin 2013 përsëri shohim një rritje të vogël.

1.9. Inflacioni tek vendet në tranzicion

Figura 6: Norma e inflacionit nëpër vite




Burimi: Të kalkuluar nga vet autori

Duke shikuar grafkonin ne arrim në konkluzion se në fillim rritje më të madhe dhe tluhatshme të inflaconit kemi në Sërbi edhe atë në vitin 2000 me një nivel të lartë të inflacionit dhe më pas kjo rritje ka filluar që të zvogohet nga viti në vit.

Nga grafikoni ne mund të shohim se në vitin 2009 kemi ulje drastike të normave të inflacionit që kanë filluar që të ulen në të gjithë vendet tjera, gjithashtu shohim se këto vende kanë pasur një normë të qëndrueshme të inflacionit që nga viti 2010 e deri në vitin 2013.

Figura 7. Rritja mesatare e normës së inflacionit



Burimi: Të kalkuluar nga vet autori

Rritje më të lartë të normës së inflacionit kemi në Sërbi me një mesatare prej 20.9% kurse më pas pason Islanda me 5.7%, Bullgaria 5.8%, Sërbia me 4.33% dhe Hungaria 5.5%. Nivel më të ulët ka Irlanda, Shqipëria, Lituania dhe Maqedonia.

Tabela 3: Inflacioni në vendet në tranzicion

Burimi: IMF's IFS - via The World Bank¹⁴

¹⁴ , <http://databank.worldbank.org>

2008	3.35	8.33	12.34	6.06	12.41	10.92	12.67	4.05	4.34
2009	2.28	-0.73	2.75	4.20	8.11	4.43	12.00	-4.47	3.82
2010	3.55	1.50	2.43	4.88	6.14	1.33	5.39	-0.94	2.70
2011	3.45	3.90	4.21	3.92	11.13	4.13	3.99	2.57	4.25
2012	2.03	3.31	2.95	5.66	7.33	3.08	5.19	1.69	3.55
2013	1.93	2.78	0.89	1.72	7.69	1.04	3.88	0.50	1.03

Nga tabela ne shohim gjithashtu se Shqipëria normë më të lartë të inflacionit ka pasur në vitin 2010 edhe atë me 3.5% kurse nivel më të ulët të inflacionit ka pasur në vitin 2013 prej 1.9%. Maqedonia në vitin 2008 ka pasur nivel më të lartë të inflacionit 8.3% kurse në vitin 2009 ka pasur nivel më të ulët të inflacionit. Bullgarian nivel më të lartë të inflacionit ka pasur në vitin 2008 prej 12.3% kurse nivel më të ulët të inflacionit ka pasur në vitin 2010 2.4%. Hungaria nivel më të lartë të inflacionit ka pasur në vitin 2008 edhe atë me 6% kurse nivel më të ulët ka pasur në vitin 2013 me 1.7%. Sërbia nivel më të lartë të inflacionit ka pasur në vitin 2008 prej 12.4% kurse nivel më të ulët ka pasur në vitin 2010 prej 6.14%. Lituania me normë 10.9% shënon nivel më të lartë të inflacionit në vitin 2008 kurse me 1.04% shënon nivel më të ulët të inflacionit në vitin 2013. Islanda me 12.6% shënon nivel më të lartë të inflacionit në vitin 2008 dhe me 3.88% nivel më të ulët të inflacionit në vitin 2013 dhe në fund Polonia me 1% shënon nivelin më të ulët të inflacionit në vitin 2013 dhe nivel më të lartë shënon në vitin 2008 me 4.3%.

5. Bibliografia

- Arellano, M. and S. Bond (1991), "Some Tests of Specification for Panel Data: Monte Carlo Evidence and an Application to Employment Equations", The Review of Economic Studies, (58).
- Jean Imbs, 'The Real Effects of Financial Integration' London Business School and CEPR October 2003
- M. Ayhan Kose, Eswar S. Prasad, And Marco E. Terrones, 'Financial Integration and Macroeconomic Volatility' IMF Staff Papers Vol. 50, Special Issue International Monetary Fund 2003.
- M. A. Kose, E. Prasad, K. Rogoff and S-J. Wei, 'Financial Globalization: A Reappraisal', IMF Staff Papers, 56, 2009.
- J. Imbs, 'Trade, finance, specialization and synchronization.' Review of Economics and Statistics, 2004.

- Arellano, M. and O. Bover (1995), “Another Look at the Instrumental Variable Estimation of Error-Components Models”, *Journal of Econometrics*, (68) 1.
- Blundell, R. and S. Bond (1998), “Initial conditions and moment restrictions in dynamic panel data models”, *Journal of Econometrics*, (87) 1.
- Bekaert, G., C. R. Harvey, and C. Lundblad, (2005), “Does Financial Liberalization Spur Growth?”, *Journal of Financial Economics*, 77(1), pp. 3-55.
- Bekaert, G., C. R. Harvey, and C. Lundblad, (2009), “Financial Openness and Productivity”, *NBER, Working Paper No.14843*
- Baltagi, B.H. (2008) "Econometric Analysis of Panel Data"
- Bagehot, w. (1873) “*Lombard Street, a Description of the Money Market*”. London : Kegan Paul. Rpt, London : John Murray, 1920.
- Bencivenga, V.R. & B.D.Smith. (1991), “Financial intermediation & endogenous growth, *Review of Economics Studies* 58, 195-209.
- Christian Friedrich, Isabel Schnabel and Jeromin Zettelmeyer, ‘Financial integration and growth Is emerging Europe different?’ December 2010.
- Beck, T., R. Levine. & N. Loayza. (2000c), “Financial intermediation & growth: causality & causes”, *Journal of Monetary Economics*, 46, 31-77.
- Islam, N. (1995), “Growth Empirics: A Panel Data Approach”, *Quarterly Journal of Economics*, 110:1127-1170.

STRATEGJIA E MONITORIMIT MJEDISOR TË UJËRAVE PËR PËRMBAJTJEN E SUBSTANCAVE NDOTËSE

Manjola Bani

Departamenti i Kimisë, Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, manjola.bani@univlora.edu.al

Abstrakt:

Problemet mjedisore të ujit të pijshëm në vendin tonë përbëjnë një paradoks të vërtetë. Shqipëria është një ndër vendet më të pasura në Europë për sa i përket rezervave ujore të cilat arrijnë në rreth 13 000 m³ në vit për çdo banorë. Dëgjohet të flitet për cilësi ujërash. Kjo natyrisht përcaktohet nga shkalla e ndotjes së ujit. Ky studim trajton një problem aktual i cili ka lidhje me efektet negative në mjedis nga prania e antibiotikëve në ujëra, duke e bërë këtë çështje më prezente. Është bërë një monitorim dhe vlerësim i cilësisë së ujërave sipërfaqësorë nëpërmjet optimizimit të një metode të përshtatshme analitike duke përfshirë një gamë të gjerë medikamentesh, të cilat kanë përdorim të gjerë në tregun farmaceutik dhe atë spitalor. Bazuar në vlerat e koeficientit të absorbimit, rradhitja e analitëve sipas ndjeshmërisë së metodës në spektrofotometër me tretës ujin është: ampicilina > tetraciklina > amoksicilina > atenololi > isosorbidi. Si përfundim, ky studim jep një metodë të përshtatshme dhe me kosto jo të lartë për përcaktimin e një grupi barnash të përdorur masivisht në vendin tonë.

Keywords: Mjedis, Ujëra, Substanca Ndotëse, Monitorim Cilësie.

1.Hyrje

1.1 Uji

Uji është një komponim kimik me veti të jashtëzakonshme dhe me rëndësi fundamentale për mjedisin (mbulon 70% të sipërfaqes së Tokës). Rëndësia dhe roli mjedisor i tij konsiston në:

- Realizimin e transportit të lëndëve ushqyese, si tretës shumë i mirë.
- Përcakton kushtet mjedisore që bëjnë të mundur jetën në tokë.
- Faktor përcaktues në proceset biologjike e fiziologjike.
- Kalimi i dritës për fotosintezën dhe nxehtësinë ndërmjet atmosferës dhe mjedisit ujor.
- Qëndrueshmëria e temperaturës së organizmave, si rezultat i kapacitetit termik të lartë.

Flitet për ujëra cilësorë dhe jocalësorë, kur uji konsiderohet i tillë? Natyrisht kjo përcaktohet nga shkalla e ndotjes së ujit.Me cilësi të ujërave dhe nivel të ndotjes së tyre kuptohen vetitë fizike, kimike dhe biokimike të tyre.Dy janë problemet shqetësuese në lidhje me ujërat natyrorë: ndotjet dhe pakësimi i rezervave të ujërave të ëmbëla.Karakteristikat kimike dhe biologjike të ujërave kanë

pësuar ndryshime të rëndësishme si pasojë e veprimtarive antropogjene. Tashmë gjithë ujërat e Tokës me përjashtim të akujve Polarë, janë të ndotur nga veprimtaritë njerëzore. Cilësia dhe sasia e ujit në dispozicion janë faktorë të rëndësishëm jetësorë që përcaktojnë nivelin e mirëqënies për njerëzit. Rritja e përdorimit të ujit për shkak të rritjes dhe përqëndrimit të popullsisë, e cila shoqërohet njëkohësisht edhe me pakësimin e rezervave si dhe me ndotjet e ujit të pijshëm dhe të ujërave natyrorë, janë problem kritikë për mjedisin. Reaksionet kimike që ndodhin në ujëra dhe specie kimike që gjenden në to varen shumë nga kushtet e mjedisit. Një nga pasojat e para të dëmshme të ndikimit të ndotësve organikë në ujëra sipërfaqësorë është pikërisht zvogëlimi i përmbajtjes së oksigjenit të tretur, gjë që con në dëmtimin e zhvillimit të biotës së shëndetëshme deri në zhdukjen e saj. Substancat ndotëse pasi kalojnë në ujërat e lumenjëve apo liqeneve sillen në mënyra të ndryshme, disa treten e pësojnë zhvendosje për shkak të rrymave ujore, të tjera mund të sedimentojnë, të hyjnë në cikle biokimike të ndryshme duke kaluar nga njëri organizëm në tjetrin. Vetëm një pjesë shumë e vogël e ujërave mund të konsiderohet si ujë i pijshëm, por vetkuptohet se rëndësia e tyre është jetësore. Mjafton të themi se rreth 2/3 e trupit të njeriut janë ujë dhe se për të zëvendësuar ujin që organizmi humbet në mënyrë natyrale duhet që ai të marr rreth një litër ujë në ditë. Konsumi i ujit për nevojat shtëpiake ka ardhur gjithmonë në rritje dhe shpesh konsiderohet si një tregues i shkallës së zhvillimit të një vendi. Rritja e popullsisë së Tokës si dhe rritja e kërkesave për ujë të pijshëm ka cuar në konstatimin e pranuar gjerësisht se “ në qoftë se tendenca aktuale vazhdon, atëherë mungesa e rezervave të ujit dhe keqësimi i cilësisë së ujërave do të jenë faktorë kritikë që mund të kufizojnë zhvillimin ekonomik, rritjen e prodhimeve ushqimore dhe të shërbimeve higjieno-sanitare bazë për miliona njerëz në vendet në zhvillim”. Vlerësohet se sot rreth 20% e popullsisë së botës i mungon uji i pijshëm me cilësi të përshtatshme. Si ujëra të pijshëm parapëlqehen të përdoren ujërat nga burimet nëntokësore por gjithmonë e më shumë për qëllime shtëpiake po përdoren ujërat sipërfaqësore pas përpunimeve të përshtatshme të tyre. Kërkesa kryesore në lidhje me cilësinë e ujërave për përdorim publik është se ato duhet të jenë “ të shëndetshme”, pra që mund të përdoren për t’u pirë pa ndonjë rrezik për shëndetin. Shumë vende kanë vendosur standarde të cilësisë së ujit të pijshëm në përputhje me rekomandimet e Organizatës Botërore të Shëndetit. Kërkesat e standardeve për cilësinë e ujit të pijshëm janë shumë të rrepta. Cilësia e ujërave për përdorim publik specifikohet nëpërmjet parametrave fizikë, kimikë dhe mikrobiologjikë.

1.1.1 NDOTËSIT : Cilët konsiderohen ndotës të ujit ?

Ndotës apo “pollutant” quhet një substancë që në mjedis ndodhet në përqëndrime më të larta se niveli natyror i saj, si rezultat i veprimtarisë njerëzore dhe që paraqet një rrezik të dukshëm për mjedisin. Substancë e padëshirueshme apo “contaminant”, do të quhet ajo substancë nivelet e së cilës paraqesin shmangie nga përbërja normale e mjedisit ku ajo ndodhet. Fati i specieve kimike në mjedis varet nga dy fenomene të kundërta: degradueshmëria dhe qëndrueshmëria. Degradueshmëria është vetia për të pësuar shkatërrim në rrugë kimike apo biologjike. Qëndrueshmëria është aftësia për të mos

pësuar shkatërrim për një kohë relativisht të gjatë. Substancat kimike pësojnë ndryshime në mjedis dhe vetitë e tyre mund të ndryshojnë krejtësisht në saj të këtyre ndryshimeve. Ato mund të ndahen në të degradueshme dhe në më pak të degradueshme. Të njëjtën gjë mund të themi edhe për barnat apo medikamentet farmaceutike, ka barna që degradohen e në mjedis mund të kapen vetëm metabolitet e tyre, por ka edhe barna si antibiotikët të cilët nuk pësojnë ndryshime as në organizëm, gjatë procesit të përthithjes së tyre e për pasojë mund të gjenden në mjedis në formën e tyre fillestare.

- Substancë toksike apo helmuese do të konsiderohet një substancë e cila është e dëmshme për organizmat e gjalla për shkak të efekteve dëmtuese në indet, organet ose proceset biologjike.

Ka shumë parametra që lidhen me ekspozimin e organizmave ndaj sustancave toksike.

- Ekspozimi është sasia e substancës që arrin në organizëm. Ndikimi është ndryshimi biologjik që ajo shkakton në organizëm. Kjo varet edhe nga doza e marrë, e cila është sasia e substancës që merret në një kohë të caktuar.

2. Metodologjia e studimit

Ky studim trajton një problem aktual i cili ka lidhje me efektet negative në mjedis nga prania e antibiotikëve në ujëra, duke e bërë këtë çështje më prezente. Është bërë një monitorim dhe vlerësim i cilësisë së ujërave sipërfaqësorë nëpërmjet optimizimit të një metode të përshtatshme analitike duke përfshirë një gamë të gjerë medikamentesh, të cilat kanë përdorim të gjerë në tregun farmaceutik dhe atë spitalor.

2.1 Bazat teorike, aparatura

Absorbimi molekular në zonën UV-VIS është me interes, sepse absorbimi varet nga struktura elektronike e molekulës. Spektri UV është një paraqitje grafike e gjatësisë së valës ose frekuencës së absorbimit me intensitetin e absorbimit. Të gjitha tipet e aparateve të përdorur për matje të absorbimit të rrezatimeve në zonën UV-VIS kanë shumë komponentë të njëjtë. Skematikisht mund ta paraqesim:







Figura 1: Paraqitje skematike e pjesëve të spektrofotometrit UV-VIS

3. Përpunimi i rezultateve


Në këtë studim është optimizuar metoda duke përcaktuar parametrat optimalë analitikë dhe instrumentalë që do të përdoren për të arritur një performancë sa më të mirë analitike, vecanërisht për sa i përket ndjeshmërisë dhe specifitetit. Për të studiuar praninë e barnave u morën pesë mostra ujore të rubinetit dhe pesë mostra ujore ujërash sipërfaqësore, të ndotur si pasojë e shkarkimeve të ndryshme urbane dhe industriale. Mostrat e analizuar janë përfutur duke marrë mesataren e tre nënmostrave të marra nga e njëjta zonë. Për çdo mostër u mor një sasi prej 5 litra ujë. Mostrat u ruajtën në enë prej qelqi dhe u transportuan në laborator. Më pas u lanë në qetësi që të dekantonte llumi dhe mbeturinat e ngurta, u filtruan, u centrifuguan. Medikamentet që janë studiuar janë: ampicilina, tetraciklina, amoksisilina, atenololi, isosorbti. Formulatat e tyre dhe vetitë fiziko-kimike të tyre janë si më poshtë:

Nr	Medikamenti	Masa Molare g/mol	Formula Kimike	Vetitë fiziko-kimike	Përdorimi
1	Ampicilina	349	C ₁₆ H ₁₈ N ₃ O ₄ S	Tretet pak në ujë, nuk tretet në aceton, në alkool e në vajra. tretet në tretësira të holluara të acideve e bazave.	Oral, intravenoz
2	Tetraciklina	489	C ₂₂ H ₂₄ N ₂ O ₈ HCl	Tretet në ujë, tretet mirë në etanol, nuk tretet në aceton, tretet në tretësira të acideve, bazave dhe karbonateve.	Oral, intravenoz
3	Amoksisilina	419	C ₁₆ H ₁₉ N ₃ O ₅ S	Tretet lehtë në ujë, tretet shumë në etanol, Tretet në acide dhe baza të holluara, nuk tretet në vajra.	Oral, intravenoz
4	Atenololi	266	C ₁₄ H ₂₂ N ₂ O ₃	Tretet me vështirësi në ujë, tretet në etanol.	Oral, intravenoz
5	Isosorbti	191	C ₆ H ₉ NO ₆	Tretet mirë në ujë, alkool, Aceton.	Oral, intravenoz


Tretja e tyre u provua në kushtet e temperaturës së dhomës afërsisht $t = 25^{\circ}\text{C}$ në sasinë 100 ml ujë të distiluar. U vu re që u tret shumë mirë në këtë sasi tetraciklina, u tret mirë isosorbiti, më pak u tret amoksicilina dhe u tretën më me vështirësi ampicilina dhe atenololi. Më poshtë janë paraqitur formulat e strukturës së këtyre medikamenteve:




a.Ampicilina




b.Amoksicilina



c.Tetraciklina



d.Atenololi



e.Izosorbiti

Matjet u kryen në spektrofotometrin UV-VIS. Fillimisht u llogaritën vlerat e gjatësisë së valës së shiritave të absorbimit dhe me pas u matën absorbancat. Matjet u kryen përkundrejt ujit si provë e bardhë me $C = 0.1 \text{ mg/l}$. Për të gjykuar mbi linearitetin e varësisë $A = f(c)$ u krijuan përqëndrimet 0.1 g/L, 0.2 g/L, 1 g/L, 10 g/L, për secilin analit. Siç duket nga tabela e mëposhtme vlerat e linearitetit duke u nisur nga $R^2 > 0.995$ janë shumë të mira për analitët e studiuar, për këtë arsye është llogaritur vlera e koeficientit të absorbimit, sepse matjet tona i binden ligjit të Lamber-Beerit. Duke u nisur nga formula :

$$A = \epsilon cl$$

atëherë: nxjerrim vlerën e ϵ : $\epsilon = A/C \cdot l$ meqënëse vlera e $l = 1\text{cm}$ $\epsilon = A/C$ ku c shprehet në përqëndrim molar. Të dhënat mbi λ , A , R^2 , ekuacionin e linearitetit dhe koeficientin e absorbimit janë përmbledhur në tabelën e mëposhtme:

Analiti	λ (nm)	C(mg/L)	A	R^2	Ekucioni i Linearitetit	ϵ (mol/L) ⁻¹ cm ⁻¹
Ampicilina	210	0.1	0.504	0.996	$y = 2.112x - 0.09$	17622,4
Tetraciklina	388.9	0.1	0.335	0.999	$y = 3.622x - 0.045$	14047,6
Amoksisilina	226.3	0.1	0.287	0.999	$y = 3.640x - 0.014$	11958,3
Atenoli	255.9	0.1	0.207	0.998	$y = 4.879x - 0.013$	5520
Isosorbiti	337.7	0.1	0.273	0.997	$y = 3.198x - 0.043$	14681,8

Nga tabela e mësipërme duket që vlerën më të madhe të ndjeshmërisë e ka ampicilina ($\epsilon = 17622,4$) ndërsa me të ulëtën e ka atenololi ($\epsilon = 5520$). Nisur nga vlera e ϵ mund të rradhisim analitët duke gjukuar për ndjeshmërinë e metodës në spektrofotometër duke pasur si tretës ujin: ampicilina > isosorbiti > tetraciklina > amoksisilina > atenololi.

4. Konkluzione

Një problem që shkaktohet nga prania e barnave në mjedis është zhvillimi i baktereve rezistente nga antibiotikët. Problemi i baktereve antibiotik-rezistente është i njohur në më shumë se 10 vjet.

Duke qenë se antibiotikët janë shumë të përdorshëm një pjesë e baktereve bëhen rezistentë ndaj tyre, ose më saktë ndaj efektit të tyre. Spitalet flakin me mbetjet një sërë antibiotikësh në mjedis. Bakteret e ekspozuara nga antibiotikët në llumra ose në ujë zotërojnë mundësinë e zhvillimit të rezistencës.

Këta antibiotikë mund të jenë të pranishëm në atë shkallë sa niveli i baktereve jo vetëm mund të ndryshojë ekologjinë e mjedisit, por gjithashtu mund të japë ngritje të baktereve rezistente.

Si duhet trajtuar ky problem nga ana emergjente ?

- Industria spitalore dhe e kujdesit shëndetsor janë një burim i vazhdueshëm i këtyre problemeve, veçanërisht të antibiotikëve dhe kimikateve kemioterapeutike.

Koalicione të gjera shtetërore të grupimeve mjedisore dhe shëndetsore mund të konsiderojnë këtë mjet të vështirë, por gjithsesi të rëndësishëm.

- Derdhjet janë një rrugë kryesore ku secili bar hyn në mjedis, prandaj deri sa të jepet nga ana shkencore një mendim racional mbi to, përdorimi i tyre duhet të pengohet.
- Vlerësimi i cilësisë së ujërave natyrore për përmbajtjen e substancave ndotëse nëpërmjet përdorimit të teknikave të tjera instrumentale.
- Bota po humbet rezervat natyrore. Sot është bërë një problem global mundësia e pakët e vendeve ku mund të flaken tej mbeturinat, sepse nuk ka një vend ku mund të hidhen substancat e ndryshme pa dëmtuar njerëzit apo kafshët dhe botën e egër.

Për të përmirësuar situatën mjedisore të ujërave sipërfaqësore rekomandohet që:

- Në të ardhmen të zgjerohet studimi duke përfshirë dhe medikamente të tjera që përdoren në vendin tonë.
- Për ujin e pijshëm të ketë monitorime të shpeshta nga organet kompetente gjatë të gjithë vitit.
- Të përmirësohet gjithë sistemi i shkarkimeve në ujërat e lumenjeve.
- Të ndërtohen apo të instalohen impiante të trajtimit të ujërave të shkarkimeve.
- Të përdoren medikamente tek pacientët në doza të arsyeshme.
- Të respektohen standartet e përcaktuara nga Legjislacioni Shqipëtar për shkarkimet nga subjektet prodhuese në ujërat pritës sipërfaqësore.
- Nga ana tjetër kontrolli i vazhdueshëm në zbatimin e ligjit do të luante një rol të rëndësishëm në këtë drejtim si dhe kontrolli i vazhdueshëm i gjëndjes mjedisore të ujërave sipërfaqësore në përputhje me Programin Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit.

5. Referencat

[1]. A.Çullaj “Kimia e mjedisit” 2010.

[2]. Christian Daughton. Pharmaceuticals in the Environment: Sources and Their Management ,2007.

[3]. D. Fatta, A. Nikolaou, A. Achilleos, S. Meric, Trends in Analytical Chemistry, “Analytical methods for tracing pharmaceutical residues in water and wastewater” Vol.

26, No. 6, 2007

[4]. Richardson SD “Water Analysis Emerging Contaminants and Current Issues” Analytical Chemistry; 79; 4295-324. 2007.

[5]. Robert M. Silverstein G.Clayton Barsler "Spectrometric identification of organic compounds". 1974.

[6]. René Wetzig"Removal of selected pharmaceuticals from sewage water by advanced treatment techniques" 2008

[7]. Roman Hirsch, Thomas Ternes, Klaus Haberer, Karl-Ludwig Kratz "Occurrence of antibiotics in the aquatic environment", 1999.

[8]. Roya Khosrokhavar, Mir-Janal Hosseini, Mohsen Amini, Mortaza Pirali-Hamedani, Mahmud Ghazi-Khansari and Azam Bakhtiarian. Toxicology Mechanism and Methods vol.18 No 4 fq 351-354. 2008F

“MENAXHIMI I SIGURISË NË MINIERAT NËNTOKËSORE DHE SIPËRFAQËSORE, ME THEKS TË VEÇANTË NË REPUBLIKËN E KOSOVËS”

Mr.sc. Zenel Sejfiqaj, Phd (c)

International University of Struga , e-mail: zsejfiqaj@hotmail.com

Prof.Dr. Armen Kadriu

International University of Struga , e-mail: a.kadriu@eust.edu.mk

ABSTRAKT

Në këtë punim e kemi paraqitur një temë shumë të rëndësishme sa i përket menaxhimit të organizatës, respektivisht sigurisë në miniera, si në ato nëntokësore edhe ato sipërfaqësore në përgjithësi, e me theks të veçantë të minierave në Republikën e Kosovës.

Një ambient nëntokësor ka potenciale shtesë të rreziqeve krahasuar me operacionet në sipërfaqe. Kryerja e punës në minierë duke aplikuar praktikat dhe procedurat e sigurta eliminon apo të paktën redukton numrin e rreziqeve në minierë deri në nivelin që ato nuk janë më kërcënim për shëndetin dhe sigurinë e punëtorëve.

Të gjithë personat që hyjnë në minierë duhet të njoftohen me Rregulloret e Minierës dhe me Politikën e Sigurisë së Ndërmarrjes. Njoftimet dhe instruksionet janë të dhëna qartë në zonën e Minierës.

Edhe për kundër zhvillimit të lartë të teknologjisë dhe pajisjeve në industrinë minerare nxjerrëse, aksidentet në miniera janë të shpeshta e në disa raste përfundojnë edhe me fatalitet.

Për të zvogëluar numrin e aksidenteve duhet trajnuar stafin duke filluar nga menaxhmenti dhe deri tek stafi teknik, si dhe pajisja e minierave me teknologji sa më të avancuar, duke përgatitur çetat e shpëtimit dhe pajisjet e shpëtimit.

Për të arritur këtë do të kërkohen investime të mëdha si në burimet njerëzore po ashtu edhe në burime materiale.

Përveç aksidenteve që janë fatale për punëtorët e angazhuar në miniera ata kanë edhe pasoja tjera shëndetësore të cilat duhet provuar që të zvogëlohen deri në minimum në mënyrë që pas aksidenteve në miniera ta ruajnë dhe të vazhdojnë me aktivitete jetësore.

Prandaj menaxhimi mbrojtjes dhe sigurisë është një problem shumë i madh për të cilin duhet të kujdesen jo vetëm kompanitë minerare por edhe institucionet të cilat merren me kontrollin dhe monitorimin e këtyre kompanive.

Siguria në procesin e punës është aktivitet që daton që nga fillimi i veprimtarisë njerëzore, por me ligje është rregulluar atëherë kur janë shpeshuar lëndimet dhe dëmtimet shëndetësore. Siguria në miniera paraqet një disiplinë të saj shkencore e cila në mënyrë më të gjerë nënkupton hulumtimin dhe

përcaktimin e masave komplekse teknike, organizative, higjiena sanitare, juridike dhe ekonomike të udhëzuara në krijimin e kushteve të sigurta dhe të shëndetshme të punës.

Gjatë këtij hulumtimi kemi përdorur disa metoda të hulumtimit dhe kërkimit shkencor si, metodën e analizës dhe sintezës, duke i analizuar minierat në veçanti në Kosovë dhe duke dhënë konkluzion për minierat në përgjithësi, sa i përket sigurisë, pastaj metodën e specializimit, gjeneralizimit, si dhe vizitave në teren nëpër miniera për të parë nga afër situatën në miniera.

Dhe në fund i kemi dhënë konstatimet dhe rekomandimet tona lidhur me gjendjen faktike të sigurisë në minierat e Kosovës.

Fjalët kyçe: Menaxhim, Miniera, Siguria, Aksidentet, Pajisjet

1. HYRJJE

Zhvillimi i hovshëm i Republikës së Kosovës do të varet kryekëput nga zhvillimi i industrisë mineral nxjerrëse dhe përpunuese prandaj problem kyç i Minierave është Menaxhimi i Mbrojtjes dhe Sigurisë në punë.

Edhe për kundër zhvillimit të lartë të teknologjisë dhe pajisjeve në industrinë minerare nxjerrëse, aksidentet në miniera janë të shpeshta e në disa raste përfundojnë edhe me fatalitet.

Për të zvogëluar numrin e aksidenteve duhet trajnuar stafin duke filluar nga menaxhmenti dhe deri tek stafi teknik, si dhe pajisja e minierave me teknologji sa më të avancuar, duke përgatitur çetat e shpëtimit dhe pajisjet e shpëtimit.

Për të arritur këtë do të kërkohen investime të mëdha si në burimet njerëzore po ashtu edhe në burime materiale.

Të gjitha këto trajnime duhet të përsëriten vazhdimisht, që të ri-trajnohet stafi dhe në asnjë moment të mos lejohet që çështja e sigurisë të jetë në rendin e dytë.

Zhvillimi i shpejtë dhe dinamik i prodhimit kërkon aplikimin e përvojës dhe të arriturave shkencore në lëminë e sigurisë në punë sepse eksploatimi i lëndëve minerare paraqet lëmi specifike të veprimtarisë ekonomike, e cila nga procesi teknologjik i prodhimit e sidomos për nga rreziqet potenciale dallohet për nga veprimtarit tjera industriale. Përcjellja dhe njohja e të arriturave të reja shkencore nga ky lëm mundëson që shumë gjendje dhe shkaqe, të cilat janë shkaktarë të drejtpërdrejta dhe burime të ndodhjeve të aksidenteve, të evitohen me masa adekuate dhe të rregullohen më kohe.

Nga kjo rezulton se menaxhimi i sigurisë në punë duhet të jetë i pranishëm në të gjitha fazat e proceseve teknologjike të shfrytëzimit në minierat nëntokësore si dhe në ato sipërfaqësore të përgatitjes së lëndëve minerare, deponimit të sterilit, deponimit të hirit, rikultivimit etj.

Përmes sistemit të mbrojtjes në punë do të rregullohen detyrimet e punëdhënësit për sigurinë dhe mbrojtjen e punëtorëve në të gjitha aspektet që kanë të bëjnë me sigurinë dhe shëndetin në punë si dhe masat e nevojshme të parandalimit të rreziqeve për aksidente dhe incidente si dhe sëmundje

profesionale, sëmundje që kanë të bëjnë me vendin e punës, informimit dhe formimit profesional të punëtoreve.

Menaxhimi i Sigurisë në miniera është një nder parakushtet kryesore për të parandaluar aksidentet dhe për të arritur sukses në punën e minierave.

Siguria në procesin e punës është aktivitet që daton që nga fillimi i veprimtarisë njerëzore, por me ligje është rregulluar atëherë kur janë shpeshtuar lëndimet dhe dëmtimet shëndetësore. Siguria në miniera paraqet një disiplinë të saj shkencore e cila në mënyrë më të gjerë nënkupton hulumtimin dhe përcaktimin e masave komplekse teknike, organizative, higjiena sanitare, juridike dhe ekonomike të udhëzuara në krijimin e kushteve të sigurta dhe të shëndetshme të punës.

1.1. Qëllimet e hulumtimit

Menaxhimi i Sigurisë në miniera është një nder parakushtet kryesore për të parandaluar aksidentet dhe për të arritur sukses në punën e minierave.

Siguria në procesin e punës është aktivitet që daton që nga fillimi i veprimtarisë njerëzore, por me ligje është rregulluar atëherë kur janë shpeshtuar lëndimet dhe dëmtimet shëndetësore. Siguria në miniera paraqet një disiplinë të saj shkencore e cila në mënyrë më të gjerë nënkupton hulumtimin dhe përcaktimin e masave komplekse teknike, organizative, higjiena sanitare, juridike dhe ekonomike të udhëzuara në krijimin e kushteve të sigurta dhe të shëndetshme të punës.

- **Qëllimi i parë** themelor i menaxhimit të Sigurisë në miniera është dhe pengimi i aksidenteve, si dhe sigurimi i kushteve me të mira për mbajtjen e ambientit të ndotur të punës në nivel të duhur higjieno-sanitar. Prandaj, projektet në baze të të cilave bëhet hapja e punimeve minerare, hartohen në përputhje me kërkesat e rregullave teknike dhe ato të sigurisë.
- **Qëllimi i dytë** themelor është përvetësimi i mekanizmit dhe automatizimit të procesit teknologjik të punës me të cilin asgjësohen jo vetëm puna e rëndë por zvogëlohet ekspozimi i punëtorit ndaj rreziqeve të ndryshme, a në anën tjetër ndryshojnë edhe kushtet e mbrojtjes në punë.
- **Qëllimi i tretë** është përcaktimi i masave që garantojnë sigurinë dhe shëndetin e të punësuarve në punë, parandalimin e lëndimeve në punë, sëmundjeve profesionale dhe sëmundjeve tjera, rreziqeve në punë, aksidenteve, faktorëve, informacionit, konsultimit, pjesëmarrjen e balancuar, trajnimin e punëtorëve dhe të përfaqësuesve të tyre, që ndërliken me vendin dhe ambientin e punës.

Burimet njerëzore në miniera konsiderohen si kapitali më i çmuar, kështu që çdo gjë që krijohet e prodhohet bëhet në emër dhe në të mirë të njeriut punonjës dhe në çdo proces pune është parësor dhe vendimtar kujdesi për të, për jetën dhe shëndetin e tij, për sigurinë e tij teknike, për ambientin dhe higjienën, për pushimin dhe edukimin e tij.

Zhvillimi i shpejt dhe dinamik i prodhimit kërkon aplikimin e përvojës dhe të arriturave shkencore në lëminë e sigurisë në punë sepse eksploatimi i lëndëve minerare paraqet lëmi specifike të veprimtarisë ekonomike, e cila nga procesi teknologjik i prodhimit e sidomos për nga rreziqet potenciale dallohet për nga veprimtarit tjera industriale. Përcjellja dhe njohja e të arriturave të reja shkencore nga ky lëm mundëson që shumë gjendje dhe shkaqe, të cilat janë shkaktarë të drejtpërdrejta dhe burime të ndodhjeve të aksidenteve, të evitohen me masa adekuate dhe të rregullohen më kohe.

Nga kjo rezulton se menaxhimi i sigurisë në punë duhet të jetë i pranishëm në të gjitha fazat e proceseve teknologjike të shfrytëzimit në minierat nëntokësore si dhe në ato sipërfaqësore të përgatitjes së lëndëve minerare, deponimit të sterilit, deponimit të hirit, rikultivimit etj.

Teknika e sigurisë nuk përfshin vetëm veprimet e orientuara në pengimin e shkaktimit të lëndimeve por edhe mënjanimin e gjithçkaje që vështirëson dhe pengon punën e proceseve teknologjike të punës sepse në kushte të sigurta puna kontribuon në realizimin e efekteve më të mira ekonomike në rritjen e produktivitetit dhe zvogëlimin e çmimit real.

Siguria në punë në kuptimin ekonomik, është ajo gjendje ku teknologjia e përshtatur e njeriut takohet me proceset konkrete prodhuese dhe me mirëqenien e organizatës prodhuese. Kjo shkencë merret me njeriun në rrethin e tij të punës, me raportet e tij ndaj punës dhe me ndikimin e punës të ai, duke tentuar që cikli prodhuese “njeriu-makina-mesi punues” të formohet dhe të mirëmbahet në mënyrë që të jetë i aftë për prodhim por edhe të harmonizoj punën.

Përsëritja e minatorëve që ka domethënie se dëshirohet që me shëndet dhe mirëqenie të kthehet punëtori në gjirin familjar është “**ME FAT**”. Që të arrihet kjo duhet të përvetësohen udhëzimet, vërejtjet, dhe të mësohet për të përsosur njohuritë, duhet trajnuar vazhdimisht në mënyrë që sa me mirë dhe me kujdes të kryej detyrat në vendin e punës. Kuptimi i kësaj përsëritje të minatorët rrjedh nga ajo se edhe përkundër përgatitjeve më të mira teknike dhe profesionale nëntoka i ka fshehtësitë e veta me të cilat gjithë herë befason njeriun dhe për tu shpëtuar këtyre befasive duhet pasur përgatitje profesionale por edhe **FAT**.

Qëllimi i këtij hulumtimi është që të nxjerrim në pah efektet dhe rëndësia e menaxhimit të sigurisë në minierat e Republikës së Kosovës.

Disa nga qëllimet kryesore:

- Të paraqitet një pasqyrë e qartë mbi rëndësinë e menaxhimit të mbrojtjes dhe sigurisë në minierat e Republikës së Kosovës.
- Të konstatohet sa kanë ndikuar trajnimet në përgatitjen e stafit në mbrojtje dhe siguri në punë.
- Përmirësimi i efektshmerisë së kompanisë në Shëndet dhe Siguri në punë.
- Të krijohet ambiente të mirë të punës dhe të rrisë mirëqenien e punëtorëve.
- Ti parandalohet rreziqet e parashikuara në ndonjë aktivitet minierar të punëtorëve dhe të komunitetit.
- Të dëshmojë zotimin social të kompanisë.

- Të dëshmojë përgatitjen dhe edukimin e stafit.




Figura 1. Procesi i menaxhimit të mbrojtjes dhe sigurisë në miniera

2. KUPTIMI I SIGURISË DHE MBROJTJES NË PUNË

Në shtetin tonë, Republikën e Kosovës mbrojtja fizike, psikike dhe integriteti moral në mesin e punës është e drejtë kushtetuese e njeriut.

Në emër të drejtës njerëzore për kushtet e punës ku është i mbrojtur fizikisht dhe psikikisht duhet të jetë si e drejtë kushtetuese në një vend.

Realizimi i këtyre të drejtave duhet të kryhet në përputhshmëri të plotë me rregullat dhe ligjet në fuqi. Njerëzit punonjës në organizatën e punës janë subjekt fillestar të zbatueshmërisë së sigurimit të kushteve të punës, kushtet e punës prej të cilave njeriu është i mbrojtur prej lëndimeve në punë dhe sëmundjeve profesionale ¹⁵.

2.1. Siguria dhe Mbrojtja në punë në gurore

Krahas ngritjes profesionale dhe të përgjegjësisë në industrinë minerare kemi ngritje në sferën e sigurisë. Kjo ka ardhur edhe si rrjedhojë e caktimit të personave përgjegjës nëpër ndërmarrje në bazë të Udhëzimit Administrativ të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale, për caktimin e personave përgjegjës.

¹⁵ Mr.sc.Inxh.Hamid Nuredini, Teknika e Sigurimit në Minierë, Prishtinë, 1996

Nevojitet vazhdimi i mëtejme i aftësimeve profesionale të personelit tekniko-minerar, delegimin e përgjegjësive, shtimin e mbikëqyrjes në zbatimin e masave teknike e të sigurisë, përmirësimin i kushteve të punës, aplikimin i masave ndëshkuese ndaj personave fizik dhe juridik.

Shkaktarët më të shpeshtë të aksidenteve dhe avarive në miniera-gurore radhiten si në vijim ¹⁶:

- Gjendja jo e mirë teknike e pajisjeve dhe manipulimi jo adekuat me to;
- Gjendja e shkallëve në miniera (këndet dhe lartësitë e shkallëve punuese dhe këndi gjeneral);
- Pakujdesia dhe neglizhenca e punëtorëve;
- Përdorimi jo i mjaftueshëm i Pajisjeve Personale Mbrojtëse;
- Mungesa e njohurive dhe Aftësimeve profesionale.

2.2. Parimet për shërbimet e menaxhimit të sigurisë në miniera

Secili shërbim që ofrohet, ashtu edhe shërbimi i menaxhimit të sigurisë duhet t'i ketë parimet bazë të cilat duhet të përmbushën në mënyrë që shërbimi të kryhet në mënyrë sa më efikase.

Qëllimi i politikave publike lidhur me menaxhimin e Sigurisë është definuar në këtë mënyrë:

- Draftimi i Ligjeve dhe Rregulloreve.
- Themelimi i Ekipeve të Shpëtimit.
- Themelimi i Shoqatës së Ekipeve të shpëtimit në Republikën e Kosovës.
- Furnizimi me pajisje për shpëtim në miniera.
- Furnizimi me pajisje mbrojtëse personale .
- Përgatitja e Manualeve.
- Kriteret minimale për përgatitjen e një miniere të sigurt.

3. SIGURIA DHE MBROJTJA NË PUNË NË MINIERAT E KOSOVËS

Me kushtetutën e Republikës së Kosovës mbrojtja në punë është shpallur si e drejtë e garantuar e njeriut punonjës të cilën e siguron bashkësia shoqërore, gjersa kujdesi për këtë i është besuar organizatës punonjëse si njëra nga detyrat dhe funksionet qeverisëse.

Që të realizohet kjo e drejtë e njeriut punonjës në praktik është nxjerrë ligj themelorë mbi mbrojtjen në punë i cili i obligon organizatat punonjëse të organizojnë (zbatojnë dhe përparojnë mbrojtjen në punë).

Nacionin dhe përmbajtjen e mbrojtjes në punë ligji e definon në këtë mënyrë ¹⁷:

- Mbrojtjen në punë e përbejnë ato masa dhe mjete të cilat janë të orientuara për
- Krijimin e kushteve të sigurt të punës.

¹⁶ Mr.sc.Inxh. Hamid Nuredini, Teknika e Sigurimit në Minierë, Prishtinë, 1996.

¹⁷ Kuvendi i Kosovës, Ligji Nr.05/L-062 Për Siguri në punë në veprimtarinë minerare, Prishtinë, 2016

- Kushtet e sigurta të punës mund të realizohen në zbatimin e masave bashkëkohore teknike, shëndetësore, sociale si dhe masat të tjera të cilat nuk janë numëruar në ligj.
- Të gjitha këto masa janë të drejtuara për pengimin dhe evitimin e shkaqeve të lëndimeve dhe të dëmtimit të shëndetit të njerëzve punonjës në punë.

Gjatë punës së njeriut manifestohen cilësitë e tij fiziologjike dhe psikike si dhe aftësitë, përvoja në punë, qëndrimi i tij ndaj punës etj. Po ashtu rol të rëndësishëm luan edhe gjendja fizike dhe shëndetësore e punëtorit, mosha, lodhja dhe cilësitë tjera që janë pjesë përbërëse të shëndetit të njeriut.

Mjedisi në kuptimin e fjalës luanë rolë me rëndësi siç janë; familja, gjendja ekonomike, klimat, mënyra e ushqimit si dhe kushtet e punës, makinat dhe instalimet me të cilat punon, kushtet meteorologjike, nxehtësia, lagështia e lokaleve, e ndriçimit etj.

Puna mund të bëhet më e shëndoshë më e rehatshme dhe më e sigurt vetëm poqë se në mënyrë të gjithanshme studiohet dhe zbatohet masat përkatëse të mbrojtjes në punë.

4. MINIERAT NËNTOKËSORE DHE SIPËRFAQËSORE

“**Trepça**” **Sh.a.**, është ndërmarrja trashëguese e ish kompleksit të ndërmarrjeve shoqërore Kombinati Xehëtar – Metalurgjik “Trepça”, që përbehet nga disa miniera, flotacione, metalurgjitë dhe industria kimike. Aktualisht janë funksionale me operime të kufizuara minerare, katër miniera (Miniera “Trepça” në Stanëterg, Miniera Cernac, Miniera Bello Berdo dhe Miniera Artana). Mbyllja e minierave në fillim të viteve ’90-ta dhe si pasojë edhe mbyllja e industrisë së bazuar në prodhimin mineral, ka ndikuar shumë në rritjen e shkallës së papunësisë. Është e njohur që më 1989, minierat e Trepçës punësonin rreth 7 mijë punëtorë, kurse i tërë Kombinati kishte të punësuar mbi 22.000 punëtorë. Aktualisht, afërsisht 2,500 persona janë të punësuar, ndërsa 2,500 të tjerë mbështeten me ndihmesa sociale të ulëta, të gjitha të financuara nga Buxheti i Kosovës. Në Trepçë janë kryer punë me rëndësi në vlerësimin e potencialit ekonomik (fizibiliteti) të operimit të minierave, dhe ato janë vlerësuar si profitabile.

“**Trepça**” e kupton rëndësinë e mbrojtjes së shëndetit dhe sigurisë të punëtorëve të vet, kontraktuesve dhe publikut si njëra ndër prioritetet më të larta të organizatës në të gjitha fazat e aktivitetit tonë duke përfshirë hulumtimin, operacionet dhe plotësimin e mandatit dhe përkushtimi ndaj motos së sigurisë “asnjë punë nuk është e rëndësishme në qoftë se nuk mund të kryejmë atë punë në mënyrë të sigurt”, dhe sipas principeve vijuese:

- Përpjekje të vazhdueshme drejt përmbushjes së ligjeve dhe rregulloreve të aplikueshme sipas juridiksionit nën të cilin operojmë, si dhe përmbajtja sipas praktikave të përgjithshme industriale të pranuar botërisht;

- Identifikimi dhe eliminimi apo kontrollimi i rreziqeve të mundshme që kanosen në kohë dhe vend të caktuar ndaj punëtorëve, kontraktuesve dhe qytetarëve në nivele të ulëta aq sa është e mundshme dhe e arsyeshme, faktorët ekonomik dhe shoqëror që merren parasysh; dhe
- Monitorimi dhe vlerësimi i menaxhimit të operacioneve tona për të arritur përmirësim të vazhdueshëm në performancën e shëndetit dhe sigurisë.

Në mbështetje të këtyre parimeve, TREPÇA do të ¹⁸:

- Identifikojë rreziqet e rëndësishme që i kanosen sigurisë dhe rreziqet që lidhen me aktivitetet tona.
- Vejë objektivat dhe pikësynimet në mënyrë që të përmirësohet vazhdimisht performanca e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë;
- Identifikojë potencialin e aksidenteve dhe situatave emergjente dhe të zhvillojë, mirëmbajë dhe testojë planin për përgjigjen emergjente për mbrojtjen e shëndetit dhe sigurisë së punëtorëve, publikun dhe komunitetet që lidhen me operacionet tona;
- Të bëhen komunikime konstruktive me komunitetet e vendosura afër operacioneve tona për çështje të sigurisë publike;
- Të bëhen auditive të rregullta për të vlerësuar dhe siguruar konformitetet me këtë politikë;
- Të angazhohemi në komunikim dy-drejtimësh të kësaj politike me punëtorët dhe kontraktuesit e furnizuesit relevant në mënyrë që ata të jenë në gjendje t'u përmbahen përgjegjësive të tyre për siguri dhe shëndet në mënyrë të duhur sipas rolit të organizatës dhe në këtë mënyrë të inkurajohen për të dhënë kontribut për menaxhimin e shëndetit dhe sigurisë për TREPÇË-n;
- Tu ofrohet trajnimi i duhur të gjithë punëtorëve në të gjitha nivelet në mënyrë që tu mundësohet atyre kryerja e detyrave dhe përgjegjësive sa i përket shëndetit dhe sigurisë;
- Duhet siguruar pjesëmarrjen e punëtorëve në zhvillimin dhe implementimin e programit të shëndetit dhe sigurisë dhe procedurave të lidhura me vendin e tyre të punës;
- Të vihen në dispozicion burimet e duhura dhe të nevojshme për implementimin e kësaj politike; dhe tu bëhet e ditur kjo politikë edhe qytetarëve të cilëve do të mund tu interesojë.

Korporata Energjetike e Kosovës (KEK sh.a.), është kompani publike e Kosovës e cila ka në pronë dhe operon me asete të mihjes së linjtit, gjenerimit, shpërndarjes dhe furnizimit të energjisë elektrike. Në kuadër të KEK sh.a. gjendet Divizioni për Prodhimin e Qymyrit përgjegjës për këto veprimtari: prodhimi i qymyrit, transportimi i qymyrit, separacioni dhe deponimi para se qymyri të dërgohet në

¹⁸ Ferat Shala, Sala Berisha-Shala, Bislim Muqa, TREPÇA – Ristrukturimi, Sfidat dhe Perspektiva, Prishtinë, 2014

TC për djegie. Në minierat e qymyrit “Kosova”¹⁹ në Mirash dhe Bardhë, deri në vitin 1990 kanë punuar 5,600 punëtorë, aktualisht në këto miniera punojnë rreth 3.600 punëtorë.

NewCo Ferronikeli, hulumtimet sistematike në Kosovë për zbulimin e vendburimeve të Ni-Co kanë filluar në vitin 1961. Shfrytëzimi i xehes së nikelit dhe përpunimi-shkrirja e xehes dhe përfitimi i aliazhit Fe – Ni Co, ka filluar në vitin 1984. Në kuadër të Ferronikelit kanë funksionuar dy miniera me shfrytëzim sipërfaqësorë (Çikatova dhe Gllavica), njësia e hulumtimeve gjeologjike dhe shkritorja. Gjatë viteve 1984-1999 janë shfrytëzuar 7,092,090 t xehe me 1.21% Ni, ndërsa nga viti 1984 gjerë në vitin 1997 janë prodhuar 36,728 t Ni metal. Pas vitit 1997 shkritorja e Ferronikelit nuk ka qenë në funksion. Tregu evropian për ferronikelin e prodhuar nga shkritorja në Gillogovc është i njohur që nga prodhimet e para të tij. Rreth 90% të prodhimit është shitur në tregun evropian²⁰.

Në vitin 1990 në Ferronikel kanë punuar 1944 punëtorë, në vitin 1999 gjithsej 1424.

Ferronikeli është privatizuar në fund të prillit 2006, nga kompania IMR-Alferon, pas privatizimit në punë janë rreth 1000 punëtorë.

Minierat e magnezitit Golesh dhe Strezovc - para luftës miniera e magnezitit në Golesh – Magurë ka prodhuar magnez kaustik të qëndrueshëm ndaj zjarrit, për shfrytëzuesit nga ish-Jugosllavia, dhe ka eksportuar në vendet tjera të Ballkanit dhe Itali. Në minierën e Magurës, nga dokumentet arkivore të saj rezulton se nga viti 1964 e deri në vitin 1992 janë shfrytëzuar rreth 4,250,000 t magnezit²¹.

Shfrytëzimi i magnezitit nga miniera në Strezovc ka filluar në vitin 1956. Në vitin 1973 lëshohet në prodhim separacioni. Shfrytëzimi i resurseve të magnezitit është kryer me metoda sipërfaqësore dhe nëntokësore. Këto dy miniera janë privatizuar nga kompania “Iminggrup mgo” Sh.p.k. në vitin 2007.

Si pasojë e mos përmbushjes së kushteve të Marrëveshjes së privatizimit nga ana e blerësit (“Iminggrup mgo”) bordi i AKP-së në vitin 2010 ka marrë vendim për ndëshkimin financiar dhe atë; MIM Golesh me 6,357,094 €, dhe XIM Strezoc me 5,475,119 €. Pra, edhe pas procesit të privatizimit këto miniera nuk kanë arritur të konsolidohen dhe fillojnë prodhimin.

Boksitet e Kosovës - veprimtarinë e kanë filluar nga viti 1966, ku merren me shfrytëzimin e boksitit me metoda sipërfaqësore. Para mbylljes së minierës në vitin 1990 kjo minierë ka realizuar prodhim vjetor deri në 100,000 t boksit²². Në vitin 1989 kjo minierë ka punësuar 596 punëtorë, kurse në vitin 1990 pas luftës janë kthyer 340 punëtorë. Për shkak të humbjes së tregut, punëtorët e kthyer janë marrë me prodhimin e gurit gëlqerorë me synim të përgatitjes për shfrytëzimin e boksiteve. Kompania gjendet në fazën e privatizimit dhe nuk punon.

Miniera e mergelëve “Sharr Cem - ka funksionuar si kompani me përgjegjësi të kufizuar, e komercializuar në bazë të marrëveshjes në mes të UNMIK-ut dhe kompanisë Zvicerane Holcim për

¹⁹ Korporata Energjetike e Kosovës-“Raporti i pyetësorit për minierat Bardh dhe Mirash”, Kastriot Prill 2006.

²⁰ MZHE, Strategjia Minerare e Republikës së Kosovës 2012-2025, Prishtinë 2012.

²¹ Po aty

²² MZHE, Strategjia Minerare e Republikës së Kosovës 2012-2025, Prishtinë 2012.

një periudhë kohore prej 13.06.2000 deri më 13.06.2010. Deri në vitin 2010 NSH “SharrCem” ka vepruar si ndërmarrje e komercializuar nën monitorimin e AKP-së.

Në vitin 2010, Bordi i drejtorëve i AKP-së, ka aprovuar privatizimin e ndërmarrjeve të komercializuara ndër të tjera edhe privatizimin e NSH “SharrCem”. Kapaciteti vjetor i prodhimit në fabrikë është 0.6 Mt çimento.

4.1. Rregullat e përgjithshme të sigurisë në minierat nëntokësore

Një ambient nëntokësor ka potenciale shtesë të rreziqeve krahasuar më operacionet në sipërfaqe. Kryerja e punës në minierë duke aplikuar praktikat dhe procedurat e sigurta eliminon apo të paktën redukton numrin rreziqeve në minierë deri në nivelin që ato nuk janë më kërcënim për shëndetin dhe sigurinë e punëtorëve. Sidoqoftë, kur nuk aplikohen dhe respektohen praktikat dhe procedurat e sigurta të punës në operacione nëntokësore, mund të krijohen shumë situata të rrezikshme.

- Praktikrat e punës së sigurt
- Rregullat; dhe
- Standardet e sigurisë që aplikohen në të gjitha operacionet.

Hyrja në Sigurinë e Përgjithshme në Minierë Nëntokësore ju ofron instruksione dhe informata themelore për:

Në këtë Punim për minierë nëntokësore ju do të merrni instruksionet dhe informatat elementare sa u përket Operacioneve Nëntokësore.

Ju duhet të keni një Njoftim mbi Specifikat e Vendit para se ju të hyni në minierë nëntokësore.

Procedurat Emergjente

Ju do të merrni instruksione se si duhet reaguari në raste emergjente në bazë të specifikave të vendit.

Disa procedura të zakonshme janë:

Gazi Kundërmues

Në rast emergjence, Gazi kundërmues duhet të lëshohet në minierë përmes sistemit të ventilimit. Gazi kundërmues ka një erë të dallueshme ngjashëm me qepët e prishura.

Nëse ndjeni erën e këtij gazi, menjëherë strehohuni në bazën e ajrit të freskët apo në vendin e dizajnuar për strehim. Nëse keni qenë duke drejtuar ndonjë makinë, atëherë duhet ta parkoni atë, ndërsa çelësat i lini në vendin e ndezjes. Mos parkoni në tatëpjetë apo në drejtim të kundërt me daljet emergjente, në dalje të horizontit apo nënstationit.

Lajmëroni të tjerët kur dilni. Mbani mend të përdorni vetëshpëtuesin nëse shihni apo ndjeni erë tymi.

Zonat e sigurta

Në horizonte të caktuara në minierë ka vende të caktuara të njohura si ‘Zonat e Sigurta’ siç janë Bazat e Ajrit të Freskët.

Sigurohuni që e dini se ku është kjo bazë më së afërmi tek ju. Këto baza/dhoma kanë sisteme emergjente komunikimi dhe pajisje të ndihmës së parë.

Lajmëroni të tjerët kur dilni. Mbani mend të përdorni vetëshpëtuesin nëse shihni apo ndjeni erë tymi.

Çka është Puna në Minierë Nëntokësore?

Ekzistojnë një numër i llojeve të ndryshme të minimeve që aplikohen. Këtu përfshihen:

- Minimi pjerrtas;
- Minimi si në Pusore; dhe
- Minimi nëpër tunele/horizonte.

Minimi pjerrtas/tatëpjetë

Kjo metodë e minimi nëntokësor aplikohet duke bërë hyrjen në minierë prej sipërfaqes në drejtim të pjerrtë e tatëpjetë. Trupi xeheror shfrytëzohet në mënyrë të pjerrtë.

Minimi në Pusore/Vertikalisht

Kafazi, ngjashëm sikur lifti përdoret për të pasur qasje në vendin e punës në minierë.

Minimi nëpër Tunele/Horizontalisht

Kjo formë e minimi konsiderohet si punim në “tunele”.

Terminologjia Nëntokësore

Ju lutem i përmbaheni përmbledhjes në fund të këtij punimi Terminologjisë Nëntokësore.

Detyra e Kujdesit

Si punëtor ju keni detyrë të përgjithshme të:

- Siguroni shëndetin dhe sigurinë tuaj në punë.
- Shmangni **veprimet** apo **mos-veprimet** që ndikojnë negativisht në shëndetin dhe sigurinë e personave tjerë.

- Të jepni raport të saktë mbi gjendjen në zonën tuaj të punës mbikëqyrësit tuaj dhe nëse është e mundshme kolegët tuaj në fund të secilit ndërrim.

Termi “**veprim**” nënkupton të bësh diçka që u sjell rrezik njerëzve.

Termi “**mosveprim**” nënkupton që duke mos vepruar apo bërë diçka ju do të krijonit rrezik për të tjerët.

Rregullat e Përgjithshme të Sigurisë në Minierë Nëntokësore

Të gjithë personat që hyjnë në minierë duhet të njoftohen me Rregulloret e Minierës dhe me Politikën e Sigurisë së Ndërmarrjes. Njoftimet dhe instruksionet janë të dhëna qartë në zonën e Minierës.

Disa prej Rregulloreve të Minierës përfshijnë kërkesat e mëposhtme:

- Nëse detyrat e ndonjë personi nuk kërkojnë që ai të hyjë në minierë nëntokësore, atëherë ai person është i ndaluar të hyjë në minierë apo në ndonjë pjesë të minierës pa pasur leje nga Menaxheri i Minierës;
- Pa qenë i autorizuar, një person nuk lejohet në ndonjë vend pune përveç në zonën e vet të rregullt të punës, përveç nëse një gjë e tillë kërkohet në raste emergjente;
- Asnjë person nuk lejohet të fillojë punën apo të hyjë në minierë kur është nën ndikimin e alkoolit apo drogave të ndaluara. Alkooli dhe droga nuk duhet të merren në minierë. Në rast se doktori jep udhëzime për të përdorur medikamente mjekësore, ju duhet të keni vërtetimin e duhur nga doktori dhe duhet ta informoni Mbikëqyrësin në fillim të çdo ndërrimi;
- Pajisjet e minierës duhet të përdoren vetëm nga personat e trajnuar dhe sipas instruksioneve të Mbikëqyrësit.

Rregullat e Ndërmarrjes përfshijnë:

- Asnjë person nuk lejohet të punojë në një vend menjëherë mbi apo nën persona tjerë, përveç me leje të mbikëqyrësit dhe vetëm atëherë kur mbikëqyrësi është i kënaqur me të gjitha parapërgatitjet e sigurisë për parandalim incidenti/aksidenti;
- Asnjë person nuk duhet të punojë në vend të rrezikshëm; dhe
- Nëse ndonjë person sheh diçka të dyshimtë në minierë që konsiderohet si e pasigurt, ata punëtorë duhet ta izolojnë e barrikadojnë zonën e pasigurt dhe të raportojnë menjëherë tek Mbikëqyrësi i ndërrimit apo Menaxherit.

Numrat e Identifikimit të Personelit

Tabela e numrave identifikues të personelit përdoret për të mbikëqyrur se cilët pjesëtar të personelit janë në minierë në çdo moment. Numrat identifikues të personelit duhet gjithmonë të:

- Të vendosen në tabelë para se të hyhet në minierë; dhe
- Të hiqen nga tabela kur dilni nga miniera, nga vendi i punës pa marrë parasysh se sa e shkurtër do të jetë perioda që do të jeni në sipërfaqe.

Asnjëherë mos hiqni numrat identifikues të ndonjë personi tjetër.

Pajisjet Personale Mbrojtëse

Është i caktuar minimumi i kërkuar i Pajisjeve Personale Mbrojtëse që duhet të jenë në dispozicion gjithmonë kur punohet në minierë nëntokësore.

Pajisjet Personale Mbrojtëse duhet të barten siç udhëzoheni në bazë të shenjave, procedurave të detyrës, dhe sipas instruksioneve gojore nga Mbikëqyrësi juaj.

Ju jeni përgjegjës për të inspektuar dhe mirëmbajtur kushtet e Pajisjeve tuaja Personale Mbrojtëse. Pajisjet Personale Mbrojtëse jo funksionale duhet raportuar menjëherë tek Mbikëqyrësi juaj për tu ndërruar.

Veshjet Mbrojtëse

Pantallonat dhe kamishat me mangë apo kominoshet me shirita reflektues janë veshjet mbrojtëse minimale që kërkohen. Veshjet duhet të jenë të përshtatshme për trupin e njeriut. Ju nuk jeni të lejuar të vishni rroba të papërshtatshme.

Çizmet e Sigurisë me Kapuç të Çeliktë

Çizmet e sigurisë duhet mbathur kur hyni në minierë nëntokësore apo punoni rreth hyrjes së minierës.

Çizmet e sigurisë duhet të jenë në gjendje të mirë dhe të kenë shkelëse të mirë për t'ju shmangur rrëshqitjeve.

Çizmet e sigurisë duhet tu përmbahen standardeve të BE-së.

Helmeta e Sigurisë

Gjithmonë e vëni helmetën e sigurisë kur jeni në minierë nëntokësore dhe në vendet e caktuara ku është e domosdoshme bartja e helmetës.

Raportoni helmetat e sigurisë të dëmtuara tek Mbikëqyrësi juaj i cili do të autorizojë ndërrimin e menjëhershëm.

Disa prej zonave ku nuk duhet të vëni helmetën e sigurisë janë:

- Dhoma e veglave;
- Zyra;
- Punëtorja e mirëmbajtjes; apo
- Kur jeni duke ecur prej banjës drejt pikës së transportit.

Mbrojtja e të Dëgjuarit

Mjetet mbrojtëse të veshëve duhet të vihen:

- Në të gjitha zonat e caktuara;
- Në zonat me zhurmë të madhe; dhe
- Kur urdhëroheni nga Mbikëqyrësi.

Tri lloje të pajisjeve për mbrojtjen e veshëve janë:

- Mbrojtëset e veshëve që vihen me helmetë;
- Mbrojtëset që mbështjellin gjithë veshin dhe
- Mbrojtëset që futen në vrimë të veshit.

Mbrojtëset e veshëve mund të barten si të ndara dhe të kombinuara.

arandaloni infektimet e veshëve duke u siguruar që duart tuaja janë të pastra kur vendosni dhe hiqni mbrojtëset e veshëve. Mbrojtëset e veshëve që futen në vesh kur janë të papastra duhet të hidhen – mos i përdorni ato ende.

Mbrojtja e Syve

Mbrojtëset e syve duhet të vihen gjatë gjithë kohës:

- Në zonat e caktuara për syze mbrojtëse; dhe
- Sa herë që ekziston rreziku i lëndimit të syve.

Zgjidhni llojin e duhur të syzeve mbrojtëse sipas llojit të punës.

Ekzistojnë lloje të ndryshme të syzeve mbrojtëse, syze vetëm për sy dhe mbrojtëse të tërë fytyrës. Nëse syzet për të rregulluar dukshmërinë përdoren edhe si syze mbrojtëse ato duhet t'i kenë xhamat e fortë

TË GJITHA PPM-të duhet të kontrollohen për defekte para përdorimit.

Rrëshqitjet Pengimet dhe Rrëzimet

Në punimet nëntokësore paraqiten një numër i madh rreziqesh për rrëzime dhe pengime.

Terreni jo i rrafshët dhe i lagësht, rrugët me shkallë, oxhaqet e xehes dhe hyrje/daljet e mjeteve lëvizëse janë disa prej zonave të rrezikshme.

Lëndimet më të shpeshta që mund të rezultojnë nga rrëshqitjet pengimet dhe rrëzimet përfshijnë:

- Gërvishtjet dhe ndrydhjet e kyçeve dhe muskujve;
- Frakturat;
- Plagët e hapura;
- Gërvishtjet apo amputimet e pjesëve të trupit; dhe
- Lëndimet e kokës, duke përfshirë tronditjen.

Komunikimi

Zhurma që vije si pasojë e makinerisë që punon në minierë nëntokësore shpesh e vështirëson komunikimin gojor të.

Një kombinim i dritës dhe i shenjave me dorë mund të përdoret për të komunikuar.

Shenjat me Dritë të Helmetës

Tri shenjat kryesore që përdoren me dritë janë:

- **Lëvizja drejt personit sinjalizohet me** – lëvizjen e llambës në formë rrethore;
- **Lëvizja larg personit sinjalizohet** – llamba lëvizet poshtë e lart; dhe
- **ndal** – llamba lëvizet prej një rës anë në tjetrën.

4.2. Procedura e mbrojtjes dhe sigurisë në minierat sipërfaqësore

Pajisjet Personale Mbrojtëse ²³

- Xhaketat reflektuese ose jelekët dhe helmetat duhet të vishen nga i gjithë personeli i minierës punuese, mbikëqyrësit dhe /ose vizitorët kur ecin / lëvizin aty ku punojnë makinat / automjetet.
- Kur ndonjë punë kryhet nga ndonjë person duhet patjetër të përdoren pajisje personale mbrojtëse të përshtatshme të aplikueshme për detyra specifike. p.sh. helmetat, syzat mbrojtëse ose syze të errëta, mbrojtëse të veshëve, respiratorë, jelekë reflektues, dorëza, rripa sigurie, çizme llastiku ose këpucë të sigurisë në punë.

²³ Mr.sc.Inxh.Hamid Nuredini, Teknika e Sigurimit në Minierë, Prishtinë, 1996.

- Sigurohuni që ju të dini rregullat relevante, standardet dhe procedurat si dhe rreziqet përcjellëse për detyrën që ju jeni të caktuar ta ekzekutoni.
- Sigurohuni që ju të dini lokacionin e aparateve për fikjen e zjarrit, rrugët e ikjes dhe pikat e mbledhjes emergjente si dhe pajisjet e ndihmës së parë.

Inspektimet para përdorimit

Të gjithë ngasësit e automjeteve dhe operuesit e pajisjeve duhet patjetër të bëjnë inspektimet e para përdorimit në automjet ose pajisje para se të operohet me to.

Procedura:

- Secili ngasës / operues do të inspekton pajisjet në fillim të ndërrimit dhe të kompletion listën kontrolluese të para përdorimit të pajisjeve aty ku është e aplikueshme, para se të operohet me pajisjen.
- Ngasësi / operuesi do të trajnohet në një procedurë për kryerjen e inspektimeve të para përdorimit, kompletimin dhe kompletimin e listës kontrolluese të para përdorimit të pajisjeve.
- Do të sigurohet që lista kontrolluese të kompletohet për çdo ndërrim për çdo makinë / pjesë e pajisjes relevante.
- Gjërat të cilat kërkohet të kontrollohen do të paraqiten në dy ngjyra, të kuqe dhe të zezë.
- Çdo pikë e printuar në të kuqe dhe nëse është në defekt, duhet të riparohet menjëherë, makina ose pajisja mund të mos përdoren derisa të kryhen këto riparime.
- Pikat e printuara në të zezë dhe që janë në defekt, makina / pajisja mund të operon me kusht që defekti të raportohet dhe të riparohet brenda 24 orëve. (Dritat të cilat nuk janë 100% efektive mund të punojnë vetëm gjatë orëve të ditës. Automjetet të cilat kanë drita me të meta nuk mund të operojnë gjatë orëve të errësirës.)
- Përveç testit të frerëve i cili bëhet gjatë inspektimit të para përdorimit, frerët do të testohen prapë në fillim të çdo ndërrimi kur shkohet poshtë rampës për herë të parë, në testin e frerëve të ndalohet regjistrimi i hyrjes në rampë.

5. KONSTATIME DHE REKOMANDIME

Edhe nëse arrijmë që t'i plotësojmë të gjitha standardet e menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit në miniera, prapë se prapë në minierat nëntokësore nuk mund të themi se jemi plotësisht të sigurt, sepse nëntoka i ka fshehtësitë e veta ku çdo herë arrinë të na befasojë, edhe përkundër të arriturave të mëdha të njerzimit me teknologji moderne prapë se prapë nuk është arritur që të zbulohen të gjitha fshehtësitë e nëntokës, kjo e sqaron edhe përshëndetjen e minatorëve "ME FAT" sepse për tu shpëtuar befasive të nëntokës përkundër përgatitjeve profesionale që duhet të bëhen duhet pasur edhe fat.

Edhe pse duhet pasur parasysh se shëndeti dhe jeta e njerëzve janë me e rëndësishmja nga të gjitha, prap se prap nevojat mëdha të njerëzve dhe të vendit, na detyrojnë që të merremi me shfrytëzimin dhe nxjerrjen e mineraleve. Mirëpo duhet që të arrihet që gjate nxjerrjes dhe përpunimit të këtyre mineraleve që ti kushtohet një kujdes të veçantë sigurisë dhe shëndetit të punëtorëve.

Që të arrihet një nivel i lartë i sigurisë dhe shëndetit në miniera atëherë duhet që i gjithë procesi të menaxhohet me përpikëri të madhe, duke filluar nga përpilimi i ligjeve me të cilat definohet dhe sanksionohet gjdo aktivitet, trajnimi i menaxhereve, trajnimi i punëtorëve, themelimi i ekipeve të shpëtimit, sigurimi i pajisjeve të punës dhe të pajisjeve të mbrojtjes në punë konform standardeve ndërkombëtare dhe përgatitja e manualeve.

Menaxheri duhet kujdesur që të aplikohen praktikat e standardeve në industrinë minerare ku përfshihen masat vijuese:

- Para-punësimit shqyrtimit / ekzaminim mjekësor;
- Shëndeti mbikëqyrjen dhe shëndeti mbikëqyrjes, rutinë ose i lidhur me rrethana të veçanta dmth ndryshimi i detyrës apo punës;
- Monitorimi i shëndetit dhe sigurisë parametrave në vendin e punës;
- Objektet për njohjen dhe trajtimin e sëmundjes dhe lëndimit në vendin e punës të shpejtë;
- Sistemet për identifikimin, monitorimin dhe kontrollin e rreziqeve të njohur apo të panjohur në vendin e punës;
- Këshilla dhe menaxhimin e planifikimit dhe organizimit të punës;
- Kontrolli për sëmundje dhe shëndetësore programet jo-profesionale;
- Mbikëqyrja e grupeve vullnetare;
- Këshilla, reagime dhe arsimit në të gjitha nivelet e punësimit.

Në ndonjë minierë ku mund të ndodhë ndonjë aksident apo ngjarje e rrezikshme, personi përgjegjës i minierës duhet të sigurojë se:

Hapat e nevojshëm ndërmerren për evakuimin dhe për trajtimin e punëtorëve të lënduar dhe merren veprimet e menjëhershme për të parandaluar rreziqet e mëtejshme që mund të paraqiten me atë rast. Një hetim i shkaqeve të aksidentit apo ngjarjeve të rrezikshme bëhet si preventivë për të shmangur ndodhjen e ngjarjeve të ngjashme në të ardhmen.

Rezultati i hetimit regjistrohet në një libër që mbahet me qëllim që të informohen autoritetet e xehetarisë (autoritetet qeveritare) në lidhje me këtë ngjarje.

Pas një aksidenti në minierë apo ndonjë ngjarje tjetër të rrezikshme, autoritetet minerare duhet të ndihmojnë minierën që të sigurojnë që praktikat e përmirësuara do të parandalojnë një gjë të tillë që të mos ndodh prapë.

Duhet punuar që vizioni të jete ***“An Kosovar minerals industry free of fatalities, injuries and diseases”***. ***“Një industri minerale Kosovare pa viktima, pa lëndime dhe pa të plagosur”***

Duhet të arrihet të krijohet DOGMA:

- Të gjithë viktime, lëndimet dhe sëmundjet janë të parandalueshme.
- Nuk ka detyrë aq të rëndësishme që nuk mund të bëhet në mënyrë të sigurt.
- Të gjitha rreziqet mund të identifikohen dhe të menaxhohen.
- Çdo njeri ka një përgjegjësi personale për sigurinë dhe shëndetin e vetë dhe të tjerëve.
- Siguria dhe performanca e shëndetit gjithmonë mund të përmirësohet.

Duke pasur parasysh se krijimi i qetave të shpejtimit me staf me përvojë dhe staf të trajnuar komfor standardeve ndërkombëtare si dhe për të pajisur këto qeta me pajisje moderne të shpëtimit dhe të intervenimit të shpejt është shumë e shtrenjtë, atëherë përveç krijimit të qetave të shpëtimit me pajisje të nevojshme në secilën minierë krijimi i një Shoqate/Agjencie të Qetave të Shpëtimit të minierave në Kosovë.

Ngritja e kualitetit dhe sigurisë në punë në operimet minerare. Edhe pse funksionimi i sektorit minerar në Kosovë shoqërohet me siguri të mirë, prapë se prapë mbetet sfida që në bashkëpunim me institucionet relevante të përvetësohen dhe zbatohen standardet teknike dhe të sigurisë që zbatohen në vendet e BE-së si:

- Promovimi i kulturës për siguri dhe mbrojtje në punë;
- Zbatimi rigoroz i masave të mbrojtjes dhe sigurisë në parandalimin e aksidenteve dhe avarive në minierat me shfrytëzim sipërfaqësor dhe nëntokësorë;
- Sigurimi i sistemit efikas të monitorimit të inspektimeve dhe hetimeve në rastet e aksidenteve dhe avarive në punë dhe evidentimi i rregullt i tyre deri te procedimi i këtyre lëndëve në gjykata;

5.1. Rekomandimet

Puna në miniera është biznes i rrezikshëm, andaj si rezultat i hulumitmit tonë, po i japim disa rekomandime apo këshilla në vijim:

- Mos e injoroni rrezikun

Hapi i parë drejt mbajtjes së sigurtë është të jesh i vetëdijshëm për faktin se puna në miniera është e rrezikshme. Prano se industria minerare është e mbushur me rrezik dhe qëndron vigjilent çdo moment në punë. Kini kujdes edhe për kolegët tuaj dhe mos lini roje tuaj poshtë. Aksidentet me ndikim të madh mund të ndodhin në një moment të pakujdesisë.

- Detyrat e rrezikshme kërkojnë planifikim dhe komunikim

Kur planifikoni detyrat, mos mendoni vetëm të plotësoni ato sa më efikase. Jepni kohë shtesë dhe para për kërkesat e sigurisë. Kurrë mos komprometoni sigurinë e punonjësve tuaj kur përpiqeni të përmbushni afatet ose të rritni cilësinë e punës. Të gjitha rreziqet duhet të vlerësohen, duke përfshirë mundësinë e aksidenteve. Mundohuni të eliminoni rreziqet sa më shumë që të jetë e mundur. Aty ku

reziku ende ekziston, jepni ekipit tuaj udhëzime të qarta dhe edukoni ata se si ta zbusin atë. Nëse është e nevojshme, merreni me rezikun nëse lindin.

- Merrni Trajnime Profesionale

Të gjithë anëtarët e ekipit duhet t'i nënshtrohen trajnimit të rregullt të sigurisë. Kjo nuk duhet të zbatohet vetëm për anëtarët e rinj të ekipit. Edhe punonjësit e vjetër duhet të bëhen për të ndjekur kurset e përsëritjes. Sesionet e trajnimit të sigurisë që përmbajnë teori dhe komponente praktike mund të jenë shumë të dobishme. Punëtorët që marrin rol të fuqishëm mund të dërgohen për kontrolle shëndetësore dhe palestër për të përcaktuar nëse ata janë në gjendje të marrin kërkesat fizike të punës së tyre.

- Gjithmonë vishni pajisjet e sigurisë

Ekziston një lammë e pajisjeve të sigurisë që përdorin punonjësit e minierave për mbrojtjen e tyre, nga helmetat në gota dhe doreza të sigurisë. Është thelbësore që të gjithë punëtorët të mbajnë pajisjet e nevojshme të sigurisë gjatë gjithë kohës. Për shembull, ka pasur histori të panumërta për punëtorët që po shpëtonin nga helmetat.

- Mbikëqyreni ekipin tuaj

Të gjithë anëtarët e ekipit duhet të ndjekin udhëzimet e sigurisë pa asnjë përjashtim. Një mbikëqyrës gjithashtu duhet të jetë i kujdesshëm për ndjekjen dhe zbatimin e rregullave. Asnjëherë mos lejoni më shumë njerëz të hyjnë në një vend se sa lejohen. Mbikëqyrësit gjithashtu duhet të dinë vendndodhjen e të gjithë anëtarëve të ekipit gjatë çdo ndërrimi. Po kështu, të gjithë punëtorët duhet të mbahen të informuar për atë që anëtarët e tjerë të ekipit bëjnë gjatë gjithë ditës. Asnjëherë mos lejoni asnjë anëtar të ekipit të shkelë rregullat e sigurisë pa paralajmërim ose, në rast të përsëritjes së mosbindjes, pasoja të dhura.

- Dokumentoni procedurat tuaja të sigurisë

Kur ndodhin aksidentet, të gjithë anëtarët e ekipit duhet të dinë saktësisht se çfarë duhet të bëjnë. Procedurat e sigurisë duhet të përcaktohen qartë. Kur dokumentoni procedurat e sigurisë, përshkruani incidentet e ndryshme që mund të ndodhin, çfarë duhet bërë dhe kujt t'i drejtoheni. Procedurat e sigurisë duhet të shfaqen në mënyrë të dukshme në vendet që mund të arrihen lehtësisht nga anëtarët e ekipit.

- Ndiqni standardet e fundit të sigurisë

Sigurohuni që të gjitha pajisjet e sigurisë të servisoen rregullisht dhe të plotësojnë të gjitha standardet më të fundit të sigurisë. Asnjëherë mos u mundoni të ruani pajisjet e sigurisë. Nëse një artikull nuk i përmbahet standardeve aktuale të sigurisë, zëvendësojeni, edhe nëse kjo do të thotë rritje e shpenzimeve ose vonesa e një projekti. Kurrë mos lejoni stafin që të përdorë pajisje të vjetruara sigurie, madje edhe për një periudhë të shkurtër kohore.

Numri i incidenteve të lidhura me sigurinë në industrinë minerare është e lartë. Për fat të keq, disa nga tragjeditë që kanë ndodhur mund të jenë parandaluar. Mos përsërit gabimet që janë bërë nga të tjerët.

Ndërsa rreziqet nuk mund të eliminohen plotësisht, ndjekja e këshillave të mësipërme mund të ndihmojë shumë.

Literatura

1. A.Jakupi, 2005. *Metodologjia e Punës Shkencore dhe Kërkimore*, Prishtinë;
2. Abrashi,R. 1985, *Ajërimi i minierave*, Prishtinë;
3. Lita,S. 1971,*Teknika e sigurimit në minierë I,II*, Tiranë;
4. Nuredini,H. 1982, *Shqyrtimi i ngjitjes së thëngjillit të Kosovës në bunkerët e seperacionit dhe aplikimi i gjuajtësve pneumatik për rrezuarjen e materialit të ngjitur – nga aspekti i sigurisë, punim profesional, revistë e EEK-së Nr.4/1982;*
5. I.Shehu,2013, *ligjëratë e autorizuar, Menaxhimi i emergjencave medikale, K. Biznesi, 2013;*
6. *I.Shehu, Menaxhimi i programeve preventive në emergjenca, Kolegji Biznesi, Ligjeratë e autorizuar;*
7. B. Andjelkovic, 2005, *Uvod u zastitu, radna i zivotna sredina*, Nis;
8. J.Milutinovic, 1982, *Organizacija zastite na radu*, Nis;
9. H.Nuredini & M.Mehani, 2013, *Mbrojtja teknike në procesin e punës*, Kolegji Biznesi, Prishtinë;
10. Kuvendi i Kosovës, 2010, *Ligji i Punës Nr. 03/L-212;*
11. Kuvendi i Kosovës, 2013, *Ligji për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, Nr. 04/L-161;*
12. Kuvendi i Kosovës, 2016, *Ligji Nr.05/L-062 Për Siguri në punë në veprimtarinë minerare, Prishtinë;*
13. Prof.Dr.Minir Dushi, *Pajisjet Minerare Ngritëse*, Prishtinë;
14. Ferat Shala, Sala Berisha-Shala, Bislim Muça, TREPÇa, 2014, *Ristrukturimi, Sfidat dhe Perspektiva*, Prishtinë;
15. Dr.sc.Ibush Luzha, 2018, *Praktika Planifikuese në Emergjenca, Ligjeratë e autorizuar, Prishtinë;*
16. Mr.sc.Inxh.Hamid Nuredini, 1996, *Teknika e Sigurimit në Minierë*, Prishtinë;
17. Ministria e Zhvillimit Ekonomik, 2012, *Strategjia Minerare e Republikës së Kosovës për periudhën 2012-2025*, Prishtinë;
18. Agjencia Kosovare për Standardizim, 2011, *Katalogu i Standardeve Kosovare*, Prishtinë;
19. Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, 2018, *Raporti vjetor për vitin 2017*, Prishtinë;
20. Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, 2012, *Rregullore Nr.08/2012, Për Pajisjet Personale Mbrojtëse*, Prishtinë;

LANGUAGE AND EDUCATION RESEARCH PAPERS

EFEKTET E REFORMËS ARSIMORE PËRMES PLATFORMËS SË EDUKIMIT FIZIKO-SPORTIV NË SHKOLLA

Doktorante Albana Hodaj

ahoday@ymail.com

Abstract

Në Arsimin Parauniversitar Shqiptar korniza kurrikulare ka pësuar transformim të thellë e të plotë strukturor e përmbajtësor, duke u fokusuar tek dija që aftëson nxënësit me kompetencat kyce për jetën dhe nxit vlerat e qytetarisë evropiane dhe asaj globale. Pjesë e rëndësishme e kësaj reforme, ka qenë hartimi, miratimi dhe jetësimi i Platformës së edukimit fiziko-sportiv që zbatohet në arsimin parauniversitar nga shtatori i vitit 2014 në klasat I-XII me tri orë në javë.

Po cilat janë efektet që ka prodhuar zbatimi i saj në shkolla, si ka ndikuar tek nxënësit, prindërit, mësuesit e edukimit fizik dhe komunitetet tona? Si ndikoi shtimi i orëve mësimore në kërkesën për burime të reja njerëzore dhe si iu përgjigjën Universitetet këtij “tregu” të ri pune? Si u fokusua informimi dhe këshillimi i maturantëve për përzgjedhjen e degëve në Sport? Po ndërhyrjet në infrastrukturën arsimore, sa e kanë lehtësuar zhvillimin e orës së edukimit fizik, në nivel bashkëkohor të mësimnxënies me bazë kompetencat? Nxënësit, përmes zbatimit të kësaj platforme, a po përvetësojnë aftësi dhe shkathtësi të reja lëvizore, a janë më entuziastë në lëndën e edukimit fizik, më të motivuar, më energjikë dhe më të kënaqur, më të shëndetshëm e më paqësorë?

Metodologjia e vëzhgimit të orëve mësimore, matjes dhe krahasimit të të dhënave sasiore trupore të nxënësve sipas standardeve që ofron kjo platformë si dhe realizimi i pyetësorëve, janë përdorur për të vlerësuar efektet e kësaj reforme në shëndetin e popullatës shkollore.

Mësuesi i edukimit fizik mbetet faktor kyç dhe i pazëvendësueshëm, që përmes profesionalizmit dhe pasionit, evidenton dhe nxit talentet, jo vetëm në disiplinat e veçanta në klasat sportive, por mbi të gjitha, krijon personalitete të “gjalla” që “vrapojnë në rërë” e jo “robotë” pasivë që presin detin në ekranin e Ipod-it, me një hamburger të stërmadh në duar.

Si përfundim, Platforma e edukimit fiziko-sportiv ka ngritur mbi parime shkencore, ligjore, sociale dhe kombëtare lëndën e edukimit fizik dhe ndikon në rritjen e gjeneratave të shëndetshme, përmes masivizimit të kulturës sportive.

***Termat kyçe:** platformë, edukim fizik, kulturë masive, shëndet, popullatë shkollore.*

Efektet e reformës arsimore përmes Platformës së edukimit fiziko-sportiv në shkolla

Në Arsimin Parauniversitar Shqiptar korniza kurrikulare ka pësuar transformim të thellë e të plotë strukturor e përmbajtësor, duke u fokusuar tek dija që aftëson nxënësit për jetën dhe edukon vlerat e qytetarisë evropiane dhe asaj globale. Sot kemi një kurrikul plotësisht të reformuar nga parashkollori e deri në klasën XII, mbi bazën e së cilës janë hartuar programet lëndore e planet mësimore, të cilat kanë bërë më fleksibël dhe më funksional procesin e nxënies sipas nevojave të nxënësve.

Reformat arsimore janë pjesa më e rëndësishme e zhvillimit të qëndrueshëm të një vendi e në vendin tim këtë barrë e mbajti një reformatore kurajoze si Lindita Nikolla, si asnjë burrë ministër më parë, ministrja grua, me vullnetin për të ndryshuar thellësisht cilësinë në arsim, por më së pari, për të sjellë një mendësi të re, të prekshme e të vërtetë: një arsim larg politikës. Ky vizion i saj si pjesë e vizionit të qeverisë “Rama 1”, solli një reformë të thellë në burimet njerëzore, nga kalimi i mësuesve në profilin përkatës, largimin e atyre pa arsimin e duhur sipas ligjit e deri tek krijimi i një praktike të re të punësimit të mësuesve, përmes Portalit “Mësues për Shqipërinë”, proces i rregulluar tashmë edhe me ligjin e arsimit parauniversitar 69/2012 të ndryshuar. U ngrit një sistem transparent, publik e sipas meritës, por që krijoi “pakënaqësi” dhe përplasje nga ana e politikës, për mungesë influence në punësime, ndërkohë që praktika vijon të përmirësohet me ndryshimet e nevojshme në udhëzimin përkatës për mirëmenaxhimin e këtij portali kombëtar.

Ulja e ngarkesës mësimore, normës së drejtuesve dhe numrit të nxënësve për klasë, solli jo vetëm lehtësim të punës së nxënësve dhe stafeve mësimore, por uli ndjeshëm efektet sociale për mësuesit e rrezikuar në vendin e punës. Për herë të parë drejtuesi i institucionit arsimor u bë punëdhënës i drejtpërdrejtë për punonjësit mësimorë dhe jomësimorë të institucionit arsimor që menaxhonte.

Vlerësimi dhe mendimi i prindërve për mësuesit dhe drejtuesit mori një rol të ri. U ngritën këshillat rajonale dhe kombëtare të prindërve si dhe u zhvilluan ditë të hapura për bashkëhartimin e planeve në shkolla. Në vitin 2017-2018 në Drejtorinë Rajonale Vlorë 10.170 prindër morën pjesë aktive në diskutimin, sugjerimet dhe miratimin e planeve shkollore. Nga këto plane të bashkëhartuara prindër-mësues- drejtues, përfituan 18.730 nxënës dhe 1652 mësues nga përcaktimi i përbashkët i regjuesve të arritjes në shkolla.

Identifikimi i nevojave të çdo mësuesi në nivel kombëtar dhe mbështetja e tyre me trajnime e kualifikime sipas këtyre nevojave, ka orientuar e ndihmuar zhvillimin profesional të mësuesve, duke ndikuar drejtpërdrejt në rritjen e cilësisë në procesin mësimdhënës e edukativ. U krijuan rrjetet profesionale sipas profileve lëndore e pozicionit të punës. Aktualisht këtë vit mësimor në drejtorinë e Vlorës funksionojnë 51 rrjete profesionale. Përmes trajnimeve online, mësuesit plotësojnë nevojën e tyre për kualifikim, duke vetëpërzgjedhur agjensinë e modulën që duan. Një nevojë gjithëpërfshirëse u vu re në trajnimet për kurrikulën e re, për nismën “3 lëndë në 6 orë”, portofolin e të nxënësve, vlerësimin e arritjeve të nxënësve si dhe në trajtimin e fëmijëve me aftësi ndryshe.

Reforma e teksteve solli në duart e nxënësve tekste bashkëkohore nga shtëpitë e botimit Cambridge, Pearson, Oxford dhe nxori nga përdorimi një numër të madh tekstesh me autorë anonimë e me probleme të shumta shkencore. Procesi i përzgjedhjes u bë më i lehtë nga numri më i kufizuar i

alternativave dhe u dha mundësinë mësuesve për t'i vlerësuar nëpërmjet pyetësorëve për secilën lëndë.

Ndryshime ndodhën edhe me Maturën Shtetërore. U shpall pragu kalues, u rrit mesatarja hyrëse në universitet mbi notën 6 (gjashtë) dhe proceset u miradministruan me angazhim dhe bashkëpunim ndërinstytucional. Të gjitha këto ndryshime, përpos risive dhe përmirësimit cilësor të treguesve të arritjes, matur nga renditja lokale sipas kartës së performancës së shkollave apo rankimit kombëtar, bazuar në rezultatet e maturës shtetërore, kanë dhe kufizimet e tyre, që duhen marrë në konsideratë nga institucionet politikëbërëse në arsim, siç është ***burokracia e shtuar shkresore-administrative, gjë e cila ul produktivitetin e procesit të nxënies, largon vëmendjen nga thelbi i orës së mësimi si dhe rrit pakënaqësinë dhe stresin në punë të mësuesit.***

Në qasjen e re të bashkëpunimit shkollë-komunitet, ishte dhe kthimi i shkollave në qendra komunitare. Po në vitin 2017-2018 në DAR-in Vlorë, përmes kordinatorëve të trajnuar në 9 shkollat që u përzgjedhën për këtë projekt, u zhvilluan 178 aktivitete sipas planeve të veprimtarive vjetore të rakorduara sipas udhëzuesit të MAS-it. Kjo qasje ka kthyer shkollën në mjedis komunitar, çlodhës, argëtues e zbavitës për nxënësit e komunitetin edhe pas orarit mësimor.” 81.7% e mësuesve në arsimin parauniversitar pohojnë se si pasojë e reformës në arsimin parauniversitar, shkolla është bërë më miqësore dhe më gjithëpërfshirëse.” (MAS, 2017:100) Po të njëjtin perceptim pozitiv kanë 81% e prindërve të pyetur sipas të njëjtit studim.

Pjesë e rëndësishme e reformës arsimore, ka qenë hartimi, miratimi dhe jetësimi i Platformës së edukimit fiziko-sportiv që zbatohet në arsimin parauniversitar nga shtatori i vitit 2014 në klasat I-XII me tri orë në javë. Po cilat janë efektet që ka prodhuar zbatimi i saj në shkolla, si ka ndikuar tek nxënësit, prindërit, mësuesit e edukimit fizik dhe komunitetet tona? Si ndikoi shtimi i orëve mësimore në kërkesën për burime të reja njerëzore dhe si iu përgjigjën Universitetet këtij “tregu” të ri pune? Si u fokusua informimi dhe këshillimi i maturantëve për përzgjedhjen e degëve në Sport? Po ndërhyrjet në infrastrukturën arsimore, sa e kanë lehtësuar zhvillimin e orës së edukimit fizik, në nivel bashkëkohor të mësimnxënies me bazë kompetencat? Nxënësit, përmes zbatimit të kësaj platforme, a po përvetësojnë aftësi dhe shkathtësi të reja lëvizore, a janë më entuziastë në lëndën e edukimit fizik, më të motivuar, më energjikë dhe më të kënaqur, më të shëndetshëm e më paqësorë?

Përkatësisht në arsimin fillor (AF), lënda “Edukim fizik, sporte dhe shëndet” zhvillohet përgjatë 105 orëve vjetore, në tri orë mësimore në javë, të cilat edhe mund të rigrupohen në varësi të planifikimit të mësuesit, prindërve, nxënësve dhe drejtuesve të shkollës. Po kështu, kjo fushë/lëndë zhvillohet me të njëjtën sasi orësh, 105 orë vjetore, me tri orë mësimore në javë, edhe në arsimin e mesëm të ulët (AMU), nga klasa e gjashtë deri në klasën e nëntë (VI-IX).

Në arsimin e mesëm të lartë (AML) në klasat X-XI zhvillohen gjithsej 108 orë vjetore për lëndën e kurrikulës bërthamë, ndërsa për kurrikulën me zgjedhje, në klasat X-XI me 1 orë mësimore në javë, zhvillohen gjithsej 36 orë mësimore në vit. Në klasën XII (AML) fushë/lënda “Edukim fizik, sporte

dhe shëndet” zhvillohet me tri orësimore në javë dhe me 34 orë vjetore, nisur dhe nga ngarkesa e programit të Maturës Shtetërore. Nëse do të bënim paraqitjen në tabelë:

Klasa	Orë mësimore vjetore	Orë/javë
1-5	105	3
6-9	105	3
10-11	108 (kurrikul bërthamë)	3
	36 (kurrikul me zgjedhje)	1
12	102 (kurrikul bërthamë)	3
	34 (kurrikul me zgjedhje)	1

Platforma iu përgjigj qasjes dhe shtrirjes së kurrikulës së re në të gjitha ciklet e arsimit parauniversitar. Instituti i Zhvillimit të Arsimit (IZHA) nxori udhëzuesit përkatës edhe për Platformën e edukimit fizik, të cilët zbërthejnë strukturën, planet lëndore vjetore dhe organizimin e temave sipas tremujorëve, qëllimet dhe metodologjinë e punës së mësuesit në hartimin e planit mësimor, vlerësimin bazuar në rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyçe. Këto dokumente administrative arsimore kanë lehtësuar punën e mësuesit të edukimit fizik duke i bërë më konkretë synimet e lëndës dhe më cilësor e të matshëm procesin e nxënies si në orën mësimore, dhe jashtë saj.

Një rol i rëndësishëm i është dhënë procesit të vlerësimit, ku nota nuk shihet si qëllim në vetvete. Ajo shërben si një instrument që jo vetëm *mat* arritjet e nxënësve, shprehitë, shkathësitë lëvizore, fizike, emocionale dhe socializuese, por ajo kthehet në mjet motivues për përmirësimin e treguesve të arritjes, në mbështetje të një procesi mësimdhënës e mësimnxënës sa më efektiv. Rezultatet në vlerësimin e vazhduar përbëjnë 40% të vlerësimit të përgjithshëm, vlerësimi i portofolit të lëndës 20% dhe 40% zë vlerësimi me test/detyrë përmbledhëse. Kjo mënyrë e re vlerësimi me të gjitha llojet e vlerësimit, ndihmon mësuesin të dokumentojë progresin e nxënësit apo mangësitë e tij dhe sjell një njohje më të plotë dhe më objektive të pikave të forta dhe të dobëta të secilit nxënës në klasë. Bazuar në këto rezultate, mësuesi ndërton punën për rritjen e nivelit, duke planifikuar metoda të larmishme dhe veprimtaritë e duhura sportive, lëvizore, shëndetësore apo komunitare.

Risi e kësaj platforme është qasja për edukim sportiv komunitar dhe masivizimi pasqyrohet si rrugë e shpejtë, e drejtë dhe e domosdoshme për shëndetin e njerëzve e nëse platforma u shërben shkollarëve, shëndeti u duhet të gjithëve. Dhjetëra aktivitete kanë mbushur rrugët e qyteteve me nxënës në orë mësimore të edukimit fizik, në kroset masive, maratona e gara çiklistike, duke u bërë promotorë të idesë se sporti është kultura më e shëndetshme për njeriun. Përgjatë vijës bregdetare të Vlorës, aty ku bashkohen deti Adriatik dhe Jon, janë zhvilluar ditë sportive me gara noti e ushtrime të larmishme

fizikulturore e argëtuese, duke marrë jodin e detit dhe duke u dhënë prindërve gëzimin e fëmijëve të shkathët e plot energji. Qytetit, një ditë ndryshe, me zhurmë e diell, që e bëjnë më të gjallë bregun dhe më optimistë njerëzit e tij.

Përmes kësaj energjie që buron nga një orë e thjeshtë mësimore, fëmija vrapon, mëson të luajë, të shohë qytetin a fshatin e tij, të fitojë a të humbë në një ndeshje klase, shkolle a rajoni e pse jo, nxitet për të qenë një lider skuadre sot, e nesër, një udhëheqës, një kampion a një mësues i edukimit fizik që përpiqet të kultivojë dije, shëndet e gjallëri.

Ky perceptim në dijen shkencore mund të konsiderohet si opinion a një dije e rëndomtë, po nëse kjo e vërtetë vjen “e matur” nga 10.000 fytyra të lumtura fëmijësh në veprimtarinë kulturoro-sportive të 1 Qershorit në rrugët e qytetit, në përplotësinë e shkallëve dhe fushës së stadiumit “Flamurtari” e Pallatit të Sportit në ndeshje e gara olimpike modeste, me zëra nxënësish që luajnë, argëtohen, garojnë e djersijnë të ngazëllyer, atëherë misioni i shkollës është përmbushur!

Le të marrim kompetencën e të shprehurit dhe të komunikimit në këto organizime masive. Nxënësit përmes demonstrimeve, përcjellin një mesazh masiv për sportin. Përmes komunikimit verbal organizojnë lojën, menaxhojnë emocionet, çlirojnë energji dhe argumentojnë apo vlerësojnë shokun a shoqen në një lojë sportive. Gjuha e trupit, gjestet në lojë dhe shenjat, i aftësojnë në komunikim duke respektuar edhe komunikimin joverbal si element në komunikimin njerëzor. Sporti u mëson një leksik specifik, brenda të cilit gjejnë kuptimin e fjalëve “humbje” apo “fitore”, “lojëtar” apo “skuadër” dhe që kanë mundësinë t’i zërthejnë në paragrafë të tërë esesh argumentuese, si pjesë e integritimit ndërlëndor dhe ndërthurjes së kompetencave.

Programi mësimor sipas kësaj platforme i ka aftësuar nxënësit për të argumentuar mbi efektet e ushtrimeve fizike në trupin e njeriut, ndikimin e sportit në një zhvillim trupor të shëndetshëm, estetik dhe harmonik. Nxënësit priren të njohin rregullat e sigurisë dhe të përshtatin teknika të reja lëvizore sipas situatave të ndryshme jo vetëm sportive, por dhe jetësore. Ata janë të aftë të hartojnë projekte të thjeshta, me ide novative dhe interesante, si në drejtim të paketave ushqimore të shëndetshme, por edhe me praktika sensibilizuese kundër duhanit, alkoolit, drogës apo varësisë nga teknologjia.

Nxënësit vijnë më të motivuar në ditën mësimore kur kanë edukim fizik. Ata përpiqen të jenë seriozë e të përgjegjshëm në paraqitjen me uniformën sportive të shkollës. Klasat sportive të organizuara me disiplinat: futboll, volejbol dhe basketboll, po sjellin evidentimin dhe nxitjen e talenteve në këto sporte, si premisë për sportistët e ardhshëm dhe ngjarje të larmishme shkollore, lokale e kombëtare.

Përmes vëzhgimit të orëve mësimore, matjes dhe krahasimit të të dhënave sasiore trupore të nxënësve sipas standardeve që ofron kjo platformë si dhe realizimi i pyetësorëve sasiorë, tregojnë efektet pozitiviste të kësaj reforme në shëndetin e popullatës shkollore, si premisë për miredukim dhe masivizim të kulturës sportive.

Në intervistat e bëra me ta, nuk ngurojnë të thonë se “fizikultura” është lënda që i bën të ndihen më të çlirët, më socialë dhe më entuziastë. I njëjti rezultat vjen edhe nga nxënësit në shkollat e rrethinave apo fshatrat e thella, pavarësisht faktit se disa prej tyre kanë mungesë të kushteve infrastrukturore,

përgjigjet janë të ngjashme, pothuajse të njëjta me shkollat që kanë terrene sportive apo palestra bashkëkohore: ora e edukimit fizik është dritare që oksigjenon mendjen e lodhur nga lëndët e tjera dhe është mjet argëtimi që nuk mbaron me orën mësimore. Kjo lëndë shihet prej tyre dhe si një “nxemje” për trup estetik apo si arenë e vetëkënaqësisë nga demonstrimi i aftësive fizike dhe parametrave truporë të moshës. Megjithatë, kushtet dhe mjetet mësimore në këtë lëndë, lehtësojnë punën e mësuesit dhe përmirësojnë ndjeshëm klimën e realizimit të procesit mësimor-edukativ.

Si risi thelbësore solli dhe hapjen e vendeve të reja të punës për mësues të profilit të edukimit fizik, madje shumë institucione arsimore në mbarë vendin u gjetën të papërgatitura për të mbuluar këto nevoja sipas kërkesave të ligjit për arsimin. Filluan trajnimet nga një trupë profesionistësh në krye të së cilës u vu vetë ideatori i platformës atleti kampion, ish-zëvendësministri i sporteve, Prof. Rauf Dimraj. Skeptikëve i kundërvuri mendimin se ushtrimet e thjeshta lëvizore nuk kishin nevojë për palestra moderne dhe se talentin në sport, nuk e bënte cilësia e godinës. Si një njeri i garave, prof. Dimraj këmbëngulte me bindje se vetëm mësuesi i pasionuar, mund t’i jepte jetë këtij dokumenti shkresor, edhe pse u përball me nevojën për shumë mësues të këtij profili.

Pavarësisht rëndësisë që ka platforma, mësuesi i edukimit fizik mbetet faktor kyç dhe i pazëvendësueshëm në procesin e dijes dhe edukimit, që përmes profesionalizmit dhe pasionit, evidenton dhe nxit talentet, jo vetëm në disiplinat e veçanta në klasat sportive, por mbi të gjitha, krijon personalitete të “gjalla” që “vrapijnë në rërë” e jo “robotë” pasivë që presin detin në ekranin e Ipod-it, me një hamburger të stërmadh në duar.

Nisur nga ky realitet i ri, disa universitete filluan hartimin, akreditimin dhe hapjen e programeve të reja në degët e sportit dhe mësuesisë në sporte, duke zvogëluar ndjeshëm përgjatë këtyre 5 viteve nevojën për burime njerëzore në këtë profil. Universitetet filluan me një qasje më optimiste dhe më angazhuese procesin e edukimit të karrierës me maturantët, për të përzgjedhur në formularë një nga degët e studimit në sport. Kjo nevojë ende mbetet e papërbushur dhe do kërkojë edhe disa vite, ndërkohë që profile të tjera janë të shumta. Po si u përceptuan këto ndryshime reformuese nga prindërit dhe vetë mësuesit në shkolla?

Sipas Raportit Kombëtar të Ministrisë së Arsimit e Sportit në vitin 2017, mbi perceptimin e mësuesve dhe prindërve të cilësisë së reformës në arsimin parauniversitar në Republikën e Shqipërisë, “86.3% e prindërve pohojnë se pesha më e madhe që i është dhënë edukimit fizik dhe sporteve, i ndihmon fëmijët për zhvillimin e aktivitetit fizik dhe edukimin për një stil jetese të shëndetshëm.” Po kështu vlerësim pozitiv kanë dhe 85.9% e mësuesve, lidhur me rikonceptimin e kurrikulës së sporteve dhe vlerën e saj në ndërgjegjësimin e nxënësve për shëndetin e tyre (MAS, 2017:100).

Në këtë rrjedhë procesesh reformuese në arsimin parauniversitar, platforma e edukimit fiziko-sportiv mbetet një dokument shumë i rëndësishëm arsimor e shëndetësor, frymëzues, motivues dhe edukues në institucionet tona arsimore. Kjo platformë ka ngritur mbi parime shkencore, ligjore, sociale dhe kombëtare lëndën e edukimit fizik dhe ndikon drejtpërdrejt në rritjen e brezave të shëndetshëm, përmes masivizimit të kulturës sportive.

Reformat bëhen nga njerëzit dhe për njerëzit, sasia dhe shpeshtësia e tyre nuk nënkupton cilësinë në çdo rast. Do të duhen disa vite të matet reformimi i cilësisë së teksteve, kornizës kurrikulare apo dhe riorganizimit të institucioneve administrative arsimore në nivel kombëtar, bazuar në rezultatet e arritjeve të nxënësve, krahasuar me bashkëmohatat e tyre në rajon e më gjerë përmes testeve ndërkombëtare e nivelit të kënaqësisë në shkolla. Ndërkohë deri atëherë, platforma e edukimit fiziko-sportiv, ky dokument i vyer arsimor, do të qëndrojë si një arterie e fuqishme në organizmin shkollor kombëtar, duke ushqyer shëndetshëm gjeneratat shkollore.

Bibliografia/Referenca

- MAS (), Platforma e edukimit fiziko-sportiv.
- IZHA (2018), Korniza Kurrikulare e arsimit parauniversitar.
- IZHA (2016-2018), Programet me kurrikulën e bazuar në kompetenca klasa 10,11,12.
- IZHA (2015), Korniza e vlerësimit të nxënësit.
- IZHA (2017), Udhëzuesit e zhvillimit të kurrikulës në arsimin e mesëm.
- MAS (2017), Raport Kombëtar. Perceptimi i mësuesve dhe prindërve mbi cilësinë e reformës së arsimit parauniversitar në RSH.

PËRMIRËSIMI I PROCESIT TË MËSIMDHËNIES NË KIMINË ORGANIKE NËPËRMJET APLIKIMIT TË MJETEVE TEKNOLOGJIKE

Manjola Bani¹, Romina Agaçi²

¹Departamenti i Kimisë, Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë, manjola.bani@univlora.edu.al

²Departamenti i Shkencave Kompjuterike, Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë, romina.agaci@univlora.edu.al

ABSTRACT

Kimia si shkencë nuk është grumbullim njohurish por veprimtari e gjallë e gjithnjë në zhvillim. Para së gjithash ajo është vetpërtëritëse dhe çdo koncept i ri nxit vrojtime dhe eksperimentime që çojnë në përsosjen e tij dhe në zhvillimin e koncepteve të reja. Kimia bashkon shkencat së bashku, ndaj luan rolin kryesor në botën e shkencave natyrore. Mësimi i shkencës së kimisë i ofron nxënësve mundësinë për të zhvilluar të kuptuarit e koncepteve dhe të proceseve shkencore, e praktikave më të përdorura nga njeriu për zhvillimin e njohurive shkencore, e kontributit të shkencës në shoqëri dhe të zbatimeve të saj në jetën e përditshme. Kompetencat që zhvillon fusha e kimisë u shërben individëve në aspektin personal, social, ekonomik dhe që lidhen me çështje lokale, kombëtare dhe globale në funksion të të nxënësve gjatë të gjithë jetës. Megjithatë, studentët dhe pedagogët gjejnë gjithmonë vështirësi lidhur me këtë lëndë, sidomos në fushën e kimisë organike. Mund të përmendim: mungesa dhe vështirësia e përqendrimit, vështirësia për të kuptuar strukturat tri-dimensionale (3D) në letër si dhe ato konformacionale (“kalë dhe karrike”), pamundësia për të parë dhe manipuluar objektet 3D, energjia e pamjaftueshme dhe mungesa e motivimit, mungesa e praktikave, analiza e dobët e problemeve, vështirësia e zhvillimit të praktikave laboratorike etj. Ndërkohë që studentët humbasin interesin e tyre për të studiuar kiminë, është thelbësore që të përdoren teknologji inovative për të përmirësuar qasjet pedagogjike dhe për të tërhequr studentët në një mënyrë më argëtuese. Për të nxënësit e suksesshëm është bazë mësimdhënia efektive. Ekzistojnë mjete dhe metoda të ndryshme teknologjike që u mundësojnë studentëve të perceptojnë dhe eksplorojnë konceptet abstrakte, si dhe të zbulojnë marrëdhënien ndërmjet objekteve dhe dukurive. Synimi i këtij punimi është t’i japi zgjidhje problematikave që hasen në fushën e kimisë kryesisht asaj organike duke prezantuar disa mjete teknologjike (ose ndryshe tools-e) që mundësojnë përmirësimin e mësimdhënies dhe arritjen e objektivave, të konkludoj impaktin që japin këta elementë në vizualizimin e strukturave 3D, konformacioneve, rritjen e interesit në këtë fushë dhe rritjen e nivelit të bashkëpunimit mësimdhënës-mësimnxënës duke krijuar kështu një spostim të avancuar të metodologjisë së mësimdhënies, nga ajo tradicionale në atë bashkëkohore.

Keywords: *Kimia Organike, Strukturat 3D, Qasjet Pedagogjike, Mjete Teknologjike*

1.Hyrje

1.1 Mësimdhënia në kimi

Arsimi i kimisë është studimi i mësimdhënies dhe mësimit të kimisë në të gjitha shkollat, kolegjet dhe universitetet. Tematikat përfshijnë të kuptuarit se si studentët mësojnë kimi, se si të mësojnë më mirë kiminë dhe si të përmirësojnë rezultatet e mësimit duke ndryshuar metodat e mësimdhënies. Mësimdhënia, vecanërisht ajo e Kimisë është një proces jo i lehtë, si veprimtari e rëndësishme shoqërore dhe me përgjegjësi. Art? Shkencë? apo të dyja së bashku? Nëse mësimdhënia është art, kërkon frymëzim, intuitë, talent e krijimtari e nëse është shkencë, mësimdhënia kërkon njohuri dhe shprehje. Mësimdhënia më e mirë është ajo gjatë se cilës përmbushen objektivat, aktivizohet studenti, nxitet ndërveprimi, përdoren pyetje të niveleve më të larta, ku studenti është në qendër të mësimdhënies. Pra mësimdhënia është një proces i cili planifikohet, drejtohet, organizohet nga mësimdhënësi sipas stileve të të nxënit dhe me pjesëmarrjen aktive të studentëve. Arti i mësimdhënies po zhvillohet vazhdimisht dhe përparon, duke bërë që mësimdhënësit e kimisë të rivlerësojnë metodat e tyre të mësimit çdo vit.

Qëllimi i këtij rishikimi është identifikimi i metodave dhe teknologjive aktuale pedagogjike që përdoren më së miri për të mësuar kiminë. Vetë emërtimi mësimdhënie bashkëkohore nënkupton një mësimdhënie ndryshe nga ajo tradicionale. Kjo nënkuptohet në shumë aspekte si: në strategji (të përshtatshme në procesin e të nxënit të studentëve), metoda, teknika, forma. Ndërsa kimia është pjesë e jetës sonë të përditshme, studentët kanë gjetur se kimia mund të jetë e vështirë për t'u kuptuar, për t'u mësuar, sepse futen në lojë shumë lloje të ndryshme të të menduarit. Për ta mësuar me sukses atë, duhet të jemi në gjendje të japim udhëzime matematikore, teknike praktike, vizualizimi 3-D dhe mësim historike. Duhet të mësojmë studentët të jenë të durueshëm me procesin e të mësuarit të kimisë, është pjesë e punës së mësimdhënies. Nuk do të jemi në gjendje të përcjellim të gjitha këto duke qëndruar para klasës dhe duke bërë asgjë, por duke ligjruar! Nëse një student zbulohet se është i dobët në këtë fushë, duhet dhënë përkrahje shtesë për ta ndihmuar atë student në mënyrë që të mund të ketë një mundësi për të realizuar potencialin e tij të plotë. Mësimdhënësit duhet t'i ndihmojnë studentët e tyre që ata të zbulojnë idetë dhe konceptet që fshihen pas faqeve që lexojnë. Jo të gjithë mund ta bëjnë këtë. Janë shumë ata që mund të japin mësim, por janë pak ata që mund të quhen mësimdhënës të mirë. Mësimdhënës eficientë janë ata që lexojnë, që janë në kontakt të vazhdueshëm me të rejtat në disiplinën e tyre dhe në fushën e mësimdhënies, dhe që njohuritë e marra dinë t'i zbatojnë në klasë. Kjo nuk është e lehtë. Ky proces kalon përmes sfidave të vazhdueshme, të cilat, kur kalohen, prodhojnë mësimnxënien e dëshirueshme. Në këtë kuptim efektiviteti i orës së mësimit s'njeh kufij. Ai, siç ka lidhje më përvojën shoqërore, sfondin akademik, nivelin e zhvillimit, dëshirën për përparim, po aq ka lidhje dhe kushtëzohet nga premisa fillestare. Kjo premisë ka dy komponentë që shpeshherë influencojnë njëri-tjetrin: (1) dëshirën për profesionin e mësimdhënësit dhe (2)

zhvillimin dhe përsosjen e mjeshtërisë. Pedagogët e rinj përgjithësisht karakterizohen nga dëshira për profesionin. Duke qenë në fillimet e punës së tyre në fushën akademike, ata janë të interesuar të mësojnë sa më shpejt sekretet e një mësimdhënie efektive. Në fakt, metodat e mësimdhënies të përdorura në orët tona mësimore janë të kufizuara. Shumë orë mësimi janë “ të mërzitshme”. Ato zhvillohen në mënyrë standarde dhe nuk i përgjigjen situatave konkrete në të cilat zhvillohet mësimi. Prandaj është shumë e rëndësishme të rritet niveli i interesit dhe të përmirësohet qasja pedagogjike, për një të nxënë të suksesshëm dhe përmirësim të procesit të mësimdhënies. Duke përdorur teknologjinë, mësimdhënësit mund të sjellin kimi në jetë dhe studentët do të jenë në gjendje të përfytyrojnë koncepte abstrakte dhe të provojnë konceptet e reja të mësuara në kimi.

1.2 Mësimdhënia në Kiminë Organike nëpërmjet teknologjisë

Kimia Organike, e konsideruar si një fushë e vështirë për t’u kuptuar nga studentët, lejon përfshirjen e teknologjisë (zbatimi i mjeteve teknologjike) në procesin e mësimdhënies kim-organike, si përparësi e vlefshme jo vetëm për mësimdhënësit por edhe për studentët. Në vendin tonë integrimi i teknologjisë në fushën e arsimit është një proces i vlefshëm në zhvillim e sipër. Meqenëse teknologjia është e pranishme në jetën e përditshme si të studentëve dhe të pedagogëve atëherë integrimi i saj në mësimdhënie mendohet si një domosdoshmëri që duhet të arrihet sa më parë. Kjo për të tërhequr studentët të përfshihen më tepër në procesin mësimor: duke e lehtësuar të mësuarin, duke mos qenë të izoluar nga teknologjia kur të hyjnë në klasë (duke u bërë ora e mësimit e mërzitshme) dhe do të jenë të motivuar për të arritur në këtë mënyrë rezultate të kënaqshme. Interneti u mundëson mësimdhënësve të zgjedhin e të përdorin një sërë mjeteve teknologjike për të përmirësuar mësimdhënien e lëndës së kimit organike.

2.1 Problemet që zgjidhen me përdorimin e mjeteve teknologjike:

- Mungesa dhe vështirësia e përqëndrimit
- Vështirësia për të kuptuar strukturat tridimensionale në letër
- Vështirësia për të parë dhe manipuluar objektet 3 Dimensionale
- Energjia e pamjaftueshme dhe mungesa e motivimit
- Mungesa e praktikave
- Vështirësia e zhvillimit të praktikave laboratorike

Disa mësues dhe ekspertë janë kundër trendeve të implementimit të mjeteve (tools) në çdo aspekt të sistemit të shkollimit, kryesisht për shkak se teknologjia është një burim shpërqëndrimi për studentët.

Megjithatë, integrimi i duhur teknologjik i udhëzon studentët drejt një kuptimi më të mirë të të gjitha koncepteve të mbuluara në klasë.

2. Metodologjia e studimit

Në këtë punim është synuar një zgjidhje e problematikave që hasen në fushën e kimisë kryesisht asaj organike duke prezantuar disa mjete teknologjike (ose ndryshe tools-e) që mundësojnë përmirësimin e mësimdhënies, arritjen e objektivave, impaktin që japin këta elementë në vizualizimin e strukturave 3D, konformacioneve, rritja e interesit në këtë fushë dhe rritjen e nivelit të bashkëpunimit mësimdhënës-mësimnxënës duke krijuar kështu një spostim të avancuar të metodologjisë së mësimdhënies, nga ajo tradicionale në atë bashkëkohore.

2.1 Disa prej mjeteve teknologjike që ndihmojnë në modelimin e strukturave 3D

Për të bërë më të thjeshtë kiminë organike ekzistojnë disa mjete teknologjike të cilat na vijnë në ndihmë. Mund të përmendim disa prej mjeteve që ne mendojmë se mund të jenë të vlefshme (viewing 3D models):

1. **MedChem Designer** është një program që ju mundëson të vizatoni struktura kimike (është free) dhe të llogariten shpejt dhe lehtë vetitë e ndryshme. Imazhet e strukturave dhe veçoritë e parashikuara mund të eksportohen në formatin Excel. Gjithashtu mund të konvertohen në skedarë të tjerë që mund të përdoren në programe të tjera (integrohen me programe të tjera). Kimistët të cilët dizajnojnë përbërje të reja farmaceutike, kozmetike, kimike industriale, pesticide, etj do të mund të përdorin ndërfaqen intuitive me një numër të karakteristikave dhe aftësive të cilat nuk janë të disponueshme në software të tjerë të vizatimit të molekulave. Ndërfaqja përfshin menyte e hapjes, ikonat e aksesit të shpejtë dhe kontrollet për funksione të ndryshme të skicimit. Veçoritë e parashikuara (ADME-Absorbimi, Shperndarja, Metabolizmi, Sekretimi ose nxjerrja) që janë në dispozicion do të jenë në pjesën e poshtme të ndërfaqes.

2. **ACD/ChemSketch** është një program ideal për modelim 3D të strukturave kimike, një paketë e plotë e vizatimeve kimike dhe mund të përdoret për qëllim akademik ose personal. Programi i vjen në ndihmë studentëve të shkollave të mesme, universitare apo të diplomuar në kimi, pasi ndihmon në mësimdhënien e koncepteve kyçe të kimisë. Ky program ju mundëson të vizatoni strukturat kimike duke përfshirë strukturat organike, polimere, dhe Markush. Ajo përfshin gjithashtu karakteristika si llogaritja e vetive molekulare (p.sh, pesha molekulare, densiteti, etj), strukturat 2D dhe 3D, funksionalitetin për emërtimin e strukturave (më pak se 50 atome dhe 3 unaza) dhe parashikimin e logP.

3. **Gjenerim interaktiv i strukturave 3D me CORINA Classic** (Online Demo). Mjafton të vizatoni strukturën me editorin (JSME) në të majtë të ekranit dhe struktura 3D do të kalkulohet nga CORINA Classic dhe do të shfaqet në të djathtë të ekranit në Jmol (Java based 3D visualization) app. Poshtë dritares së aplikacionit të vizualizimit Jsmol/Jmol, shfaqen 2 linqe për të shkarkuar strukturën si PDB ose Molfile.

4. **MolView**. Është një aplikacion web-i, intuitiv dhe open-source për të bërë shkencën dhe arsimin më mbresëlënës. Ky aplikacion do të ndihmojë pedagogët dhe studentët të vizualizojnë strukturat molekulare dhe veçoritë e tyre. MolView përdor libraritë JavaScript (JS që përdor teknologjinë WebGL- Web Graphics Library, një JS API për pasqyrimin e grafikëve 2D dhe 3D në çdo shfletues web-i të pajtueshëm pa përdorur plug-ins) për të vizualizuar strukturat e molekulave organike, proteinave, kristaleve, makromolekulave biologjike. Gjithashtu nëpërmjet këtij aplikacioni ju mund të shtoni në mënyrë interaktive modelet 3D në faqe interneti. MolView përdor Glmol, Jsmol dhe ChemDoodle Web për vizualizimet 3D.

5. **Molinspiration Galaxy 3D Structure Generator**. Ky aplikacion ju lejon të vizatoni molekulën, të llogarisni veçoritë e molekulës dhe të gjenerojë strukturën 3D të saj (nëpërmjet Galaxy Visualizer- një mjet web-i që lejon krijimin e strukturave 3D nga SMILES (Simplified Molecular Input Line Entry System)).

6. Ju mund të përdorni **ChemSpider** – një bazë të dhënash e strukturave kimike që siguron një akses të shpejtë në mbi 67 milion struktura nga qindra burime të dhënash. Kërkimi mund të realizohet nga emri kimik ose struktura kimike (duke përdorur skedarë strukturash) dhe më pas mund të lexoni karakteristikat e asaj çfarë ju kërkuat ose të shikoni vizualizimin 3D.

7. Një teknologji mjaft interesante dhe e fuqishme në fushën e arsimit është dhe **realiteti i shtuar** (ose ndryshe njihet si Augmented Reality-AR). **AR** është një teknologji e cila kombinon realen dhe virtualen, është interaktive në kohë reale dhe regjistron në botën reale në 3-D. AR në mësimdhënien e kimisë organike mund të përdoret p.sh për të shtuar grafikë 3D të strukturave kimike apo konformacioneve në një video (të mbivendosur në kohë reale në pamjen e kamerave të një tableti apo Smartphone) në mënyrë të tillë sikur elementët virtualë të ishin pjesë e mjedisit realë. Disa aplikacione interaktive që përdorin këtë teknologji për vizualizimin e komponimeve kimike mund të përmendim:

- **Arloon Chemistry** është një aplikacion interaktiv, një mjet që ndihmon studentët të mësojnë kiminë duke bashkëvepruar me prezantime të ndryshme 3D të molekulave, duke shkruar formulat për mbi 3000 komponime apo duke eksperimentuar për të formuar molekula dhe

kripëra. Ndërfaqja e saj vizuale dhe interaktive ofron një eksperiencë të të mësuarit që nuk mund të riprodhohet në klasën tradicionale (me pagesë).

- **ModelAR** nga Alchemie është një mjet i fuqishëm modelimi 3D (free) që i vjen në ndihmë studentëve të praktikojnë kiminë organike. Ky mjet ju lejon të bashkëveproni me molekula virtuale në kohë reale dhe sjell kiminë në jetë.
- **MoleculAR** është një aplikacion AR dhe përdoret në kiminë organike, i cili ju mundëson të vizualizoni dhe bashkëveproni me molekulat. Rezultati do të jetë një prezantim 3-D, interaktiv që do të shfaqet përpara syve tuaj dhe ju mund ta lëvizni dhe rrotulloni strukturën si të dëshironi.

3. Përpunimi i rezultateve

3.1 Aplikimi i mjeteve teknologjike në mësimdhënien e kimisë organike (shembull)

Kemi marrë si shembull *Dimethyl-1,2-benzoldisulfonat*.

Fillimisht mund të përdorim mjetin ChemSpider për të kërkuar në databazë me atë emër sistematik dhe më pas na shfaqen të dhënat e tij si p.sh, formula molekulare: C₈H₁₀O₆S₂, masa mesatare dhe monoizotopike, kodi SMILES: COS(=O)(=O)c1ccccc1S(=O)(=O)OC , dhe më e rëndësishmja pamja në Jsmol ose Jmol, ku ju mund të printoni atë, mund të shikoni strukturën në pamjen 2D ose 3D dhe ta zmadhoni atë.




Figura 11 Strukturat 2D dhe 3D duke përdorur ChemSpider

Më pas duke marrë kodin SMILES e përdorim atë në Galaxy 3D Generator dhe më pas klikojmë Generate 3D. Disa pamje të gjeneruara i kemi paraqitur si më poshtë:




Figura 12 Disa pamje 3D duke përdorur Galaxy 3D Generator

Ndërsa në MolView paraqesim një vizualizim si më poshtë:




Figura 13 Imazhi strukturor i formulës në MolView

Më poshtë kemi paraqitur disa shembuj modelesh dhe pamjesh.




Figura 14 Modeli Stick (majtas) dhe modeli van der Waals Spheres (djathtas) në Jmol

Gjithashtu kemi përdorur dhe programin MolecularAR.




Figura 15 Një imazh i gjeneruar nga MolecularAR

4. Konkluzione

Ky integrim i mjeteve teknologjike të përmendura më sipër në mësimdhënien e kimisë organike është realizuar me studentët e vitit të dytë të Universitetit “ Ismail Qemali” Vlorë dhe janë nxjerrë rezultate evidente që përfshijnë:

- Nxitja e motivimit e të mësuarit, studentët ishin më të përqëndruar në orën mësimore. Pra, këto mjete i ofruan klasës një nivel më të lartë motivimi.
- Identifikimi i pikave në të cilat studenti ka vështirësi dhe ka nevojë për ndihmë, bërja e mësimit më të lehtë për studentët, konceptet e vështira u bënë më të qarta për ta, si rezultat u përmirësua niveli i të kuptuarit brenda klasës.

- Mjetet teknologjike ishin një kuriozitet i ngazëllyer për studentët dhe ata panë realisht se mësimi në një mjedis që përdor teknologjinë është më stimulues se një mjedis tradicional.
- Angzhim dhe një mënyrë interaktive për t'u përgatitur , si dhe rezultative.
- Bashkëpunimi më efektiv, nëse praktika interaktive përfshihet në mjedisin e klasës atëherë kjo sjell rritjen e nivelit të mbajtjes mend të informacionit deri në 80% nga shumica, ose deri në 95% për disa studentë.
- Studentët mësuajnë mënyra të reja që mund të përdorin për të vizualizuar strukturat dhe konceptet e tyre komplekse, si dhe për të fituar aftësi praktike.
- Studentët mund të përdorin këto mjete jo vetëm brenda klasës, por kudo dhe kurdo që dëshirojnë, të angazhohen në përgatitjen e provimeve, të shërbejnë në këtë mënyrë si një praktikë paraprake për provimet.
- Vizualizimi është karakteristika më efektive dhe e rëndësishme në këtë fushë dhe AR është e përshtatshme për të realizuar atë më së miri.

Ajo çfarë mund të kufizojë mënyrën në të cilën teknologjia ndikon në të mësuarin është mungesa e të kuptuarit në lidhje me këto opsione të reja të të mësuarit dhe si funksionojnë ato. Është e rëndësishme për pedagogët që të mësojnë më shumë rreth opsioneve që janë në dispozicion në mënyrë që ata të mund t'i integrojnë ato në programet arsimore, ose t'i këshillojnë studentët rreth përdorimit të këtyre mjeteve interaktive.

6. Referencat

- [1] American Chemical Society, ACS Green Chemistry Institute, (2011). www.acs.org/gci (accessed Jan 17, 2012).
- [2] American Chemical Society (2011). J. Chemical Edu. Home page, 2011: <http://pubs.acs.org/journal/jceda8> (accessed Feb 3, 2012).
- [3] American Association for the Advancement of Science (1993). Benchmarks for Science Literacy. Oxford University Press: New York.
- [4] American Chemical Society (2009). Student Code of Conduct for Secondary Science Program, levels.
- [5] Kimia Organike, Genc Damani, Tirane.

- [6] Agaçi, R, 2017, “Augmented Reality in Education” (NRA-CSIT 2017, Vlorë)
- [7] <https://www.simulations-plus.com/software/medchem-designer/>
- [8] <https://www.acdlabs.com/resources/freeware/chemsketch/>
- [9] https://www.mn-am.com/online_demos/corina_demo_interactive
- [10] <http://molview.org/>
- [11] <https://www.molinspiration.com/docu/galaxy/galaxyvis.html>
- [12] <http://www.chemspider.com/>
- [13] <https://play.google.com/store/apps/details?id=com.Arloon.Chemistry.AR&hl=sq>
- [14] <https://www.alchem.ie/modelar/game>
- [15] <https://organicchemexplained.com/molecular-augmented-reality-app/>

Appendix

Figura 16 Strukturat 2D dhe 3D duke përdorur ChemSpider

Figura 17 Disa pamje 3D duke përdorur Galaxy 3D Generator

Figura 18 Imazhi strukturor i formulës në MolView

Figura 19 Modeli Stick (majtas) dhe modeli van der Waals Spheres (djathtas) në Jmol

Figura 20 Një imazh i gjeneruar nga MolecularAR

METODAT E MËSIMDHËNIES NË KUADËR TË NJË TEME MËSIMORE

Ermira Doku¹, Eltjon Halimi²

¹ Shkolla 9-vjeçare 'Bakushe Visha' Fushë-Krujë; ermira.doku@gmail.com

² Fakulteti i Shkencave të Natyrës, Universiteti i Tiranës; eltjon.halimi@fshn.edu.al

Abstrakt

Në këtë studim janë marrë në shqyrtim metodat e ndryshme të mësimdhënies. Këto metoda ndihmojnë jo vetëm në të kuptuarin e kurrikulës mësimore por edhe në njohjen e zhvillimin e aftësive të nxënësve dhe udhëheqjen e zhvillimit të tyre përgjatë orës mësimore. Për një pasqyrim më të qartë janë zhvilluar pyetësorë në një kampion prej 350 nxënësish gjatë vitit akademik 2017 – 2018, në Tiranë dhe në Fushë-Krujë, nga të cilët vetëm 311 prej tyre u kthyen të plotësuar. Mbështetur në kurrikulën e Biologjisë në pyetësor janë listuar pyetje të mbyllura me alternative dhe një pyetje me përgjigje të hapur. 111 nxënës mendojnë që metodika e përdorur gjatë orëve mësimore është mjaftueshëmrisht e qartë për të kuptuar zinxhirët ushqimorë. Ndërsa 311 nxënës pohojnë njëzërashi që pjesërisht zhvillojnë orë laboratorit apo ekskursionet për tu njohur më mirë me konceptet e zinxhirëve ushqimorë. Të pyetur për metodikën që vetë nxënësit do dëshironin të përdornin gjatë orëve mësimore 65% e tyre sugjerojnë zhvillimin e ekskursioneve. Kjo vjen si një metodë e cila do të nxisë bashkëpunimin mes nxënësve dhe nxit zhvillimin e të menduarit në mënyrë kritike. Gjithashtu duke marrë në konsideratë një temë mësimore nga lënda e biologjisë kemi përshtatur disa metoda mësimdhënie për të nxjerrë në pah çka nxënësit përfitojnë dhe zhvillojnë. Metodat e mësimdhënies realizojnë ndër të tjera edhe integrimin lëndor duke shmangur përçarjen e informacionit nga lënda në lëndë. Ndër të tjera u jep mundësinë nxënësve me nivel të ndryshëm zhvillimi dhe aftësi të ndryshme të integrohen gjatë procesit mësimor.

Fjalë kyçe: metodë mësimdhënie, kurrikul, zinxhir ushqimorë.

Hyrja

Çdo ditë përballemi me ndryshime që prekin sfera të ndryshme të shoqërisë dhe mjedisit. Ndaj lind e nevojshme që të adaptohemi ndaj këtyre ndryshimeve dhe për këtë përgjegjësia më e madhe bie mbi shkollën dhe mësuesit. Suksesi në adaptimin ndaj këtyre ndryshimeve, përballjen me sfida të

ndryshme por edhe në zgjidhjen e problemeve të ndryshme gjen shprehje konkrete në përdorimin e metodave, strategjive dhe teknikave mësimore bashkëkohore ndërvepruese dhe gjithëpërfshirëse.

Prej disa vitesh tashmë sistemi arsimor në Shqipëri ka implementuar kurrikulën e ndërtuar mbi bazëkompetencash. Ky model kurrikular garanton efektshmëri më të lartë të procesit të mësimdhënies, mësimnxënies dhe procesit të vlerësimit. Ekziston një lidhje e ngushtë mes këtij modeli kurrikular dhe metodave të mësimdhënies të cilat aplikohen në një orë mësimore. Nga ana tjetër këto metoda mësimdhënieje jo vetëm ndihmojnë në zbatimin e kurrikulës me bazë kompetencat por mundësojnë që nxënësit të kenë përgjigje të efektshme ndaj sfidave të botës së jashtme duke menduar, vepruar, nxënë, transferuar dije dhe për të kërkuar zgjidhje në mënyrë të pavarur.

Sipas Colin J. Marsh (2009, f.58) përdorimi i metodave të ndryshme të mësimdhënies varet edhe nga disa faktorë të tillë si:

- Lloji i veprimtarisë në klasë
- Lloji i organizimit të klasës
- Përdorimi i burimeve
- Grupimi dhe organizimi i nxënësve
- Rolet e nxënësve në klasë
- Kriteret e përdorura për vlerësimin e nxënësve
- Natyra dhe sasia e bisedave midis nxënësit dhe mësuesit

Përdorimi i metodave të ndryshme të mësimdhënies të cilat vënë në qendër nxënësin synojnë zhvillimin e aftësive të nxënësve për të kërkuar informacion, analizuar, sintetizuar dhe argumentuar. Gjithashtu nxënësit me anë të këtyre metodaveaftësohen për të zgjidhur probleme të ndryshme, për të menduar në mënyrë kritike dhe për tu përgatitur për jetën.

Roli i mësuesit mbetet i rëndësishëm, jo si person qëndror i mësimdhënies, por si drejtues i veprimtarisë së nxënësve në klasë dhe orientues i punës së tyre. Mësuesi vecon qartë ato njohuri dhe aftësi të cilat janë të domosdoshme për nxënësin, duke përcaktuar edhe nivelin minimal për të gjithë nxënësit. Në ndërtimin e qëndrueshëm të formimit të dijeve rol të rëndësishëm luan edhe integrimi lëndor, që shmanget kështu copëtimin e dijeve dhe krijon një bazë solide për përvetësimin e tyre nga ana e nxënësve.

Materiale dhe metoda

Punimi ynë i referohet të dhënave të studimit i cili u zhvillua në vitin akademik Prill 2017-Maj 2018. Për të arritur në një përfundim sa më të saktë dhe objektiv të punimit tonë është realizuar një pyetësor.

Pyetësi ka 3 pyetje të cilat tregojnë metodikën e përdorur për njohjen e zinxhirëve ushqimorë dhe përbërësve të tij, si dhe një pyetje më sygjerime për të përmirësuar metodikën e mësimdhënies për këtë koncept.

Analizimi i përgjigjive mendojmë se do na tregojë një gjëndje reale të nivelit të kuptimit të njohurive për zinxhirin ushqimor, si dhe kompetencat që fitojnë nga të kuptuarit e këtij koncepti në nivelin e mësimdhënies në ciklin Parauniversitar. Pyetësi u shpërnda në qytetin e Tiranës në Shkollën ‘Qemal Stafa’ dhe në qytetin e Fushë-Krujës në shkollën ‘Shote Galica.’

Duke u mbështetur në kurrikulën e Biologjisë, në pyetësor kemi listuar pyetje të mbyllura, me alternative zgjedhje, me qëllim grumbullimin e të dhënave sasiore dhe një pyetje me përgjigje të hapur me qëllim grumbullimin e të dhënave cilësore. Të intervistuarit kanë plotësuar pyetësin me përgjigjet e tyre, pa praninë e intervistuesit. Pyetjet ishin standarte ku u ruajt anonimati i të intervistuarëve. Përzgjedhja e klasave ishte rastësore, po ashtu dhe përzgjedhja nxënësve që e plotësuan atë ishte rastësore. Pyetësi u shpërnda në orën e Biologjisë, rastësisht nëpër reshtat me nxënës, dhe duke i mbledhur ato në fund të orës. Niveli i suksesit të nxënësve që plotësuan pyetësin (nota në lëndën e Biologjisë), nuk është marrë parasysh. Kjo metodologji e ndjeku realizon një mënyrë plotësim nga të gjitha nivelet nxënësve, dhe jep përfundime më afër realitetit. Në përgatitëm 350 pyetësor, nga të cilët na u kthyen të plotësuar plotësisht 311 pyetësore, dhe 39 nuk na u kthyen, ose ishin të plotësuar pjesërisht, të cilët nuk i morëm parasysh në analizën tonë.

Rezulate dhe diskutime


1. Nga metodika e përdorur gjatë orës mësimore a i kuptoni në mënyrë të qartë konceptet mbi *zinxhirët ushqimorë*?

a) Pjesërisht

b) Mjaftueshëm

c) Plotësisht

Më shumë nxënës ose 151 nxënës kanë zgjedhur alternativën C, duke menduar që metodika është plotësisht e qartë për të kuptuar konceptet për zinxhirët ushqimorë. Më pak nxënës ose 111 prej tyre kanë zgjedhur alternative B, duke menduar që metodika është mjaftueshëmrisht e qartë dhe akoma më pak nxënës ose 49 prej tyre kanë zgjedhur alternativën A duke menduar që metodika është pjesërisht e qartë për të kuptuar konceptet për zinxhirët ushqimorë. (Aneks: Tabela 1 Rezultatet e pyetjes 1)



Grafiku 1 Shpërndarja e përgjigjeve të nxënësve referuar pyetjes 1


2. A zhvilloni orë laborator për tu njohur me konceptet ose nivelet e *zinxhirëve ushqimorë*?

a) Pjesërisht

b) Mjaftueshëm

c) Plotësisht

Për pyetjen e 2-të të gjithë nxënësit kanë zgjedhur alternativën A, duke menduar që i zhvillojnë pjesërisht laboratorët. (Aneks: Tabela 2 Rezultatet e pyetjes 2)



Grafiku 2 Shpërndarja e përgjigjeve të nxënësve referuar pyetjes 2


3. Zhvilloni ekskursione në natyrë për tu njohur me prodhuesit apo konsumatorët e rendeve të ndryshme?

a) Pjesërisht

b) Mjaftueshëm

c) Plotësisht

Për pyetjen e 3-të nxënësit ndajnë sërish të njëjtin mendim duke zgjedhur alternativën A: pjesërisht zhvillojnë ekskursione në natyrë për tu njohur me konceptet e zinxhirëve ushqimorë. (Aneks: Tabela 3 Rezultatet e pyetjes 3)




Grafiku 3 Shpërndarja e përgjigjeve të nxënësve referuar pyetjes 3

4. Çfarë metodike do të sugjerorit për të përmirësuar të kuptuarit e konceptit për zinxhirët ushqimorë?

Për metodikën, nga analizimi i rezultateve të përgjigjeve të alternativave të pyetësorit kemi këto të dhëna Më shumë nxënës ose 65% e tyre, sugjerojnë gjithashtu ekskursionet në natyrë, 14% zhvillimin e orëve laboratorike, 7% zhvillimin e veprimtarive të ndryshme, 5% videot, 11% kërkojnë orë shtesë, 3% më shumë shembujve dhe me nga 1% vizitat në Kopësht Zoologjik dhe takime me ekspertë të fushës. (Aneks: Tabela 4 Rezultatet e metodikës së sugjeruar nga nxënësit)

Vërehet se ekskursionet shikohen si metodokë të në dy shkollat, duke nxjerë si përfundim se kemi mangësi në zhvillimin e tyre.



Grafiku 4 Shpërndarja e përgjigjeve të nxënësve referuar pyetjes 4


Bazuar në sugjerimet e nxënësve pëe një metodikë ndryshe më poshtë listojmë disa nga metodat e ndryshme të mësimdhënies sipas të cilave mund të përshtatet një temë mësimore.

Pse është e rëndësishme përdorimi I metodave të ndryshme të mësimdhënies?


1. Vërschim i shpejtë i ideve (brainstorming)

- Çfarë janë zinxhirët ushqimorë?
- Si ndërtohen?
- Sa lloje janë zinxhirët ushqimorë?
- Si transferohet energjia?
- Ku pozicionohen organizmat në një zinxhir ushqimor?
- Çfarë janë piramidat e numrave dhe të biomassës?


2. Kllasteri



3. Pesëvargëshi



4. Tabela e koncepteve



5. Di / Dua të di / Mësoj

Di	Dua të di	Mësova
Skemë e transferimit të nergjisë	A tranferohet e gjithë energjia?	Energjia humbet kur transferohet në një zinxhir ushqimor.
Nisin me prodhuesin	Roli i dekompozuesve?	Ushqehen me mbetje bimore dhe shtazore.
Herbivorë – kafshë që ushqehen me bimë	Llojet e zinxhirëve ushqimorë.	Grabitqarë, parazit dhe saprofit.
Karnivorë- kafshë që ushqehen me kafshë të tjera	Çfarë tregojnë nivelet trofike dhe si ndërtohen.	Pozicionimi i organizmit në zinxhir ushqimorë.


6. Grupet e ekspertëve

Fleta Eksperti 1

- 1.Çfarë janë zinxhirët ushqimorë?
2. Ndërtoni një zinxhir të thjeshtë ushqimor duke përdorur si shembuj kafshë të qytetit ku jetoni ose të Shqipërisë.

Fleta eksperti 2

- 1.Çfarë janë nivelet trofike?
- 2.Ndërtoni piramidën e numrave dhe tregoni çfarë tregon secili nivel trofik.



Fleta eksperti 3

1.Çfarë kuptoni me termat: prodhues, konsumator i rendit të I, konsumator i rendit të dytë.

2.Ndërtoni një zinxhir ushqimor saprofit.

Fleta eksperti 4

1.Çfarë paraqet rrjeta ushqimore?

2Ndërtoni një rrjetë të thjeshtë ushqimore.

7. Alfabet

A	B Biomasë	C	Ç	D Dekompozues	DH
Eenergji	Ë	F	G	GJ	H Herbivorë
I	J	K Karnivorë	L Ligji i të 10-it	LL	M
N Nivel trofik	NJ	O	P Prodhues, piramidë	Q	R
RR Rrjetë ushqimore	S	SH	T Transferim	TH	U
V	X	XH	Y	Z Zinxhir ushqimor	ZH

8. Kubimi

Përshkruaje: forma, përmasa.

Krahasoje: Me kë ngjason?

Shoqeroje: Çfarë ju vjen ndërmend?

Analizoje: Si ndërtohet? Nga se përbëhet?

Zbatoje: Cili është roli i tij?

Argumentoje: Cili është qëndrimi juaj?

Mësuesi	Nxënësi
Drejton, orienton, udhëzon	Përfshihet, vepron
Vë nxënësit të drejtojnë pyetje	Bëjnë pyetje dhe kërkojnë përgjigje
Bisedon, diskuton, arsyeton, shkëmben ide	Diskuton, arsyeton, argumenton, analizon
Nxit vetëvlerësimin	Bëjnë vetëvlerësim

Përfundime:

1. Nxënësit flasin, krijojnë vetë-besim, zhvillojnë imagjinatën
2. Shprehin mendimet pa u ndjerë të gjykuar.
3. Realizohet lidhja ndërlëndore.
4. Rrit vizionin e nxënësve për këndvështrim më të gjerë për dukuritë dhe për ngjarjet.
5. Ndhmon në formimin e koncepteve.
6. Rrit bashkëpunimin mes nxënësve.
7. Nxit të kërkuarin e informacionit, sintezën dhe analizimin e tij.
8. Aftëson nxënësit për të zgjidhur probleme
9. Nxit të menduarin kritik
10. Nxit të menduarin krijues.
11. Nuk zhvillohen orë laboratorit apo ekskursione.
12. Metodika e përdorur deri më tani është plotësisht e qartë për vetëm 151 nxënës dhe pjesërisht e paqartë për 49 nxënës.
13. Si metodikë të re nxënësit më shumë sugjerojnë ekskursionet dhe laboratorët.

Referenca:

- Paparito, A. 2016, Metodika e mësimdhënies së Biologjisë: *Teknikat e të nxënit*, (Tiranë) fq. 113
- Marsh, Colin. J. 2009, Koncepte themelore për të kuptuar kurrikulumin: *Përzgjedhja dhe organizimi i mënyrave të mësimdhënies dhe të të nxënit*, (Londër) fq. 58
- Zwiers. J. 2006, *Zhvillimi i shprehive të të menduarit në klasat 6-12* (Delaware, SH.B.A)

Aneks

Tabela 1 Rezultatet e pyetjes 1

Numri i nx/ Alternativa	A	B	C	Total
Nr. i Nxënësve	49	111	151	311

Tabela 2 Rezultatet e pyetjes 2

Nr. i nx/Alternativa	A	B	C	Total
Nr. i Nxënësve	311	0	0	311

Tabela 3 Rezultatet e pyetjes 3

Nr. i nx/Alternativa	A	B	C	Total
Nr. i Nxënësve	311	0	0	311

Tabela 4 Rezultatet e metodikës së sugjeruar nga nxënësit

Shkolla / alternativa	Ekskursione	Laborator	Video	Shembuj	Orë shtesë	Postera	K.Zoologjik	Ekspert fushe	Total
% e nxënësve	65%	14%	5%	3%	11%	0	1%	1%	100 %

SHFRYTËZIMI I EDMODO PËR MËSIMDHËNJEN E TË SHKRUARIT DHE ANGAZHIMI I NXËNËSVE

Doc.Dr.Festim Halili,Phd

Department of Informatics, Faculty of Natural Sciences and Mathematics, University of Tetovo

festim.halili@unite.edu.mk

Msc.Natyra Berishta ,University of Tetovo

n.muhadri@hotmail.com

Msc. Erleta Alihajdaraj University of Tetovo

erleta_leta1@hotmail.com

Msc. Leunora Shoshi University of Tetovo

leunorashoshi@hotmail.com

Abstract

Zhvillimet në Teknologji Informative (TI) sigurojnë edukim me zgjidhje të ndryshme dhe krijimin e mjediseve të reja të të mësuarit.

Edmodo si një platformë mësimi besohet të ofrojë zgjidhje adekuate në mësimin e gjuhës angleze, veçanërisht të mësuarit në të shkruar të gjuhës angleze. Ky hulumtim ka për qëllim të paraqes se si Edmodo si një platformë mësimi, në një mjedis të kombinuar të mësimnxënies u zbatua në mësimin e të shkruarit në gjuhë angleze, si Edmodo lehtësoi angazhimin e nxënësve dhe si nxënësit perceptonin shfrytëzimin e platformës Edmodo në procesin dhe aktivitetet e mësimit.

Ky hulumtim shfrytëzoi një qasje cilësore me hartimin e studimit të rasteve. Hulumtimi përfshinë pjesëmarrës nga klasa e njëmbëdhjetë e një Shkolle të Lartë të Mesme në Kosovë. Të dhënat u grumbulluan përmes vëzhgimeve, analizave të dokumenteve, intervistave dhe pyetësorëve. Rezultatet treguan se në të mësuarit e të shkruarit, ishte e mundur të integrohej platforma Edmodo në aktivitetet e procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies.

Platforma Edmodo ndihmoi me angazhimin e nxënësve edhe gjatë seancave në klasë. Nxënësit tregonin përgjigje të ndryshme ndaj përdorimit të Edmodo duke bazuar në kornizën e shfrytëzimit si dhe teorive të ndërtimeve të gratifikimit (Ang. *Uses and Gratification Theory* “UGT”). Disa çështje mbi përdorimin e Edmodos të identifikuar në këtë punim ishin edhe çështja e fuqisë transmetuese (bandwidth), krijimet e konfuzioneve të ndryshme në përdorimin e Edmodo, problemeve me funksionimin e aplikacioneve telefona të menqur, si dhe mungesa përgjegjësisë së nxënësve për të mësuarit. Janë paraqitur sugjerimet edhe për hulumtime të mëtejshëm.

Fjalët kyçe: *Edmodo, mësimi u kombinuar, angazhimi i nxënësve, QBG, UGT të shkruarit*

HYRJE

Shfrytëzimi i teknologjive për mësimin e gjuhëve, në mënyrë specifike asaj me shkrim, nuk është më një fenomen i ri. Mësimdhënia respektivisht mësimnxënia ka ndryshuar rrënjësisht nga shfrytëzimin e teknologjive të reja, që njëkohësisht procesin e të mësuarit e ka sjell në rrethana të lehtësuara pa u kufizuar në aspektin kohorë dhe ose kufizim në kontekstin hapësinor (Fauzi, 2017) Teknologjia gjithashtu besohet të sigurojë nxënësit e gjuhës me një numër të madh mundësish për të rritur mësimin e gjuhës (Dudney & Hockly, 2007). Ata në mënyrë specifike argumentojnë se teknologjia me zhvillimin e saj të përhershëm, mund të jep nxënësve ekspozime deri në masën e qasjes për të praktikuar njohuritë dhe të lehtësojnë mësimdhënësve çështjen e të vlerësuarit mbi aftësitë gjuhësore të tyre. Aplikimi i teknologjisë në të shkruar e cila është dhe vazhdon të mësohet në letër, veçanërisht në të kaluarën, bëhet gjithnjë e më i përmirësuar nga zhvillimi i shpejtë i teknologjisë. (Werswood, 2008) vlerëson se në epokën e informacionit, shkrimi nuk është i bazuar vetëm në letër por gjithashtu përdor mediat më të pasura siç janë platformat multimediale.

Një konsensus i përbashkët të cilën e kanë studentët, është që nuk janë të prirur për të shkruar, dhe arsyeja e tyre për të shkruar bazohet kryesisht për shkak të veprimtarive të lidhura në procese mësimore në institucione edukative. Mbetet detyrë e vështirë për mësimdhënësit që t'i bëjnë studentët të bien në dashuri me shkrimin dhe të i gjejnë format që stimulojnë ata që të angazhohen personalisht në procesin e shkrimit. Prandaj, mësimdhënësit kanë obligim moral dhe profesional për të gjetë metoda të pranueshme të të mësuarit duke kërkuar alternative të mundshme që t'iu ofrohet mundësia për mësimdhënie dhe mësimnxënie interesante dhe efektive.

Edmodo ofron një formë të zhvillimit teknologjik për qëllime edukimi. Besohet që është mbështetje e fuqishme për mësimdhënësit në përgjithësi e posaqërisht në ato klasë ku synimi kyç është të mësuarit e gjuhës. Edmodo ka një platformë shumë të përshtatshme për të vepruar, i ngjason madje një rrjeti social, duke mundësuar interaktivitet në hapësira pune për mësimdhënësit, studentët, madje qasje edhe për prindërit, duke maksimizuar procesin e mësimnxënies (Kongchan, How a non-digital-native teacher makes use of Edmodo, 2012). Shkrimi që duket se është i rëndë dhe i mërziqshëm, do të jetë më pak i kërkuar pasi që Edmodon ofron shumë mundësi dhe ndihmon praktikisht mësimdhënësit dhe studentët për të ndërtuar dhe strukturuar si duhet por edhe për të organizuar shkrimin duke kaluar hap pas hapi proceset e ndryshme, qoftë në orët e mësimit në klasë apo gjatë kohëve të ndryshme në hapësira individuale si proces i të mësuarit në shtëpi (Lara, 2013).

SHQYRTIMI I LITERATURËS

Procesi i të mësuarit të përzier (Jacob, 2011) është kombinimi i mësimnxënies të drejtpërdrejtë në ballafaqim me mësimdhënësin dhe të mësuarit në *internet* me platforma të ndryshme (Bonk & Graham, 2005, Friesen, 2012) siç është Edmodo. Mësimi i kombinuar ndodh kur teknologjia përdoret

në procesin e të mësuarit (Clark & Mayer, 2011) dhe synon të rrisë njohuritë dhe performancën (M.J., 2001)

Gjatë një procesi të tillë me mësim të kombinuar, në mënyrë filozofike krijohet një nxitje për të fituar njohuri të reja dhe duke krijuar një lidhje me njohuritë dhe përvojat paraprake (Schunk, 2015)

Një nga teknologjitë e aplikuara në klasat e gjuhëve është platforma *Edmodo*, një platformë e përzier mësimi e hartuar nga O'Hara dhe Borg në 2008 dhe tani është në dispozicion për emet ueb faqes www.edmodo.com. Projektuar pothuajse të ngjashme me *Facebook* për qëllime arsimore (Kongchan, 2018),. Edmodo përdoret nga shumë institucione arsimore në mbarë botën për veçoritë e tij tërheqëse ((Delacruz, 2016) mirëdashësi për përdoruesin (Winitkun & Kongchan, 2014); mjedisi i lirë dhe i sigurt në internet; ndërfaqet e internetit më të mira të mësimdhënies dhe të mësimnxënies që ndiqen me inovacionin koherente dhe kreativitetin (Kongchan, How Edmodo and google docs can change traditional classrooms, 2018). Prandaj, nuk ka dyshim se Edmodo lehtëson përvojën e të mësuarit në përgjithësi.

Edmodo njihet tanimë të jetë i zbatueshëm në procesin e të mësuarit në të shkruar të gjuhës. Hulumtime të shumta nga autorë të ndryshëm kanë testuar platformën Edmodo për integrimin e punës në klasë ku është mësuar të shkruarit (Adas & Bakir, 2013; Gardner, 2015; Pop, 2016; Karyawati, 2018; Abadi, Ahmadi & Mehrdad, 2018). Rezultatet e hulumtimeve tregojnë më së shumti se Edmodo është në gjendje të integrohet lehtësisht në procesin e të mësuarit të shkruar.

Qasja e Bazuar në Gjini (QBG) është veçanërisht e përshtatshme për studentët e gjuhës angleze për qëllime specifike (Harmer, 2007). Megjithatë, Harmer gjithashtu pohon se qasja është gjithashtu e dobishme për ata që mësojnë anglisht të përgjithshme. Autori beson se kjo qasje mund të ndihmojë edhe nxënësit e varfër për të shkruar. Qasja sipas (Fadani, 2018) theksojnë se mësimdhënësit duhet të udhëzojnë studentët në procesin e shkrimit duke i mësuar në mënyrë eksplicite se si të ndërtojnë një tekst të mirë.

Modeli i mësimdhënies me QBG është zhvilluar gradualisht, aktualisht në kryerjen e qasjes përbëhet nga katër cikle: 1) Ndërtimi i njohurive të terrenit, 2) modelimi, 3) puna në grupe, dhe 4) puna e pavarur - individuale.

Në thelb gjatë procesit mësimorë shfrytëzohen një sërë metodash. Këto përfshijnë hetimin e teksteve dhe konteksteve në situata të targetuara të nxënësve, inkurajimin e reflektimit në praktikat e shkrimit, shfrytëzimin e grupeve punuese dhe krijimin e portofolios në sisteme të të mësuarit të përzier. Për më tepër, qasja në procesin mësimor të mësimdhënies zakonisht kalon mes një cikeli që merr të shkruarit përmes modelimit, negocimit të punëve grupore dhe punës individual, duke krijuar në aspektin e mësimnxënies studentëve qasje nga këndvështrime të ndryshme, e që njëkohësisht i jep mundësi mësimdhënësve të zgjerojnë horizontin nga këndvështrimi i studentit.

[Përfshirja e studentëve me TIK](#)

Një dimension që vlerësohet në procesin e të angazhuarit të studentëve është angazhimi intelektual, natyrisht nuk përjashtohen vlerësimet e dy angazheve të tjera siç janë sjellja dhe angazhimi emocional

(Fredricks, Blumenfeld, & Paris, 2014), që në princim reflekton vullnetin e studentit që ka në lidhje me punën dhe aftësitë për të përfunduar punën e tyre (Davis, Summers, & Miller, 2012) dhe për të kuptuar materialet mësimore (Appleton, Christenson, & Furlong, 2018).

Psikologjikisht lidhur me strategjitë e proceseve mësimore (Bandura, Human agency in social cognitive theory., 1989) sugjeron që procesi angazhimit intelektual që ndikohet nga vetë-efikasiteti i studentit për të arritur qëllimet njohëse ose arritjet profesional janë në gjendje të udhëheqin veten në ngritje të performances dhe arritje të lartë akademike. Për më tepër (Bandura, Human agency in social cognitive theory., 1989) vlerëson që procesi intelektual lejon studentët të parashikojnë se cilat skenarë duhet të aplikojnë për të zgjidhur problemet e ofruara në detyrat shkollore. Duke theksuar idenë (Fredricks, Blumenfeld, & Paris, 2014) të cilët përmendin që angazhimi intelektual në mënyrë të ndjeshme merret me vetë-rregullimin dhe aspektin strategjik zhvillimor. (Bandura, 1991) më tej pohon se ky proces pastaj kontribuon në të menduarit kritik të studentëve dhe në fund ndikon në realizimin e tyre të performancës drejt detyrave të shkollës.

Të menduarit kritik nga studentët, veçanërisht në procesin e të shkruarit, mund të identifikohet me zbatimin e mendimit të rendit të sugjeruar nga (Garrison & Kanuka, 2014). Kur procesi i të menduarit nga studenti arrinë në nivelin më të lartë, aty fillon të zhvillohet mendimi kritik. (Garrison & Kanuka, 2014) mbështesin idenë duke përmendur se zhvillimi i të menduarit mund të kontribuojë në arritjen e të menduarit kritik. Kjo do të thotë se qëllimi i të mësuarit të përzier zhvillon procesin e të menduarit dhe mund të arrijë dhe të formësojë mendimin kritik te studentët. Në anën tjetër *infuzioni* i teknologjisë besohet që ka ndikuar edhe më tej duke rritur angazhimin e studentëve siç konfirmohet nga (Coffman, 2009), derisa (Kearsley & Shneiderman, 1999) pohojnë se teknologjia, në thelb, është në gjendje të lehtësojë angazhimin nëpërmjet dy gjërave: ndërveprimi dhe detyra kuptimplote.

Vazhdimësia me TIK shkon tutje (Fadani, 2018) konfirmon nocionin e ndërveprimit në studimin e tij duke thënë se shumica e pjesëmarrësve bashkëveprojnë me sukses njëri-tjetrin duke përdorur një platformë të veçantë të SMM (Sistemet për Menaxhimin e Mësimdhënies).

Edmodo është një nga SMM-të efektive. Në përputhje me këtë, Edmodo është një platformë e lirë dhe e sigurt e cila fokusin e ka te fazat e të mësuarit, dhe që përdoret për të siguruar një mënyrë të thjeshtë për mësimdhënësin për të krijuar dhe menaxhuar klasën nga distanca (*online*) dhe për t'u mundësuar studentëve të lidhin me mësimdhënësin dhe studentët e tjerë kudo dhe në çdo kohë (Shams-Abadi, Ahmadi, & Mehrdad, The effect of Edmodo on EFL learners' writing performance, 2015).

Lloji i ndërveprimeve mund dhe duhet të jetë i ndryshëm. Kjo mund të jetë në segmentuar në formë të tre ndërveprimeve siç sugjerohet nga shumë autorë, dhe siç përmendet tek (Lonn, 2009):

- ndërveprimi me përmbajtjen e nxënësve,
- ndërveprim nxënës-instruktur (instrukturët japin këshillim, përkrahje dhe inkurajim),
- ndërveprim nxënës-nxënës ose bashkëmoshatar (komunikimi ndërmjet studentëve me ose pa praninë e instruktorëve).

Ndërkohë, në lidhje me detyrat domethënëse, (Miliszewska & Horwood, 2006) japin një udhëzim strikt: detyrat kuptimplota të dizajnuara në mësimin e bazuar në TIK duhet të jenë në gjendje të përcaktohen nga nxënësit dhe ata mund të përqendrohen në aplikimin e ideve të tyre në një kontekst të veçantë.

Në rastet kur studentit i mungojnë njohuritë, mund të shfrytëzojmë dhe nxjerrim më të mirën nga ta duke u mbështetur në tre burime të mundshme: mësuesin, nxënësit e tjerë dhe shembujt e synuar. Mësimdhënësit mund të japin të dhëna në drejtim të mësimin, student të tjerë mund të bëjnë përsëritjen e koncepteve të njëjta dhe atë në kontekstin e punëve grupore me një ambient më pak kërcënues, por ajo që vlerësohet si burimi më i dallueshëm i të dhënave në lidhje me njohuritë kontekstuale dhe gjuhësore në qasjen e një procesi është aktiviteti për ndërgjegjësimin e gjuhës.

Kriteret e zhvillimeve dhe njohurive çdo here shkojnë dhe vlerësohen më hollësisht, sa i përket të angazhuarit e studentëve në TIK. Siç vlerësojnë edhe (Reading & Levins, 2010) zhvillimet shtohen dhe segmentohen tutje. Më vijim janë propozimet që dhanë autorët për t'iu adaptuara proceseve të të mësuarit:

- a) Puna e pavarur brenda grupeve,
- b) Ngritja e shqetësimeve lidhur me cilësinë e punës,
- c) Pjesëmarrja në situata dhe procese të ndryshme të mësimnxënies, dhe
- d) Vlerësimin e TIK-ut si pjesë integrale e procesit të mësimnxënies.

Shfrytëzimi i teorisë së kënaqësisë

Shfrytëzimi i teorisë së kënaqësisë (Ang. *Uses and Gratification Theory UGT*) I referohet kënaqësisë e cila konceptohet si ndjenja pozitive ose negative e njerëzve ndaj mediave që përdorin. Interpretohet gjithashtu si të gjitha aspektet e kënaqësisë të vetë-raportuar nga shfrytëzuesit e mediave të ndryshme. (Karimi, Khodabandelou, Ehsani, & Ahmad, 2014) më tej vlerëson se UGT është gjithashtu e zbatueshme për të gjetur motivim individual në shfrytëzimin e mediave. Këto përkufizime konkludojnë se kënaqësitë janë ndjenjat e shfrytëzuesve, qofshin ato pozitive apo negative për mediat të cilat i shfrytëzojnë.

UGT është e zbatueshme për të gjitha mediat siç janë televizioni dhe interneti. Përdorimi i mëtejshëm i UGT kohëve të fundit është edhe platforma e të mësuarit si Edmodo (Cankaya, Durak, & Yunkul, 2013) që njëherit është Sistem për Menaxhimin e Mësimdhënies (SMM).




Figure 21 Shembul i UGT - Burimi: Autori

(Purnawarman, Susilawati, & Sundayana, 2013) argumentojnë se njerëzit kanë tendencë të përdorin mediat e komunikimit bazuar në nevojat e mëposhtme: zgjerimin e diapazonit të njohurive të përgjithshme, nevojat për njohëje, afektive, personale dhe sociale. Ndërsa (Kim & Hahn, 2012) vlerësojnë që kënaqësi të tjera të cilat i pasurojnë ndjenjat personale të përmendura nga ekspertët të ndryshëm, janë: relaksimi, argëtimi, moda, përfshirja në dashuri, shoqërimi dhe ikja. Ky zhvillim tregon se UGT është rritur nga vetë teknologjia, në të cilën njerëzit përdorin teknologjinë për synime të shumëfishta. Kriteret më të hollësishme të UGT janë zhvilluar nga (Delacruz, 2016).

ZBATIMI I EDMODO NË PROCESIN E MËSIMDHËNIES

Edmodo zbatohet për mësimdhënie të shkrimit duke integruar rrjedhat e të mësuarit të përzier (Bersin, 2014) në ciklet e shkrimit. Disa studime kanë konfirmuar gjithashtu se si Edmodo është i integruar në mësimdhënie dhe modelet të të shkruarit (Bandura, 1991).

Edmodo vendi për angazhimin e studentëve

E themeluar në vitin 2008 e zhvilluar ndër vite dhe avancuar drejt nevojave dhe përshtatjes për të gjithë mësimdhënësit, studentët dhe prindërit. Së pari, Edmodo përmes platformës SMM lejon studentët të punojnë në mënyrë të pavarur brenda funksionit të një grupi të vogël. Edmodo (Edmodo.com) konfirmon se puna bashkëpunuese në Edmodo synon të personalizojë të mësuarit, në të cilën studentët do të kenë hapësirën e tyre për të mësuar pa ndonjë shqetësim nga të tjerët. Ideja mbështetet nga (Lara, 2013) si dhe nga (Delacruz, 2016), se teknologjia duke përfshirë platformën e mësimit duhet të japë mundësi për studentët të punojnë në mënyrë të pavarur.

Së dyti, platforma krijoj mundësi studentëve që të interesohen për cilësinë e tyre të punës. Me dokumentet e ngarkuara në platformë mund të konkludohet se studentët ishin të etur të korrigjojnë veprat e tyre duke mirëpritur reagimet e mësuesve, duke treguar se pjesëmarrja dhe përfshirja e punës po zhvillohet në një dinamikë si asnjëherë më parë (Fauzi, 2017). Kjo është gjithashtu strategjia e studentëve për t'u shkruar si një pjesë e angazhimit: si të punoni në detyra dhe si ata i zotëronin materialet mësimore. Psikologjikisht, studentëve ju krijohet nevoja për përpjekje të shtuar drejtë përfundimit të punës së caktuar (Smiley & Anderson, 2011).

Së treti, u mundësoi studentëve të marrin pjesë në situata të të mësimnxënies duke u përfshirë në diskutime. Gjatë diskutimit, aktivitetet e pyetjeve dhe përgjigjeve u zbatuan zakonisht dhe në vazhdimësi prodhojnë efekte pozitive. Këto aktivitete janë një tregues i kriterëve të angazhimit kognitiv sipas (Delacruz, 2016). Megjithatë, duke parë klasa *online* dhe *offline*, jo të gjithë studentët morën pjesë në mënyrë aktive. Përdoruesit e shpeshtë dhe të tjerët u identifikuan më pas nga frekuenca e pjesëmarrjes së studentëve, që vërehen lehtësisht me rastin e qasjes në SMM. Kjo përfshirje tregon interesin e studentëve për të mësuar atë që reflektohen në kryerjen e detyrave ose aktiviteteve.

Një strukturë tjetër e ofruar nga Edmodo ishte interaksioni dhe detyra kuptimplote. Menyja e shënimeve ofroi mundësi për studentët dhe mësuesit për të bashkëpunuar duke postuar diçka ose duke shkëmbyer informata dhe komente lidhur me një temë të caktuar. Ndërveprimi u zhvillua gjithashtu kur studentët i dërgojnë mësuesit pyetjet ose kur ata hasin në vështirësi për të hyrë në tiparet e Edmodos.

Më tej, Edmodo gjithashtu ndihmoi në proceset për studentët edhe me shkrimin. Derisa shkrimi brenda platformës nuk është vetëm për të krijuar një produkt (Saville-Troike, 2006), por edhe për të përfshirë proceset, proceset njohëse në shkrim, në të vërtetë, nuk mund të neglizhohen. Proceset mbi njohuritë siç janë kompozimi, sintetizimi i ideve dhe botimi i shkrimit janë format e aktiviteteve të menduarit që drejton studentën në rrugëtimin e tyre. Kjo natyrisht nuk është e aplikueshme vetëm në të shkruarit në letër por gjithësi përfshinë edhe mjedisin multimedial. (Reading & Levins, 2010) nxjerr në pah këtë mendimin e lartë si një aktivitet mësues multimedial në fushën përkatëse si njohës i cili mund të përdoret për të matur angazhimin e studentëve. Më tej, besohet se i udhëheq studentët në performancë të lartë akademike të motivuar nga vetë-efikasiteti.

Mendimi kritik i studentëve u vu në pah thjesht nga mënyra se si ata krijuan idetë e tyre, si zhvillimi i një teze për të treguar pozicionin e tyre, zhvillimin e argumenteve dhe përfundimin e temave e vlerësonin duke dhënë rekomandime e nevoshjshme dhe të sakta. Kur shkruanin idetë e tyre, studentëve u siguronte formati i shkrimit me qëllim të ndarjes së ideve bazuar në strukturën gjenerike. Ky format shkrimi, sipas (Coffman, 2009), gjithashtu kontribuon në procesin e të menduarit kritik të studentëve, pasi ai mund të jetë mjet për të kontrolluar mendimin kritik të studentit.

Megjithatë, Edmodo në drejtim kritereve njohëse, ndërveprimit dhe detyrave kuptimplote dhe proceseve njohëse të shkrimit, dhe hapësire dhe konstatime që disa studentë kanë tendencë të jenë më pak përgjegjëse për punimet e tyre në grup. Dukej se punimet grupore të kryera gjatë seancave nuk arrinin optimumin e duhur. Në pothuajse çdo grup ka pasur një model që kontribuesit më të vegjël gjenin mbështetjen e studentëve të veçantë për të postuar draftin e shkrimit të tyre, derisa përgjegjësia ideale mbetet të përmirësohet nga teknologjia e integruar në *klasë*.

PERCEPTIMI I STUDENTËVE NDAJ SHFRYTËZIMIT TË EDMODO

Të dhënat treguan se studentët dhanë përgjigje pozitive dhe negative ndaj përdorimit të Edmodos në procesin për mësuesit e të shkruarit.

Shumica e studentëve e shikonin Edmodon duke u dhënë atyre njohuri të reja dhe përvojë të të mësuarit, por që kur Edmodo është i ri për ta, ata nuk kanë asnjë ide se çfarë duhet të bëjnë me Edmodon. Prandaj, prezantimi i Edmodos është thelbësor përpara se studentët të fillojnë ta përdorin atë. Kjo është ajo që përmendin në parimet e integritit të mësimit elektronik dhe vërtetuan në një hulumtim të kryer nga (Candrasari, 2015).

Studentët gjithashtu treguan se kjo ishte hera e parë e të mësuarit për të shkruar në internet, në të cilën ata pranuan se kishte ndodhur procesi i të shkruarit në formë më të organizuar. Mekanizmi më i

organizuar i shkrimit është në të vërtetë një respekt i siguruar nga rrjedha e programeve e të mësuarit të përzier. Programi i të mësuarit të përzier i adaptuar ofron hap pas hapi për të kryer mësimdhënien dhe e plotëson atë duke bërë hapa të sigurtë për të drejtuar studentët.

Mbështetja e idesë nga (Shams-Abadi, Ahmadi, & Mehrdad 2015), pasiqë kanë vërejtur se shkrimi në të mësuarit të përzier ofron më shumë cilësi sesa shkrimi ashtu edhe në procesin e interaktivitetit nga studentët. Përveç kësaj, shumica e studentëve pranu se Edmodo ia lehtësoi procesin me qasje në bibliotekë nga ecila mund të shkarkonin materialet mësimore të ngarkuara nga mësimdhënësit.

Studentët vlerësojnë dhe pëlqejnë përdorimin e Edmodos me risi unike dhe lehtësi për veprim. Kjo do të thotë se Edmodo përmbush parimin e novacionit të përdorimit të teknologjisë në klasë. Përshtatshmëria dhe zbatimi i lehtë i të shkruarit dhe të mësimnxënies gjithashtu pranohen nga studentët. Këto dy pika janë pranuar edhe elaboruar edhe nga disa studime të kryera më parë (Kongchan, 2013; Adas & Bakir, 2013; Lara, 2013; Thongmak, 2013; Abadi, Ahmadi & Mehrdad, 2015). Studentët gjithashtu komentojnë se procesi i të shkruarit me Edmodon ishte i lehtë dhe më i thjeshtë, si dhe i motivonte ata të shkruanin.

Studentët vlerësojnë se Edmodo lehtësoi komunikimin me mjedisin e tyre (mësimdhënësit dhe shokët e klasës) duke u bashkuar me grupet dhe duke komentuar postimet / bisedat, si dhe duke u bashkuar me funksionet e të mësuarit. Diskutimi i përdorimit të Edmodo për komunikim shfaqet edhe në (Piotrowski, 2010) si funksionalitet i ofruar nga teknologjia në të mësuarin dhe lidhjen e studentët në rrethin akademik. Megjithatë, ata që e shfrytëzojnë më pak Edmodo pohuan se Edmodo nuk u dha shanset për t'u bashkuar me komunitetin dhe se kishin njohuri të kufizuara për përdorimin e Edmodo. Përveç komunikimit, studentët ranë dakord që mësimdhënësi të japë reagime në Edmodo për shkrimin e tyre. Duke parë se si reagojnë studentët, ishte e qartë se studentët shprehnin përgjigje pozitive ndaj reagimeve. Përshtypjet u përqëndruan në disa gabime të zakonshme të bëra nga fillestarët, pra organizimi i ideve, drejtshkrimi, struktura dhe fjalori.

KONLUZIONE DHE PËRFUNDIME

Rezultatet e këtij studimi treguan se kishte një ndryshim të rëndësishëm në rezultatin e nxënësve pasi mësuan duke përdorur Edmodon. Në këtë kontekst, mund të konkludohet se të shkruarit përmes Edmodos do të çonte në rezultat më të mirë të shkrimit.

Veçanërisht, sugjerohet që mësimdhënësit e gjuhës të përdorin Edmodon për të ndryshuar konceptin e të mësuarit tradicional. Përveç kësaj, studentët mund të përdorin Edmodon jo vetëm që të dorëzojnë detyrat e tyre, por edhe të shohin punën e tyre jashtë orarit, të ndajnë informacione, të kenë burime relevante, të përcjellin vlerësimin e punës së tyre etj.

Edmodo përmes platformës së saj lehtëson angazhimin njohës të studentëve duke mundësuar: a) Punë të pavarur brenda grupeve punuese, b) ngritje e shqetësimeve lidhur me cilësinë e punës, c) pjesëmarrje në situata dhe procese të ndryshme të mësimnxënies, dhe d) vlerësoj TIK-un si pjesë integrale e procesit të mësimnxënies.

Sidoqoftë, janë identifikuar gjithashtu se studentëve u mungojnë përgjegjësitë për detyra e të mësuarit e tyre pasi që mbështeten tek njëri-tjetri në dorëzimin e detyrave dhe disa nga studentët rrallë i bashkohen *klasave online* në internet. Në lidhje me zbatimin dhe angazhimin, studentët tregojnë përgjigje të ndryshme si pozitive dhe negative ndaj përdorimit të Edmodos. Çështja e *bandwidth*, konfuzion studentët në përdorimin Edmodo, dhe papajtueshmëria e të mësuarit me aplikacionet duke shfrytëzuar telefonat e menqur janë identifikuar gjithashtu.

Lidhur me gjetjet e studimit, sugjerohen disa aspekte të mirren në konsideratë. Së pari, për të krijuar një ambient të të mësuarit të përzier, duhet pas parasysh mundësinë që e kanë studentët për qasje dhe qasje në internet stabil, duke shkruar tutje dhe vlerësuar në studentët kanë pajisjet që janë përputhshme me LMM. Sigurimi i studentëve me objekte të mjaftueshme dhe qasje në interneti është një parakusht absolut. Së dyti, është një sfidë për mësuesin që të zbatojnë Edmodon në shkrimin e mësimit në bashkëpunim (punimet në grupe) pasi që studentët me sa duket mbështeten tek njëri-tjetri për të ngarkuar draftet e shkrimit; prandaj duhet provuar që veprat të jenë individuale dhe qasja në Edmodo të mundësohet e kontrolluar. Së treti, për të shmangur konfuzionin në përdorimin e Edmodos, informacioni mbi formën dhe modalitetin e përdorimit duhet sugjeruar para implementimit. Së fundmi, angazhimi i nxënësve duhet të rritet më shumë nga përdorimi i Edmodos në *klasa* të mësimit të përzier. Përmirësimi i motivimit të nxënësve për t'u angazhuar dhe për të marrë përgjegjësi të plotë në të mësuarit e përzier do të jetë një pikë kyçe në zbatimin e të mësuarit të suksesshëm të përzier.

LITERATURA

- Appleton, J., Christenson, S., & Furlong, M. (2018). Student engagement with school: critical conceptual and methodological issues of the construct. Wiley Wiley Inter Science www.interscience.wiley.com.
- Bandura, A. (1989). Human agency in social cognitive theory. *American Psychologist*, 1175-1184.
- Bandura, A. (1991). Social cognitive study of self-regulation. *Organizational Behaviour and Human Decision Processes*, 248-287.
- Candrasari, M. (2015). A descriptive study on the use of Edmodo website for English teaching and learning process in Salatiga State Institute for Islamic studies. *Thesis*. Salaiga: IAIN Salatiga.
- Clark, R. C., & Mayer, R. (2011). *e-Learning and the Science of Instruction*. San Francisco: John Wiley & Sons.
- Coffman, T. (2009). *Engaging students through inquiry-oriented learning and technology*. United Kingdom: Rowman & Littlefield Education.

- Davis, H., Summers, J., & Miller, L. (2012). *An interpersonal approach to classroom management: Strategies for improving student engagement*. Corwin.
- Delacruz, S. (2016). Online reading response using Edmodo. *The Florida Reading Journal*, 9-12.
- Dudeney, G., & Hockly, N. (2007). *How to teach English with technology*. Essex: Pearson Education Limited.
- Fadani, A. (2018). The implementation of Genre-based Approach in Teaching writing by a University Tracher in Jombang. *Journal of English Language Teaching and Applied Lingusitics*, 132-141.
- Fauzi, A. (2017). The effect of Edmodo on Students' writing skill in recount text. *International Journal of Pedagogy and Teacher Education*, 73-79.
- Fredricks, J. A., Blumenfeld, P. C., & Paris, A. H. (2014). School Engagement: Potential of the Concept, State of the Evidence. *Review of Educational Research*, 57-109.
- Garrison, R., & Kanuka, H. (2014). Blended Learning: Uncovering Its transformative potential in higher education. *The Internet and higher education*, 95-105.
- Harmer, J. (2007). *How to teach English*. London: Pearson Education Limited.
- Karimi, L., Khodabandelou, R., Ehsani, M., & Ahmad, M. (2014). Applying the uses and gratifications theory to compare higher education students' motivation for using social networking sites: Experiences from Iran, Malaysia, United Kingdom, and South Africa. *Contemporary Educational Technology*, 53-72.
- Kearsley, G., & Shneiderman, B. (1999). Engagement theory: A framework for technology-based teaching and learning. retrieved from <http://www.gwu.edu/engage.htm>.
- Kim, J., & Hahn, K. (2012). Effects of personal traits on generation y consumers' attitude towards the use of mobile devices for communication and commerce. *An Interdisciplinary Journal on Humans in ICT Environments*, 133-156.
- Kongchan, C. (2012). How a non-digital-native teacher makes use of Edmodo. *International Conference "ICT for Language Learning"*. Florence: ICT for Language Learning.
- Kongchan, C. (2018). How Edmodo and google docs can change traditional classrooms. *The Asian Conference on Language Learning*. Tokyo: ACLL.
- Lara, V. D. (2013). Social media in a content course for the digital natives. *TEFLIN Journal*, 254-263.
- Lonn, S. D. (2009). Students use a learning management system for group projects: A case study investigating interaction, collaboration and knowlege construction. Michigan: Unpublished Dissertation.
- M.J., R. (2001). *E-learning: strategies for delivering knowledge in the digital age*. New York: McGraw-Hill-Professional.

- Miliszewska, I., & Horwood, J. (2006). Engagement theory: A framework for supporting cultural differences in transnational education. <https://www.researchgate.net/publication/228786927>.
- Piotrowski, M. (2010). What is an E-Learning Platform? In Y. Kats, *Learning management system technologies and software solutions for online teaching: Tools and applications* (pp. 20-36). Rivier College: IGI Global.
- Purnawarman, P., Susilawati, S., & Sundayana, W. (2013). Using educational social networking sites in higher education: Edmodo through the lenses of undergraduate students. *European Journal of Educational Technology*, 3-23.
- Reading, C., & Levins, M. (2010). ICT in learning: Negotiating criteria to measure engagement. *DIGITAL DIVERSITY CONFERENCE*. MELBOURNE: ACEC2010: .
- Saville-Troike, M. (2006). *Introducing second language acquisition*. Cambridge : Cambridge University Press.
- Schunk, D. (2015). *Learning Theories: An educational perspective, pearson eText with loose-leaf version - Edition 7*. Greensboro: Pearson.
- Shams-Abadi, B. B., Ahmadi, S. D., & Mehrdad, A. G. (2015). The effect of Edmodo on EFL learners' writing performance. *International Journal of Educational Investigations*, 88-97.
- Shams-Abadi, B. B., Ahmadi, S. D., & Mehrdad, A. G. (2015). The effect of Edmodo on EFL learners' writing performance. *International Journal of Educational Investigations*, 88-97.
- Smiley, W., & Anderson, R. (2011). Measuring Students' Cognitive Engagement on Assessment Tests: A Confirmatory Factor Analysis of the Short Form of the Cognitive Engagement Scale. *ERIC*, <https://eric.ed.gov/?id=EJ1062738>.
- Werswood, P. (2008). *What teachers need to know about reading and writing difficulties*. Victoria: Acer Press.
- Winitkun, D., & Kongchan, C. (2014). A Case Study on Perceived problems in the student teacher's spoken classroom language through a supervisor's feedback. *Journal of Language Education*, 59-67.

TEMA: TIPARET DALLUESE TË VARIACIONIT SINONIMIK DHE STILIT NË TRAGJEDINË “MAKBETH”. NJË VËSHTRIM KRAHASUES MIDIS TEKSTIT ORIGJINAL TË SHEKSPERIT DHE TEKSTIT TË PËRKTHYER NGA NOLI

Ornela Çoku Msc

Universiteti “Aleksandër Xhuvani” Elbasan

e-mail: ornelacoku@yahoo.com

Abstrakti

Artikulli ka për qëllim të shprehë tiparet dalluese të variacioneve sinonimike leksikore dhe stilin në tragjedinë e “Makbethit” të përkthyer nga Fan Noli. Ai thekson se variacioni sinonimik është i nevojshëm për ekzistencën e gjuhës në jetën e gjatë e të pasur të popullit.

Thelbin e sistemit gjuhësor e përbën një bërthamë e përbashket gjuhësore, leksikore dhe sintaksore e cila i shërben strukturimit të mëtejshëm gjuhësor si bosht mbështetës për përdorimet e ndryshme diakronike dhe sinkronike të emërtuara ‘variante. Thelbi i variacionit, rrjedhimisht dhe i stilit, krijon lidhjen ndërmjet gjuhës, kontekstit dhe sjelljes gjuhësore në një situatë të caktuar ligjërimi. Është dallimi i cili, mund të analizohet duke u bazuar në krahasimet që janë të domosdoshëm për të vënë në dukje shkallën e variacionit stilistik në situata specifike ligjërimi. Efektet e spikatura stilistike krijohen si rezultat i shmangieve nga përdorimi që është më së normal për situatën e dhënë. Në çdo rast, në marrëdhënjet folës/dëgjues, shkruar/lexues, vendoset një masë e caktuar pritshmërie, në varësi të lidhjes mesazh-situatë ligjërimore, rrjedhimisht mesazhi i pritshëm përmbush kërkesat ose e zhgënjën dëgjuesin/lexuesin; në rast se mesazhi i përmbush kërkesat atëherë ai përputhet me stilin.

Artikulli do të paraqesë variantet leksikore semantike, të cilat janë variacione sinonimike të shprehura me emër, apo mbiemër dhe që dallohen nga shkalla e ndryshme e shfaqjes së një tipari kuptimor të tyre.

Fjalë kyçe: Variacionet leksikore sinonimike, variacion leksikor sinonimik i shprehur me emër dhe Variacion sinonimik i shprehur me mbiemër.

Xhevat Lloshi shkruan për *Variacionin Gjuhësor* se gjuha shqipe ka një bërthamë të qëndrueshme, e cila shfaqet në volum. Bërthama përbën strukturën ndërsa realizimet quhen variante. Çdo variant ka ndarjet e veta, rolin dhe kushtet e përdorimit. Variacioni është i nevojshëm për ekzistencën e gjuhës në jetën e gjatë e të pasur të popullit. Kur variantet

largohen shumë përfundojnë në gjuhë të ndryshme, siç janë gjuhët neolatine kundrejt latinishtes.²⁴

Tipat e varianteve dallohen nga ndryshimi gjatë historisë. Gjuha shqipe merr përsipër rolin historik për t'iu përgjigjur kërkesave të unitetit e të variacionit ndaj kjo është problematika themelore e shqipes si gjuhë e kulturës e një kombi dhe të një shteti. Nga njëra anë ajo synon drejt një norme sa më të ngulitur e të përgjithshme; nga ana tjetër ajo shfaqet me një sistem tërësor variantesh *ligjërimore* e funksionale. Vendosja e normës standarde sipas Lloshit sjell ngadalësimin e ndryshimeve strukturore sidomos në fonetikë dhe morfologji. Ndryshimi dhe pasurimi bëhen sidomos në leksik, fjalëformim, semantikë e sintaksë të cilat përcaktohen nga kërkesat e stileve, ku vihen re *variacione* me vlera stilistike. Në etapën e sotme merr më tepër rëndësi shtresimi social e stilistik i gjuhës. Sistemi stilistik është sot shfaqja themelore e variacionit të gjuhës dhe atij i përket e ardhmja si zgjidhja më e përshtatshme për variacionin. Ristani thekson se: “Thelbin e sistemit gjuhësor e përbën një bërthamë e përbashkët gramatikore, leksikore dhe sintaksore e cila i shërben strukturimit të metejshëm gjuhësor si bosht mbështetës për përdorimet e ndryshme diakronike dhe sinkronike të emërtuara ‘variante’.”²⁵Gjuha, sistemi i saj, ofron shpesh disa mundësi për të shprehur të njëjtin kuptim.

“Fjalët që përcaktojnë kuptimin e foljeve, që tregojnë cilësinë e veprimit, bëjnë punë të ngjashme me përcaktorin, janë si të thuash përcaktor i foljes dhe shprehen me ndajfolje dhe lokucione ndajfoljore ose me emra të prirë nga parafjalë *me, pa, në* etj., me togfjalësh të zakonshëm e frazeologjik”²⁶. Secili mjet paralel e plotëson idenë bazë me ngjyrimë llojesh të ndryshme. P.sh. ndërtimet parafjalë + emër kanë ngjyrimë të ligjërimin bisedor krahasuar me disa ndajfolje që evokojnë sferën librore të komunikimit, etj. Në librin e tij *Ristani* për variacionin stilistik shkruan: “Thelbi i variacionit, rrjedhimisht edhe i stilit, duke përbërë lidhjen ndërmjet gjuhës, kontekstit dhe sjelljes gjuhësore në një situatë të caktuar ligjërimi, është dallimi, i cili mund të analizohet duke u bazuar në krahasimet që janë të domosdoshëm për të vënë në dukje shkallën e variacionit stilistik në situata specifike ligjërimi. Efektet e spikatura stilistike krijohen si rezultat i shmangieve nga përdorimi që është më se normal për situatën e dhënë. Në çdo rast, në marrëdhënjet folës/dëgjues, shkruar/lexues, vendoset një masë e caktuar pritshmërie, në varësi të lidhjes mesazh-situatë ligjërimore, rrjedhimisht

²⁴ Xhevat Lloshi *Stilistika e Gjuhës Shqipe dhe Pragmatika*, Albas 2005, f.147

²⁵ Viktor Ristani, *Kontribut Në Studimet Përkthimore Gjatë Viteve '90*, shtëpia botuese Geer, 2010, f.13

²⁶ *Fonetika dhe gramatika e gjuhës së sotme letrare shqipe*, III, 2, Tiranë, 1983, f.6

mesazhi i pritshëm përmbush kërkesat ose e zhgënjën dëgjuesin/lexuesin. Në rast se mesazhi i përmbush kërkesat atëherë ai përputhet me stilin”²⁷

Noli i shfrytëzon në mënyrë artistike këto shprehje duke krijuar lshpesh variacione sinonimike. “Sinonimet janë një dukuri objektive në gjuhë, meqenëse ekzistojnë fjalë, forma morfologjike, kategori dhe ndërtime gramatikore që kanë kuptime të afërta, por jo krejtësisht të njëjta. Megjithatë, shkrimtarët nuk kufizohen vetëm me mundësitë që u vë përpara sinonimika e gjuhës së përgjithshme, ata përpiqen të futin në marrëdhënie sinonimie edhe mjete të reja. Varfëria e sinonimeve, sipas mendimit të M.Gorkit, tregon jo vetëm pakujdesi, por edhe padije.”²⁸ Noli është shumë i aftë në përdorimin e mjeteve sinonimike me anën e të cilave synohet që mendimi e ndjenjat të jepen me ngjyra të bukura stilistike. Në këtë mënyrë ai shmang dhe monotoninë që shkaktohet nga përdorimi herë pas here i të njëjtit mjet. Këto mjete të cilat përdoren gjërësisht nga Noli janë sinonime kuptimore jo të plota. Midis tyre ka dallime. Si të tilla këto mjete ndihmojnë për të dhënë një informacion të pasur e të detajuar. *Mendoj se* për këtë arsye përdorimi i tyre, i këmbyer, e bën ligjërimin më të gjallë.

Këto shprehje që vihen re në ligjërimin e Nolit në përkthimin e “Makbethit” të Shekspirit, mund të ndahen në disa lloje variacionesh kryesore. Si :Variacione sinonimike të shprehura me emra dhe mbiemra Në këtë grup bëjnë pjesë variacione të shprehura me emra dhe mbiemra të cilët cilësojnë emra dhe shprehin tipare të sendeve e të dukurive të shënuara me emra. Për të shprehur tipare të tilla përdoren mbiemra dhe emra. Ristani, thekson për dukurinë e variacionit në raport me ligjërimin: “Autorë të ndryshëm, duke trajtuar pamjen e dimensioneve stilpërshkruese dhe stilformuese, e cila është më e gjërë, komplekse dhe nuk përputhet me idenë thjeshtëzuese të variacionit stilistik të gjuhës pohojnë se do të ishte e çuditshme në rast se kompleksiteti i variacionit gjuhësor të mund të shpjegohet duke iu referuar vetëm fushës së veprimtarisë, statusit, modalitetit dhe njëjtësisë. Por duhet skema e organizimit të tipareve stilistike, në mënyrë që të krijohet në kuadrin e strukturës së tekstit, një ndërthurje e dimensioneve të përshkrimit, kategorive të përshkrimit dhe tipareve stilistike nën veprimin e kufizuesve situative, të cilët nuk i shqyrtojnë të veçuar, por në ndërveprim.”²⁹

Mbiemrat në përgjithësi kanë ngjyrim vlerësuese. Mbiemri lejon të kuptohet qëndrimi i folësit ndaj sendit a qënies apo personit të përcaktuar. Përcaktorët mbiemërorë lidhen drejtpërsëdrejti me fjalën e përcaktuar, ndërsa emrat lidhen me fjalën e përcaktuar indirekt,

²⁷ Viktor Ristani, Kontribut Në Studimet Përkthimore Gjatë Viteve '90,shtëpia botuese Geer,2010, f.42

²⁸ Fatmir Aglliu, Gjuha e Nolit në veprat origjinale të tij, monografi, Botimet TOENA , Tiranë, 1999, f.169

²⁹ Viktor Ristani, Kontribut Në Studimet Përkthimore Gjatë Viteve '90,shtëpia botuese Geer,2010, f.28.

ose me ndërmjetësinë e një mjeti tjetër. Në shembujt e poshtëshënuar përdoren të këmbyer mbiemri dhe emri si fjalë përcaktore. Kështu që përcaktimi bëhet me mbiemër, ose me emrin përgjegjës që është sinonimi i tij në planin kuptimor: Disa shembuj nga “Makbethi” i Fan Nolit: (a Child *crowned*, with a tree in his hand), [Sh: 301] ... (një foshnjë e *kurorëzuar* me një degë në dorë). [N: 104].

(What is this that rises like the issue of a king, and wears upon his baby-brow the round, and top of sovereignty?). ([Sh:301] Kush është ky që ngrihet si bir mbreti, kjo foshnjë *me kurorën* përmbi kokë? [N:104]. Në shembullin e parë është përdorur përcaktori i *kurorëzuar*, në shembullin e dytë është përdorur emri me *kurorën*. Këto dy gjymtyrë janë sinonime kuptimore, të cilat mund të zëvendësohen njëra nga tjetra. Kështu ai krijon nga rrënja e emrit *kurorë*, mbiemrin *i kurorëzuar*. Një emër abstrakt mund të shënojë cilësinë që është i së njëjtës familje me mbiemrin që shënjon. Në pikëpamje sintaksore emri abstrakt i cilësisë është më i pavarur se fjala që shënjon bartësin e cilësisë. Kjo bën që cilësia të jetë tepër e spikatur. P.sh.:

(*Spiteful and wrathful*, who, as others do,) [Sh: 299]. (*smirtar e zemërndezur* që lakmon), [N: 94] Është shprehur me emër dhe mbiemër.

(You murdering ministers, Wherever in your sightless substances) [Sh: 288] (O xhinder *vrasës, gjakës* të padukur), [N: 33]

(It is the bloody business which informs , thus to mine eyes), [Sh: 290]. (Kjo s’është veç se vepra e *gjakëshme* që po m’i shfaqet syrit). [N 46]. Dallimi midis këtyre mjeteve cilësuese paralele ka të bëjë me semantikën e shprehësinë e tyre. Përcaktorët emërorë të përdorur nga Noli si *vrasës, gjakës*, luajnë një rol sintaksor më të pavarur, sido që janë gjymtyrë të dyta të fjalisë. Kjo pavarësi, që ka të bëjë me veçoritë morfologjike të fjalës, vepron në vlerën e saj përcaktuese. Pikërisht cilësia e shprehur me emër e bën paraqitjen më konkrete, më të dukshme, dhe më të spikatur. Përcaktori emër e jep cilësinë më konkretisht, dhe e detajon me anë të përdorimit të ndonjë mbiemri apo emri që plotëson më tej kuptimin e emrit.

Këto njësi paralele dallojnë njëra nga tjetra. Ato shprehin ngjyrimet emocionale. Elementi që ka ngjyrim emocional plotëson elementin tjetër. Ato kanë dhe dallime të cilat lidhen me semantikën dhe shprehësinë e tyre. Edhe pse që të dy variantet sinonimike janë gjymtyrë të dyta të fjalisë, përcaktori emër apo vetë emri luan një rol sintaksor më të pavarur. Kjo ka të

bëjë me veçoritë morfologjike të fjalës. Emri në funksionin e përcaktorit e jep cilësinë më të detajuar

(And thy hair, Thou other gold-bound brow, is like the first. What, will the line stretch out to the crack of doom?) [Sh: 301]. (Si *mbret* i par' i paske dhe ti flokët: Çudi! mos po vazhdon kjo vijë *mbretërishe*) [N: 106].

Në këtë shembull ndodh përsëritja e së njëjtës fjalë me forma të ndryshme. Në fjalinë e dytë njësia '*mbretërishe*' shërben si përcaktor i fjalës vijë me kuptimin varg (*mbretërishe*). Në fjalinë e parë kemi variantin *mbret*, emër në emërore.

(I am bent to know, by the worst means, the worst.) [Sh: 299]. Se jam gati të di më të *ligën*, *me mjetet më të liga*, [N: 93]. Një herë përdoret emri *të ligën* pastaj mbiemri në shkallën krahasore të sipërisë *më të liga*. Fjalët kanë lidhje prejardhjeje. Zakonisht përcaktorët mbiemra dhe emra, përdoren në të gjitha sferat e komunikimit.

Disa mbiemra të tjerë kanë ngjyrimet poetike, ngjasojnë me mjetet tingëlluese poetike. Ngjyrimet poetike i dallojnë ata, nga përcaktorët – emra përgjegjës: mjete të *liga* dhe emri *të ligën*.

(Of direst cruelty!) [Sh: 288]. (*Me zemërgurësinë më të egër*), [N: 33]. Tipari i paraqitur, ligësi ekstreme, jepet njëherë me emrin *zemërgurësi* që përcaktohet më tej me mbiemrin *më të egër*.

(My lord, his throat is cut; that I did for him. Thou art the best o' the cut-throats:) [Sh: 297] (Imzot ia preva *kokën*: e mbarova. Je më i miri i *kokëprerësve*): [N: 84] Në rastin e parë kuptimi jepet me një grup folje + emër, më pas me kompozitën *kokëprerësve*. Njësitë dallojnë në semantikë dhe në shprehësi. Njësia *preva kokën* e ka ngjyrimin emocional brenda kuptimit të saj se prerja e kokës ngjall gjithnjë emocione e ndjenja krejt negative. Ndërsa *kokëprerës* shënon personin sipas këtij veprimi makabër. Mund të përdorej ndërtimi sinonimik *ai që pret koka*. Por fjala e përbërë *kokëprerës* del më sinjifikative dhe shprehëse. Edhe këtu lidhja e prejardhjes është e evidente. Nga analiza konstatoam se i njëjti fenomen ndodh edhe në gjuhën angleze, si psh: *mystery* (me mister) emër , (*mysterious*) (*misterioze*) mbiemër, etj.

Sipërfundim Noli i shfrytëzon artistikisht të gjitha mundësitë që ofron gjuha për një shprehje sa më të detajuar, në mënyrë të hollësishme të ideve dhe të emocioneve. Duke patur parasysh

shembujt e lartpërmendur, Noli krijon larmi shprehëse me variante sinonimike të cilat shprehen në forma të ndryshme si: *emër me mbiemër, emër me folje, emër me emër, mbiemër me folje, mbiemër me mbiemër, folje me folje, ndajfolje me mbiemër*. Variacionet sinonimike paraqesin tipare me shumë saktësi, me ngjyrimë e me forcë ndikuese.

Shkurtime:

[N: 15] = Fan Noli Makbethi Shqip.Tiranë 1943, f.15(nr i faqeve ndryshon).

[Sh:288] =Shakespeare, Great books of the Western World, Volume 2.1952 Encyclopedia Britanica, Inc.p.288 (Nr I faqeve ndryshon).

Bibliografi :

Fatmir Aglliu, Gjuha e Nolit në veprat origjinale të tij, monografi, Botimet TOENA , Tiranë, 1999.

Fonetika dhe gramatika e gjuhës së sotme letrare shqipe,III,2,Tiranë, 1983,

Viktor Ristani, Kontribut Në Studimet Përkthimore Gjatë Viteve '90,shtëpia botuese Geer, 2010.

Xhevat Lloshi Stilistika e Gjuhës Shqipe dhe Pragmatika, Albas 2005.

PËRDORIMI I MJETEVE MËSIMORE DIDAKTIKE NË TË MËSUARIT ME KOMPETENCA NË LËNDËN GJEOGRAFI

Dr. Shkëlqim Sirika¹, Msc. Silvana Kasa²

¹Universiteti European i Tiranës. E-mail: shkelqim.sirika@yahoo.com

² Shkolla 9-vjeçare “Vilson Blloshmi”, Librazhd. E-mail: silvana_kasa@yahoo.com

Abstrakt

Ndryshimi i kurrikulës në arsimin parauniversitar në R. e Shqipërisë (v.2014), solli risi konceptin e të mësuarit me bazë kompetencash. Në këtë kuadër për një mësimdhënie/nxënie të suksesshme dhe të kalimit nga të mësuarit për dije në të mësuar për kompetenca rol të rëndësishëm zë përdorimi i mjeteve mësimore didaktike.

Në këtë punim do të trajtojmë si përdoren mjetet mësimore në lëndën e gjeografisë nga mësuesit dhe nxënësit me synim arritjen rezultateve të të nxënimit me bazë kompetenca. Gjeografia si lëndë ndërdisiplinore e cila përfshihet në fushën Shoqëria dhe Mjedisi, i ofron nxënësit mundësi të zhvillojë të kuptuarit e veçorive natyrore dhe shoqërore dhe ndërveprimit njeri-mjedisi. Për një të mësuar me kompetenca, përdorimi i mjeteve mësimore duhet të bëhet në përshtatje me lëndën, rezultatet e të nxënimit, veprimtaritë mësimore, moshës dhe karakteristikave të nxënimit të nxënësve. Përdorimi dhe përgatitja e mjeteve mësimore-didaktike në lëndën e gjeografisë ka specifika të veçanta të cilat do i trajtojmë në këtë punim.

Realizimi e këtij punimi shkencor është arritur nëpërmjet gërshetimit të një sërë metodash si ajo e hulumtimit, intervistimit, anketimit (pyetësorëve) analizimit si dhe paraqitjes grafike.

Qëllimi i studimit është evidentimi, vlerësimi, përdorimi, përgatitja e mjeteve mësimore didaktike në mësimdhënien/nxënien e lëndës së gjeografisë dhe ndikimi për një mësimdhënie të suksesshme dhe të nxënimit në të mësuarit me bazë kompetencash. Gjetjet e këtij studimi dhe sugjerimet për mësimdhënësit e lëndës së gjeografisë, nëpërmjet përdorimit me efikasitet të mjeteve mësimore mund të jetë një kontribut i shtuar në fushën e metodikës.

Fjalë kyçe: mjete mësimore, të mësuarit, kompetenca, të nxënimit, gjeografi.

I. Hyrje

Thelbi për të qenë një mësues i efektshëm qëndron në atë që të dish se çfarë duhet të bësh për të nxitur të nxënit e nxënësit dhe të jesh në gjendje ta bësh atë. Mësimdhënia efektive është e lidhur kryesisht me organizimin e atij tip aktiviteti të të nxënit për secilin nxënës, i cili do të jetë i suksesshëm nëse zbaton atë lloji të të nxënit që mësuesi synon.

Shumë studiues kanë arritur në mendimin se, një element i rëndësishëm i aftësive të mësimdhënies është edhe natyra interaktive e tyre. Është e një rëndësie të veçantë që gjatë veprimtarisë së tij në orën e mësimi mësuesi të marrë në konsideratë temën mësimore me specifikat përkatëse të saj. Aftësitë e mësimdhënies bazohen në vlerësimin e pasurisë së mjeteve të përdorura nga mësuesi dhe të rishikimit të performancës së tij. (Middlewo he Cardno, 2001, Jones, 2006).

Lënda e gjeografisë në të mësuarit me kompetenca synon, paisjen e nxënësve me një sistem njohurish, sjelljesh e vlerash. Konceptet bazë të cilat ajo synon, janë konceptet e lokalizimit e të shpërndarjes së vendeve dhe popullsisë, të karakteristikave të ndryshme natyrore të vendeve, të marrëdhënieve shoqëri- mjedis të ndërveprimit hapësinor, të rajoneve gjeografike si njësi efikase për studim, vlerësim dhe zhvillim të mjedisit. Për pajisjen me këto koncepte dhe të nevojës së rrënjësore për t'u aftësuar në orientim dhe lokacion në hapësirë, nuk mjafton vetëm përdorimi i metodologjisë në mësimdhënie por dhe konkretizimi me mjete mësimore dhe didaktike. Për një të mësuar me bazë kompetence, përdorimi i mjeteve mësimore të konkretizimit duhet të bëhet në përshtatje me nivelin e arritjeve të nxënësve, veprimtarinë mësimore, moshës dhe karakteristikave të të nxënit të nxënësve. Përdorimi dhe përgatitja e mjeteve mësimore-didaktike në lëndën e gjeografisë ka specifika të veçanta të cilat do i trajtojmë në këtë punim.

II. Çfarë janë mjetet mësimore didaktike?

Mjetet mësimore janë instrumente didaktike, që përshtaten, zgjidhen, përgatiten për nevojat e mësimi dhe procesit mësimor që i shërbejnë mësuesit, jo vetëm për ngritjen e cilësisë së mësimdhënies/nxënies, por edhe si një stil mësimdhënie për çdo mësues. Për një mësues të gjeografisë, mjetet mësimore didaktike janë ato mjete që përdoren për të lehtësuar mësimin, kuptimin ose përvetësimin e njohurive, koncepteve dhe aftësive nga nxënësit.

Mjetet mësimore didaktike janë instrumente që mundësojnë ose mbështesin procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies, janë mbartës dhe ndërmjetësues të informacionit, janë mjete të komunikimit si dhe objekte e stimuj e të mësuarit. Ato zakonisht përfshijnë çfarë u referohen si “ndihmës të mësimdhënies” (psh, letër, laps, dërrasë e zezë, shkumës, tabakë, projektor i varur,

kompjuter, aparat CD, televizor dhe SMART Boards.). Mjetet mësimore didaktike, si materialet e shkruara, hartat, diagramat, tabelat, figurat, ushtrimet praktike dhe problemat i ndihmojnë nxënësit t'a përpunojnë informacionin që është depozituar përkohësisht në kujtesën funksionale dhe t'a stabilizojnë atë në kujtesën afatgjatë.

Klasifikimi i mjeteve në mësimdhënie/nxënie

Konkretisht mjetet didaktike që mund të përdoren në një orë mësimore në lëndën e gjeografisë grupohen në katër kategori të mëdha:

- ✚ Burime njerëzore
- ✚ Objekte reale
- ✚ Medie mësimdhënëse
- ✚ Ndihmës të mësimdhënies (Laps, letër, dërrase e zezë, CD, DVD, Pc, videoprojektor)

✚ Burime njerëzore

Të gjithë personat mund të kontribuojnë në procesin e të mësuarit, si qenie njerëzore të informuara dhe krijuese. Në të kaluarën, mësuesit ishin jo vetëm ndërmjetësuesit e informacionit, por gjithashtu shpesh burimi kryesor i informacionit për nxënësit e tyre. Në njëfarë mase, (megjithëse disi më të paktë), ata ende e përmbushin këtë rol. Por ka edhe njerëz të tjerë nga të cilët nxënësit mund të mësojnë dhe mësojnë: – prindërit e tyre, një grup ekspertësh (duke përfshirë ligjëruesit e ftuar), pjesëtarët e medias dhe nxënësit e tjerë.

✚ Objektet reale

Janë dhe *naturalë* dhe të *prodhuara* nga njeriu, varësisht nga tema mësimore që jepet mësim ata mund të përfshijnë; bimë, kafshë, shkëmbinj, ndërtesa, monumente dhe trashëgimi industriale. Nëpër klasa mund të përfshijnë koleksione mostrash, monedha të vjetra, sende të çmuara familjare dhe koleksione etnografike. Ndryshe nga media të tjera, ata japin një *përvojë ndijesore* të drejtpërdrejtë me objektet e të mësuarit, këto objekte mundën më së miri të përdoren kur janë të panjohura për nxënësit. Objektet reale kanë një cilësi tredimensionale, e cila i'u mungon objekteve të tjera. Ata shpesh ndikojnë tek nxënësit, që të përdorin të gjithë shqisat e tyre: *shikimin, dëgjimin, prekjen, nuhatjen dhe shijen*. Një avantazh tjetër i përdorimit të objekteve reale është se ata, si "origjinalë" kanë trupëzuar në veten e tyre një faktor të fortë motivues. Domethënë ata kanë një "aura-atmosferë" të autenticitetit, origjinalitetit dhe realitetit, ku mund të ngjallin magjepsjen, që shumë mjete të tjera nuk mund ta kenë. Një rëndësi të veçantë në mësimdhënien/nxënien për lëndën e gjeografisë merr media mësimdhënëse.

Kategoria e medias mësimdhënëse

Përfshin katër nën-kategori: *pamore, dëgjimore, dëgjimore-pamore, interaktive* (Teknologji të Informacionit dhe Komunikimit).

Media pamore; mjetet verbale – materiale tekstuale. Mund të jenë materiale të shtypura, të përgatitura ose të botuara, si dhe të riprodhuara, të përgatitura nga mësuesi ose nxënësi, (teskti shkollor, fletët e punës, udhëzuesi i mësuesit, atlaset, fjalorë, enciklopedi, revista, pankarta të varura dhe analogë hapësinorë, gazeta, revista, buletinë statistikore, monografi, guida turistike, makete, fotografi, vizatime, skema, tabela, postera, piktura, diagrame, mjete grafike, etj). *Mjetet pamore natyrore:* trupat e ndryshëm për demonstrim, këto mjete kanë përparësi relative ndaj mjeteve të tjera të konkretizimit sepse; përdoren si teknika hyrëse, motivuese, apo si mjete për të prezantuar mësimin në mënyrë sa më tërheqëse dhe interesante. Mediet pamore më shpesh plotësojnë mediet e tjera, megjithëse mund të përdoren edhe të vetme. Dokumentet, duke përfshirë tabelat, figurat dhe grafikët janë forma veçanërisht të rëndësishme të medias së shtypur. Organizuesit grafikë, skicimet e përmbajtjes, janë instrumente shumë të dobishme për të ndihmuar në të mësuarin e nxënësve. Analogët hapësinorë, si globet dhe modelet e vullkaneve, veprimtarive sizmike, mund t'i ndihmojnë nxënësit të kuptojnë gjëra që ose janë tepër të mëdha, ose tepër të vogla për t'i parë me sy të zhveshur.

Media dëgjimore; (psh, transmetimet radiofonike, shiritat magnetikë, CD-të dhe regjistrimet elektronike në hard-disk), angazhojnë shqisën tonë të dëgjimit dhe konsiderohen të domosdoshme për të paraqitur informacionin e përshtatshëm stimul, në qoftë se na kujtohen shqetësimet për objektivin e të mësuarit ose për njohjen e tingujve, psh. dukuritë e uruganeve, tajfuneve, tornadeve, shpërthimeve vullkanike, etj.

Media dëgjimore-pamore; (psh., filmat me metrazh të gjatë, dokumentarët dhe videot) nxisin “të shikuarit” dhe “të dëgjuarit” në mënyrë integrative. Një fotografi e vetme mund të sigurojë mbështetjen për të mësuar një koncept apo ide të vetme, një dokumentar nga ana tjetër iu bën të mundur nxënësve të shohin ndryshimin në kohë, të dëgjojnë shpjegimet e ngjarjeve dhe të kuptojnë marrëdhëniet shkakësore. Psh një dokumentar mbi fetë, grupeve racore, zhvillimeve urbane, tipoplogjitë e vendbanimeve/qyteteve, aktiviteteteve humane, etj

Media interaktive; i ngjan medias dëgjimore-pamore në atë që të dyja janë shumëshqisore por shkon përtej kufijve të medias dëgjimore-pamore duke i angazhuar nxënësit në mënyrë më interaktive. Shembulli aktual më i mirë i medias interaktive është Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit (ITC).

Mediet mësimore përdoren më mirë të kombinuara, gjë që jep si rezultat një sistem multimedial. Shumica e situatave të mësimdhënies kërkojnë ose lejojnë përdorimin e një apo më shumë mediumi për t'i ndihmuar nxënësit të arrijnë objektivat. Dërrasat me shkumës, dërrasat e

bardha dhe gjithnjë e më shumë SMART Boards, (janë tabela ku ekspozohen materiale interaktive), përdoren në të njëjtën kohë në prezantimet me gojë. Videot mund të paraprihen nga një hyrje e mësuesit dhe të pasohen nga diskutimi në klasë. Kjo renditje “dëgjo-ndiq” e “dëgjo-bisedo”, simulon shqisa të shumta, të cilat nga ana e vet çojnë në të kuptuarit më të plotë të përmbajtjes. Përdorimi i medias së shumëfishtë po ashtu jep mundësi të shumta që të realizohet të mësuarit. Në qoftë se një nxënësi i shpëton diçka në hyrje, ai apo ajo mund ta kapë atë në video ose në diskutimin pasues. Analogjikisht në qoftë se një nxënës hutohet lidhur me diçka në video, ky hutim mund të reduktohet në masë të konsiderueshme ose të eliminohet gjatë diskutimit në klasë.

Funksionet e mjeteve mësimore-didaktike

Funksioni i njohjes, realizohet duke kaluar nga njohja konkrete në njohjen abstrakte, duke krijuar kështu koncepte të qëndrueshme.

Funksioni didaktik, konsiston pikërisht në ndihmesën që ato japin për përvetësimin e njohurive sa më sistematike e të qëndrueshme.

Funksioni motivues, konsiston në rritjen e interesit të nxënësve për temen e ilustruar me mjetin më të përshtatshëm të konkretizimit për të.

Gjithashtu studimet kanë treguar se kur nxënësi përballet me probleme reale, për të cilat nuk mund t'i japë menjëherë përgjigje apo zgjidhje, ai zhvillon të menduarit krijues.

III. Kompetencat në lëndën e gjeografisë dhe të mësuarit me mjete konkretizuese

Kompetencat në lëndën e gjeografisë ndërtojnë tek nxënësi njohuritë që ai duhet zotërojë gjatë gjithë jetës së tij. Kompetencat e lëndës, të cilat janë pjesë e kërkimit gjeografik, zhvillojnë dhe ndërtojnë kompetencat tek nxënësit, si të aftësohen dhe t'i përdorin ato në mënyrë që të thellojnë dhe të zgjerojnë njohuritë, shkathtësitë, qëndrimet dhe vlerat e tyre duke arritur progres. Këto kompetenca përkojnë me kërkimin e përgjigjeve ose të zgjidhjeve të problemeve shkencore, përdorimin e njohurive shkencore dhe teknologjike. Kompetencat e lëndës së gjeografisë që lidhen me kërkimin gjeografik janë:

- Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike
- Përpunimi i informacionit gjeografik
- Marrja e vendimeve mbi bazën e informacionit të mbledhur

Konkretizimi i mësimit është një nga parimet e rëndësishme për të realizuar një përvetësim të qëndrueshëm të njohurive. Kjo në aspektin didaktik ndihmon tek nxënësi formimin e përfyterimeve dhe koncepteve. Mësimi zhvillohet mbi bazën e përceptimit të drejtperdrejtë të sendeve dhe dukurive të realitetit ose figurave të tyre. Konkretizimi në lëndën e gjeografisë është i nevojshëm në të gjitha shkallët e sistemit arsimor, sepse ndihmon për të kuptuar më mirë marrëdhëniet që ekzistojnë në realitet midis dukurive e fenomeneve të ndryshme, për të formuar ide dhe koncepte të qarta e të plota mbi proceset natyrore dhe humane që ndodhin në planetin tonë. Nëpërmjet përfshirjes në eksperiencën mësimore, nxënësi arrin të depërtojë në lidhjet shkak-pasojë, nëpërmjet vetveprimit dhe nën drejtimin e mësuesit. Përvoja tregon se nxënësit hasin vështirësi në të kuptuarit e këtyre lidhjeve. Konkretizimi i tyre dhe vrojtimi i shembujve konkrete në mjedisin përreth ose gjatë ekskursioneve krijon tek nxënësi bindjen e ndërveprimit të dukurive natyrore dhe njeri-mjedis. Nxënësit përvetësojnë mjetet dhe gjuhën gjeografike, teksa hulumton marrëdhënien e njeriut me vendet e mjedisin dhe zbulon rolin që duhet të përmbushë për zhvillimin e qëndrueshëm. Vëzhgimet dhe puna në terren, puna me hartën, interpretimi i shpërndarjes hapësinore të veçorive natyrore dhe shoqërore në Tokë dhe ndërvarësisë midis tyre, zhvillojnë shkathtësitë themelore gjeografike.

Nëpërmjet konkretizimit të mësimit në lëndën e gjeografisë, përveç shpjegimit të mësuesit, përdorimi i mjeteve mësimore nga nxënësi, nxit tek ata shkathtësitë dhe shprehitë e nevojshme për të zbuluar fakte, për të gjetur lidhjet midis tyre dhe për t'i krahasuar ato në mënyrë të pavarur, duke nxjerrë përfundime teorike dhe dhënë zgjidhje praktike.

Roli i mjeteve mësimore-didaktike-konkretizuese sëbashku me metodën e hulumtimit dhe të demonstrimit, në krijimin e shkathtësive e shprehive në të mësuarit me kompetenca në lëndën e gjeografisë, është i pazëvendësueshëm. Përdorimi i mjeteve jo vetëm që nxit të zhvilluarit të shkathtësive, por dhe formimin e shprehive nëpërmjet të ushtruarit të veprimeve. Mjete të tilla si (hartat, globi, tablo, poster, moket, etj), jo vetëm që shërbejnë si burim njohurish, por formojnë tek nxënësi shkathtësitë dhe shprehitë e lokalizimit shpejt e saktë të objekteve e dukurive gjeografike, të përshkrimit të tyre, të evidentimit të lidhjeve shkakësore.

IV. Metodologjia

Metodologjia e përdorur në studimin tonë bazohet në qasjen kërkimore mikse, ku ndërveprojnë metoda sasiore dhe metoda cilësore. Instrumentet e përdorura në studim përfshijnë: (1) pyetësorë të strukturuar, (2) fokus grup. (3) hulumtim në tryezë.

Shtrirja gjeografike, realizmi i studimit u zhvillua në katër shkolla, (tre gjimnaze dhe një shkollë 9 – vjeçare), me një shtrirje rastësore hapësinore, me respondentë mësues të gjeografisë dhe

nxënës të klasave 9-10-11-12. Konkretisht në gjimnazet “Isa Boletini” Paskuqan, “Ibrahim Rugova” Kamëz, “Skënderbeu” Has dhe shkollën 9- vjeçare “Vilson Blloshmi”, Librazhd.

Formati i pyetësorëve të strukturuar dhe i fokus grupit të përdorur në këtë punim, përmbajnë dimensione dhe pohime që fokusohen në komponentët evidentimit, vlerësimit, përdorimit, përgatitjes së mjeteve mësimore didaktike në mësimdhënien/nxënien e lëndës së gjeografisë, ndikimi për një mësimdhënie të suksesshme dhe të nxënësve në të mësuarit me bazë kompetencash. Kampioni i studimit përbëhet nga respondentët mësues të lëndës së gjeografisë, (N= 18). Përzgjedhja e respondentëve në zhvillimin e pyetësorëve dhe në fokus grupe ishte rastësore, duke mundësuar një kampionim përfaqësues nga shkolla me pak ose aspak mundësi të sigurimit të mjeteve mësimore-didaktike nga institucionet përgjegjëse. Duke përfshirë respondentët mësues të gjimnazeve nga bashki kryesisht me funksion administrativ si Kamëz, Has dhe Librazhd. Respondenti nxënës, (N= 87) u realizua në një atmosferë mirëkuptimi dhe shkëmbimi të lirshëm mendimesh dhe idesh mbi rolin e mjeteve mësimore- didaktike, mbi aftësitë dhe kompetencat që formojnë nxënësit, të cilat rrjedhin nga kompetencat kyçe.

V. Rezultatet dhe diskutimi

Rezultatet e pyetësorëve të përfuara pas analizimit të tyre do të paraqiten me grafik ku dhe do diskutohen gjetjet e tyre si më poshtë.

Përfundimet e diskutimeve në fokus grup, u përmbledhën në mënyrë sintetike për t'i shfrytëzuar si bazë për analizën e gjetjeve.


Vlerat e përqindjeve sipas gjinisë tregojnë se kampioni i respondentëve të mësuesve dhe nxënësve që morën pjesë në studim përbëhet nga 50 % femra dhe 50% meshkuj.

Vlerat e përqindjeve sipas shkallës të kualifikimit të mësuesve, tregojnë se nga kampionimi i respondentëve mësues që morën pjesë në studim rezulton se, 27.4% e tyre kanë shkallën e I të kualifikimit, 33.4% e tyre kanë shkallën e II të kualifikimit, 28.1% e tyre kanë shkallën e III të kualifikimit dhe 11.1% e tyre kanë shkallën e IV të kualifikimit. Kjo tregon që shumica e mësuesve që përbëjnë kampionimin e studimit zotërojnë shkallë të lartë kualifikimi.

Rezultatet e respondit mësues: Vlerat e përqindjeve të përdorimit të mjeteve mësimore-didaktike për një mësimdhënie/nxënie të efekshme në lëndën e gjeografisë, tregojnë se nga kampionimi i respondentëve të mësuesve që morën pjesë në studim rezulton se 89.6% e tyre pohojnë se mësuesi në lëndën e gjeografisë e kanë domosdoshmëri, përdorimin e mjeteve mësimore-didaktike


në mësimdhënien me bazë kompetencat e nxënësve; ndërsa 4.6% e tyre mendojnë se nuk përbëjnë në çdo orë dhe temë mësimore domosdoshmëri, ndërkohë që 5.8% e tyre mendojnë që mjetet mësimore nuk ndihmojnë aspak në të mësuarit me kompetenca tek nxënësi. Vlerat e përqindjeve të mësipërme paraqiten grafikisht si më poshtë.

Grafiku 1: Përdorimi i mjeteve mësimore nga mësuesit




Rezultatet e respondit nxënës: Vlerat e përqindjeve të përdorimit të mjeteve mësimore-didaktike, tregojnë se nga kampionimi i respondentit nxënës të përfshirë në studim rezulton se, 81.6% e tyre pohojnë se të nxëniti është më efektiv kur mësuesit përdorin mjetet mësimore-didaktike gjatë mësimdhënies dhe në veçanti të atyre demonstruese në tema mësimore që kërkojnë shpjegim të koncepteve të cilat ata i kanë të vështirë ti kuptojnë vetëm në aspektin teorik; ndërsa 12% e tyre pohojnë se nuk e shikojnë si rritje të efektivitetit të të nxëniti tek ata përveç se në veprimtari të posaçme me nxënësit si punë praktike/detyra kërkimore, ndërkohë që 6.4% e tyre janë të pavendosur. Rezultatet paraqiten grafikisht si më poshtë.

Grafiku 2: Efektiviteti i përdorimit të mjeteve mësimore nga mësuesit




Rezultatet e respondentit mësues: Vlerat e përqindjeve të parapërgatitjes të mjeteve mësimore-didaktike tregojnë se nga kampioni i respondentëve të mësuesve që morën pjesë në studim rezultoi se, 82.3% e tyre pohojnë se vetëm në orë të veçanta apo tema specifike parapërgatisin mjete mësimore/didaktike nga vetë ata, por më shumë përdorin mjete të gatshme që zotëron shkolla; ndërsa 11.5% e tyre pohojnë se përgatitin mjete mësimore/didaktike nga vetë ata, ndërkohë që 6.2% e tyre nuk e shikojnë si opsion përgatitjen nga mësuesi të mjeteve mësimore. Rezultatet parqiten grafikisht si më poshtë.

Grafiku 3: Parapërgatitja e mjeteve mësimore nga mësuesit



Rezultatet e respondentit nxënës: Vlerat e përqindjeve të identifikimit të nevojave për pasjen e një kabineti të gjeografisë në shkollë me mjetet e duhura mësimore-didaktike tregojnë se nga kampionimi i respondentit nxënës, që morën pjesë në studim rezultoi se 83.4% e tyre pohojnë se në shkollat e tyre identifikohen nevojat e nxënësve për zhvillimin e mësimin në kabinete për lëndë të tilla që kërkojnë demonstrime reale të koncepteve siç janë dhe konceptet gjeografike; ndërsa 5.1% e tyre pohojnë se nuk e shikojnë si domosdoshmëri, ndërkohë që 11.5% e tyre janë të pavendosur. Rezultatet parqiten grafikisht si më poshtë.

Grafiku 4: Nevoja për kabinet të gjeografisë në shkolla



Diskutim: Nga analiza e pyetësorëve si të respondentit të mësuesve dhe të nxënësve rezulton se mjetet më të përdorura në lëndën e gjeografisë janë harta të tematikave të ndryshme, glob, postera, videoprojektor, laptop, shpesh harta skicë, mokete, foto, fletëpalosje dhe më rrallë tabela dhe diagrama, SMART Boards, plan të qytetit/lagjes, kampion shkëmbijsh, etj. Nxënësit në përgjithësi shprehen se me përgatitjen e mjeteve mësimore nga vetë nxënësit ata nxiten nëpërmjet stimulimit të kureshtjes, konkretizimit, punës krijuese dhe të pavarur si dhe bashkëpunimin mes nxënësve të tjerë ata bëhen më aktiv dhe më të vëmendshëm gjatë gjithë procesit mësimor. Mjetet të përgatitur nga nxënësit janë, fotoalbum, hartë skicë, foto dhe pamje, poster, fletë palosje, modelime-mokete, të dhëna mbi popullsinë si dhe shpërndarjen e vendbanimeve, etj. Në kushtet kur në shumë shkolla shqiptare dhe në veçanti në rrethina, mungojnë mjetet mësimore-didaktike, nxënësit dhe mësuesit shprehen që, përgatitja e tyre nga mësuesit dhe nxënësit do të lehtësonte punën e mësimeve dhe mësimnxënien do bëhej më atraktive.

Pyetjes, nëse nxënësit do të mund t’ a zhvillonin mësimin e gjeografisë për tema specifike, në një “laborator natyror” a do të ishte më efektiv për to, ata i janë përgjigjur: “Shumë” dhe me argumentin sepse në këtë mënyrë ata do të mund të kuptonin dhe zotëronin njohuritë shkencore dhe bëjnë lidhjen e njohurive me mjedisin që i rrethon. Një kombinim i teorisë me praktikën, konkretizimit me objekte reale aftëson nxënësit për aplikimin në jetën e përditshme. Një mësimdhënie/mësimnxënie në natyrë nëpërmjet të nxënësve vizual, nxënësit arrijnë t’i “prekin” realitetin fiziko-gjeografik dhe zhvillimet humane. Kjo arrihet nëpërmjet përdorimit të metodave dhe teknikave të tilla si vrojtimit, vëzhgimit, hulumtimeve, ekskursioneve, ku nëpërmjet konkretizimit real, nxënësit nxiten në zgjidhjen e problemeve, zbatimit dhe të menduarit kritik dhe krijues.

Përfundime

- Mjetet mësimore didaktike janë të dobishëme për nxënësit sepse ato mund të shtojnë mundësitë për të mësuar, të mbështesin ndërtimin e dijes, të rritin të kuptuarit e përmbajtjes, të krijojnë interes, të shtojnë motivimin dhe kontribuojnë në qëndrime pozitive në lëndën e gjeografisë dhe të mësuarit në përgjithësi.
- Për mësuesit, mjetet mësimore didaktike mund të shtojnë, zgjerojnë dhe/ose pasurojnë mësimdhënien e tyre dhe ndihmojnë të krijohen dhe mbahen mjedise në të cilat ka më së shumti gjasa të realizohet të mësuarit.
- Nga analiza e pyetësoreve me mësuesit mbi përdorimin e mjeteve mësimore-didaktike në lëndën e gjeografisë vërehet që ka një dallim midis mësuesve të gjeneratës së vjetër, ku eksperiencia e mësimdhënies tradicionale të tyre ka qenë e madhe dhe me mësuesit e gjeneratës së re ku kryesisht i përkasin eksperiencave të mësimdhënies me në qendër nxënësin dhe të mësuarit me kompetenca.
- Zhvillimi aktual i teknologjisë, digjitalizimi, kanë rritur mundësitë e një mësimdhënie nëpërmjet përdorimit të një game të gjerë mjedish të cilat shtohen dita-ditës me elemente të rinj, të ndryshëm e me të sofistifikuar.
- Pamvarsisht për mësuesit që i përkasin të edukuarit me metoda tradicionale janë përfshirë në mësimdhënie/mësimnxënie me kompetenca, janë kualifikuar për përdorimin e metodave të reja të mësimdhënies, përgjithësisht e kanë të vështirë të aplikojnë mjete konkretizuese të avancuara teknologjiksht deri të sofistifikuara.
- Mësimdhënësit e rinj guxojnë më shumë në aplikimin e mësimdhënies me mjete mësimore-didaktike që i përkasin teknologjisë së fundit deri tek të mësuarit me tablet (mësimi digjital). Zotërimi i aftësive teknologjike të mësimdhënësit e rinj mundëson sigurimin më të lehtë dhe më të shpejtë dhe përdorimin e mjeteve mësimore-didaktike.
- Të mësuarit nëpërmjet konkretizimit, rrisin dhe nxisin përfshirjen e nxënësve në mësim, duke simuluar sjellje të dëshiruara tek ata. Nxënësit kur përgatisin dhe përdorin mjete mësimore-didaktike, ilustrojnë dhe demostrojnë, situatë problemore, dukuri/fenomene gjeografike apo dëshmojnë fakte, sigurojnë përfitimin e kënaqësisë dhe vetvlerësimin nga kryerja me sukses e detyrës.

Rekomandime

Rekomandime për mësimdhënësit e lëndës së gjeografisë:

- Jini i/e ndërgjegjshëm për larminë e mjeteve mësimore didaktike në lëndën e gjeografisë.

- Zgjidhni mjete mësimore të të mësuarit që janë; të bashkërenduara me rezultatet e të nxenit; mbështetëse për veprimtaritë tuaja mësimdhënëse të të mësuarit; të përshtatshme për nxënësit tuaj në terma të dijes së tyre e përvojës së mëparshme, moshave ose niveleve të zhvillimit.
- Lokalizoni një larmi mjetesh të të mësuarit për të përmbushur nevojat e ndryshme dhe stilet e të mësuarit të nxënësve në klasën tuaj.
- Bëjini mjetet mësimore “të vijnë në jetë”.
- Mbani mend, jeni ju, mësuesi që vendos se si përdoren metodat dhe mjetet mësimore për të krijuar mjedise nxitëse të të mësuarit dhe për t’i dhënë formë asaj që mësojnë nxënësit.
- Përdorimi i teknologjisë në mënyrë të përshtatshme dhe të efektëshme për të mbështetur mësimdhënien tuaj.

Literatura

1. Aguerro, I. 2009, Complex knowledge and education competence, (UNESCO IBE, Geneva, Switzerland).
2. Armitage, S. 2017, Approaches to Learning and Teaching Geography a toolkit for international teachers. (Cambridge). f, 103-114
3. Burke, J. 1989. Competency Based Education and Training. (The Falmer Press, UK).
4. Dibra, G., G., Taip, M., Halluni, E. 2015, Mësuesi dhe mësimdhënia. (Botime-Vllamasi) f, 237-248
5. Farstad, H. 2004. Competencies for Life: Some Implications for Education. Background Paper to workshop 3: (Quality Education and Competencies for Life).
6. IZHA, 2016. Kurrikula e bazuar në kompetenca. (Programi i gjeografisë, Tiranë).
7. Marcus, A. S., Metzger, S. A., Paxton, R. J., & Stoddard, J. D. 2010, Teaching history with film. (London: Routledge).
8. Verma, O.P., 1970. Geography Teaching (Delhi: Sterling Publishers (P) Ltd). p. 38.
9. Trëndafil, G, Karaguruni, M. 2005, Metodika e Gjeografisë, (Tiranë, Erik Botime).
10. Verma, O.P., 1951. N.V. Scarfe, ed., A Hand-book of Suggestions on the teaching of Geography (Netherlands: Unesco, ed.), p. 28-39.
11. Yeomans, J. & Arnold, C. 2006, Teaching, learning, and psychology. (London: David Fulton Publishers)

KONTRIBUTI I XHON DJUIT NË ZHVILLIMIN E KONCEPTEVE PRAGMATISTE NË PEDAGOGJI

Remzi BUJARI- PHD KANDIDAT NË PEDAGOGJI

r.bujari@hotmail.com

Abstrakt

Xhon Djui, është njëri ndër mendimtarët, filozofët dhe pedagogët amerikan më me ndikim në pedagogjinë dhe edukimin e shekullit të njëzet. Xhon Djui ndikoi në botën e arsimit, në atë mënyrë që edhe ai vetë nuk e kishte menduar. Ndikimi i tij ishte praktik dhe i prekshëm në edukimin e brezit të ri. Sipas Djuit, në shoqërinë tradicionale, dija ka qenë e monopolizuar në shërbim të një grupi të vogël njerëzish dhe pa kurrfarë lidhjeje me shoqërinë. Kjo qasje izoluese dhe monopolizuese e dijes, do të ndikojë më vonë në raportin në mes të edukatorit dhe të nxënësit, ku i pari shihej si përques i informatës, kurse i dyti kishte rol pasiv në integrimin e tij në shoqëri. Ai ishte për një qasje tjetër në procesin edukativ dhe arsimor. Xhon Djui, duke trajtuar çështje të edukatës dhe të arsimit, ideoi zbatimin e pragmatizmit në shkollë, pra që shkolla të jetë e lidhur me jetën e jo e ndarë siç ishte deri në atë kohë. Djui, i kushtoi rëndësi të veçantë faktit, që përvoja t'i paraprijë mësimin dhe teoria e praktika të mos ndahen.

Xhon Djui, me idetë e tij u angazhua që të ndryshojë sistemi arsimor në Amerikë, ku ndikoi që ky sistem të jetë i pranishëm edhe në vende të tjera.

Fjalë kryesore: Xhon Djui, kontribut, koncepte, pedagogji, pragmatiste, zhvillim

HYRJE

Pragmatizmi është filozofi, sipas të cilës, veprimi, aktiviteti, përvoja e nxënësve duhet të jetë bazë për zhvillimin e procesit mësimor. Ndër themeluesit e kësaj fryme pedagogjike është pedagogu e mendimtari i shquar, Xhon Djui. Ai dhe kolegët e tij pragmatistë, patën një ndikim të jashtëzakonshëm sa i përket qasjes së problematikës së shkollës, edukatës dhe çështjeve pedagogjike në përgjithësi. Qasja e tyre praktike, bëri që nxënësit të vihen në qendër të vëmendjes, ku aktiviteti dhe përvoja e tyre u bënë shumë të rëndësishme. Sipas Djuit, shkolla është e shoqërisë dhe gjithçka, që prindi më i mirë dhe më i zgjuar kërkon që të arrijë fëmija i tij, atë duhet ta kërkojë edhe komuniteti për të gjithë fëmijët e vet. Pra, Djui, konsideronte se gjithçka që shoqëria ka arritur për vete, vihet në dispozicion të anëtarëve të saj të ardhshëm nëpërmjet shkollës.

Xhon Djuj, me idetë e tij përparimtare, fillimisht do ta “pushtojë” Amerikën, pastaj idetë e tij do të arrijnë deri në vendet më të largëta, duke i përfshirë edhe ato të Ballkanit. Përmes literaturës që e botoi, por, edhe përmes punës praktike, u bë shembull i mësimdhënësit praktik, që nuk e pranonte të vërtetën absolute, por sipas tij e vërteta është relative dhe ajo që është e dobishme. Ishte ithtar i lidhjes së teorisë me praktikën, i jetës me punën, i lidhur me veprimtarinë e individit.

Pavarësisht, kritikave rreth disa koncepteve të Djuj, ai mbetet njëri ndër pedagogët më të shquar të shekullit XX, që la gjurmë të thella në fushën e pedagogjisë dhe më gjerë.

1. RRETH FILOZOFISË PRAGMATISTE

Fjala pragmatizëm rrjedh nga fjala e njëjtë greke, që rrjedhin edhe fjalët praktikë, praktik, veprim. (James, W., 2005)

Pirs (Pirce, 1931), Xhejms (James, 1907), Djuj (Dewey, 1931) dhe Med (Mead, 1938), formuluan pragmatizmin, si një alternativë filozofike ndaj shkencës abstrakte dhe racionaliste. Pragmatizmi ka një bazë të qartë në empirizmin, por shkon përtej një orientimi të pastër për të vëzhguar një realitet të dhënë. Baza në veprimin njerëzor i jep pragmatizmit një orientim drejt një bote të ardhshme, ende jo të realizuar. (Goldkuhl, G., 2004).

Shqetësimi kryesor, pas një pozicioni pragmatist, në botën empirike është veprimi. Kjo nuk do të thotë që një pragmatist merret vetëm me veprime dhe shpërfill çështjet e tjera. Një studiues pragmatist lejon, që veprimet të shfaqen si diçka domethënëse dhe themelore për të studiuar. Çështje të tjera, gjithashtu, mund të jenë të rëndësishme për t'u studiuar. Por, këto çështje të tjera janë përqendruar rreth veprimeve, si njësia kryesore e analizës. (Goldkuhl, G., 2004).

Pragmatizmi përfaqëson një qëndrim plotësisht të njohur në filozofi - qëndrimin empirist. Pragmatizmi braktis abstraksionin dhe pamjaftueshmërinë, zgjidhjet verbale, arsyet e këqija apriori, parimet fikse, sistemet e mbyllura dhe absolutet e origjinat e rreme (James, W., 2005).

Lindja dhe zhvillimi i pragmatizmit mund të jetë një bekim për njerëzimin, sepse thekson anën tjetër të së njëjtës pamje. Afron një botëkuptim alternativ, një mjet të ri heuristik dhe një mënyrë të mundshme të llojit të tretë, për të adresuar konfliktet në mes të modernizmit dhe të traditës, si dhe midis modernizmit dhe postmodernizmit. Ai ka një potencial të madh në ndërmjetësimin e marrëdhënieve të divorcuara midis teorisë dhe praktikës dhe konflikteve të mprehta midis një ekstremi dhe tjetrës. (Jia, W., 2005)

2. XHON DJUI (1859-1952)

Xhon Djui, ishte filozof amerikan, edukator dhe themelues i Shkollës Filozofike të Pragmatizmit. Në vitin 1899, u zgjodh president i Shoqatës së Psikologëve Amerikan dhe ishte anëtar i Bordit të parë të Redaktorëve të Rishikimit Psikologjik. Ai ka punuar në shumë fusha, ku në disa prej tyre ka arritur shumë. Djui, në vitin 1910, u zgjodh si psikolog në Akademinë Kombëtare të Shkencave (Pillsbury W. B., 1957).

Xhon Djui, u lind në Burlington - Vermont, në një familje me jetë modeste (Gutek, Gerald L. 2005). Ishte filozofi më i rëndësishëm amerikan i gjysmës së parë të shekullit të njëzet. Karriera e tij përfshinte tre breza. Zëri i tij mund të dëgjohej në mes të kontradiktave kulturore në Shtetet e Bashkuara (dhe jashtë) nga vitet 1890 deri në vdekjen e tij (në moshën 93-vjeçare), më 1952. (Westbrook, B. R., 1999).

Djui ishte profesor i filozofisë në Universitetin e Miçiganit, Minesotës, Universitetin e Çikagos, si dhe në Universitetin e Kolumbisë në NewYork. Djui themeloi edhe një “shkollë-laborator”, pranë Universitetit të Çikagos. Djui, pas afirmimit të tij dhe të ideve të tij, mbajti ligjërata në Japoni, në Kinë, si dhe në disa vende të tjera. Idetë e tij i pasqyroi në veprat: “Psikologji” (1887), “Psikologji e aplikuar” (1889), “Shkolla dhe shoqëria” (1899), “Si mendojmë” (1910), “Demokracia dhe arsimit” (1916), etj. Veprat e Xhon Djuit, u përkthyen në shumë gjuhë të ndryshme, si dhe u shfrytëzuan si bazë teorike për zbatimin praktik të ideve të tij.

Përpjekjet e Djuit për të formuar filozofinë e tij nëpër shkolla, si një fakt jetësor, hasën në polemika dhe kundërshti. Edhe sot e kësaj dite, ai mbetet një gur prove në debatet për mangësitë e arsimit amerikan: një kopuk i respektuar për konservatorët që të “kthehemi te themeloret” dhe një paraardhës frymëzues për reformatorët “qendra-fëmija”. Të dyja palët e këtyre debateve kanë tendencë që të gjykonin gabim punën e Djuit, të mbivlerësojnë ndikimin e tij dhe të nënvleftësojnë idealet demokratike, që ishin thelbi i pedagogjisë së tij (Westbrook, B. R., 1999).

3. SISTEMI PEDAGOGJIK I XHON DJUIT

Djui, është pedagogu prijës amerikan, i cili konceptonin e vet pedagogjik e ka ndërtuar drejtpërsëdrejti në pragmatizëm. (Zhlebnik, L., 1964).

Idetë e Djuit pasqyrojnë ndikimet e reja të shoqërisë së kolonizuar e të industrializuar, të mbushur me problemet dhe pasojat e dy luftërave botërore. Ai u frymëzua, kryesisht, nga teoria e Marksit për luftën sociale dhe konfliktin midis klasave. Teoria e konfliktit të Marksit është se shoqëria është e shtresuar me shtresa të ndryshme dhe ekziston një konkurrencë brenda këtyre klasave të ndryshme. Marksi, theksoi se analiza sociale duhet të përqendrohet në strukturën dhe marrëdhëniet e klasës. Djui kishte një frymëzim nga mendimet e Habermas, të cilat janë në traditat e Kantit dhe theksojnë rolin e

edukimit, për ta transformuar botën në një shoqëri më njerëzore, të drejtë dhe barazuese. (Sikandar, A., 2015).

Xhon Djuj, konceptoi një sistem pedagogjik të veçantë dhe për shumëçka origjinal, karakteristikat kryesore të të cilit janë:

-Instrumentalizmi, sipas të cilit, dituria, arsimiti, paraqet bazën për veprim praktik;

-Rikonstruktionizmi, sipas të cilit edukata është një rindërtim i përhershëm i përvojës;

-Progresivizmi, sipas të cilit edukata është një veprimtari shumë e rëndësishme, e cila duhet t'i shërbejë përparimit shoqëror;

-Pedocentrizmi, sipas të cilit fëmija duhet të jetë në qendër të procesit edukativo-arsimor;

-Aktivizmi, sipas të cilit, faktori themelor i zhvillimit të njeriut, është aktiviteti i tij. (Koliqi, H., 1998).

Xhon Djuj, e ka studiuar në mënyrë të gjithanshme bazën teorike dhe anën praktike të mësimin. Ai u mor me çështje të përmbajtjeve mësimore, me organizmin e mësimin dhe me shumë fenomene, që kanë të bëjnë me mësimin dhe mësimdhënien. (Zylfiu, N., 2005).

3.1. Pedagogjia pragmatiste e Djuj

Xhon Djuj, ishte përfaqësues i shquar i pragmatizmit, dhe si i tillë, besonte se mendimet shtohen aty ku shtohen problemet praktike (Baku, P., 2011). Ai niset nga teza e njohur pragmatiste se nuk ka të vërtetë objektive, sepse e vërtetë është vetëm ajo që është e dobishme për individin. (Zylfiu, N., 2005).

Gjatë rrjedhës së viteve 1890, Djuj u zhvendos vazhdimisht nga idealizmi absolut drejt pragmatizmit dhe natyralizmit të filozofisë së tij të pjekur. Duke ndërtuar një psikologji funksionale, që i detyrohej shumë biologjisë së evolucionit darvinian dhe mendësisë së mikut të tij pragmatist, Uilliam Xhejms (William James). Ai filloi të zhvillonte një teori dijesh, të cilat e kontestonin dualizmin e mendjes dhe të botës, mendimit dhe veprimin dhe që kishin lënë gjurmë në filozofinë perëndimore, qysh në shekullin e shtatëmbëdhjetë. Mendimi, argumentonte ai, nuk ishte një grumbullim i përshtypjeve ndijore apo artefakti i diçkaje të quajtur “vetëdije”, as një manifestim i një mendjeje absolute, por më tepër një funksion ndërmjetësues dhe instrumental, që kishte evoluar për t'i shërbyer interesave të mirëqenies dhe të mbijetesës njerëzore. (Westbrook, B. R., 1999).

Kuptimi i Djuj, si një pragmatist nënkupton vlerësimin e shumë ideve tona, në lidhje me mësimin e shërbimit dhe, veçanërisht, rolin e reflektimit në të. Ka katër koncepte kryesore në traditën filozofike të pragmatizmit, që mbajnë praktikën e reflektimit në mësimin e shërbimit. Së pari, mendimi dhe të

mësuarit fillojnë në pasiguri. Së dyti, rezultatet e mendimit janë zakonet e veprimit që qetësojnë dyshimin. Së treti, veprimet që zgjidhin dyshimin, gjithashtu, rezultojnë në zakonet e mendjes, që të mendojnë drejtpërdrejt. Dhe, e katërta, vetë njohuria është produktive (Maddux, C. H & Deborah D., 2015).

Fokusi në metodën shkencore në arsim është koherent me bindjet pragmatike, në lidhje me realitetin dhe natyrën e së vërtetës. Pragmatizmi identifikoi hetimin me njohuri. Kjo do të thotë, besimet që vendosen në thelbin e përkufizimit të njohurisë, janë testuar dhe me të vërtetë marrin kuptimin vetëm nëpërmjet bashkëveprimit, midis besimtarit dhe mjedisit të saj. Ndryshe, nga sistemet filozofike të mëparshme, të cilat mendonin se ishin kategorikisht të ndryshme nga bota e jashtme, Djui e kuptoi mendimin, si një produkt të ndërveprimit ndërmjet organizmit dhe mjedisit. Njohuria, sipas pikëpamjes së Djuit, kishte një instrument praktik në udhëheqjen dhe kontrollin e atij ndërveprimi. (Gribov, Sh. & Simon F., 2011).

Kuptimi më i zakonshëm i deklaratave të Djuit për filozofinë arsimore është përqendruar në kundërshtimin e tij të fortë ndaj asaj, që ai e quan “arsim tradicional” ose “edukim i vjetër”. Sipas mendimit të tij, karakteristikat tipike të një arsimimi të tillë dhe, rrjedhimisht, nga shkolla tradicionale janë “pasiviteti i qëndrimit”, “mbledhja mekanike e fëmijëve” dhe “uniformiteti i programit mësimor dhe metodës”, të gjitha që rezultojnë nga fakti se “qendra e gravitetit është jashtë fëmijës. Është në mësuesin, tekstin, kudo dhe kudo, që ju dëshironi, përveç në instinktet e menjëhershme dhe aktivitetet e vetë fëmijës”. (Gaber, S. & Ana P. 2012).

Pedagogjia djuiane (e Djuit), u bëri thirrje mësuesve, që të kryejnë detyrën jashtëzakonisht të vështirë të “rivendosjes në përvojë” të lëndës së kurrikulit. Kjo lëndë, si të gjitha njohuritë njerëzore, ishte produkt i përpjekjeve të njeriut për të zgjidhur problemet, që e hasnin në përvojë, por, si një trupë formale e dijes, ajo ishte nxjerrë nga situatat problematike, ku ishte zhvilluar, fillimisht. Tradicionalistët argumentonin se kjo dije thjeshtë, duhej të imponohej te fëmija në një vijimësi hapash të përcaktuar nga logjika e këtij grumbulli të veçuar të vërtetash. (Westbrook, B. R., 1999).

Pedagogjia e Djuit, ndryshoi atmosferën në shkollë. E bëri më të lirë, më demokratike, mbasi kishte idenë se vetë demokracia mund të ngrihet e të zhvillohet nëpërmjet shkollës (Kraja, M., 2006).

Njëqind vjet më vonë, konceptet dhe qasjet arsimore të Djuit ende gjenerojnë interes, dhe që nga vitet e 90-ta të shekullit të kaluar, janë afirmuar nga edukatorë nga vende të ndryshme të botës, të cilët kërkonin përgjigje në pyetjet e ngritura nga kushtet bashkëkohore (O'Hear, 1991; Ryan, 1995; Silkock, 1999; Sullivan, 1996; Tanner, 1997).

3.2. Shkolla djuiane

Sipas Djuit, shkollat janë, me të vërtetë, një metodë e rëndësishme e transmetimit, që formon dispozitat e të papjekurve; por është vetëm një mjet, dhe, krahasuar me agjencitë e tjera, një mjet relativisht sipërfaqësor (Dewey, J. 2001).

Sipas Djuit, gjithçka që shoqëria ka arritur për vete, vihet në funksion të anëtarëve të saj të ardhshëm, përmes shkollës.

Xhon Djui, kontribuoi, që shkolla të shndërrohet në një institucion për nxënës, t'i përshtatet interesave të tij, si dhe përvoja e nxënësve duhet të merret për bazë nga mësuesit. (Koliqi, H., 1998). Sipas Djuit, shkolla e mirëfilltë është një institucion shoqëror (Koliqi, H., 1998). Këtë e arsyeton, duke shtuar se qendra e vërtetë e lidhjes reciproke të temave të shkollës nuk është as shkenca e as literatura, por aktivitetet shoqërore të fëmijës.

Djui, ishte kundërshtar i shkollës tradicionale. Ishte për arsimin progresiv. Ai e përshkroi arsimin progresiv si “një produkt i pakënaqësisë me arsimin tradicional”, i cili imponon standardet, lëndët dhe metodologjitë e të rriturve. Arsimi progresiv, siç përshkruhet nga Djui duhet të përfshijë angazhimin shoqëror, përvojat e të mësuarit, që janë të përshtatshme për zhvillimin e fëmijëve e vegjël (Dewey, J., 1938). Djui mendoi se edukimi efektiv erdhi, kryesisht, nëpërmjet ndërveprimeve shoqërore dhe se vendosja e shkollës duhet të konsiderohet një institucion shoqëror (Flinders&Thornton, 2013). Ai arsimin konsideronte “proces i jetesës dhe jo një përgatitje për jetesë të ardhshme” (Flinders&Thornton, 2013).

Ai vlerësoi se shkolla tradicionale është, pothuajse, e shkëputur nga jeta. Mësimi tradicional e ndrydh shpirtin e fëmijës, ku fëmija e ka vetëm një problem, si t'i përgjigjet kërkesave të mësuesit (Dewey, J., 2003; Koliqi, H., 1998). Shkollës i mungonte dimensionin i saj social. Në klasën tradicionale, ka shumë pak vend për të punuar si: kabineti i punës me dorë, laborator, baza materiale dhe veglat, me të cilat fëmija ndërton, krijon, interesohet në mënyrë aktive, madje edhe hapësira më e domosdoshme në shumicën e rasteve mungon. Djui, kritikoi shkëputjen e shkollës nga jeta, nga praktika, mosnjohjen e psikologjisë së fëmijës nga ana e mësuesit. Sipas Djuit, klasat tradicionale, me kompletet e bankave të tyre, sugjerojnë se çdo gjë është e organizuar, për të punuar me një numër sa më të madh nxënësish, në masë, si një konglomerat individësh, ku përsëri ata trajtohen në mënyrë pasive (Dewey, J., 2003). Djui, ishte për një shkollë e klasë, ku fëmijët janë aktivë dhe veprimtaria e fëmijëve t'i paraprinte informacionit të mësuesit, ose ku fëmijët të kishin ndonjë shtysë për të kërkuar informacionin. Djui ishte për komunikim të lirë në mes të nxënësve, shkëmbim të ideve, sugjerime të njëri-tjetrit. Fëmijët, mendonte Djui, kur vinin në shkollë, nuk ishin si ato rrasat e bardha, mbi të cilat mësuesit mund të shkruanin mësimet e qytetërimit. Në kohën që

fëmija hynte në klasë, ai tashmë ishte tejet aktiv dhe çështja e arsimit është çështje e kapjes së veprimeve të tij, e t'u dhënit drejtim atyre. (Dewey, J., 1899, tek Westbrook 1999).

Edukimi, duke qenë një proces shoqëror, e bën shkollën, thjesht, një formë jete komuniteti, ku të gjitha degët e saj të mësimdhënies janë të përqendruara të jenë sa më efektive në nxitjen e fëmijës, për të ndarë kështu burimet e trashëguara të njerëzimit dhe për t'i përdorur forcat e tij për qëllime shoqërore (Dewey, J., 2003), të mënjanojë ndikimet negative të nxënësit, si dhe të vërë baraspeshë midis rrethit shoqëror dhe individit (Koliqi, H., 1998). Sipas tij, shkolla duhet të thjeshtësojë jetën shoqërore, dhe të fëmija të përfaqësojë jetën e gjallë dhe reale, që ai bën në shtëpi, në lagje, apo në sheshin e lojërave. Djui, besonte se jeta shkollë duhet të rritet gradualisht nga jeta e shtëpisë, dhe të vazhdojë aktivitetet, me të cilat fëmija tashmë është familjarizuar në shtëpi (Dewey, J., 2003). Sa i përket rolit të shkollës në edukimin moral, Djui, thekson: “Shtëpia është formë e jetës shoqërore, ku fëmija është edukuar dhe në lindje me të cilën ai ka pasur trajnimin e tij moral. Është detyrë e shkollës të thellojë dhe të zgjerojë kuptimin e këtyre vlerave të filluara në jetën e shtëpisë”.

Sipas Djuit, shkolla është një imazh, që vazhdon të rritet gjatë gjithë kohës; një shkollë, ku disa aktivitete konstruktive aktuale dhe të mirëfillta, do të jenë qendra dhe burim i gjithë kësaj gjëje dhe, nga e cila, puna duhet të lartësohet gjithnjë në dy drejtime: një nga mbështetësit shoqërorë të kësaj industrie konstruktive, kurse tjetra është kontakti me natyrën, që e furnizon atë me materialet e saj. Teorikisht, mund të kuptojë se si zdrukthëtari etj., për të ndërtuar një shtëpie model, do të jetë qendra e një trajnimi shoqëror, nga njëra anë dhe, atij shkencor, nga ana tjetër, të gjitha të mbajtura brenda kuptimit të një zakoni pozitiv konkret të syrit dhe të dorës (Dewey, J., 1894 në Westbrook, B.R., 1999).

Djui, besonte se është detyrë e cilitdo person të interesuar për edukimin, të këmbëngulë që shkolla të kthehet në instrumentin parësor dhe më efektiv të progresit shoqëror dhe reformës së tij, me qëllim që shoqëria të ketë mundësi të zgjohet e të kuptojë drejt se çfarë përfaqëson shkolla në të vërtetë, për të nxitur më pas domosdoshmërinë e financimit të edukatorit me pajisjet e mjaftueshme, që i nevojiten për të kryer siç duhet detyrën e tij (Dewey, J., 2003).

3.2. Edukimi në këndvështrimin e Djuit

Xhon Djui, ishte ndër ata pedagogë, që kishte besim shumë të madh tek edukimi. Madje, ai konsideronte se edukimi është metoda themelore për progresin shoqëror dhe reformimin e tij (Dewey, J., 2003).

Sipas Djuit, literatura është shprehje e pasqyrimin dhe e interpretimit të përvojës shoqërore, kështu që ajo duhet të shoqërojë dhe jo t'i paraprijë një përvojë e tillë. Për pasojë, ajo nuk mund të bëhet bazë, por vetëm një përmbledhje e unifikimit (Dewey, J., 2003).

Shoqëria ekziston nëpërmjet një procesi të transmetimit, po aq sa edhe jeta biologjike. Ky transmetim ndodh përmes komunikimit të zakoneve të të bërit, të të menduarit dhe të ndjenjës nga më të moshuarit te të rinjtë. Pa këtë komunikim idealesh, shpresash, pritjesh, standardesh, mendimesh, nga ata anëtarë të shoqërisë, që po kalojnë nga jeta e grupit, tek ata që hyjnë në të, jeta shoqërore nuk mund të mbijetojë. Nëse anëtarët, që përbëjnë një shoqëri kanë jetuar vazhdimisht, ata mund të edukojnë anëtarët e rinj, por do të ishte një detyrë e drejtuar nga interesi personal e jo nga nevoja sociale. Tani kjo është një punë e domosdoshme. (Dewey, J., 2001).

Djui konsideronte se edukimi ka vlerë të madhe, si në shkollë, ashtu edhe në shoqëri dhe zhvillohet nga pjesëmarrja e individit në vetëdijen shoqërore të njerëzimit. Edukimi është proces, që fillon në mënyrë të pavetëdijshme, pothuajse, në lindje dhe është vazhdimisht në formim të forcave të individit, në ngarkimin e vetëdijes, në formimin e shprehive të tij, në trajnimin e ideve të tij, në nxitjen e ndjenjave, si dhe të emocioneve të tij (Dewey, J., 2003).

Djui, konsideronte se edukimi është proces i të jetuarit dhe jo përgatitje për jetën e ardhshme. Nëse nuk ndodh përmes formave të jetës, është gjithmonë një zëvendësim i dobët i realitetit të vërtetë dhe orvatet ta mpijë dhe ta bëjë të pandjeshëm (Dewey, J., 2003). Edukim i njeriut fillon nga lindja dhe vijon gjatë gjithë jetës (Koliqi, H. 1998). Edukimi i vërtetë unik arrihet nëpërmjet stimulimit të forcave të fëmijës me anë të kërkesave të situatave shoqërore, ku ai do të gjendet. Nëpërmjet këtyre kërkesave, ai stimulohet që të veprojë, si një anëtar i një bashkësie, të dalë nga kufizimi i tij organik i veprimit dhe i ndjenjave dhe të konceptojë veten nga pikëpamja e mirëqenies së grupit, të cilit ai i përket.

Në zhvillimin e natyrës së fëmijës, ana aktive i paraprinë asaj pasive. Edukimi është metoda themelore për progresin shoqëror dhe reformimin e tij dhe, detyra e cilitdo person të interesuar, për edukimin është që shkolla të kthehet në instrument parësor. Ai besonte në përputhje me rrethanat, se baza parësore e edukimit gjendet në forcat e fëmijës, në punë nëpër të njëjtat linja konstruktiviste të përgjithshme, si ato që kanë sjellë qytetërimin.

Djui konsideronte se qëllimi duhet të jetë brenda edukimit, dhe sipas tij, të vendosësh çdo qëllim jashtë edukimit, si pjesë e synimit dhe standardit të tij, do të thotë t'i heqësh procesit të edukimit shumë nga domethënia e vet dhe të orvatesh të na lësh, që të mbështetemi në stimuj të pavërtetë dhe të sipërfaqshëm në trajtimin e fëmijës. (Dewey, J., 2003).

Sipas Djuit, anët psikologjike dhe shoqërore, janë të lidhura organikisht dhe se edukimi nuk mund të shihet si një kompromis ndërmjet të dyjave apo një mbivendosje e njërit mbi tjetrin. Sipas Djuit, ishte thënë se përcaktimi psikologjik i edukimit është shterp dhe formal, mirëpo kjo na jep vetëm idenë e një zhvillimi të potencialit mendor, pa na dhënë një ide të përdorimit të tij praktik. Nga ana tjetër, është theksuar se përcaktimi shoqëror i edukimit, si përgatitje ndaj qytetërimin, krijon prej tij një proces të dedikuar dhe të sipërfaqshëm dhe përfundon me nënshtrimin e lirisë së individit në një status politik dhe shoqëror të formuar më parë. (Dewey, J., 2003). Nëse këto anë veçohen nga njëra - tjetra,

atëherë kundërshtimet për këtë çështje janë të vërteta. Pra, përcaktimi psikologjik dhe shoqëror, nuk duhen veçuar, individi duhet të jetë aktiv në marrëdhëniet shoqërore.

3.4. Roli i mësuesit dhe pozita e nxënësit sipas Djuit

Djui thekson ndjeshmërinë e edukatorëve ndaj nevojave të nxënësve dhe dallimeve të tyre individuale. Për Djuin, mësuesit duhet ta kuptojnë se nuk ka një koncept të vetëm për të gjithë mësimdhënien dhe mësimin. Proceset mësimore duhet të planifikohen, duke marrë parasysh aftësinë, përvojat e mëparshme dhe përvojat e tyre të tanishme (Sikandar, A., 2015).

Djui e çmoi shumë rolin dhe personalitetin e mësuesit, duke konsideruar se ai duhet të jetë krenar për punën dhe profesionin e vet (Koliqi, H., 1998). Ai potencoi se vendi i mësuesit dhe puna në shkollë, duhet të interpretohen nga po e njëjta bazë. Mësuesi nuk është në shkollë, për të diktuar ide të caktuara apo për të formuar shprehje të caktuara të fëmija, por është aty si një pjesëtar i komunitetit, për të përzgjedhur faktorët, të cilët do të ndikojnë ndaj fëmijës dhe ta ndihmojë atë të reagojë siç duhet ndaj këtyre faktorëve (Dewey, J., 2003). Djui besonte se çdo mësues duhet të realizojë dinjitetin e profesionit të tij, që do të thotë se ai është një shërbyes shoqëror i vendosur për mirëmbajtjen e rregullit të duhur shoqëror dhe për sigurinë e zhvillimit të drejtë shoqëror (Dewey, J., 2003).

Djui për mësuesit thoshte se duhej të ishin profesionistë shumë të aftë, të kishin dije të plota për lëndën mësimore, që ata jepnin. Të ishin të trajnuar në psikologjinë e fëmijës dhe të aftë në teknikat, që siguronin shtysën e nevojshme, në mënyrë që lënda mësimore të bëhej pjesë e përvojës në rritje të fëmijës (Westbrook, B. R., 1999).

Djui ishte i shqetësuar në lidhje me zhvillimin e individualitetit të fëmijës. Zëri i fëmijës nuk u dëgjua askund, siç u imponuan nga shkolla, kurrikuli, lënda dhe konceptet. Kjo është arsyeja pse Djui konsideroi një fëmijë si më të rrezikuarin anëtar të shoqërisë, i cili është prekur drejtpërdrejt nga praktikat dhe qëndrimet e anëtarëve të akademisë - ata që vendosin politika mbi të dhe kontrollojnë atë (Sikandar, A., 2015). Djui ishte, veçanërisht, i shqetësuar për të drejtat e fëmijës si individë, e drejta e tij për të ushtruar vendimet e tij, zgjedhje në të mësuar dhe edukim dhe pjesëmarrja e tij në një proces demokratik të të mësuarit.

3.5. Arsimi dhe të nxënit

Djuit konsideronte si të domosdoshme që fëmijët të lejohen të eksplorojnë mjedisin e tyre, duke i vënë theks të mësuarit në bazë të nevojave të fëmijëve. Sipas Djuit, nuk mund të nënvlerësojmë rëndësinë, për qëllime edukative të njohjes nga afër me natyrën, së pari, me gjërat dhe sendet e vërteta, me proceset e vërteta të përpunimit të tyre, si dhe të njohjes së nevojave dhe përdorimeve të tyre në shoqëri. Asnjë lloj mësimi i konkretizuar, ose i organizuar si i tillë, nuk mund të japë qoftë edhe hijen

e asaj, që shërben si njohja e bimëve në kopsht dhe e kafshëve në fermë, që fitohet duke jetuar në mes tyre dhe duke u kujdesur për to (Dewey, J., 2003).

Ishte ithtar dhe mbështetës i fuqishëm i arsimit, përmes aktiviteteve dhe nuk e përkrahte mënyrën formale të të mësuarit. Preferonte mësimin eksperimental, pasi që përmes tij aktivizoheshin më shumë nxënësit, ndërsa nuk ishte për lëndët tradicionale, të cilat e kishin ngulfatur nxënësin.

Djui ishte për klasë me në qendër nxënësin apo studentin. Ishte për globalizmin e përmbajtjeve mësimore dhe jo të orientuar në lëndë. Në klasat e përqendruara në nxënës, mund të shohësh shumë nga teoria e të mësuarit shoqëror të Xhon Djuj dhe besimet edukative në veprim. Ai e shihte klasën, si një entitet shoqëror për fëmijët, ku mund të mësonin dhe të zgjidhnin problemet së bashku si një komunitet. Në këto klasa, fëmijët konsiderohen si individë unikë; nxënësit mund të jenë të zënë në punë, duke ndërtuar njohuritë e tyre, përmes kuptimit personal, në vend të njohurive të imponuara nga mësuesit dhe aktiviteteve të drejtuara nga mësuesit (Schiro, M. S., 2013).

Lidhur me zbatimin e metodave mësimore, sipas Djuj, ka të bëjë me përpunimin efektiv të lëndës mësimore dhe theksoi funksionalitetin e saj, gjegjësisht, ndikimin e saj në aktivizimin e nxënësit në një mjedis të caktuar shoqëror. Mësimi nuk duhet të jetë abstrakt dhe i shkëputur nga jeta. Mësimi duhet të ketë karakter praktik dhe se praktika të shërbejë si motivacion për punë dhe që mësimi të ndikojë drejtpërdrejt në pasurimin e përvojës së nxënësve (Koliqi, H., 1998).

Djui thotë se një teori e dijes, që nuk ka një ndikim konkret dhe të rëndësishëm në botën e arsimit është një teori joadekuate dhe artificiale. Prandaj, është thelbësore të rritet integrimi ekzistues midis dimensioneve personale dhe sociale të inteligjencës dhe mendjes, me një teori të njohurisë dhe të të mësuarit (Fernandes, M.P. J. et al., 2018).

Thithja e thjeshtë e fakteve dhe e të vërtetave është një çështje tërësisht individuale, deri aty sa ajo ka prirjen që në mënyrë shumë të natyrshme të kalojnë në egoizëm. Nuk ekziston ndonjë motiv shoqëror i dukshëm për përfitimin nga të mësuarit. Nuk ekziston ndonjë përfitim i qartë shoqëror në këtë pikë. E vetmja masë suksesi është ajo e konkurrimit, në kuptimin e keq të fjalës, është një krahasim i rezultateve për riprodhimin ose provimin për të parë se cili fëmijë ka arritur më shumë të dalë përpara të tjerëve, për sa i përket ruajtjes në tru dhe grumbullimit të një informacioni sa më të gjerë (Dewey, J., 2003). Djui, ishte për komunikim të lirë, shkëmbim të ideve, sugjerimeve, i analizës së rezultateve dhe dështimeve, pasi që këto ndikojnë në përmirësimin e të nxënësve. Djui ishte për sistemin e garave në mes të nxënësve, po, jo nga sasia e informatave, që posedojnë, por në pikëpamje të cilësisë së punës që ka bërë.

3.6. Lidhja e teorisë me praktikën

Sa i përket lidhjes së teorisë me praktikën, në bazë të propozimit të Djuj, Universiteti i Çikagos, themeloi shkollën laborator, ku për qëllim kishte mbajtjen në kontakt të punës teorike me kërkesat praktike. Në këtë shkollë, vijuan mësimet shumë nxënës nga familje profesionistësh. Në qendër të

kurrikulumit të kësaj shkolle, ishte ajo çfarë Djui e quajti “zanati”, që është një lloj veprimtarie e kryer nga fëmija, e cila riprodhon ose shkon paralel me disa punë të vijuara në jetën shoqërore. (Dewey, J., 2003, Westebrook, B. R., 1999). Djui pohonte se puna në dru, në metal, endje, qepje, etj., duhen kuptuar si metoda jetese e jo si studime të veçanta. Këto punë praktike duhen kuptuar për rëndësinë shoqërore, si faktorë nëpërmjet të cilave vetë shkolla do të bëhet një formë e jetës aktive në komunitet, në vend të një vendi të veçuar për të bërë mësimet.

Aktivitetet profesionale, nga njëra anë, synonin drejt studimit shkencor të materialeve dhe proceseve të përfshira në praktikën e tyre dhe, në anën tjetër, drejt rolit të tyre në shoqëri dhe kulturë. Prandaj, fokusi tematik në profesionet siguroi rastin, jo vetëm për trajnimin manual dhe hetimin historik, por edhe për punën në matematikë, gjeologji, fizikë, biologji, kimi, lexim, art, muzikë dhe gjuhë. (Westebrook, B. R., 1999).

3.7. Disiplina

Djui ishte për disiplinë, por jo për disiplinën e ngurtë, siç thekson ai: Nëse ke si qëllim që dyzet apo pesëdhjetë fëmijët të mësojnë një sasi të caktuar mësimesh, të cilat duhet t’i riprodhohen mësuesit, atëherë disiplina duhet t’i përkushtohet këtij rezultati. Mirëpo, nëse qëllimi është zhvillimi i një shpirti për bashkëpunim social dhe jetën në komunitet, atëherë disiplina duhet të shmanget dhe të ketë të bëjë vetëm me këtë gjë. Nga puna, nga të bërit e gjërave që do të prodhojnë rezultate dhe nga të bërit e tyre në mënyrë shoqërore dhe bashkëpunuese, lind një disiplinë e llojit të vet.

Disiplina në klasën përgjegjëse trajtohet ndryshe nga disiplina në shumicën e rasteve në klasën tradicionale. Nganjëherë referohej si një qasje pozitive për disiplinën, “ajo ka për qëllim të ndihmojë fëmijët të zhvillojnë vetëkontroll, të fillojnë të kuptojnë që sjellja është përgjegjësi shoqërore, dhe vijnë për të vlerësuar sjellje të tilla” (Brady, Forton, & Porter, 2011). Nxënësit në klasat e përgjegjshme mësohen në mënyrë eksplicite rreth asaj se si zgjedhjet e tyre kanë pasoja pozitive dhe negative. Kur ndodh sjellja e keqe, mësimsdhënësit përdorin strategji respektive për ndalimin e sjelljes së keqe dhe ridrejtimit për kthimin e sjelljes pozitive. (Brady, Forton, & Porter, 2011).

PËRFUNDIME

Xhon Djui, është njëri ndër pedagogët që la gjurmë të thella në rrafshin e pedagogjisë dhe më gjerë, fillimisht, në Amerikë, e më vonë ndikimi i tij, u shtri edhe në vende e kontinente të tjera. Xhon Djui, ishte ideator i qasjes pragmatiste në shkollë. Kundërshtimi i Djuit, ndaj shkollës dhe koncepteve tradicionale ishte i rreptë dhe pati një ndikim të jashtëzakonshëm. Ai e kundërshtoi sistemin arsimor në Amerikë, ku nxënësit duhej të përgatiteshin për mësuesin dhe konsideronte se ka shterpësi në arsim, dhe sipas tij, e gjithë shterpësia në arsim vjen nga izolimi. Ai dha ndihmesë të rëndësishme në ngritjen e rolit të nxënësit në klasë. Djui, insistonte që shkolla t’i përshtatej nxënësit, përvojës dhe

interesit të tij. Përvojën e nxënësit e çmoi shumë. Kërkonte që njohuritë në shkollë të jenë të lidhura me jetën e nxënësve, e jo jeta shkollore të jetë e ndarë nga jeta reale. Ai e ngriti lart rolin e punës praktike të nxënësve dhe rolin shoqëror të shkollës.

Pavarësisht, se janë bërë kritika ndaj tij se e mbiçmoi përvojën e nxënësit, nënçmoi teorinë dhe mbiçmoi praktikën, ai mbetet njëri ndër pedagogët më të shquar, që me kontributin e tij, lirisht mund të themi se bëri ndryshime të mëdha në fushën e pedagogjisë.

Literatura

- Baku, P. 2011. Enciklopedia universale e ilustruar, “Bacchus”, Tiranë.
- Brady, K., Forton, M.B., & Porter, D. 2011. Rules in school: Teaching discipline in the responsive classroom. (2nd Ed.). Massachusetts: Northeast Foundation for Children, Inc.
- Dewey, J. 2003. Shkolla dhe Shoqëria (The school and Society), Plejad, Tiranë.
- Dewey, J., 2001. Democracy and Education, by John Dewey. A Penn State Electronic Classics Series Publication,
- https://www.academia.edu/.../Democracy_and_Education_A_Penn_State_Electronic_Cla...
- Dewey, J. 1949. The School and Society. Chicago: The University of Chicago Press.
- Dewey, J. 1938. Experience and education. New York: Macmillan.
- Dewey, J. 1910. How We Think, Boston: D.C. Heath & Co.; selections from Part One, “The Problem of Training Thought,” spelling and grammar modestly modernized.
- Fernandes, M. P. J. et al. 2018. Democracy, intelligence and (sound) education in the perspective of John Dewey, Educ. Pesqui., São Paulo, v. 44, e169625.
- Flinders, D., & Thornton, S. (2013). *The curriculum studies reader*. (4th Ed.). New York: Routledge.
- Gaber, S. and Ana P. 2012. Dewey, J. The School and Society, Ljubljana: University of Ljubljana, Faculty of Education. ISBN 978-961-253-060-0.
- Gribov, Sh.&Simon F. 2011. John Dewey’s Pragmatism and Moral Education, Philosophy of Education, pp. 373-380 .
- Gribov, Sh. 2011. John Dewey’s Pragmatism and Moral Education, Philosophy of education.
- Goldkuhl, G. 2004. Meanings of Pragmatism: Ways to conduct information systems research
- Gutek, Gerald L. 2005. Historical and Philosophical Foundations of Education: A Biographical Introduction. Upper Saddle River, NJ: Pearson Education Inc. [ISBN 978-0-13-113809-4](https://doi.org/10.1002/9780471113809).
- James, W. 2005. Pragmatizmi, Plejad, Tiranë.
- Jia, W. 2005. The Deweyan Pragmatism: Its Implications for the Study of Intercultural Communication Intercultural Communication Studies XIV: 1.

- Koliqi, H. 1998. Historia e Pedagogjisë botërore II, UP, Prishtinë.
- Kraja, M. 2006. Pedagogjia (ribotim me disa kapituj plotësime), Tiranë.
- Maddux, C. H.&Deborah D. 2015. John Dewey's Pragmatism: Implications for Reflection in Service-Learning, *Michigan Journal of Community Service Learning*.
- O'Hear, A. (1991). Father of Child-Centredness: John Dewey and the Ideology of Modern Education. London: Centre for Policy Studies.
- Pillsbury W. B. 1957. JOHN DEWEY (1859-1952). *Biographical Memoir*, Copyright national academy of sciences Washington d.c
- Radu, Lucian. 2011. John Dewey and progressivism in American education, *Bulletin of the Transylvania University of Brasov Series VII: Social Sciences • Law • Vol. 4 (53) No. 2*, pp 85-90.
- Ryan, A. (1995). John Dewey and the High Tide of American Liberalism. New York, London: W.W. Norton & Company.
- Schiro, M. S. 2013. Curriculum theory: Conflicting visions and enduring concerns. (2nd Ed.). Los Angeles: Sage Publications.
- Sikandar, A. 2015. John Dewey and His Philosophy of Education, *Journal of Education and Educational Development*, Vol. 2 No. 2.
- Silcock, P. 1999. New Progressivism. London: Falmer Press.
- Sullivan, K., 1996. Progressive Education: where are you now that we need you?
- Oxford Review of Education, 22 (3), 349-355.
- Tanner, L. N. 1997. Dewey's Laboratory School: Lessons for Today. New York and London: Teachers College, Columbia University.
- Zylfiu, Nijazi. 2005. Didaktika (Teoria e mësimit dhe e mësimdhënies), UP, Prishtinë.
- Zhlebnik, L. Histori e përgjithshme e shkollave dhe ideve pedagogjike. 1964. EBTRSS, Beograd.
- Westbrook, B. R. 1999. JOHN DEWEY (1859-1952). UNESCO: International Bureau of Education.
- Westbrook, Robert. John Dewey and American democracy. Ithaca, NY, Cornell University Press, 1991.
- Whale, J. K. George. 1967. John Dewey and pragmatism: Philosophy as education "All Philosophy is Philosophy of education", British Columbia.
- Williams, K. M., 2017, John Dewey in the 21st Century, *Journal of Inquiry & Action in Education*, 9 (1).

ROLI I EDUKATORIT NË FORMIMIN E SHPREHIVE POZITIVE TË FËMIJËT E MOSHËS 5-6 VJEÇ

Bashkim RAKAJ PHD-CANDIDATE

Email: rakajbashkim45@gmail.com

Abstrakt

Edukatori është personaliteti, i cili ka ndikimin më të madh tek fëmijët e moshës parashkollore, prandaj me një përkushtim dhe angazhim të madh, mund të ketë ndikim përcaktues në krijimin e shprehive pozitive të fëmijëve. Me ndikimin pozitiv të familjes dhe institucioneve parashkollore, mund të krijohen shprehi pozitive. Pastaj fëmija, duke i ushtruar dhe duke i përsëritur gjithnjë këto veprime ose punë, gradualisht do të formohen te ai shprehitë e dobishme, të cilat do t'i shërbejnë mirë në jetë.

Krijimi i shprehive pozitive i fëmijëve, është parakusht që ata të formohen drejt dhe të kenë rezultate pozitive. Për këtë arsye, edukatori duhet të ketë kujdes gjatë punës me fëmijë, pasi që në vend të krijimit të shprehive pozitive, ai mund të ndikojë në krijimin e shprehive negative.

Studimi i kësaj problematike ka për qëllim vlerësimin e ndikimit të edukatorit në krijimin e shprehive pozitive të fëmijëve të moshës parashkollore.

Rezultatet treguan se 23.6% e edukatorëve, kanë qenë shumë të kënaqur me shprehitë që fëmijët i kanë krijuar në familje dhe me ato shprehi kanë shkuar në institucionin parashkollor, 69.9% e edukatorëve pajtohen plotësisht se kanë ndikuar që fëmijët të krijojnë shprehi pozitive, si dhe 51.8% e edukatorëve, janë shumë të kënaqur me krijimin e shprehive të fëmijëve të klasës së tyre.

Fjalë kyçe: edukatorë, fëmijë, parashkollor, shprehi, pozitivë, rol.

1. SHQYTIMI I LITERATURËS

1.1. Formimi i shprehive tek fëmijët e moshës parashkollor

Shprehitë janë veprime relativisht të automatizuara, të cilat formohen si rezultat i të mësuarit, i ushtrimeve të organizuara e sistematike, që zgjasin, varësisht nga shkalla e ndërlikueshmërisë (Nushi, P. 1987:285).

Periudha parashkollore, është një periudhë kur fëmijët kanë mundësi të krijojnë shprehi pozitive, dhe të vazhdojnë me zhvillimin dhe forcimin e këtyre shprehive, apo edhe të krijojnë shprehi negative, e

që pastaj duhet punuar shumë që të çrrënjosen këto shprehi, e të formohen shprehi pozitive. Pasi shumë më e lehtë është të krijohet një shprehi nga fillimi se sa çrrënjosja e shprehive negative dhe formimi i shprehive pozitive, të krijojmë te ata shprehitë e duhura.

Shprehitë fëmiju i fiton në familje. Prandaj, prindërve u bie barra që të kujdesen për fëmijët e tyre që të fitojnë shprehi të mira e të dobishme qysh në vitet e para të moshës së tyre dhe të pengojnë formimin e shprehive të këqija tek ata (Gjevori, M., 2005:79).

Institucioni i dytë, që kanë rol kyç në edukimin dhe formimin e fëmijëve, janë institucionet parashkollore, ku rolin kryesor e kanë edukatori, të cilat lirisht mund të konsiderohen si prindërit e dytë të fëmijëve.

Si në familje, edhe në institucionet parashkollore, prindërit dhe edukatorët, duhet të kenë kujdes që tek fëmijët të mbjellin shprehi, të cilat do t'i shërbejnë fëmijës në jetë.

Si në familje dhe në institucionet parashkollore, duhet pasur kujdes tek fëmijët të krijohen shprehitë:

- Formimi i shprehive pozitive të vullnetit dhe karakterit. Në procesin e mirëfilltë edukativ, doemos duhet të synohet të ndërtohet objektivi që njohuritë e fituara të shndërrohen në bindje, bindjet në vepra, dhe më tutje ato në veti pozitive të vullnetit dhe të karakterit (Vukasević, A., 1977:47), me që dihet mirëfilli se bindja është bazë e veprimit, por në mes bindjes dhe veprimit praktik ekziston një proces i ndërlikuar i ushtrimeve dhe formimit të shprehive (Trnavac, N.,&Djordjević, J., 1992:131).

- Krijimi i shprehive higjienike-shëndetësore të nxënësve në procesin mësimor

Mënyra përmes së cilës fëmijët e vegjël i mësojnë shprehitë që kanë të bëjnë me përkujdesjen dhe higjienën personale përvetësohet në familje. Por, edhe ekspozimi në mjedis të ndryshëm social dhe fizik edhe jashtë familjes po ashtu ndikon në mënyrën sesi fëmijët i formojnë qëndrimet, vlerat dhe sjelljet e tyre. Arritja e këtij standardi realizohet përmes ofrimit të aktiviteteve që e inkurajojnë pavarësimin gradual të fëmijës në realizimin e aktiviteteve të përditshme që kanë të bëjnë me përkujdesjen dhe higjienën personale. Në këtë segment veçmas i rëndësishëm është ekzistimi i modelit pozitiv në mjedisin në të cilin lëviz fëmija dhe edukatori përdor metodë të mësimdhënies së drejtpërdrejtë, nxitje për realizimin e aktivitetit dhe reflektim të vazhdueshëm dhe komunikim verbal, sepse sjellja e tillë është e rëndësishme. Fëmijët i mësojnë këto shkathtësi në kontekst të aktiviteteve të përditshme në çerdhe dhe në shtëpi (MPPS, 2014:34).

- Formimi i shprehisë për punë

Sipas Mehmet Gjevorit, ndër shprehitë e mira dhe më me rëndësi për jetë që duhet të fitojë fëmija qysh në moshë të njomë, është shprehia e punës, e cila ka rëndësi shumë të madhe, sepse ndikon shumë në formimin e karakterit dhe përgjithësisht në personalitetin e njeriut (2005:79).

Kultivimi i qëndrimit të drejtë ndaj punës është një detyrë e rëndësishme dhe e ndërlikuar, e cila përfshinë shumë elemente: formimin e botëkuptimeve të qarta për rolin dhe rëndësinë e punës në shoqëri, formimin e qëndrimit emocional ndaj punës, formimin e shprehive për punë dhe të kulturës së punës, formimin e vetive pozitive të vullnetit dhe karakterit, siç janë: ndërgjegjja, zelli, qëndrueshmëria, ndjenja e detyrës dhe e përgjegjësisë (Shimllesha , P.,1988:180).

Për këtë arsye, formimin e qëndrimit të drejtë ndaj punës duhet ta mbështesim mbi dituri dhe bindje, mbi formimin e shprehive për punë dhe të cilësive pozitive të vullnetit e të karakterit.

1.1.1. Roli i familjes në krijimin e shprehive pozitive

Familja është institucioni i parë dhe shumë i rëndësishëm për formimin e shprehive pozitive të fëmijëve. Në familjet e ngushta, ku jetojnë burri, gruaja dhe fëmijët, është më e lehtë të krijohen shprehitë pozitive tek fëmijët, pasi që ndikimi është vetëm i prindërve, pa ndonjë ndikimi të faktorëve të tjerë. Megjithatë, prindërit duhet të kenë kujdes, që tek fëmijët të krijojnë shprehitë higjienike, duke i mësuar që fillimisht të pastrojnë duart, fytyrën, dhëmbët, dhe me shembullin e tyre, të reflektojnë tek fëmijët për shprehitë e punës, sjelljen kulturore, të vërtetën, besimin, pastaj kur fëmija të filloj të komunikoj me prindërit dhe rrethin shoqëror, do të sillen ashtu siç sillen prindërit e tyre.

Hapat e parë të sjelljes, fëmija i merr në familje, nëse prindërit përdorin shprehje fyese, edhe fëmijët do të përdorin, nëse prindërit janë gënjeshtarë, të tillë do të bëhen edhe fëmijët. Pra prindërit duhet pasur kujdes se si sillen, si komunikojnë, pasi që sjellja e tyre do të ndikojë në sjelljen e fëmijës së tyre.

Stili i përgjithshëm i jetesës në familje, regjimi dhe shprehitë në familje e edukojnë tërthoras fëmijën, prandaj shumë i shpeshtë është edhe edukimi në mënyrë spontane." (Shimllesha, P., 1988:258).

Prindërit duhet edukuar fëmijën për oraret; kur duhet të bien në gjumë, kur duhet të zgjohen, kur duhet të ushqehen, si të ushqehen, dhe shprehi të tjera, të cilat janë të rëndësishme fillimisht për shëndetin e fëmijës, por edhe për forcimin dhe praktikimin e një sjellje nga ana e fëmijës.

1.1.2. Ndikimi i institucioneve parashkollore në formimin e shprehive

Institucionet parashkollore duhet të jenë institucione të specializuara, të cilat do të merren me edukimin e fëmijëve. Këto institucione, duhet të jenë të përgatitura që në rastet kur fëmijët shkojnë me shprehi negative, të jenë në gjendje t'i eliminojnë këto shprehi, dhe të krijojnë shprehi pozitive të fëmijëve. Ka raste kur fëmijët shkojnë në institucione parashkollore me shprehi negative, dhe detyrë e

edukatorëve është që gradualisht t'i eliminojë këto shprehi, dhe në mënyrë sistematike të forcojë shprehi pozitive tek fëmijët.

Në institucionet parashkollore, edukatorët duhet të kenë kujdes që fëmijëve tu sigurojnë mënyrën e drejtë të jetës: fëmijët të ushqehen me orar, të flenë me orar, qëndrimi i rregullt në ajër të pastër dhe higjiena personale (Bartushkova, M., 1978:93), dhe kështu të krijohet shprehia e të ushqyerit me rregull, të fjeturit me orar, të zgjuarit me orar, etj. Duke e respektuar orarin për gjumë, ushqim, lojë, fëmija krijon shprehi, dhe me krijimin e shprehive, fëmija do të jetë edhe i shëndetshëm.

Duhet mësuar fëmijët që ta shfrytëzojnë në mënyrë pozitive ajrin e pastër, ujin, rrezet e diellit (Shimllesha, P., 1988:256).

Me anë të përcaktimit dhe kombinimit të aktiviteteve, fëmijëve u bëhet shprehi rendi dhe rregull i caktuar ji aktiviteteve të lidhura me mënyrën e drejtë të ushqimit. Nëse aktivitetet e ndryshme ndërrohen në të njëjtën kohë, te fëmijët krijohen shprehitë, për shembull të flenë, të zgjohen, të ushqehen etj (Bartushkova, M., 1978:93). Bëjnë shprehi të koncentrohen në kohën e caktuar në aktivitete që kërkojnë angazhim intelektual, të luajnë bashkërisht, të dalin për të shëtitur dhe të zhvillojnë aktivitete tjera të parapara e të përcaktuara në pikëpamje kohore.

Institucionet parashkollore dhe edukatorët duhet të kenë një kujdes të posaçëm për pastërtinë e fëmijës dhe rrethit të fëmijës, dhe me këtë zvogëlohen mundësitë e infektimit të fëmijëve, por edhe krijohen shprehitë pozitive higjienike. Lidhur me këtë duhet të përpiqemi që fëmija të krijojë shprehitë elementare higjienike e shprehi të tjera, dhe këto t'i ushtrojë pavarësisht me masën që është adekuate për moshën e tij (Shimllesha, P., 188:265).

Fëmijët duhet të angazhohen në lojë, dhe me anë lojërave të ndryshme, fëmijët e avancojnë të folurit dhe të shprehurit, hyjnë në marrëdhënie me të rriturit dhe fëmijët, dhe këtë rast fillojnë të krijojnë sjelljen e vetë.

“Regjimi ditor i realizuar nëpërmjet orarit ditor ndihmon fort formimin e shprehive pozitive higjienike dhe kulturore, bëhet mjet i rëndësishëm i edukimit moral (Bartushkova, M., 1978:94). Ndikon në zhvillimin e vullnetit, të pavarësisë, në zhvillimin e tipareve pozitive të karakterit dhe të vullnetit, si dhe në formimin e grupit të fëmijëve.

Me anë të regjimit ditor të fëmijëve në ente parashkollore, zhvillohet përpikëria, si shprehi shumë pozitive, pasi që fëmijët e mësojnë një orar për të gjitha aktivitetet e tyre, dhe krijohen edhe një rend i rregullt. Gjithashtu me aktivitetet e rregullta, në orar të njëjtë, tek fëmijët krijohen aftësitë për kryerjen e këtyre aktiviteteve, dhe me përsëritje e këtyre aktiviteteve, fitohen shprehitë. Pra veprimet e matura të edukatorëve, bëjnë që fëmijët të krijojnë shprehi pozitive. Fëmija do të bëjë shprehi të jetojë e punojë në kushte higjienike, do të formojë shprehitë e mirësjelljes e të veprimit nëse rrethina

shoqërore, ku jeton e vepron ajo, i ka të gjitha këto veti të mira, nëse nuk ndërrojnë kushtet në të cilat lidhen impulset e kryhen veprimet e caktuara.

Shprehitë janë faktor i rëndësishëm edhe në formimin e personalitetit, dhe në bazë të psikanalistëve, "...në zhvillimin e personalitetit ndikon edhe formimi i shprehisë për toaletë (Smilaniq, V., & I. Toliçiç, 1979:228). Qëndrimi i vrazhdë ndaj fëmijëve në vitet e para të jetës përkitazi me shprehitë për pastërti, mund të ketë pasoja negative dhe t'i shkaktojë disa cilësi të padëshirueshme: koprracinë, kokëfortësinë dhe pedantërinë e tepruar.

Përveç shprehive që u përmendën më lart, edukatorët duhet që t'i mësojnë fëmijët edhe si të qëndrojnë në bankë, si ta mbajnë lapsin, çfarë programe televizive të shikojnë, dhe kështu me kalimin e kohës, fëmijët të kenë krijuar shprehje pozitive dhe të jenë të gatshëm të shikojnë në shkollë.

1.1.2.1. Roli i edukatorit në formimin e shprehive pozitive të fëmijëve

Shprehitë bëjnë të mundshme që njeriu të silllet në rrethana të caktuara mu ashtu si duhet. Këto shprehje, po që se janë të formuara drejtë, sigurojnë sjellje të sakta e të përshtatshme në situata të ndryshme të jetës, në familje, në shkollë, në vendin e punës, gjatë përshëndetjes me të tjerët, apo edhe në situata të tjera (Shimllesha, P., 1988:170-171). Mungesa e shprehive pozitive, bënë që individi të silllet shumë herë në mënyrë të papërshtatshme në situata të ndryshme.

Shprehitë janë themel i sjelljes, prej tyre varet qëndrimi i individit ndaj njerëzve të tjerë.

Shkolla dhe mësuesit kanë për detyrë që shprehitë e mira që sjellin nxënësit me vete në shkollë, t'i përkrahin dhe t'i zhvillojnë më tutje, ndërsa shprehitë e këqija t'i mënjanojnë dhe t'i zëvendësojnë me shprehje pozitive.

Procesi i fitimit të shprehive përcillet edhe me rastin e të vërejturit dhe të regjistrimit të përparimit në të mësuarit e shkathtësive të veçanta, që janë të nevojshme për profesionin e caktuar (Rot, N., 1975:109).

Në procesin e vazhdueshëm, mësimi i nxënësve duhet të aktualizohet apo të drejtohet në punë kulturore, të krijohen shprehitë e punës, t'i respektoj format racionale të punës, jo vetëm për mësim, por në përgjithësi të zhvilloj aftësitë psiko-fizike për jetë (Vukasović, A., 1976:30).

Në fushën e zhvillimit intelektual, mësuesi duhet të ketë kujdes në formimin e shprehive për lexim, shkrim, llogaritje, forma të ndryshme të shprehjes, vlerësimin mbi të menduarit e plotë, përshkrimin të vëzhgimit, eksperimentimi, dhe kryerja e detyrave të ndryshme.

Shprehitë formohen me anët të ushtrimeve, me punë të vetëdijshme dhe të bazuar në përsëritje me qëllim të caktimit të punës së caktuar për formimin e të menduarit dhe shprehisë. Në praktikën arsimore nuk potencohet kryesisht me përsëritje, shpeshherë bazohet si proces i trajtuar me etapa të ndryshme si aftësi apo dije e zbatimit praktik, e cila bazohet në ushtrime.

Nuk është me rëndësi vetëm pasurimi me dije i nxënësve, por me rëndësi është procesi i punës për njohuri të reja. Në këtë proces, nxënësit duhet të përvetësojnë kulturën e punës, dhe të zhvillohet shprehia për punë (Vukasović, A., 1976:36).

2. METODOLOGJIA E HULUMTIMIT SHKENCOR

2.1. Qëllimi i hulumtimit

Qëllimi kryesor temës, është që ndër të tjera përmes hulumtimit teoriko-empirik të vihet në pah ndikimi që e ka edukatori në formimin e shprehive pozitive të fëmijëve të moshës parashkollore.

2.2. Pyetjet dhe Hipotezat e hulumtimit

Pyetjet kërkimore:

- A ka ndërlidhje në mes të nivelit arsimor të edukatorëve në ndikimin e krijimit të shprehive pozitive të fëmijët e moshës parashkollore?
- A ka ndërlidhje në mes të moshës së edukatorit dhe ndikimit të saj në krijimin e shprehive pozitive të fëmijët e moshës parashkollore?
- A ka ndërlidhje në mes të drejtimit të kryer dhe ndikimit në zhvillimin e shprehive pozitive të fëmijëve?
- A ka dallime në mes të numrit të fëmijëve në klasë dhe ndikimit të edukatorit në zhvillimin e shprehive pozitive?
- A ka ndërlidhje në mes të shprehive të fëmijëve të krijuara në familje dhe kënaqësisë me krijimin e shprehive nga ana e fëmijëve në kopsht?

Hipoteza kërkimore:

- Ka ndërlidhje në mes të përgatitjes arsimore të edukatorëve dhe ndikimit në zhvillimin e shprehive pozitive të fëmijëve;
- Ekziston ndërlidhje statistikisht e rëndësishme në mes të moshës së edukatorëve dhe zhvillimit të shprehive pozitive të fëmijëve;
- Ka ndërlidhje në mes të drejtimi të kryer dhe ndikimit në zhvillimin e shprehive pozitive të fëmijëve;
- Ka ndërlidhje statistikisht të rëndësishme në mes të numrit të fëmijëve dhe ndikimit të edukatorit në zhvillimin e shprehive pozitive.
- Ka ndërlidhje në mes të shprehive të fëmijëve të krijuara në familje dhe kënaqësisë së edukatorëve në krijimin e shprehive nga fëmijët.

2.3. Grupi reprezentativ

Grupi përfaqësues përbëhet nga 84 edukatore të institucioneve të edukimit parafillor në komunën e Prizrenit.

2.4. Instrumentet e hulumtimit

Për realizimin e hulumtimit, është përdorur një instrument i hulumtimit të shkallës Likert. Pyetësi për realizimin e hulumtimit, është pyetësor i përpiluar enkas për këtë hulumtim.

Pyetësi përbëhet prej 2 pjesëve: të dhënat e përgjithshme, dhe pjesa e pyetjeve. Në kuadër të pyetjeve, janë 3 shkallë me gjithsej 23 pyetje.

2.4.1. Rezultatet e analizës së besueshmërisë sipas modelit Alpha Chronbach's

Koeficienti i përgjithshëm i Alpha Chronbach's i besueshmërisë së matësit, është 0.906, ndërsa koeficienti i parashikuar është 0.915. Në bazë të këtij rezultati, mund të konstatohet se konsistenca në me të pyetjeve të pyetësit është e një niveli të lartë dhe instrumenti i përdorur është shumë i besueshëm, dhe i plotëson kriteret për zbatim në praktikë.

Reliability Statistics		
Cronbach's Alpha	Cronbach's Alpha Based on Standardized Items	N of Items
.906	.915	23

Tabela nr. 2.1. Besueshmëria e instrumentit sipas modelit Alpha Chronbach's

2.5. Analiza statistikore

Të gjitha të dhënat janë analizuar përmes programit SPSS. Për të testuar qëndrueshmërinë e brendshme të instrumentit, është përdorur Alpha Cronbach, duke marrë vlerën mbi 0.7 si vlerë që dëshmon nëse pyetësi ka ose jo qëndrueshmëri të brendshme.

Të dhënat që janë marrë nga pyetësi në lidhje me ndikimin e edukatorit në formimin e shprehive të fëmijëve, ka qenë i formës së Shkallës Likert, përkatësisht niveli i zbatimit është paraqitur nga 1 (aspak nuk pajtohem dhe Aspak e kënaqur) deri në 5 (pajtohem plotësisht dhe shumë e kënaqur).

Në kuadër të statistikës deskriptive, janë trajtuar, mesatarja, modi, mediana, devijimi standard, testi ANOVA një drejtimëshe, Kruskal Walis dhe Mann-Whitney U.

3. REZULTATET E HULUMTIMIT

Në kuadër të kapitullit të tetë, rezultatet e hulumtimit, do të trajtohen: rezultatet e frekuencës, mesatarja dhe devijimi standard si dhe rezultate lidhur me hipotezat e hulumtimit.

3.1. Rezultatet e frekuencës

Në tabelën 3.1., janë paraqitur rezultatet e frekuencës, ku rezultate janë paraqitur të përgjithësuara në 3 shkallë: Shprehitë e fëmijëve të krijuar në familje, Ndikimi i edukatorë në formimin e shprehive dhe Kënaqësia e edukatori nga formimi i shprehive të fëmijëve.

Në bazë të rezultateve, lidhur me Shprehitë e fëmijëve të krijuar në familje, vërehet se 23.6% e edukatorëve, kanë qenë shumë të kënaqura me shprehitë që fëmijët i kanë krijuar në familje dhe me ato shprehi kanë shkuar në institucionin parashkollor, 29.3 % e edukatorëve, kanë qenë të kënaqura,

34.3 % e tyre, deri diku kanë qenë të kënaqura, 10.7 % e tyre, pak kanë qenë të kënaqura dhe 2.1 % e edukatorëve aspak nuk kanë qenë të kënaqura.

Rezultatet për shkallën e dytë, Ndikimi i edukatorit në formimin e shprehive, treguan se 69.9% e edukatorëve pajtohen plotësisht se kanë ndikuar që fëmijët të krijojnë shprehi pozitive, 21.4 % e tyre, pajtohen pjesërisht se kanë ndikuar në krijimin e shprehive pozitive të fëmijëve të klasës së tyre, 6.9% e edukatorëve, deri diku pajtohen se kanë ndikuar që fëmijët e klasës së tyre të krijojnë shprehi pozitive, 1.8 % e edukatorëve, mendojnë se nuk kanë ndikuar që fëmijët e klasës të krijojnë shprehi pozitive.

Rezultatet për shkallën, Kënaqësia e edukatorit nga formimi i shprehive të fëmijëve, treguan se 51.8% e edukatorëve, janë shumë të kënaqura me krijimin e shprehive të fëmijëve të klasës së tyre, 42.2 % e edukatorëve janë të kënaqura me shprehinë e fëmijëve të klasës së tyre, ndërsa 6 % e edukatorëve, deri diku janë të kënaqura me shprehinë e krijuara nga fëmijët e klasës së tyre.

SHKALLA		Shumë e kënaqur	E kënaqur	Deri diku e kënaqur	Pak e kënaqur	Aspak e kënaqur
1	Shprehinë e fëmijëve të krijuar në familje	23.6%	29.3%	34.3%	10.7%	2.1%
SHKALLA		Pajtohem plotësisht	Pajtohem pjesërisht	Deri diku pajtohem	Nuk pajtohem	Aspak nuk pajtohem
2	Ndikimi i edukatorit në formimin e shprehive	69.9%	21.4%	6.9%	1.8%	0%
SHKALLA		Shumë e kënaqur	E kënaqur	Deri diku e kënaqur	Pak e kënaqur	Aspak e kënaqur
3	Kënaqësia e edukatorit nga formimi i shprehive të fëmijëve	51.8%	42.2%	6%	0%	0%

Tabela nr. 3.1. Rezultatet e frekuencës

3.2. Rezultatet lidhur me hipotezat

Hipoteza 1:

Hipoteza alternative (HA): Ka ndërlidhje në mes të përgatitjes arsimore të edukatorëve dhe ndikimit në zhvillimin e shprehive pozitive të fëmijëve

Hipoteza zero (HO): Nuk ka ndërlidhje në mes të përgatitjes arsimore të edukatorëve dhe ndikimit në zhvillimin e shprehive pozitive të fëmijëve.

Testimi i kësaj hipoteze u bë përmes testit joparametrik Kruskal Wallis Test.

Lidhur me çështjen: Unë kam ndikuar që fëmijët e klasës sime, t'i krijojnë shprehitë e përgjithshme pozitive, $X^2=24.416$, $p=0.000<0.05$. Nga ky rezultat, lidhur me pohimin e paraqitur, vërehet se ka dallime në mes të edukatorëve me përgatitje të ndryshme arsimore.

Lidhur me çështjen: Kam punuar që fëmijët e klasës time, të sillen mirë me të tjerët, $F=14.006$, $p=0.000<0.05$. Rezultatet treguan se lidhur me këtë pohim, ka dallime në mes të edukatorëve me përgatitje të ndryshme arsimore.

Lidhur me pohimin e edukatorëve: Kam ndikuar që fëmijët e klasës, të qëndrojnë ulur drejt në karrige dhe bankë, $F=34.170$, ndërsa $p=0.000<0.05$. Nga rezultatet. Vërehet se ekziston dallim statistikisht i rëndësishëm në mes të edukatorëve me përgatitje të ndryshme arsimore dhe ndikimit në qëndrimin e drejtë në bankë të fëmijëve.

Lidhur me pohimin e edukatorëve: Fëmijët e klasës sime, kanë qëndrueshmëri, rregullsi, dëgjueshmëri, $F=23.431$, $p=0.000<0.05$. Rezultatet treguan se ka dallime statistikisht të rëndësishme në mes të edukatorëve me përgatitje të ndryshme arsimore dhe ndikimit në qëndrueshmërinë, rregullsinë dhe dëgjueshmërinë e fëmijëve.

Lidhur me pohimin: Fëmijët e klasës sime, kanë krijuar shprehi pozitive të punës, $F=37.870$, $p=0.000<0.005$. Nga rezultatet, mund të konstatohet e ka dallime statistikisht të rëndësishme në mes të edukatorëve me përgatitje të ndryshme arsimore dhe ndikimin e tyre që fëmijët të krijojnë shprehi pozitive.

Lidhur me pohimin e edukatorëve: Fëmijët janë në gjendje të përdorin mjetet e punës në kopsht, $F=18.955$, $p=0.001<0.05$. Rezultatet treguan se ka dallime në mes të edukatorëve me përgatitje të ndryshme arsimore dhe ndikimit të tyre që fëmijët t'i përdorin mjetet e punës në kopsht.

Lidhur me pohimin: Fëmijët ushqehen, vishen dhe kryejnë veprime të tjera në mënyrë të pavarur, $F=33.730$, $p=0.000<0.05$. Nga rezultatet e paraqitura, vërehet se ka dallime statistikisht të rëndësishme në mes të edukatorëve me përgatitje të ndryshme arsimore dhe të ushqyerit dhe kryerjes së disa veprimeve të tjera në mënyrë të pavarur.

Lidhur me pohimin e edukatorëve: Fëmijët kanë krijuar shprehi pozitive higjienike, i pastrojnë duart, fytyrën, dhëmbët dhe e mbajnë mirë higjienën trupore, vlera e $F=36.900$, $p=0.000<0.05$. Ka ndërlidhje statistikisht të rëndësishme në mes të krijimit të shprehive higjienike të fëmijëve dhe përgatitjes arsimore të edukatorëve.

Lidhur me pohimin: Para dhe pasi të hanë ushqim, fëmijët i pastrojnë duart, $F=29.329$, $p=0.000<0.05$. Rezultatet treguan se ka ndërlidhje në mes të pastrimit të duarve para dhe pas ushqimit dhe përgatitjes arsimore të edukatorëve.

Lidhur me pohimin: Fëmijët sa herë shkojnë në banjo, i pastrojnë duart me sapun, vlera e $F=0.000 < 0.05$. Rezultatet treguan se ka ndërlidhje në mes të mbajtjes së higjienës së duarve kur fëmijët shkojnë në banjo dhe përgatitjes arsimore të edukatorëve.

Lidhur me pohimin: Mendoj se jam shembull për fëmijët e klasës sime për shprehi pozitive, $F=9.457$, vlera e $p=0.051 > 0.05$. Rezultatet treguan se nuk ka dallime statistikisht të rëndësishme në mes të të menduarit të edukatorëve se janë shembull për fëmijët dhe përgatitjes arsimore të tyre.

Lidhur me pohimin: Fëmijët gjatë ditës, në intervale të ndryshme pushojnë, $F=34.037$, $p=0.000 < 0.05$. Rezultatet treguan se ka ndërlidhje në mes të përgatitjes arsimore të edukatorëve dhe të pushuarit të fëmijëve.

Nga këto rezultatet, mund të konstatohet se ka ndërlidhje statistikisht të rëndësishme në mes të përgatitjes arsimore të edukatorëve dhe ndikimit të tyre në krijimin e shprehive pozitive të fëmijëve.

Test Statistics ^{a,b}												
	P 6	P 7	P 8	P 9	P 10	P 11	P 12	P 13	P 14	P 15	P 16	P 17
Chi-Square	24.416	14.006	34.170	32.431	37.870	18.955	33.730	36.900	29.329	45.685	9.457	34.037
df	4	4	4	4	4	4	4	4	4	4	4	4
Asymp. Sig.	.000	.007	.000	.000	.000	.001	.000	.000	.000	.000	.051	.000
a. Kruskal Wallis Test												
b. Grouping Variable: Përgatitja arsimore												

Tabela nr. 3.2. Ndërlidhja në mes të përgatitjes arsimore dhe ndikimit në zhvillimin e shprehive pozitive

Hipoteza 2:

Hipoteza alternative (HA): Ekziston ndërlidhje statistikisht e rëndësishme në mes të moshës së edukatorëve dhe zhvillimit të shprehive pozitive të fëmijëve

Hipoteza zero (HO): Nuk ekziston ndërlidhje statistikisht e rëndësishme në mes të moshës së edukatorëve dhe zhvillimit të shprehive pozitive të fëmijëve

Për testimin e hipotezës, mbi ndikimin e moshës së edukatorëve në zhvillimin e shprehive pozitive të fëmijëve, është përdorur analiza e testit NOVA një drejtimshe.

Në bazë të rezultateve, vërehet se në variablën: Unë kam ndikuar që fëmijët e klasës sime, t'i krijojnë shprehite e përgjithshme pozitive, $F=5.051$, $p=0.001 < 0.05$, nuk mbështetet hipoteza zero. Në variablën: Kam punuar që fëmijët e klasës time, të sillen mirë me të tjerët, $F=1.840$, $p=0.129 > 0.05$, mbështetet hipoteza zero. Në variablën: Kam ndikuar që fëmijët e klasës, të qëndrojnë ulur drejt në karrige dhe bankë, $F=14.295$, $p=0.000 < 0.05$, vërehet se ka dallime në mes të edukatorëve në bazë të

nivelit arsimor. Në variablën: Fëmijët e klasës sime, kanë qëndrueshmëri, rregullsi, dëgjueshmëri, $F=12.604$, $p=0.000<0.05$. Në variablën: Fëmijët e klasës sime, kanë krijuar shprehi pozitive të punës, $F=40.952$, $p=0.000<0.05$, në variablën: Fëmijët janë në gjendje të përdorin mjetet e punës në kopsht, $F=9.350$, $p=0.000<0.05$. Në variablën: Fëmijët ushqehen, vishen dhe kryejnë veprime të tjera në mënyrë të pavarur, $F=14.448$, $p=0.000<0.05$. Në variablën: Fëmijët, kanë krijuar shprehi pozitive higjienike, i pastrojnë duart, fytyrën, dhëmbët dhe e mbajnë mirë higjienën trupore, $F=11.075$, $p=0.000<0.05$. Në variablën: Para dhe pasi të hanë ushqim, fëmijët i pastrojnë duart, $F=0.923$, $p=0.455>0.05$. Në variablën: Fëmijët sa herë shkojnë në banjo, i pastrojnë duart me sapun, $F=1.685$, $p=0.162$. Në variablën: Mendoj se jam shembull për fëmijët e klasës sime për shprehi pozitive, $F=3.662$, $p=0.009<0.05$, dhe variabla: Fëmijët gjatë ditës, në intervale të ndryshme pushojnë, $F=3.332$, $p=0.014<0.05$.

Nga rezultatet, vërehet se vetëm në 3 variabla është mbështetur hipoteza zero, ndërsa në variablat tjera, është mbështetur hipoteza alternative. Nga këto rezultate, mund të themi se është mbështetur hipoteza alternative, ka ndërlidhje në mes të moshës së edukatorëve dhe ndikimit në zhvillimin e shprehive pozitive të fëmijëve.

Hipoteza 3:

Hipoteza alternative (HA): Ka ndërlidhje në mes të drejtimi arsimor të edukatorëve dhe ndikimit në zhvillimin e shprehive pozitive të fëmijëve

Hipoteza zero (HO): Nuk ndërlidhje në mes të drejtimi arsimor të edukatorëve dhe ndikimit në zhvillimin e shprehive pozitive të fëmijëve

Testimi për i hipotezës është bërë përmes Mann Whitney U.

Në bazë të rezultateve, mund të vërehet se variablat: Kam ndikuar që fëmijët e klasës, të qëndrojnë ulur drejt në karrige dhe bankë, $U=171$, $Z=-2.326$ dhe $p=0.020<0.05$, Fëmijët e klasës sime, kanë krijuar shprehi pozitive të punës, $U=144$, $Z=-2.702$, $p=0.007<0.05$, Fëmijët janë në gjendje të përdorin mjetet e punës në kopsht, $U=157.500$, $Z=-2.181$ $p=0.029<0.05$ dhe Fëmijët, kanë krijuar shprehi pozitive higjienike, i pastrojnë duart, fytyrën, dhëmbët dhe e mbajnë mirë higjienën trupore, $U=180$, $Z=-2.068$, $p=0.039<0.05$. Nga këto rezultate, vërehet se në këto variabla mbështetet hipoteza alternative, ndërsa në të gjitha variablat tjera mbështetet hipoteza zero. Rezultatet treguan se nuk ka ndërlidhje statistikisht të rëndësishme në mes të drejtimit arsimor të edukatorëve dhe ndikimit në zhvillimin e shprehive pozitive.

Test Statistics ^a												
	Pyetja 6	Pyetja 7	Pyetja 8	Pyetja 9	Pyetja 10	Pyetja 11	Pyetja 12	Pyetja 13	Pyetja 14	Pyetja 15	Pyetja 16	Pyetja 17
Mann-Whitney U	225.000	216.000	171.000	198.000	144.000	157.500	238.500	180.000	252.000	234.000	234.000	198.000
Wilcoxon W	1128.000	1119.000	249.000	1101.000	1047.000	235.500	1141.500	1083.000	330.000	1137.000	1137.000	1101.000
Z	-.688	-1.376	-2.326	-1.298	-2.702	-2.181	-.299	-2.068	.000	-.944	-.944	-1.734
Asymp. Sig. (2-tailed)	.492	.169	.020	.194	.007	.029	.765	.039	1.000	.345	.345	.083

a. Grouping Variable: Drejtimi

Test Statistics^a

Tabela nr. 3.3. Ndërlidhja në mes të drejtimit arsimor dhe ndikimit në zhvillimin e shprehive pozitive

Hipoteza 4:

Hipoteza alternative (H_A): Ka ndërlidhje statistikisht të rëndësishme në mes të numrit të fëmijëve dhe ndikimit të edukatorëve në zhvillimin e shprehive pozitive të fëmijëve;

Hipoteza zero (H₀): Nuk ka dallime statistikisht të rëndësishme në mes të numrit të fëmijëve dhe ndikimit të edukatorëve në zhvillimin e shprehive pozitive të fëmijëve

Testimi është bërë testit ANOVA një drejtimëshe.

Në bazë të rezultateve, vërehet se në shumicën e variablave mbështetet hipoteza alternative.

Rezultatet treguan se ka dallime statistikisht të rëndësishme në mes të edukatorëve me numër të ndryshëm të fëmijëve në klasë dhe formimin e shprehive pozitive, pasi që $F=8.332$, ndërsa $p=0.000<0.05$.

Në variablën: Kam punuar që fëmijët e klasës time, të sillen mirë me të tjerët, $F=2.625$, $p=0.006<0.05$, që është tregues se ka dallime në mes të edukatorëve me numër të ndryshëm të fëmijëve në klasë.

Në variablën: Kam ndikuar që fëmijët e klasës, të qëndrojnë ulur drejt në karrige dhe bankë, vlera e $F=5.793$, ndërsa $p=0.000<0.05$. në variablën: Fëmijët e klasës sime, kanë qëndrueshmëri, rregullsi, dëgjueshmëri, $F=1.3$, $p=0.238>0.05$.

Në variablën: Fëmijët e klasës sime, kanë krijuar shprehi pozitive të punës, $F=2.410$, $p=0.011<0.05$.

Në variablën: Fëmijët janë në gjendje të përdorin mjetet e punës në kopsht, $F=4.143$, $p=0.000<0.05$.

Në variablën: Fëmijët ushqehen, vishen dhe kryejnë veprime të tjera në mënyrë të pavarur, $F=3.044$, $p=0.002<0.05$.

Në variablën: Fëmijët, kanë krijuar shprehi pozitive higjienike, i pastrojnë duart, fytyrën, dhëmbët dhe e mbajnë mirë higjienën trupore, $F2.002$, $p=0.036<0.05$.

Në variablën: Para dhe pasi të hanë ushqim, fëmijët i pastrojnë duart, $F=1.004$, $p=0.45>0.05$.

Në variablën: Fëmijët sa herë shkojnë në banjo, i pastrojnë duart me sapun, $F=1.758$, $p=0.072$.

Në variablën: Mendoj se jam shembull për fëmijët e klasës sime për shprehi pozitive, $F=4.034$, $p=0.000<0.05$.

Në variablën: Fëmijët gjatë ditës, në intervale të ndryshme pushojnë, $F=4.800$, $p=0.000<0.05$.

Nga këto rezultate, vërehet se nga 12 variabla, vetëm në 3 prej tyre është mbështetur hipoteza zero, ndërsa në 9 të tjera është mbështetur hipoteza alternative, andaj mund të konkludohet se ka ndërlidhje në mes të numrit në një klasë dhe zhvillimit të shprehive pozitive nga edukatori.

Hipoteza 5:

Hipoteza alternative (HA): Ka ndërlidhje në mes të shprehive të fëmijëve të krijuara në familje dhe kënaqësisë së edukatorëve në krijimin e shprehive nga fëmijët

Hipoteza zero (HO): Nuk ka ndërlidhje në mes të shprehive të fëmijëve të krijuara në familje dhe kënaqësisë së edukatorëve në krijimin e shprehive nga fëmijët

Përmes Testit Kruskal Wallis, është bërë testimi në mes të shprehive që i kanë pasur fëmijët kur kanë shkuar në kopsht dhe kënaqësisë së edukatorëve lidhur me zhvillimin e shprehive pozitive të fëmijëve.

Në bazë të rezultateve, vërehet se lidhur me variablën: Sa jeni e kënaqur me formimin e shprehive të përgjithshme pozitive të fëmijëve të klasës Suaj?, vlera e $X^2=12.533$, $p=0.006<0.05$.

Në variablën: Sa jeni e kënaqur me formimin e shprehive higjienike të fëmijëve të klasës Suaj?, vlera e $X^2=18.997$, $p=0.000<0.05$.

Në variablën: Sa jeni e kënaqur me qëndrimin e nxënësve në karrige dhe bankë?, vlera e $X^2=15.796$, $p=0.001<0.05$.

Në variablën: Sa jeni e kënaqur me fëmijët e klasës Suaj, në formimin e shprehive të punës?, $X^2=14.282$, $p=0.003<0.05$.

Në variablën: Sa jeni e kënaqur me sjelljen e fëmijëve të klasës Suaj?, vlera e $X^2=18.612$, $p=0.00<0.05$.

Në variablën: Sa jeni e kënaqur me qëndrueshmërinë, rregullsinë, dëgjueshmërinë, pavarësinë e fëmijëve të klasës Suaj?, vlera e $X^2=10.245$, $p=0.017<0.05$.

Rezultate treguan se ka ndërlidhje në mes të shprehive me të cilat kanë shkuar fëmijët në kopsht dhe kënaqësisë së edukatorëve në formimin e shprehive pozitive të fëmijëve, andaj mund të konstatohet se është mbështetur hipoteza alternative.

Test Statistics ^{a,b}						
	Pyetja 18	Pyetja 19	Pyetja 20	Pyetja 21	Pyetja 22	Pyetja 23
Chi-Square	12.533	18.997	15.796	14.282	18.612	10.245
df	3	3	3	3	3	3
Asymp. Sig.	.006	.000	.001	.003	.000	.017
a. Kruskal Wallis Test						
b. Grouping Variable: Fëmijët në kopsht kanë ardhur me shprehi të përgjithshme pozitive						

Tabela nr. 3.4. Rezultatet e testit Kruskal Wallis, lidhur me shprehitë e fëmijëve

PËRFUNDIME

Nga rezultatet e frekuencës, vërehet se një pjesë e edukatorëve, nuk kanë qenë të kënaqur me shprehitë me të cilat fëmijët kanë shkuar në kopsht. Një pjesë e madhe e edukatorëve, konsiderojnë se kanë ndikimit në zhvillimin e shprehive pozitive të fëmijëve, shumica e edukatorëve janë të kënaqura me formimin e shprehive të fëmijëve.

Nga rezultatet lidhur me hipotezat, u nxorën këto rezultate:

1. Ka ndërlidhje në mes të përgatitjes arsimore të edukatorëve dhe ndikimit në zhvillimin e shprehive pozitive të fëmijëve. Lidhur me këtë hipotezë u gjetë se ka ndërlidhje statistikisht të rëndësishme në mes të përgatitjes arsimore të edukatorëve dhe ndikimit të tyre në krijimin e shprehive pozitive të fëmijëve, andaj nga këto rezultate, mund të konstatohet se është mbështetur hipoteza alternative.

2. Ekziston ndërlidhje statistikisht e rëndësishme në mes të moshës së edukatorëve dhe zhvillimit të shprehive pozitive të fëmijëve. Rezultatet e hulumtimit treguan se ka ndërlidhje në mes të moshës së edukatorëve dhe zhvillimit të shprehive pozitive të fëmijëve, andaj mund të konstatohet se është mbështetur hipoteza alternative.

3. Ka ndërlidhje në mes të drejtimi arsimor të edukatorëve dhe ndikimit në zhvillimin e shprehive pozitive të fëmijëve. Lidhur me këtë hipotezë, rezultatet treguan se nuk ka ndërlidhje në mes të drejtimit arsimor që kanë përfunduar edukatorët dhe ndikimit të zhvillimin e shprehive pozitive të fëmijëve.

4. Ka dallime statistikisht të rëndësishme në mes të numrit të fëmijëve dhe ndikimit të edukatorëve në zhvillimin e shprehive pozitive të fëmijëve. Lidhur me këtë hipotezë, rezultatet treguan se ka ndërlidhje në mes të numrit të fëmijëve dhe ndikimit që e kanë edukatorët në zhvillimin e shprehive pozitive të fëmijëve.

5. Ka ndërlidhje në mes të shprehive të fëmijëve të krijuara në familje dhe kënaqësisë së edukatorëve në krijimin e shprehive nga fëmijët. Lidhur me këtë hipotezë, rezultate treguan se ka ndërlidhje në mes të shprehive me të cilat kanë shkuar fëmijët në kopsht dhe kënaqësisë së edukatorëve në formimin e shprehive pozitive të fëmijëve, andaj mund të konstatohet se është mbështetur hipoteza alternative.

LITERATURA

- Bartushkova, Marija. 1978. Pedagogjia e moshës parashkollore (botimi i dytë), ETMM, Prishtinë.
- Grillo, K. 2002. Fjalor Edukimi (Psikologji-Sociologji-Pedagogji), ISP, Tiranë
- Granhed, S.,&F. Lundgren. 2009. Educational Hygiene for Children. A study of children and hygiene, and the development of educational hygiene products, Göteborg, Sëden.
- publications.lib.chalmers.se/records/fulltext/103659.pdf
- Gjevori, M. 2005. Prindërit-edukatorë të parë të fëmijëve, “Drini graf”, Prishtinë.
- Hyder, A. Adnan and Richard H. Morroë. 2005. Culture, Behavior, and Health
- Kraja, M. 2006, 2002. Pedagogjia, “Libri universitar”, Tiranë.
- Mialaret, G. 1997. Pedagogjia e Përgjithshme, “Koha”, Prishtinë
- Murati, Xh. 2004. Pedagogjia e Përgjithshme, “Logos”, Shkup
- Musai, B. 1999. Psikologji edukimi, “Pegi”, Tiranë.
- Nushi, Pajazit. 1987. Fjalor i Psikologjisë, Prishtinë.
- Pettijohn, F. T. 1996. Psikologjia, një hyrje koncize (botimi II), “Lilo”, Tiranë.
- Piaget, J. 2005. Mbi Pedagogjinë, IKS, Tiranë
- Rot, dr. N. 1975. Psikologjia e personalitetit, ETMM, Prishtinë
- Toli, K.& L. Hasani. 2001. Higjiena Shkollore, shblu, Tiranë
- Trnavac, N.& J. Djordjević. 1992. Pedagogjia, Beograd.
- Smilaniq, V.& I. Toliçiç (1979), Psikologjia Fëmijore (botimi katërt), ETMM, Prishtinë
- Shimllesha, P. (redaktor). 1988. Pedagogjia, ETMM, Prishtinë

- Vukasovič, A. 1995. Pedagogjia, Zagreb.
- Vukasevič, A. 1977. Moralne kvalitete naših učenika, Zagreb.
- Vukasović, A. 1976. Intelektualni odgoj, IZJA, Zagreb.
- Woolfolk, A. 2011. Psikologji edukimi (botimi i njëmbëdhjetë), “CDE”, Tiranë.
- Zbatimi i standardeve për mësim dhe zhvillim të hershëm. 2014. Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, Shkup.

PERCEPTIONS OF THE PRIMARY EDUCATION TEACHERS ON THE BASIC TEACHING METHODS

Msc. Armanda Xhani Baca

aarmi98@gmail.com

ABSTRACT

The Impact of Contemporary Methods on Academic Achievement in Low-Cycle Students Numerous personalities and different authors have spoken about teaching and methods together. What they have on students' achievements and how contemporary methods affect their students, their use, and so on. Different authors have also treated the learner's relationship as to how they affect the student's level. We have Sander and Rivers who has spoken about the impact that the good teacher figure has on the students. Skills that a teacher has to master to manage and organize the classroom. In this work I have the behaviors and instances of teachers when faced with two-grade classes on how the teacher should act in this case to ensure harmony in the classroom. What kind of impact does the game bring to students, is the game a good method to attract students attention, how much should it be applied, when it is advisable to use at what stage, or foster the learning game of students. The game makes them connect to reality with the new information they receive and helps them to better remember through the game as a method that students also have fun and learn together. The authors Ogdeni, Brofi and Everstoni are studying which of the methods produced positive outcomes to students, zinc or casual reading in their studies, they argued that reading in turn had a better impact on student academic outcomes as it creates the opportunity All students are involved in the reading process, so all students become active during the lesson and acquire something about it. While occasionally we can forget any. Also, we have the case of Dunn and Grigs researchers who made their studies of importance to the country, time and the society in which students came to their learning. These elements are important for students to learn more quickly and accurately. I say faster because it is happening in a country and society that want to learn faster and more accurately as they are motivated. During this work I have also touched upon the studies that have been made about the importance of visual appearance to the students, the presentation of the themes of learning through the eyes and different projector vision. I have touched and patter should be used and to what level does she or she help her to measure maternal level to diagnose problems in student learning. In this paper I have also compiled questionnaires for students and teachers to find out how influential contemporary methods influence students to reach the teachers properly and properly. Have they come to understand or bring forth the benefits this method brings to their teaching? Through the questions I have been aiming to draw from the teachers that they make two methods of teaching the contemporary and traditional to list the positive and negative sides that they think have these methods.

Key words: traditional teaching, student-centered teaching, inclusion, outcome.

I. Entry

The learning process, starting from childhood, and everything that happens at that age, leaves its mark throughout the life of the individual. Children are a "tabula rasa", where what is written in it is very difficult to erase or modify, so children learn what they are living.

Learning should be actively built; therefore, it is presented as an active discovery process. The role of the teacher is not to inculcate the student's knowledge through continuous repetition, or to push students to learn through the use of rewards or punishments. Its role is to facilitate the discovery by providing the necessary resources and guiding students as they strive to acquire new knowledge of existing ones and modify existing knowledge to adapt to new knowledge. Likewise, the teacher has an extraordinary role in the development of creativity and critical thinking in primary school students; precisely this is the core of this paper.

As highlighted by psychologists and specialists in the field of education, preschool education is one of the most important stages of the beginning of the child education process. During this phase children can be educated in their families or preschool institutions. During this process, children are exposed to different experiences, which through various activities set the foundation for physical, cognitive, emotional and social development. This paper will present methods and techniques for developing critical and creative thinking in primary school students.

1.1. Contemporary teaching and its significance

With contemporary teaching, we need to understand that kind of teaching, which facilitates student learning process with appropriate forms, methods, techniques and strategies. Contemporary teaching implies changing teacher and student roles, community participation in school life, and many other educational factors. Contemporary teaching is the kind of teaching that facilitates student learning by:

- Developing students' abilities to realize an independent learning;
- Developed initiative and independence;
- Encourage diversity in student learning and creativity;
- Developing the best communication skills;
- Developing managerial, organizational skills;
- Promote self - esteem and appropriate assessment of the learning outcomes achieved.

Today's teaching alongside the above characteristics is related to the content of the curriculum that the school offers. Thus, in the new school controversy, where a new curriculum is concerned, the age and physical aspect of a curriculum should be considered.

Looking at the problem from the coherence and freshness perspective of a curriculum that conveys a new content and, consequently, unlike before, and a new teaching, we set out some principles that make up the features of a new curriculum that enables a coherent teaching³⁰.

Teaching includes teachers, curricula and students. Problems can arise from each of these elements. Part of the teacher's tasks are not only student motivation, but also providing successful experiences, enhancing progress and increasing interest in the process of learning. The use of diverse teaching strategies will meet the needs of different teachers and students and will help to prevent boredom. Teaching strategies and materials should be selected in such a way that they are tailored to learning objectives with different levels of students, learning style and motivation level. Successful teaching practices require teachers to constantly monitor and adapt the techniques and materials according to the needs of students.

Simplified teaching will not improve student preparation unless teaching strategies are improved. Finally, distressed, tense students often have more knowledge than the results achieved in their examinations. Thus, anxiety interferes with certain points of learning and knowledge control, especially exams and tests³¹. According to Rama (2011), contemporary teaching enables students, encourages them in learning activities, finds information resources themselves, develops skills, skills, and forms their own skills. To achieve these outcomes, conditions must be created for an appropriate learning environment³²

This makes teaching, as Musai (2003) asserts is a difficult and complex task, which according to him requires extensive knowledge, skills and habits.

The teaching process is based on contemporary methods and techniques where the learner learns by reflecting, evaluating, discovering, and solving problems. It is a process that is constantly changing. In contemporary teaching the learner is encouraged in the teaching process, various activities for acquiring new knowledge, always relying on their experience, interest, needs and skills. Therefore, the sources of information are numerous and different from: teacher, experience, texts, internet and shock-shock through interaction etc³³.

1.2 Troubleshooting

The main problem that I seek to answer and solve with the topic I have chosen is the impact of contemporary methods on the academic achievements of primary school students. By solving this problem I can see the success that this method entails in teaching.

³⁰ Group of Authors (2005). Teaching the student centered. QTKA, 16.

³¹ Woolfolk (2011). Educational Psychology. Tiranë: CDE, 271.

³² Rama, B. (2011). Teaching Methods and Their Impact on Learning "Pedagogical Journal". Tiranë, 30.

³³ Musai, B. (2003). Teaching methodology. Tirana: CDE, 11.

Has this method influenced the teachers at what level has influenced the understanding that teachers have changed the teaching process just to their personal diary or even during the practical classroom development.

Have the students adapted this form of teaching or have their way of thinking and reasoning changed freely in the classroom.

1.3 Purpose of the study

The purpose of this microteesis is to describe and analyze teacher perceptions on teaching methods and techniques through creative projects, and which methods and techniques apply in our schools, generally based on the experience of teachers who have years of experience in the field of education in primary education

• Objectives

This study focuses on the following objectives:

1. Reconsider various theoretical approaches to contemporary methods
2. Determine characteristics of teachers' attitudes on school methodology
3. Compare the perceptions of teachers based on age, gender and educational level
4. Determine their impact on the educational-educational process at school

1.4 Research Questions

1. What is the relationship between teachers' attitudes and demographic factors, such as gender and age?
2. What is the relationship between teachers' attitudes and their degree of qualification?

1.5 The importance of the study

This study is important in several respects:

- in the individual aspect: it is a next attempt to deepen the field of theoretical knowledge and enrich it further with respect to data from the field
- in the research aspect: measures the perceptions of teachers referring to the field of methodology
- in terms of school: it helps teachers of peripheral and rural schools to expand their knowledge

2. Methodology

2.1. Method

This study supports his research into teacher attitudes on teaching methods. The aim of the study is to explore how teachers perceive teaching methods and how they proceed during the learning process. The research form pursued in this study is an interview, as a qualitative method. Interviews are intended to provide teachers opinions on the emerging issues

2.2. Population and Champion

In order to create a representative sample of the target population, a list was provided by the Durres Education Department, the names and addresses of all nine-year schools in the city of Durrës. Referring to the DAR list, the total number of basic education schools is 21 9-year public schools.

The population of this study was:

Primary school teachers in public institutions of pre-university education in the suburbs (village) of Durres city.

For the purpose of the study, as mentioned above, 7 schools were randomly selected and 50 teachers were invited to become a participant in the study. All teachers were selected to be teachers who taught in the first, second and third classes.

Teachers have met individually and are clarified with the purpose of the study, and have been instructed by the researcher on how to respond to the instrument. Further clarifications are provided when doubts have been raised by the participants. Interviews were completed not in the presence of the researcher, as teachers requested more time to fill it.

A total of 29 surveys were completed, as only 29 teachers returned the completed surveys.

2.3. Search Tool

This study is a quality research. Interviews were used as a research tool.

The interview consists of two parts; the first consists of the demographic data, gender, age and qualification of the teacher. The second consists of four questions that require the opinion of teachers on teaching methods, such as:

- *Do teaching methods affect the student's involvement in learning?*

Which methods and why?

- *Do teaching methods affect student outcomes?*

Which methods and why?

- *Do the traditional (traditional) methods have advantages?*

Do you apply them and where?

- *Do contemporary methods have advantages?*

Do you apply them and where? Please, can list some of them.

At the same time, the interview also contained an open question, through which the teacher's thinking about the current methodical teaching practices was sought. The last question is as follows:

- Based on your work:

What methods have brought you more results?

Can you bring successful experiences from your job?

3.4 Data Processing

Data was processed manually. So all the answers given by the interviewer to a word page were thrown. Applied:

и одговорностите на создавачите и корисниците на класифицирани информации, меѓународната размена, како и други прашања во врска со користењето на класифицирани информации. Целта на овој закон е обезбедување на законито користење на класифицирани информации и оневозможување на секаков вид незаконски пристап до информациите. Според член 28 од Законот, мерки и активности за информатичка безбедност се: сертификација на комуникациско-информациски системи и процеси; процена за можно нарушување на безбедноста на класифицираната информација со упад во информатичкиот систем и употреба и уништување на класифицирана информација обработувана и чувана во комуникациско-информациски системи; утврдување на методи и безбедносни процедури за прием, обработка, пренос, чување и архивирање на класифицирани информации во електронска форма; заштита на информациите при процесирање и чување на класифицирани информации во комуникациско-информациски системи; продукција на крипто клучеви и друг крипто материјал; криптографска заштита на комуникациски, информациски и други електронски системи преку кои се подготвуваат, пренесуваат, обработуваат и архивираат класифицирани информации; определување на зони и простории заштитени од компромитирачко електромагнетско зрачење и - инсталирање на уреди за чување на класифицирани информации.⁵³

Со *Законот за национална криминалистичко – разузнавачка база на податоци* се уредуваат востановувањето и функционирањето на Националната криминалистичко-разузнавачка база на податоци, обработката на податоците во базата, безбедноста на податоците во базата, користењето на базата за цели на соработка со странски субјекти и надзорот над функционирањето на базата.⁵⁴ Со *Закон за оперативно – техничка агенција* се уредуваат основањето на Оперативно-техничка агенција (ОТА), надлежностите, раководењето, правата и обврските од работен однос на работниците во ОТА, стручниот надзор и финансирањето на ОТА. ОТА дејствува како посреднички орган кој воспоставува технички премин помеѓу операторот и овластените органи, без можности за активирање или спроведување на снимањето на следените комуникации.⁵⁵ Членот 50 од *Законот за аудио и аудиовизуелни медиумски услуги* ја регулира заштита на малолетните лица. Според овој член, давателите на аудиовизуелни медиумски услуги не смеат да емитуваат програми кои можат сериозно да му наштетат на физичкиот, психичкиот или моралниот развој на малолетните лица, особено програми кои содржат порнографија или непотребно насилство. Забраната се однесува и на други програми кои веројатно би можеле да му наштетат на физичкиот, психичкиот или моралниот развој на малолетните лица освен кога е обезбедено со нивното емитување или репризирање во одреден временски период или со примена на одредена техничка мерка, малолетните лица во периодот на емитување или репризирање нема на

⁵³ Закон за класифицирани информации

⁵⁴ Закон за национална криминалистичко-разузнавачка база на податоци

⁵⁵ Закон за оперативно-техничка агенција

вообичаениот начин да ги слушнат или да ги видат тие програми.⁵⁶ Со **Закон за заштита на децата** се уредува системот и организацијата за заштита на децата. Заштита на децата се остварува преку обезбедување на определени права, средства и облици на заштита на децата. Во примената на одредбите од овој закон се тргнува од принципите на заштитата на правото на живот и развој на детето, заштитата на најдобриот интерес на детето, обезбедување на минимум стандард за секое дете под еднакви услови, исклучување на каква било форма на дискриминација, почитување на правото на детето на слобода и безбедност на личноста, на сопствено мислење и слободно изразување, здружување и образование, услови за здрав живот и остварување на други социјални права и слободи на детето. Со законот се забранува секоја форма на дискриминација врз основа на расата, бојата на кожата, полот, јазикот, вероисповедта, политичкото или друго убедување, националното, етничкото или социјалното потекло, културна или друга припадност, имотната состојба, онеспособеноста, раѓањето или друг статус на детето или на неговиот родител или законски старател.⁵⁷

Кривичниот законик содржи сплет од кривични дела во кои се инкриминирани прототивправните дејствија извршени преку средствата за електронските комуникации, па во таа насока се применуваат следните членови: член 122 став 41 и 42 - Под насилство врз дете покрај семејното насилство се подразбира и психичко насилство, насилство преку интернет, врничко насилство, како и демнење и следење на детето. Како дело од омраза изречно предвидено со одредбите од овој Законик, се смета кривично дело против физичко или правно лице и со нив поврзани лица или имот кое е сторено во целост или делумно поради реална или претпоставена (замислена, вообразена) карактеристика или поврзаност на лицето што се однесува на раса, боја на кожа, националност, етничко потекло, религија или уверување, ментална или телесна попреченост, пол, родов идентитет, сексуална ориентација и политичко уверување., член 144 – Загрозување на сигурноста, член 147 – Повреда на тајноста на писмата или други пратки, член 149 – Злоупотреба на лични податоци, член 149-а – Спречување на пристап кон јавен информатички систем, член 157-а – Повреда на правото на дистрибутерот на технички посебно заштитен сателитски сигнал, член 157-б – Пиратерија на аудиовизуелно дело, член 157-в – Пиратерија на фонограм, член 193 – Покажување на порнографски материјал на дете, член 193-а – Производство и дистрибуција на детска порнографија, член 193-б – Намамување на обљуба или друго полово дејствие на малолетник кој не наполнил 14 години, член 251 – Оштетување или неовластено навлегување во компјутерски систем, член 251-а – Правење и внесување на компјутерски вируси, член 251-б – Компјутерска измама.⁵⁸

⁵⁶ Закон за аудио и аудиовизуелни медиумски услуги.

⁵⁷ Закон за заштита на децата

⁵⁸ Кривичниот законик

Примената на начелото “ најдобар интерес на детето “ во сајбер просторот

Приватноста е фундаментално и уставно загарантирано право на секој човек. За остварување на ова право, потребно е пред се од страна на родителите, законските старатели на децата како и од страна на државата да се обезбеди максимална заштита на приватноста, на личните податоци на децата а пред се заштита од дигиталните насилства во сајбер просторот. Тоа може да се постигне на следниот начин:

Обезбедување на заштита на личните податоци и информации коишто се пласираат преку интернет мрежата. Ова подразбира да не се изнесуваат преку средствата за електронска комуникација на непознати лица преку интернет или преку мобилни телефони личните податоци за себе и за своето семејство, име и презиме, називот на училиштето во кое децата се образуваат, адресата на живеење, фотографиите на децата, телефонските броеви итн. Лозинките на детето треба да ги знае барем еден од родителите или законскиот старател на детето и истите не смеат да се изнесат на непознати лица, ниту пак да се кажат на своите пријатели. Предупредување на детето од своите родители или законските старатели за постоење на можноста од лажно претставување на личности со кои детето ја остварува или би можело во иднина да оствари електронска комуникација. Во таа насока, децата треба да се предупредат дека постои можност личноста која е на спротивната страна на компјутерот да изнесува неистините податоци за себе, податоци за своите години, приватниот живот, итн. Честопати во секојдневниот живот се случува лажното претставување на повозрасните лица кон малолетните лица да има за цел искористување, манипулирање, вознемирување и насилства. Па токму поради таа цел, неопходно е кон децата да се изгради однос на доверба помеѓу детето и родителот односно законскиот старател за да се заштити детето од сите облици на дигиталните насилства што со себе ги носи модерниот начин на живот. Спречување на средби со непознати лица кои детето ги запознало преку средствата за електронска комуникација. Доколку личноста лажно се претставува на детето при електронско комуницирање и побара заедничка средба, тоа е доволен показател за постоење на опасност од искористувања или насилства. Родителите односно законските старатели треба да го предупредат детето да во случај доколку личноста со која комуницира му побара заедничка средба, потребно е претходно родителот или законскиот старател да биде запознат за таа средбата како и детето да се охрабри да побара дозвола за да појде на средба само со присуство на неговиот родител односно законски старател. Примање на пораки, слики, видеа со неприемливи (вознемирувачки или сексуални) содржини преку средствата за електронските комуникации (е-маил, СМС; ММС пораки, социјалните мрежи) може да создаде проблем поради што е потребно детето да се охрабри да побара помош или совет од повозрасна, на нему блиска личност за да се справи со вознемирувања или насилства. Предупредување на

детето да не испраќа свои лични пораки, слики, видеа кон лица со кои комуницира преку електронските средства за комуникација за да не се доведе во ситуација на можни уцени, закани од лицата на кого ги испраќа содржините како и од можноста за јавно објавување на содржините од страна на тие лица. Детето треба да се предупреди за содржините на пораките кои ги испраќа бидејќи истите можат да се најдат како предмет на злоупотреби и искористувања од лицата на кои им ги испраќа. Поради наведеното, потребно е децата постојано да се советуваат и да се работи на нивната електронска едукација за да се спречат злоупотреби преку средства за електронската комуникација (да не споделуваат лични податоци со нивните пријатели, познаници и други луѓе. ; секогаш децата да имаат ефективен и ажуриран вграден антивирус и софтвер против шпиунирање на уредот преку кој пристапуваат на интернет; никогаш да не откриваат лични податоци како одговор на испратената електронска порака, писмо или телефонски повик ако не се сигурни дека барањето е од безбеден извор).

Во случај доколку детето е жртва на говор на омраза on line потребно е веднаш да се пријави до надлежните органи за гонење на сторителите од кривични дела. Во нашата држава активно функционира Одделението за компјутерски криминал надлежен за детектирање на кривични дела сторени преку компјутерски ситеми. Во случај доколку детето е зависно од видео игри потребно е родителот или законскиот старател на детето: веднаш да го ограничи времето кое детето го поминува пред компјутерот; да води разговор со кој ќе му ги предочи сите негативните страни што го носи прекумерното играње на видео игрите и недостаток на социјализација; поттикнување на детето да го поминува своето слободно време рекреативно и со своите пријатели; укажување дека видеоигрите доведуваат до сосјтојба на изолираност и агресивност.

Заклучоци и препораки

Секое дете заслужува детство без грижи, насилства, експлоатација и злоупотреби. На децата им е потребна посебна заштита преку интернет и тие треба постојано да се едуцираат за начинот како да ги одбегнат опасностите кои ги демнат преку користење на интернет мрежата. Интернетот ги изложува децата на богатство од можности, но, исто така и на ризици кои можат да имаат штетно влијание по нивниот психофизички развој. Некои од овие ризици вклучуваат сајбер-малтретирање, прашања за заштита на податоците, компјутерски криминал. Во нашата држава, законодавството треба да претрпи промени во смисла на воведување на нови законски решенија што ќе водат во насока на заштита на децата од дигиталните насилства кои што се остваруваат преку средствата за електронската комуникација. За реализација на таа цел, државата треба да превземе мерки преку воведување на програми за сузбивање на насилства врз децата, да се залага за поголема едукација на родителите, законските застапници и на

децата. Министерството за образование, министерството за правда како и канцеларијата на народниот правобранител треба да вршат периодични истражувања со цел да ја следат и да ја утврдат зачестеноста на појавата на експлоатација на деца преку интернет мрежите и врз основа на добиените податоци да спроведат информативни кампањи и едукативни проекти во насока на сузбивање на дигиталните насилства врз децата. На основа на воспоставена пракса, сите институции на државата треба да постават и да развијат реална, ефикасна и одржана стратешка рамка како и да ги применат акционите планови во таа област. Поради тоа, државата треба да се залага за воведување на долгорочен план и програма за заштита на децата од дигиталните насилства а со кои ќе се прецизираат превентивните активности и мерки за интервенција во ситуации на дигиталните насилства врз децата. Со цел превенција и сузбивање на експлоатација на децата преку компјутерска технологија потребно е со закон да се обврзат компаниите кои ги нудат интернет услугите или мобилните уреди да донесат интерни документи или правила со кои би се регулирале прашањата за заштита на децата од експлоатација преку интернет мрежите. Заради недоволно стручно познавање од оваа област, потребни се континуирани обуки на стручните лица во институциите кои се занимаваат со деца а во согласност со меѓународните и националните прописи и стратешките документи на државата.

Се наметнува потребата од промовирање на интегрирана национална стратегија за заштита од дигиталните насилства. Во таа насока, Советот на Европа ќе ги поддржи државите членки во примената на препораките на Комитетот на министрите за интегрирана национална стратегија за заштита на децата од дигиталните насилства. Препораките содржат насоки за развој на правни, стратешки и на институционални рамки, промовирање на култура за почитување на правата на децата, воспоставување на механизми и услуги прилагодени на детето како и донесување на национални агенди за истражувања во областа на спречување и решавање на разновидни облици на насилства врз децата. Се налага и потребата од усогласување на националното законодавство со најновите нормативни трендови во ЕУ од областа на остварување на безбедноста на личните податоци во сајбер просторот.

Во рамките на редовниот образовен систем потребно е: организирање и спроведување на едукативни програми како за родителите, така и за децата од областа на правилно користење на интернет услугите како и воспоставување на правилата за користење на интернет услугите и на мобилните телефони во образовниот процес, обезбедување на нивната применливост со цел спроведување на контрола врз децата при користењето на интернет услугите. За реализација на таа цел, потребно е да се инсталираат филтер програми или апликации на секој компјутер во установите каде децата ги користат компјутерите со цел да се ограничат програмите со несоодветни содржини за децата како и да се ограничи времетраењето на користењето на интернет. Во таа насока, голем удел имаат наставниците по

информатика како и училишните тимови за превенција и сузбивање на насилства врз децата преку интернет мрежите во училиштата.

Воведување на концептот позитивно родителство преку градење на позитивен однос на доверба помеѓу родителите и децата за да можат децата на родителите да им се доверат во случај доколку се најдат како жртви на дигитални насилства. Во средствата за електронската комуникација потребно е да се вградат апликации со кои на децата ќе им се ограничи пристап до непримерни содржини кои се прикажуваат на интернет мрежата. Државата треба за таа цел да изнајде софтверско решение за надградба на апликациите коишто се користат преку средствата за електронска комуникација.

Според извештајот на Прибе, во насока на следењето на комуникациите се дадени следните препораки за нашата држава: потреба од спроведување на итни реформски приоритети, првенствено оние кои се однесуваат на укинувањето на посредничката функција на УБК и укинување на директен пристап кон техничката опрема која овозможува следење на комуникацискиот сигнал; формирање на Национален координативен центар за криминалистичко разузнавање кој делотворно ќе ја овозможи соработката меѓу органите за спроведување на законот и кој ќе биде одговорен за следење на комуникациите во кривични случаи со налог издаден од суд; преземање на итни чекори во правец на професионализација на УБК и утврдување на план за реформа на овој орган. Владата треба одново да ги воспостави механизмите за превземање на активности за спроведување на препораките на Народниот правобранител и да го зајакне надзорот на нивното спроведување од страна на владините институции. Исто така, владата треба да преземе про-активна улога во областа на заштита на лични податоци, потоа да ја утврди состојбата во владините институции и да дефинира планови за зајакната заштита на личните податоци. Дирекцијата за заштита на лични податоци треба да има активна улога во истражувањата на кршењето на правилата за заштита на личните податоци во случаите при следењето на комуникациите и за истите да објави извештај.

Референци:

1. Buljan Flander, G., Dugić, S. i Handabaka, I. (2015), „Odnos elektroničkog nasilja, samopoštovanja i roditeljskih čimbenika kod adolescenata.“ *Klinička psihologija*, vol. 8 (2): 167-180.
2. Konstantinović-Vilić, S., Nikolić-Ristanović, V., *Kriminologija*, Niš, 2003, str.178-179.
3. <http://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=COM:2001:0051:FIN> preuzeto 20.07.2015.
4. Đuraković, J.S., Šincek, D. i Tomašić Humer, J. (2014), „Prikaz skale doživljavanja/činjenja nasilje preko

Interneta i rezultata primjene te skale na vinkovačkim srednjoškolicima.“ Život i škola, vol. 32 (60):61-74.

5.Hodak Kodžoman, I. Velki, T. i Cakić, L. (2013), „Izloženost djece starije školske dobi elektroničko nasilju “

Život i škola, vol. 30 (59): 110-128.

6.Bilić, V. (2010) Povezanosti medijskog nasilja s agresivnim ponašanjem prema vršnjacima, Odgojne znanosti,

sv. 12 (2), str. 265.

7. Hrpka, H. (2016.), „Je li moje dijete ovisno o videoigrama?“, Medijska pismenost.hr,

<http://www.medijskapismenost.hr/ovisnost-o-videoigrama/> (objavljeno: 2.11.2016.).

8. The World Health Report, World Health Organization, 2018.

9. Ciboci, L., Kanižaj, I. (2011) „Kako je nasilje preko medija ušlo u naše domove: Utjecaj, učinci i posljedice

nasilja u medijima na djecu i mlade“. U: L. Ciboci, I. Kanižaj, D. Labaš (ur.) Djeca medija – od marginalizacije do senzacije, Zagreb: Matica Hrvatska, str. 29

10. Bilić, V. (2010) Povezanosti medijskog nasilja s agresivnim ponašanjem prema vršnjacima, Odgojne znanosti, sv. 12 (2), str.265.

11. Holladay, J. (2010), „Cyberbullying-The stakes have never been higher for students or schools, “ Teaching Tolerance, vol. 38: 42-45.

12. Council of Europe Policy guidelines on integrated national strategies for the protection of children from

violence, page 15 related to Recommendation No. R (97) 19 of the Committee of Ministers on the portrayal

of violence in electronic media and Council of Europe Parliamentary Assembly Recommendation 1466

(2000) on “Media education”.

13. European Court of Human Rights, K.U. v. Finland, 2009.

14. Декларација за побезбеден интернет (Службен весник на РМ, бр. 31 од 03.03.2010 година).

15. Уставот на Република Северна Македонија.

16. Закон за заштита на личните податоци.

17. Кодекс за заштита на приватноста на Интернет.

18. Закон за заштита на приватноста.

19. Закон за електронските комуникации.

20. Закон за следење на комуникациите.

21. Закон за класифицирани информации.

22.Закон за национална криминалистичко-разузнавачка база на податоци .

23.Закон за оперативно-техничка агенција

24. Закон за аудио и аудиовизуелни медиумски услуги.
25. Закон за заштита на децата
26. Кривичниот законик на Република Северна Македонија.

DIVERSITY AND INCLUSION IN LABOUR MARKET

Geranda Mulla

NATO Communication and Information Agency (NCIA), The Hague, Netherlands,
gerandaago@yahoo.com

Abstract:

The concept of diversity is complex and multidimensional. The article will expand the definition of diversity beyond gender, age, and nationality. The best contemporaries' practice, concepts and policies will be described in more details. The main goal is to point out the importance of establishing a diverse and inclusive culture in the labour market. The research aim to point out on how diversity awareness can increase the work opportunities and inclusion of young professionals in the everyday work environment. The methodology used in this article in mainly a research of literature and will represent in specific the three categories of diversity: demographic diversity, experiential diversity and cognitive diversity. Fostering and promoting of the above mentioned types of diversity is vital to enhance a business' operational effectiveness.

Key words: maximum diversity, inclusion, business effectiveness

Hyrje

Diversiteti është një term kyç në teoritë sociale, politikat dhe praktikat bashkëkohore. Shpesh përdoret njëkohsisht si përshkrim i realiteteve komplekse shoqërore dhe si mënyrë trajtimi për vlerësimin dhe menaxhimin e këtyre realiteteve (Taylor 2012). Në këtë kontekst diversiteti dhe gjithëpërfshirja i referohet mirëqenies së njerëzve në punë, ruajtjen e burimeve mendore dhe fizike të tyre, dhe promovimin e të drejtave dhe dallimeve kulturore të cilat të gjitha bashkërisht i ndihmojnë ata që të kenë sukses në punë.

Një mjedis gjithëpërfshirës lejon që secili të japë kontributin individual dhe të arrijnë potencialin e plotë, pa pasur asnjë lloj diskriminimi apo përjashtimi me bazë gjinore, moshe, feje, përkatësie etnike, etj. Nëse biznesi nuk do të limitojë veten dhe do të njohë potencialin që ofron një forcë pune diverse atëherë të gjithë do të kenë mundësinë të përfaqësohen në tregun e punës dhe të ushtrojnë të drejtën e tyre legjitime për të pasur mundësi punësimi të barabarta pa marrë parasysh prejardhjen, identitetin ose rrethanat e tjera. Nga perspektiva e biznesit kuptimi dhe vlerësimi i diversitetit dhe gjithëpërfshirjes ka të bëjë me përqafimin e tyre për të fituar avantazh në tregun e punës si një kompani lider me përgjegjësi sociale për punonjësit, klientët dhe komunitetin ku operon.

Vështrim historik i legjislacionit mbështetës

Barazia në mundësi dhe trajtim është një parim kryesor i drejtësisë sociale që ka qenë në thelb të Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO) që prej momentin kur u themelua në vitin 1919. Gjithësesi, rregullime të arsyeshme kanë ndodhur më kalimin e kohës dhe janë një komponent kryesor për promovimin e diversitetit dhe përfshirjes në vendin e punës dhe të drejtën për barazi në punësim, formim profesional dhe edukim.

Nga rishqyrtimi i literaturës vërejmë se ka shkrime të hershme që kanë trajtuar diversitetin dhe çështje të rëndësishme lidhur me të. Në këtë kuadër një vlerë të veçantë zë Karta Ndërkombëtare e të Drejtave të Njeriut neni 14, *“Ndalimi i diskriminimit: Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të njohura në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, opinionet politike ose çdo opinion tjetër, origjina”* e miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara më 10 dhjetor 1948 në Palais de Chaillot, Paris. Po kështu, citohet dhe në një sërë Konventash të tjera Ndërkombëtare si Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, dhe Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike, me dy Protokolle opsionale.

Ndërkohë që Shqipëri aspiron për të qënë pjesë e Bashkimit Europian, motoja e tij e cila u përdor për herë të parë në vitin 2000 është *“ Të bashkuar në Diversitet ”*. Ajo qëndron për barazi për të gjithë, pavarësisht nga raca ose origjina etnike, orientimi seksual, gjinia, mosha, aftësia e kufizuar dhe feja. Në legjisllacionin e shtetit shqiptar, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë shpreh qartësisht respektimin e të drejtave themelore të njeriut në nenin 18 *“1. Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit. 2. Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore. 3. Askush nuk mund të diskriminohet për shkaqet e përmendura në paragrafin 2, nëse nuk ekziston një përlligje e arsyeshme dhe objektive.”* Dhe thellohet akoma më tej duke iu adresuar pakicave etnike në nenin 20: *“Personat që u përkasin pakicave kombëtare ushtrojnë në barazi të plotë para ligjit të drejtat dhe liritë e tyre. Ata kanë të drejtë të shprehin lirisht, pa u ndaluar as detyruar, përkatësinë e tyre etnike, kulturore, fetare e gjuhësore. Ata kanë të drejtë t'i ruajnë e zhvillojnë ato, të mësojnë dhe të mësohen në gjuhën e tyre amtare, si dhe të bashkohen në organizata e shoqata për mbrojtjen e interesave dhe të identitetit të tyre.”* Edhe pse në retorikën e politikave qeverisëse diversiteti është bërë një nga fjalët kyçe, terma të tilla si identiteti, kultura shpesh janë të paqarta dhe lenë vend për diskutim.

Përkufizimi i diversitetit

Ekziston një gamë e gjerë e përkufizimeve nga shkencëtarë të ndryshëm mbi diversitetin. Gjetjet e hulumtimeve janë të lidhura me qëllimin e përdorimit të tij. (Christian, Porter dhe Moffitt, 2006). Diversiteti sipas Thomas (1991) nënkupton racën dhe genderin në vendin e punës. Por,

studiuesit kanë shkuar më tej për të përcaktuar diversitetin në dimensionet primare dhe dytësore. Dimensionet primare janë mosha, përkatësia etnike, gjinia, aftësitë/cilësitë fizike, raca dhe orientimi seksual. Dimensionet kryesore formojnë imazhin themelor për veten tonë si dhe pikëpamjen tonë për botën. Përveç kësaj, ato kanë ndikimin më të madh në grupet në vendin e punës dhe në shoqëri (Loden dhe Rosener, 1991). Dimensionet dytësore përfshijnë sfondin arsimor, vendndodhjen gjeografike, të ardhurat, statusin martesor, besimet fetare dhe përvojën e punës. Këto dimensione dytësore të diversitetit ndikojnë në vlerësimin dhe përkufizim për veten tonë.

Mëgjithëse ka shumë mënyra klasifikimi të diversitetit për këtë studim më relevant është kategorizimi i trajtuar nga Annca dhe Aragon (2018). Sipas tyre 3 janë tipet kryesore të diversitetit: diversiteti demografik, eksperiencial/përvoja dhe ai kognitiv/njohës. Diversiteti demografik përveç karakteristikave që mbrohen sipas legjislacionit të diskriminimit në aspektin e racës, aftësisë së kufizuar, gjinisë, besimit, orientimit seksuale përfshin dhe karakteristika personale si prejardhja/background, kultura, personaliteti dhe stili i jetës, etj. Diversiteti demografik është i lidhur me *identitetet tona të origjinës* - karakteristikat që na klasifikojnë që në lindje dhe që do ti mbajmë përgjatë gjithë jetës sonë. Ky është quajtur ndryshe si dimension i brendshëm dhe mbi të cilin ne nuk kemi kontroll për ta ndryshuar. Zakonisht këto karakteristika primare janë burim për paragjykim dhe diskriminim. Ndërkohë diversiteti eksperiencial është i bazuar në përvojat jetësore që formojnë universin tonë emocional të tilla si prirjet, ngashmëritë, hobet dhe aftësitë. Ngjashmëritë janë ato që na bashkojnë me njerëz më të cilët ndajmë disa nga pëlqimet apo mos pëlqimet tona duke ndërtuar bashkësi emocionale. Ndikimin e diversitetit eksperiencial mund ta konsiderojmë si identitetet tona të rritjes. Diversiteti kognitiv/njohës na bën që të kërkojmë mendime të tjera për të plotësuar mendimet tona të cilin mund ta emërtojmë identitete të aspirates.

Kuptimi i llojeve të shumta të diversitetit është veçanërisht i rëndësishëm në kohën tonë komplekse. Kjo sepse nevojiten zgjidhje komplekse pasi një zgjidhje për të gjithë qasjen nuk funksionon. Çdo formë e diversitetit është e ndryshme dhe kërkon strategjinë e tij të menaxhimit për të integruar në mënyrë efektive njerëzit.

Përkufizimi i gjithëpërfshirjes dhe aspekte të tjera relevante

Për të arritur një kulturë gjithëpërfshirëse, njerëzit duhet të ndihen të vlerësuar, të dëgjuar dhe të respektuar (Wallace dhe Pillans 2016). Përfshirja është një mënyrë që maksimizon diversitetin e të gjithë punonjësve (Janakiraman 2011). Megjithëse shpeshherë termat diversitet dhe gjithëpërfshirje/përfshirje keqpërdoren apo konsiderohen si sinonim i njëri-tjetrit, ndikimi që secili prej tyre ka është dukshëm i ndryshëm. Diversiteti mund të rrisë përfaqësimin e pakicave dhe të ndihmojë

arritjen e objektivave etnike ose gjinore, por rrallë do të adresojë faktorët shoqërorë dhe organizativë që çojnë në përjashtimin e shumë njerëzve. Në të vërtetë, gjithëpërfshirja mund të jetë zgjidhja. Diversiteti është shpesh një lojë e përqindjeve, apo kuotave që organizatat angazhohen për ti përmbushur. Gjithëpërfshirja është ajo që shkon përtej këtyre kuotave të paracaktuara. Ajo ka të bëjë me krijimin e mjediseve ku të gjithë njerëzit mund të përparojnë dhe përparojnë pa marrë parasysh racën, ngjyrën, gjininë, aftësinë fizike, moshën, fenë, orientimin seksual ose besimin.

Një term tjetër i përdorur gjerësisht prej vitit 1989 në politikat e Bashkimit Europian është dhe përfshirja sociale. Fillimisht politikat e përfshirjes sociale ishin një alternative e Bashkimit Europian për politikat e varfërisë. Përfshirja sociale lufton përjashtimin social, pra intergrimin e individëve të përjashtuar ose për të parandaluar përjashtimin e tyre (Atkinson, 2005). Njerëzit konsiderohen të përjashtuar nga shoqëria kur marrëdhënia e tyre me shoqërinë është ndërprerë ose është jofunksionale. Prandaj janë politikat e përfshirjes sociale ato të cilat luajnë një rol të rëndësishëm për integrimin e njerëzve në shoqëri, të cilët nuk janë në gjendje të jenë anëtare të plotë të shoqërisë (Bhalla & Lapeyre, 1997; Atkinson et al, 2005).

Ashtu si diversitetit dhe përfshirja sociale është një koncept multidimensional dhe dimensionet më kyçe janë ato ekonomik, punësimi, dhe socio-kulturor (Bhalla & Lapeyre, 1997; Peace, 2001; Dieckhoff & Gallie, 2007; Daly, 2008). Dimensioi ekonomik i politikës sociale përqendrohet në ata individë që nuk kanë akses, pasuri dhe burimeve të mjaftueshme ekonomike, zakonisht i referohet politikave mbi varfërinë. Dimensioi i dytë i punësimit thekson rëndësinë e punës në shoqërisë. Pjesa më e madhe e të papunëve janë grupi më i rëndësishëm i këtij dimensionit. Në Shqipëri të rinjtë janë më të prekur duke qënë se përbëjnë shumicën e popullsisë prandaj politikat aktive të tregun të punës luajnë në rol të rëndësishëm për të luftuar papunësinë. Dimensioi socio-kulturor i drejtohet përmirësimit të shërbimeve sociale për atë kategori njerëzish të cilët nuk kanë mundësi ti përfitojnë ato.

Menaxhimi i diversitetit dhe gjithëpërfshirja në tregun e punës

Menaxhimi i diversitetit është një proces që synon të krijojë dhe të mbajë një energji pozitive në mjedisin e punës ku ngjashmëritë dhe dallimet e individëve janë të vlerësuara në mënyrë që të gjithë të mundën të arrijnë potencialin e tyre dhe të maksimizojnë kontributin me synim që të arrihen qëllimet dhe objektivat strategjike të organizatës. Ndërgjegjësimi dhe rritja e informacionit mbi diversitetin dhe gjithëpërfshirjen ndihmon në pasjen e një force pune të shumëllojshme. Promovimi i këtyre vlerave të përbashkëta, jo vetëm në vendin e punës, por edhe në shoqërinë në përgjithësi tregon se vetëm duke punuar së bashku, mund të krijojmë vende pune dhe shoqëri më gjithëpërfshirëse.

Avantazhet e menaxhimit të diversitetit

Nëse shqyrtojmë botimet e kryera nga Komisioni Europian do të shohim se 5 (pesë) avantazhe kryesore janë theksuar në implementimin e politikave aktive mbi Menaxhimin e Diversitetit si mëposhtë:

1. Forcon vlerat kulturore të një organizate.
2. Përmirëson imazhin e institucionit.
3. Ndihmon për të tërhequr dhe mbajtur njerëz shumë të talentuar.
4. Nxit motivimin dhe efikasitetin e stafit.
5. Rrit inovacionin dhe kreativitetin e punonjësve

Nëse do ti referohemi pikës së parë diversitetit kulturor, një përkufizim i saktë gjendet në Deklaratën Universale mbi Diversitetin Kulturor të UNESCO ku neni 1 dhe 2 thekson se: *“diversiteti kulturor është burim i shkëmbimit, inovacionit dhe krijimtarisë, e domosdoshme për njerëzimin, po aq sa biodiversiteti është për natyrën”* Në këtë kontekst mund të themi se politikat sociale në nivel kombëtar edhe ndërkombëtar duhet të stimulojnë edhe nxisin kohezionin social për të garantuar harmoni në ndërveprimet e njerëzve me dinamika të ndryshme kulturore. Pavarisht se Bashkimi Europian nuk ka kompetenca legjislativë në këtë fushë të gjerë të politikave, thekson se bashkimi do të "sigurojë që trashëgimia kulturore e Evropës të ruhet dhe të zgjerohet" dhe se roli i tij është të mbështesë (gjithashtu financiarisht), të plotësojë dhe të koordinojë përpjekjet e shteteve anëtare në mënyrë që të ruajë dhe respektojë diversitetin kulturor të tij.

Konkluzione

Diversiteti konsiderohet si një vlerë e shtuar në ambjentin që na rrethon. Më shumë sesa dallim ai konsiderohet një shumëllojshmëri e domosdoshme me dimensione të shumta, të tilla si: gjinia, mosha, kultura, etnia, kultura rajonale, orientimi seksual, aftësitë mendore dhe fizike, arsimit, besimi, gjuha, aftësitë e shkrimit dhe leximit, eksperiencia e punës, roli dhe statusi funksional, statusi ekonomik, statusi familjar, fusha e punësimit, vendndodhja gjeografike, metoda e punës, stili i komunikimit, metoda e të mësuarit, mënyra e të menduarit, metoda e menaxhimit, personaliteti, ideologjia, profesioni, sektori etj. Një forcë pune diverse dhe gjithëpërfshirëse është e nevojshme për të nxitur inovacionin, të forcojë kreativitetin dhe të udhëheqë strategjitë e biznesit duke i ofruar mundësi dhe shance të barabarta sidomos të rinjve të cilët janë më të prekur në aspektin e punësimit. Në kontekstin e politikave gjithëpërfshirëse kuadri ligjor në vend është në përputhje me praktikën më

të mira ndërkombëtare ku dialogu, mirëkuptimi dhe diversiteti kulturor shihen si një pasuri dhe diversiteti konceptohet si një pjesë integrale e reformave të mëtejshme evropiane.

Bibliografia

1. Anca C.; Aragon S.(2018). The 3 types of diversity that shape our identities. Harvard Business Review.
2. April K.; Shockley M. (2007). Diversity: new realities in a changing world. Palgrave Macmillan.
3. Diversity & inclusion in tech: a practical guide for entrepreneurs. (2018). Diversity VC publication.
4. Edewor A. P.; Aluko A.Y. (2007). Diversity management, challenges and opportunities in multicultural organizations, Vol 6. The international journal of diversity in organization, communities and nations.
5. International Labour Organization - Konventa 122 e Politikave të Punësimit, 1964.
6. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.
7. Promoting diversity and inclusion through workplace adjustments: a practical guide / International Labour Office. - Geneva: ILO, 2016.
8. Taylor A. (2012). Educational diversity: the subject of difference and different subjects.

TOPIC: "TYPES AND CHARACTERISTICS OF REPRESENTATION"

PhD candidate, Nurten Kala Dauti

Faculty of law, Iustinanus Primus, Skopje. IUS, Teaching assistant, Faculty of Law-Struga.
n.kala@eust.edu.mk

Abstract:

Representation is a term used in judicial administration which means: giving written consent for case representation. The subjects of the right are entitled to transfer their rights and obligations to the other person so that he or she will take the actions he / she will take as the person he / she represents.

Representation (proxy) is carried out with the consent and free will of the representee and the representative.

The law has established that certain legal actions can only be taken personally by the individual, while others may, by his own will, delegate to someone else to take on his behalf. It is also foreseen in which cases the representation is mandatory.

In the following paper we will explain some forms of representation, legal, contractual and judicial.

Kay words: representation, representative, represented, institution, legal action

Tema:” Llojet dhe karakteristikat e përfaqësimit”

Abstrakt:

Përfaqësimi termë i përdorur në drejtësi e administratë me kuptimin: dhënia me shkrim e pëlqimit për përfaqësimin e rastit. Subjektet e së drejtës kanë të drejtë që të drejtat dhe detyrimet e tyre mund të ja kalojnë personit tjetër, që ai me veprimet që do të ndërmerr do të llogariten sikur i ka marrë vetë personi të cilin ai e përfaqëson.

Përfaqësimi realizohet me pëlqimin dhe vullnetin e të përfaqësuarit dhe të përfaqësuesit.

Ligji e ka përcaktuar taksativisht që disa veprime të caktuara juridike mund të merren vetëm personalisht nga individi, ndërsa për të tjerat me vullnetin e tij mund të bartë dikujt tjetër që të ndërmerr në emër të tij. Poashtu, është paraparë se në cilat raste përfaqësimi është i detyrueshëm.

Në vijim do ti sqarojmë disa forma të përfaqësimit, atë ligjor, kontraktor dhe gjyqësor.

Fjalët kuçe : përfaqësim, përfaqësues, i përfaqësuar, institucion, veprim juridik

Hyrje

Përfaqësimi paraqitet si institucion në lëminë juridiko civile, por si institucion ka rëndësi në të drejtën procedurale dhe në degët tjera të drejtësisë. Përfaqësimi ka lindur si domosdoshmëri juridike, që subjektet e së drejtës, qoftë person fizik apo person juridik të mund të ushtrojnë dhe të ekzekutojnë si të drejtat e fituara, si titullar të të drejtave, po ashtu edhe detyrimet e marra përsipër me anën e veprimeve juridike, pra bartës së detyrimeve nga ana e veprimeve juridike të kryera ose të kryejnë veprime të tjera të ligjshme me ndihmën e një personi tjetër. Me rregull, subjektet e së drejtës civile, si të drejtat e fituara ashtu edhe detyrimet që u burojnë nga ato të drejta, i ushtrojnë dhe i përmbushin me anë të veprimeve juridike që i kryejnë drejtëpdrejtë ato vetë.

Në jetën e përditshme mund të ndodh që, për shkaqe juridike apo për shkaqe të tjera reale të ndryshme, subjekti i së drejtës qoftë person fizik apo juridik, mund të mos ketë mundësi që të kryej vetë veprimin juridik, të ushtrojë të drejtën apo të përmbush detyrimin vetë, por këtë mund ta realizojë me ndihmën e institucionit të përfaqësimit, duke autorizuar tjetrin që të verpojë në emër dhe për llogari të tij.

1. Nocioni i përfaqësimit dhe llojet e përfaqësimit

Që të kuptohet përfaqësimi dhe rëndësia e tij në të drejtën civile, është më se e nevojshme që ai fillimisht të definohet. Kur është fjala për përfaqësimin në të drejtën civile, ekzistojnë pikëpamje të ndryshme.

Zakonisht ekzistojnë dy pikëpamje në këtë drejtim. Sipas mendimit të parë, përfaqësimi është marrëdhënie juridike në të cilën një person, fizik apo juridik, kryen ndonjë punë ose veprim tjetër juridik në bazë të autorizimit për përfaqësim, në emër dhe për llogari të një subjekti tjetër, qoftë ai fizik apo juridik, nga të cilat veprime juridike zakonisht lindin të drejta dhe obligime për të përfaqësuarin.⁵⁹Në kuptimin e dytë, përfaqësimi paraqet ushtrim i punëve juridike në emër të subjektit tjetër, krej kjo në bazë të autorizimit për përfaqësim, kështu që të drejtat dhe detyrimet vërtetohen drejtëpërsëdrejti për të përfaqësuarin.⁶⁰

Në nenin 64 të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, me përfaqësimin, një person (përfaqësuesi), brenda tagrave që i janë dhënë nga ligji, nga prokura ose nga gjykata, kryen veprime juridike në emër e për llogari të një personi fizik ose juridik tjetër (i përfaqësuar).

⁵⁹ Gams, Andrija. "Hyrje në të drejtën civile (pjesa e përgjithshme)", Libraria Iversi, Universiteti i Prishtinës, 1986, fq.230

⁶⁰ Kadriu, Osman. "Hyrjenëtdrejtëncivile", TringDesing, Tetovë, 2008, fq.396

Në nenin 64, aliena e 2 thuhet: përfaqësimi nuk lejohet kur veprimi juridik, sipas ligjit, duhet të kryhet nga vetë personi.

Neni 64, alinea 3, nuk mund të veprojë si përfaqësues personi që nuk ka zotësi të plotë për të vepruar.

Pra, te përfaqësimi lindin marrëdhënie juridike ndërmjet përfaqësuesit dhe të përfaqësuarit.

Ndërsa në procedurë kontestimore sipas profesor Arsen Janevskit, përfaqësimi do të thotë kryerje të veprimeve juridike në emër të huaj dhe në llogari të huaj. Personi që kryen veprime juridike në emër dhe në llogari të personit tjetër quhet përfaqësues.

Nevoja për përfaqësim paraqitet për shkak se subjektet juridike nuk kanë përherë mundësi që vetë ti ndërmarrin veprimet juridike, qoftë për shkak se nuk kanë zotësinë e nevojshme për këtë (zotësinë e veprimit), ose për shkak të pengesës faktike për të ndërmarrë veprimet juridike. Ndonjëherë subjektet juridike edhe pse, kanë zotësi për ndërmarrje të pavarur të veprimeve juridike, dëshirojnë që këtë në emër dhe në llogari të tyre të bëjë tjetri- përfaqësuesi.⁶¹

2. Përfaqësimi kontraktor

Përfaqësimi kontraktor, bazohet në ekzistimin e kontratës e cila lidhet ndërmjet të përfaqësuarit dhe përfaqësuesit.

Nga karakteri dhe natyra juridike e përfaqësimit kontraktor buron edhe një veti e theksuar. Me themelimin e përfaqësimit kontraktor, faktikisht dhe juridikisht krijohen dy marrëdhënie civile juridike, dhe atë: 1) marrëdhënia civile ndërmjet përfaqësuesit dhe të përfaqësuarit dhe 2) marrëdhënia ndërmjet të përfaqësuarit dhe personit të tretë, person i cili është palë në një punë juridike. Prej këtyre marrëdhënieve civile juridike, padyshim se marrëdhënia ndërmjet të përfaqësuarit dhe personit të tretë, palë kontraktuese, është marrëdhënie tejet e rëndësishme.⁶²

Duke pasur parasysh përmbajtjen e tagrave të dhënë përfaqësuesit prej të përfaqësuarit, prokurat mund të përcaktohen, si:

1. Prokura e përgjithshme,
2. Prokura e posaçme.

Prokura është e përgjithshme kur I përfaqësuarit I ka dhënë përfaqësuesit tagër për të kryer veprime juridike të shumëllojshme, të cilat kanë të bëjnë me një të drejtash të të përfaqësuarit, përveç atyre që I ka përjashtuar shprehimisht. Prokura e përgjithshme është prokura për të administruar pasurinë e të përfaqësuarit etj.

⁶¹Janevski Arsen & Zoroska-Kamiloska, Tatjana. "Edrejta e procedurës civile, libri I, e drejtakontestimore. Grafičnicentar Jugoreklam- Skopje, 2009, fq.200

⁶²Kadriu, Osman. "Hyrjenët e drejtës civile", Tring Desing, Tetovë, 2008, fq.402

Prokura është e posaçme, kur I përfaqsuari I ka dhënë përfaqësuesit tagër për të kryer një ose disa veprime juridike të caktuara që karakterizohen nga një qëllim I përbashkët. Prokurë e posaçme është prokura që i jepet përfaqësuesit për të kryer një veprim juridik të caktuar, psh: për të blerë dhe për të shitur një send të caktuar, prokura për të përfaqësuar në gjykatë ,etj.⁶³

3. Përfaqësimi ligjor

Përfaqësimi ligjor është përfaqësim i paraparë nga vetë ligji. Prandaj edhe si i tillë titullohet. Përfaqësimi ligjor emërohet edhe përfaqësim i pastër ligjor. Te përfaqësimi ligjor me rëndësi të përmendet se ai përcaktohet nga vet ligji në bazë të ndonjë cilësie ndërmjet të përfaqësuarit në njërin anë, dhe përfaqësuesit, në anën tjetër. Këto cilësi fitohen prej ngjarjeve të veçanta, ngjarje të cilat paraqesin fakte relevante në krijimin, ndryshimin ose shuarjen e marrëdhënieve civilo-juridike. Një ngjarje e tillë është lindja e fëmijës. Lindja sjell deri te krijimi i raportit të përfaqësimit ndërmjet fëmijës dhe prindit. Për shkak të mospasjes së zotësisë vepruese, fëmija ka nevojë për përfaqësim. Përfaqësimi i fëmijës përkryerjen e punëve juridike bëhet nga ana e prindërve të tij.⁶⁴

Pra, me fjalë të tjera përfaqësimi i cili është përcaktuar me ligj, është përfaqësimi ligjor. Përfaqësimi është ligjor dhe përfaqësuesi e kryen përfaqësimin në bazë të dispozitave ligjore, i cili përfaqësim është edhe përfaqësim i detyrueshëm, psh: prindi është përfaqësues ligjor i fëmijës së tij të mitur.

Përveç përfaqësimit ligjor nga ana e prindërve, për të njëjtin institucion bëhet fjalë edhe kur është në pyetje përfaqësimi që bën kujdestari i përcaktuar nga ana e organit të kujdestarisë. Ky lloj i përfaqësuesit (kujdestarit) u përcaktohet fëmijëve të cilët nuk janë në përkujdesje prindërore, si dhe personave të moshës madhore të cilët për shkaqe të caktuara (zakonisht sëmundja psiqike) nuk kanë aftësi vepruese dhe kanë nevojë për përkujdesje.⁶⁵

Në nenin 72, paragrafi 1, i Ligjit për procedurë kontestimore thuhet, palën e cila nuk ka zotësi procedurale e përfaqëson përfaqësuesi i saj ligjor. Me që pala e cila është përfaqësuar nga përfaqësuesi ligjor nuk ka zotësi veprimi dhe zotësi procedurale, ose nuk është i aftë që faktikisht ti mbrojë interesat e veta, ajo vet nuk e vendos përfaqësuesin ligjor. Përfaqësuesi ligjor përcaktohet me ligj ose me akt të organit kompetent shtetëror.⁶⁶

Me përjashtim, përfaqësuesi ligjor e përfaqëson edhe palën me zotësi procedurale, nëse ajo për arsye të tjera, faktikisht nuk ka mundësi që vet ti mbrojë interesat e veta në procedurë. Përfaqësuesi ligjor është personi fizik i cili ka zotësi veprimi dhe zotësi procedurale.

⁶³Kondili, Valentina. "e drejta civile I- pjesa e përgjithshme", Geer, ribotim, 2008, fq.201

⁶⁴Kadriu, Osman. " Hyrjenëtëdrejtëncivile", TringDesing, Tetovë, 2008, fq.407

⁶⁵Kadriu, Osman. " Hyrjenëtëdrejtëncivile", TringDesing, Tetovë, 2008, fq.407

⁶⁶Gazeta zyrtare e R.M.V, Ligji për procedurë kontestimore.

Përfaqësuesit ligjor të personave fizik dhe juridik janë të përcaktuar me normat e së drejtës materiale dhe procedurale.

- a) Prindërit janë përfaqësues ligjor të fëmijëve të tyre të mitur (nei 48 LF), në punët në të cilat ata nuk kanë zotësi veprimi dhe zotësi procedurale. Në rastet kur personi i mitur nuk e ka fituar zotësinë e plotë të veprimit, por, ka zotësi procedurale në kufijtë në të cilat i njihet zotësia e veprimit (neni 71, prag3 LPK), ka mundësi që brenda atyre kufijve pavarësisht të ndërmer veprime procedurale.

E drejta prindore i takon edhe babait edhe nënës. Prindërit ushtrojnë të drejtën prindore bashkërisht dhe me marrëveshje. Prindërit kanë të drejtë të njëjtë që të përfaqësojnë fëmijët e tyre dhe janë të barabartë sa i përket përfaqësimit. Në rast të shkurorizimit ose anulimit të martesës, të drejtën prindore e ushtron vetëm prindi të cilit i është besuar fëmija në ruajtje dhe edukim. Nëse njëri nga prindërit është i vdekur ose i panjohur, ose i është hequr e drejta prindore ose zotësia e veprimit, e drejta prindore i takon prindit tjetër .

Edhe pse që të dy prindërit janë përfaqësues ligjor të fëmijëve të tyre të mitur, kjo nuk do të thotë se ata marrin pjesë në procedurë njëkohësisht si përfaqësues ligjor. Në rast të mospajtimit të prindërve lidhur me ushtrimin e së drejtës prindore, si edhe me përfaqësimin e fëmijëve të tyre të mitur vendos qendra për punë sociale (neni 76.parag. 2 LF) . kur të drejtën prindore e ushtron në mënyrë të pavarur njëri nga prindërit, atëherë ai paraqitet si përfaqësues ligjor i fëmijës në procedurë.

Parashtresat dhe deklaratat për personat e mitur mund tu dorëzohen në mënyrë të plotëfuqishme njërit ose prindit tjetër, ndërsa nëse prindërit nuk jetojnë së bashku atëherë prindit të i cili jeton fëmija (neni 49 LF).⁶⁷

- b) Adoptuesit janë përfaqësues ligjor të të adoptuarve të vet të mitur (n.113 dhe 115 LF)
- c) Kujdestari është përfaqësuesi ligjor i personit nën kujdestari. Në këtë kuptim, si përfaqësues ligjor paraqitet kujdestari i personit të mitur pa kujdes prindëror, kujdestari i personit madhor, të cilit i është hequr ose kufizuar zotësia e veprimit dhe kujdestari për raste të veçanta
- d) Qendra për punë sociale është përfaqësues ligjor i personave nën kujdestari, nëse vendos që detyrën e kujdestarit ta ushtrojë drejtpërdrejtë, nëse ja ka kufizuar autorizimet e kujdestarit dhe nëse ka vendosur që personin nën kujdestari ta përfaqësojë vetëm ajo (neni 135, paragraf.1 dhe 138 LF).⁶⁸

⁶⁷Gazetazyrtare e R.M.V. Ligjimbifamiljen.

⁶⁸JanevskiArsen&Zoroska-Kamiloska, Tatjana.“ Edrejta e procedurëscivile, libri I, e drejtakontestimore. GrafičkicentarJugoreklam- Skopje, 2009, fq.202-203

4. Përfaqësimi gjyqësor

Përfaqësimi gjyqësor është një institucion që gjen zbatim në jetën e përditshme, me një qëllim të vetëm që personat fizik dhe juridik të realizojnë mbrojtjen e tyre gjatë gjykimit të kontesteve, për të cilat përpara gjykatës është inicuar procedurë për shqyrtim. Ata mund të paraqiten në procesin gjyqësor në cilësi të paditësit, të paditurit apo person i tretë.

Përfaqësimi gjyqësor, është më se e logjikshme se vendimin për këtë lloj të përfaqësimit e sjell vetë gjykata para së cilës zhvillohet një procedurë e caktuar, kontestimore ose jashtkontestimore. E drejta jonë pozitive në mënyrë taksative i rregullon rastet e përfaqësimit gjyqësor. Të tilla janë përshembull, në kontestet e mohimit ose vërtetimit të atësisë ose amësisë, gjykata sipas detyrës zyrtare i përcakton fëmijës përfaqësues gjyqësor. Ky lloj i përfaqësimit emërohet si përfaqësues i kolezionit. Kjo nga vetë fakti se interesat ndërmjet prindit dhe fëmijës janë në kolozion, prandaj ka nevojë që fëmija të përfaqësohet nga personi tjetër e jo nga prindi, i cili është zakonisht përfaqësues ligjor i fëmijës. Rasti tjetër është në procedurën e zbrërthimit të trashëgimisë, për trashëgimitarin për të cilin gjykata nuk ka të dhëna për vendbanimin ose vendqëndrimin e tij. Përfaqësuesi gjyqësor i këtij personi i përcaktohet me qëllim të mbrojtjes së interesave të tij në procedurën trashëgimore. Rasti i tretë ka të bëjë me përcaktimin e përfaqësuesit gjyqësor për mbrojtjen e interesave të fëmijës së zënë, por ako i palindur, për realizimin e të drejtave konkrete në procedurat përkatëse gjyqësore. Si rastë i veçantë numerohet edhe ai që ka të bëjë me një person të vdekur i cili nuk ka trashëgimtarë, kurse personat që kanë interes juridik, inicojnë procedurë për vërtetimin e atësisë pas vdekjes së fëmijës.⁶⁹

Likuiduesit e personave juridik, punën e të cilëve e ka ndaluar organi kompetent, respektivisht administratorët e falimentimit të personave ndaj të cilëve është hapur procedura e falimentimit dhe të cilët me këtë e humbin zotësinë procedurale, janë përfaqësues ligjor sui generis të atyre personave.

Përfaqësuesi i përkohshëm dhe përfaqësuesi i përkohshëm për pranimin e shkresave janë përfaqësues ligjor, të cilët i cakton gjykata kontestimore në kuptimin e dispozitave të LPK.⁷⁰

Gjykata do të përcaktojë të paditurit përfaqësues të përkohshëm, veçanërisht nëse: 1) i padituri nuk ka zotësi procedurale, ndërkohë që nuk ka as përfaqësues ligjor; 2) ekzistojnë interesa të kundërta ndërmjet të paditurit dhe përfaqësuesit të tij ligjor; 3) që të dyja palët kanë përfaqësues të njëjtë; 4) vendqëndrimi i të paditurit është i panjohur, ndërsa i padituri nuk ka përfaqësues me prokur;

⁶⁹Kadriu, Osman. "Hyrjenëtdrejtëncivile", TringDesing, Tetovë, 2008, fq.407

⁷⁰JanevskiArsen&Zoroska-Kamiloska, Tatjana." Edrejta e procedurëscivile, libri I, e drejtakontestimore. GrafičkicentarJugoreklam- Skopje, 2009, fq. 203

5) i padituri ose përfaqësuesi i tij ligjor, të cilët nuk kanë përfaqësues me prokurë në Republikën e Maqedonisë, ndodhen jashtë shtetit ndërsa dorzimi nuk ka mundur të realizohet. (neni 76, paragr. 2 LPK).

Sipas LPK, gjykata përcakton përfaqësues të përkohshëm për pranimin e shkresave në dyraste:

a) kur pala ose përfaqësuesi i saj ligjor ndodhen jashtë shtetit, ndërsa nuk kanë përfaqësues me prokurë në Republikën e Maqedonisë, gjykata do të thërrasë që brenda afatit të kuptueshëm të vendosin përfaqësues për pranimin e shkresave në Republikën e Maqedonisë. Nëse pala ose përfaqësuesi i saj ligjor nuk përcaktojnë përfaqësues të tillë, gjykata emëron përfaqësues të përkohshëm për pranimin e shkresave, me shpenzime të palës dhe për këtë menjëherë e lajmëron palën, respektivisht përfaqësuesin e saj ligjor.

b) nëse më tepër persona padisin bashkarisht (bashkëndërgjyqësit aktiv), ndërsa nuk kanë përfaqësues ligjor të përbashkët, respektivisht përfaqësues me prokurë, gjykata mund të thërrasë që brenda afatit të caktuar të emërojnë përfaqësues të përbashkët për pranimin e shkresave.⁷¹

5. Shuarja e përfaqësimit

Përfaqësimi është punë juridike e veçantë. Përfaqësimi i lidhur apo i krijuar ndërmjet subjekteve të së drejtës mund edhe të shuhet.

Prokura përdoret për të kryer veprime juridike të caktuara në një afat të caktuar dhe në rrethana të caktuara. Me vërtetimin e këtyre rrethanave prokura mbaron.

Në nenin 76 të kodit civil të R.së Shqipërisë, përcaktohet se prokura mbaron në këto raste: përfaqësuesi ka kryer veprimet juridike për të cilat ajo i ishte dhënë; është plotësuar afati për të cilin ishte dhënë; ka vdekur përfaqësuesi apo i përfaqësuar, ose njëri nga ata e ka humbur zotësinë vepruese; ka mbaruar personi juridik përfaqësues apo i përfaqësuar; dhe i përfaqësuar e ka shfuqizuar prokurën ose përfaqësuesi ka hequr dorë prej saj.

Rast tjetër dhe i rëndomtë i shuarjes së përfaqësimit është me kryerjen e obligimeve të përfaqësuesit ndaj të përfaqësuarit, e kjo ndodh më shpesh kur përfaqësuesi lidh punën juridike me personin e tretë, lidhje që ka qenë obligimi i tij i kryesor. Me lidhjen e punës juridike, natyrisht nëse përfaqësuesi ka qenë i obliguar vetëm për një punë juridike dhe për lidhjen e saj, përfundon edhe vetë

⁷¹JanevskiArsen&Zoroska-Kamiloska, Tatjana.“ Edrejta e procedurëscivile, libri I, e drejtakontestimore. GrafičnicentarJugoreklam- Skopje, 2009, fq. 205-206

përfaqësimi. Në të gjitha ato raste kur përfaqësimi lidhet në kohë të caktuar, me skadimin e kohës ai do të pushon. Sa raste të veçanta të shuarjes së përfaqësimit janë edhe rastet e humbjes së zotësisë vepruese të përfaqësuesit ose të të përfaqësuarit.⁷²

Revokimi është bazë e veçantë juridike e shuarjes së përfaqësimit. Kjo bëhet me deklaram të njëanshëm të vullnetit të përfaqësuarit (pushtetdhënësit), deklaram i cili mund të ushtrohet me gojë, me shkrim ose në procesverbal përpara gjykatës. Shuarja e përfaqësimit mund të ndodh edhe me denoncim nga ana e përfaqësuesit për shkaqe të ndryshme.⁷³

Shuarja e përfaqësimit mund të bëhet edhe kur humbet besimi. Shfuqizimi i përfaqësimit mund të bëhet me çdo formë. Mirëpo, po pranohet mendimi se shfuqizimi dhe heqja dorë nga prokura duhet ti përgjigjet formës së kërkuar ligjore për përpilimin e saj.

Përfundimi

Me përfaqësimin një person (përfaqësuesi) kryen, brenda tagreve që i janë dhënë nga ligji, nga prokura ose nga gjykata, veprime juridike në emër e për llogari të një personi fizik ose juridik tjetër (i përfaqësuar). Përfaqësimi nuk lejohet kur veprimi juridik duhet, sipas ligjit, të kryhet nga vetë personi. Nuk mund të veprojë si përfaqësues personi që nuk ka zotësi të plotë për të vepruar.

Te përfaqësimi ligjor targat janë përcaktuar në dispozitat ligjore që ja japin këtë cilësi, ndërsa te autorizimi i përcakton vet i përfaqësuarit.

Përfaqësuesi obligohet të përfaqësojë vet dhe jo të emërojë ndonjë person tjetër, përveç në rastet kur ka dhënë pëlqim i përfaqësuarit, për shkak se objekti ndodhet në ndonjë territor tjetër, ose nënprokura e tillë jepet me qëllim të mbrojtjes së interesit të të përfaqësuarit.

Prokura bëhet gjithmonë me shkresë. Çdo prokurë për të lidhur një kontratë, e cila sipas ligjit mund të bëhet vetëm me akt noterial, duhet të përpilohet në këtë formë, përndryshe është e pavlefshme. Edhe prokura për kryerjen e veprimeve para gjykatave dhe institucioneve të tjera shtetërore, duhet të bëhet me akt noterial, përveç kur me dispozita ligjore lejohet që ajo të bëhet me shkresë të thjeshtë. Prokura në emër të personave juridikë publikë e privatë mund të bëhet edhe vetëm me nënshkrimin e drejtuesit të tij dhe me vulën përkatëse, përveç kur ligji kërkon që veprimi juridik të kryhet me akt noterial.

Të gjitha llojet e përfaqësimit, qoftë ai ligjor, kontraktor apo gjyqësor, me përfundimin e veprimit juridik për të cilën është dhënë, ai shuhet.

⁷²Kadriu, Osman. " Hyrjenëtdrejtëncivile", TringDesing, Tetovë, 2008, fq.411

⁷³Po aty

Te përfaqësimi i personave madhor të cilët për shkak se janë të pa zotë për të vepruar, e drejta e përfaqësimit ligjor shuhet me fitmin e zotësisë për të vepruar, nëse nuk ka mundësi të tillë (për shkak të pjekurisë mendore) atëherë ky përfaqësim përfundon me vdekjen e përfaqësuesit ose të përfaqësuarit.

Literatura

1. Kondili, Valentina.” E drejta civile, pjesa e përgjithshme”, GEER 2008, ribotim,2008
2. Gams, Andrija. “ hyrje në të drejtën civile (pjesa e përgjithshme)”, Libraria Iversi, Universiteti i Prishtinës, 1986
3. Aliu, Abdulla. “ e Drejta civile pjesa e pergjithshme” ,2014
4. Kadriu, Osman. “ Hyrje në të drejtën civile” , Tring Desing, Tetovë, 2008
5. Janevski Arsen& Zoroska-Kamiloska, Tatjana. “ E drejta e procedurës civile, libri I, e drejta kontestimore. Grafički centar Jugoreklam- Skopje, 2009
6. Zhivkovska, Rodna. “ Gragjansko pravo, opsht del”, Skopje,2011
7. Nuhiu, Agim &Qato, Merita. “ Procedura civile kontestimore”, Tetovë, 2016 (ligjerata të autorizuara)
8. Gazeta zyrtare e R.M.V, Ligji për procedurë kontestimore.
9. Gazeta zyrtare e R.M.V., Ligji mbi familjen.
10. Kodi civil i Republikës së Shqipërisë

QUO VADIS? SFIDAT E SHTETEVE TË BALLKANIT PERËNDIMOR NË RRUGËN DREJT BE-SË GJATË FILLIMSHEKULLIT XXI

Lumnis Çela, PhD.c.

Universiteti “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan, Shqipëri; lumniscela@yahoo.com

Abstrakt:

Në Ballkanin Perëndimor të fillimshekullit XXI, rrugëtimi integrues drejt BE-së është karakterizuar nga një ndërthurje situatash dhe zhvillimesh sa komplekse aq edhe dinamike. *Nga njëra anë ky rajon dominohet nga prania e një sërë tiparesh të brendshme si: hallkat e pakonsoliduara institucionale shtetërore, mungesa e dakordësisë për shumë çështje të akumuluarra fqinjësie, eksperiencia demokratike e kufizuar, brishtësia e spikatur ekonomike, etj., ndërkohë që nga ana tjetër rëndom shfaqet një atmosferë rrethuese sa e luhatshme aq edhe kritike europiane që lidhet me simptomat e aty-këtushme të: lëkundjes së stabilitetit politiko-shoqëror, krizës sporadike të treguesve ekonomiko-financiarë, divorcit prej anëtarësisë 28-vendëshe, konkurrencës gjeo-strategjike etj. Në këtë kontekst, ky punim synon që të vështrojë dhe analizojë më nga afër specifikat e udhëtimit të vështirë integrues me të cilat është duke u përballur Ballkani Perëndimor i viteve të fundit, ku ndërthuren dhe ndërvaren një mozaik aktorësh dhe faktorësh si të brendshëm ashtu edhe të jashtëm, që diktojnë drejtpërdrejt ose tërthorazi në ritmin dhe cilësinë e rrugës sfiduese drejt Bashkimit European. Për sa kohë që elementë të problematikave të sipërpërmendura vijnë që të shfaqen, rikthehen, apo mbeten prezent tek të dyja palët respektive, BP dhe BE, atëherë pikëpyetja më e madhe prej nga nxitet edhe ky punim, ka të bëjë me parashtrimin dhe argumentimin e atyre dilemave ndikuese dhe diktuese në trajektoren dinamike të integrimit.*

Fjalët çelës: Ballkani Perëndimor (BP), Bashkimi European (BE), integrimi, sfidat.

Hyrje

Qysh pas përfundimit të konflikteve të armatosura në Ballkanin Perëndimor *post* ‘90-të, politikat respektive demokratizuese, integruese dhe europeanizuese të shekullit XXI kanë lundruar midis prioriteteve afatshkurtra me karakter stabilizues dhe atyre afatgjata me karakter reformues. Nëse do t’i kushtojmë pak më shumë vëmendje sfidave që janë hasur në BP, nuk është çudi të konstatojmë se një pjesë e konsiderueshme e tyre nuk lidhen drejtpërsëdrejti *as* me të ashtuquajturat Kriteria të Kopenhagen-it (që janë kushtet thelbësore për anëtarësimin e çdo kandidati të mundshëm brenda Bashkimit European) *dhe as* me gamën ligjore të BE-së (e njohur botërisht si *acquis communautaire*

dhe e detyrueshme për adoptim prej çdo vendi aspirant). Në fakt, shumë prej këtyre sfidave janë sa specifike aq edhe të ndryshme në krahasim me eksperiencat e mëparshme gjatë zgjerimeve të Unionit. Thënë këtë, klasifikimi i tyre më dysh do na ndihmonte të qartësonim më shumë jo vetëm tablonë ekzistuese të çështjeve me të cilat po përballen shtetet e BP në rrugën drejt BE, por pse jo edhe alternativat e mundshme për shmangien dhe/ose kapërcimin e tyre.

Në këtë kuadër, pa mohuar apo nënvleftësuar asnjë prej shkaqeve të shumta që ndikojnë drejtpërdrejt ose tërthorazi në cilësinë, ritmin, trajektoren dhe specifikat e integritit europian të Ballkanit Perëndimor, ky punim është fokusuar në disa prej atyre problematikave tipike të këtij rajoni të brishtë që gëlon prej ndikimit të një sërë aktorëve dhe faktorëve të sojit ballkanik, europian, por dhe më gjerë. Kësisoj, përmes përzgjedhjes dhe shenjimit të drejtpërdrejtë të disa çështjeve sa të prekshme aq edhe të ndjeshme konkrete, punimi tenton të hedhë më shumë dritë mbi pikëpyetjet dhe dilemat e përbashkëta me të cilat vijojnë të ballafaqohen 6 vendet e fundit të paintegruara të Ballkanit Perëndimor, në rrugën e tyre sfiduese drejt BE-së. Thënë këtë, gjysma e parë e punimit i referohet atyre problemeve të *mjedisit të brendshëm* që janë hasur në rajonin ballkanik në tërësi gjatë viteve të fundit, ndërkohë që gjysma e dytë ka të bëjë me ato *rrethana specifike të jashtme* që janë duke influencuar ndjeshëm ritmin dhe trajektoren e proceseve integruese euro-(atlantike) të rajonit në fjalë.

Konteksti i brendshëm i Ballkanit Perëndimor nën optikën e integritit europian

Përsa i përket çështjeve me të cilat vijojnë të përballen prej kohësh vendet e BP-së në përgjithësi, vlen për të nënvizuar se niveli i çalë e i pamjaftueshëm i sundimit të ligjit dhe qeverisjes kryesojnë listën e problematikave të hasura në shkallë të ndryshme brenda këtij rajoni. Ndonëse nuk duhet harruar se legjislacioni *de jure* i adoptuar gjatë harkut kohor të shekullit të ri është karakterizuar nga një cilësi relativisht pozitive, përsëri ekzistojnë boshllëqe mbi zbatueshmërinë e tij *de facto* përsa kohë që hallkat e drejtësisë vuajnë nga mungesa e efikasitetit dhe/ose e pavarësisë. Kështu, nënshtrimi ndaj ndikimeve ekstra-institucionale politike, prania e akteve korruptive, mungesa e transparencës ligjore, pandëshkueshmëria, klientelizmi i përhapur, partitizmi i kalçifikuar i institucioneve, përballja e kufizuar me krimin e organizuar, pamjaftueshmëria e lirisë së shprehjes dhe asaj të medias etj. (O'Brennan, 2018, f. 4), dëshmojnë bashkarisht se cilësia e ligjshmërisë, qeverisjes dhe demokracisë vijon që të ketë akoma nevojë dhe vend për përmirësim.

Përderisa këto karakteristika të tejzgjatura në kohë përbëjnë thelbin e sfidave të brendshme të pazgjidhura të BP-së, atëherë edhe qasja e BE-së ndaj kësaj situatë ka tentuar drejt shtrëngimit të “parimit të kushtëzimit” si dhe theksimit të “çështjeve prioritare”. Në këtë kuptim, strategjia e iniciuar qysh prej vitit 2012 e në vazhdim, ka parashikuar adresimin e drejtpërdrejtë dhe të pandërprerë të atyre problematikave që lidhen me fushën e gjyqësorit dhe të drejtave themelore, ashtu sikurse dhe me drejtësinë, lirinë dhe sigurinë. Kështu, nga njëra anë përsa i takon shembujve të Malit të Zi dhe

Serbisë që vijojnë me fazën e negociatave që prej vitit 2012 dhe 2014 respektivisht, *Kapitujt 23 dhe 24* kanë qenë jo vetëm ndër të parët e hapur, por edhe ndër të fundit për t'u mbyllur në këtë negociim (Zelyazkova, 2019, *et.al.*, f. 24). Nga ana tjetër, e njëjta linjë veprimi do të ndiqej prej KE-së edhe përmes ndërmarrjes së *Dialogut të Strukturuar* me Bosnje-Herzegovinën mbi pavarësinë e gjyqësorit (European Commission (a), 2015), e me Kosovën për sundimin e ligjit (Kmezic, 2015, f. 13), ashtu sikurse ka ndodhur dhe me Shqipërinë e Maqedoninë [e Veriut] në kuadrin e *Dialogut të Nivelit të Lartë* mbi prioritetet kyçe të fushës në fjalë (European Commission (b), 2016). Në thelb, ndjekja e një qasjeje të tillë ka synuar jo vetëm dhënien e kohës maksimale të mundshme për krijimin e legjislacionit të nevojshëm dhe institucioneve të qëndrueshme për suksesin e procesit të negociatave me 2 vendet paraprijëse të përmendura më lart, por ka shërbyer edhe si një mekanizëm ndihme për 4 vendet e tjera më të ngadalta, që ndonëse nuk po negocionin fazën e anëtarësimit në BE, duhet të vijonin pa mëdyshje në rrugën drejt saj.

Në Ballkanin Perëndimor, Unioni ka treguar dhe më parë sesi shfrytëzimi i parimit të kushtëzimit ka mundur që t'ia dalë mbanë, përderisa Kroacia dhe Serbia u detyruan që të bashkëpunojnë me Gjykatën Ndërkombëtare për Krimet në ish-Jugosllavi, për hir të ecurisë së integritetit të tyre europian. Kësisoj, një mekanizëm i tillë nuk është habi që të funksionojë edhe në vazhdimësi për sa kohë që “detyrimet” ballkanike do të balancohen nga “shpërblimet” europiane. Nga njëra anë, modeli i suksesshëm i Kroacisë na dëshmon sesi *perspektiva e besueshme* e anëtarësimit të saj në Union mundësoi arritjen e një konsensusi të gjerë mes aktorëve politikë, ekonomikë dhe shoqërorë për të zbatuar reformat e sundimit të ligjit të dakordësuara në Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit, ndërkohë që nga ana tjetër, edhe liberalizimi i vizave në rajon shërben si një shembull i mirë për mekanizmat e *presionit të butë* që BE ka dhe mund të vërë akoma më shumë në dispozicion. Në këtë kontekst, ndjekja e praktikës së transformimit përpara anëtarësimit ka bërë që modeli normativ i BE-së të shndërrohet automatikisht në një domosdoshmëri, ku oferta paraprake institucionalizuese përvijuar më pas nga ajo anëtarësuese do shërbente si një stimul i fortë për mbajtjen e shteteve të Ballkanit Perëndimor brenda orbitës së Unionit (Abazi, 2008, f. 240).

Pavarësisht kësaj, ekzistojnë jo pak pikëpyetje dhe dyshime mbi kapacitetet dhe vullnetin real për integrim, për sa kohë që gjendet një hendek i konsiderueshëm midis angazhimeve të ndërmarrura *formalisht* dhe zbatueshmërisë së tyre *praktikisht*. Në fakt, një qasje e tillë e dyzuar brenda vendeve të BP-së ngjason me shembujt e dikurshëm të Bullgarisë dhe Rumanisë ku aktorët politikë shfaqnin një përkushtim retorik ndaj adoptimit të normave të Bashkimit Europian, ndërkohë që qeverisnin përmes rrjeteve klienteliste informale në terren (Cabada, 2013, f. 38, 42; O'Brennan, 2018, f. 4). Për të shmangur kalçifikimin e një skenari të tillë, do ishte e nevojshme që mekanizmi i kushtëzimit të bënte një ndërthurje më të qartë dhe më të shpeshtë midis përdorimit të “shkopit” për ndërmarrjen dhe zbatimin e reformave të vështira dhe ofrimit të “karrotës” për legjitimimin e procesit dhe rezultatit të

tyre, por njëkohësisht të tregonte edhe pak më shumë origjinalitet për zhbllokimin e çdo pengese të mundshme, pasi kjo do të ishte mënyra më e mirë për të kompensuar besueshmërinë e ulët që ekziston në BP lidhur me anëtarësimin e tij të shpejtë në Union.

Përkrah problematikave përmendur më lart, Ballkanit Perëndimor nuk i kanë munguar as rastet specifike të pa krahasueshme me më parë si psh., statusi i pazgjidhur i sovranitetit të Kosovës, ngërçi federativ në Bosnje-Herzegovinë, apo dilema shumëvjeçare për emrin kushtetues të Maqedonisë (së Veriut, qysh prej Shkurtit 2019). Aktualisht, ky rajon vijon që të përballet me situata të herëpashershme kontestuese për çështje të tilla si: konfigurimi i kufijve territorialë, e drejta e shtetësisë së grupimeve të caktuara, pretendimet mbi identitetin kombëtar, përpjekjet për shkëputje, apo përplasjet me sfond etnik. Pa dashur të futemi më thellë në histori, strategjia për gjetjen e kompromisit qëndron në themel të qëndrimeve të BE-së, e cila e ka kushtëzuar ecurinë e hapave të anëtarësimit me gjetjen e zgjidhjeve respektive. Shembulli i Kosovës dhe Serbisë që kanë pranuar të përpiqen për normalizimin e marrëdhënieve të përbashkëta *me negociata*, për hir të ecurisë së integritit europian; adoptimi i marrëveshjes së gushtit 2015 për krijimin e *Asosacionit të komunave Serbe* në Kosovë (Teokarević, 2016, f. 12); ndërmarrja dhe dakordësimi i çështjes së *demarkacionit kufitar* mes Malit të Zi dhe Kosovës gjatë harkut kohor 2013-2018 (Bakota, 2018); *firmosja e Marrëveshjes së Prespës* mes Maqedonisë dhe Greqisë në qershor 2018 për zgjidhjen e emrit kushtetues; etj. dëshmojnë se nevoja për bashkëpunim ndër-shtetëror mes fqinjëve apo brenda-shtetëror mes grupimeve në BP është një prej kritereve përcaktuese të ecurisë apo ngecjes së projektit europianizues në rajon. Kësisoj, çdo vonesë apo devijim i mundshëm ballkanas nga trajektorja e parashikuar për adresimin e çështjeve të mësipërme por jo vetëm, parakupton aktivizimin e mekanizmave frenues europianë mbi ecurinë vijuese të integritit.

Parë nga ky këndvështrim, harmonizimi dhe bashkërendimi i këmbënguljes diplomatike të udhëheqësve europianë me vullnetin dhe iniciativën politike të udhëheqësve rajonalë ka bërë të mundur që gjeste të tilla të spikatura si: – përafrimi mbresëlënës i kryeministrit serb Vučić dhe atij shqiptar Rama përmes takimit të nëntorit 2014 në Beograd; vizita e 3 bashkë-presidentëve bosnje-herzegovinas në Beograd në 2014-n dhe reciprociteti i demonstruar prej Vučić gjatë përkujtimores në Srebrenicë në 2015-n; angazhimi i liderëve ballkanikë në Forumin e Vjenës në vitin 2015 për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve me negociata; keqardhja e presidentit boshnjak Bakir Izetbegović në qershor 2016 për martirizimin e serbëve në Kazami të Sarajevës; firmosja e Traktatit të Miqësisë mes Maqedonisë dhe Bullgarisë në gusht të 2017-s; (Mirel, 2018, f. 8) e të tjera si këto, – në tërësi të dëshmojnë se fryma e pajtimit të ngushtë brenda Ballkanit Perëndimor mund të bëhet realitet e të zërë vend brenda kontureve më të gjera *pan-europizuese*.

Përtej kësaj panorame optimiste që meriton padyshim një vlerësim pozitiv, vlen për t'u nënvizuar se nevoja për stabilitet rajonal nuk duhet që të dominojë mbi nevojën për demokraci të brendshme,

gjithsesi. Dështimi në ndërtimin e institucioneve të depolitizuara dhe prania e polarizimit të theksuar politik, ka treguar shenja përkeqësimi gjatë dekadës së fundit në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni të Veriut dhe Mal të Zi. Rastet e sulmeve të dhunshme ndaj deputetëve edhe brenda në parlament (siç kulmoi në Maqedoni), përdorimi i gazit lotsjellës gjatë seancave kuvenduese (të herëpashershme në Kosovë), bojkotet parlamentare periodike të partive opozitare (në Shqipëri e Mal të Zi), apo bllokatat legjislative mes qeverive dhe opozitave (të vendeve respektive në përgjithësi), janë dëshmia më e qartë e kontradiktave me të cilat vijnë të përballen aspirantët europeistë të BP-së. Në këtë kontekst, preferenca e BE-së për 'stabilitokraci' të jashtme në kurriz të 'demokracisë' së brendshme nuk duhet që të zërë vend gjithsesi (O'Brennan, 2018, f. 4), për sa kohë që ajo mund të prodhojë pakënaqësi, kaos politik, pasiguri, radikalizim politik dhe mungesë qëndrueshmërie në këto vende.

Është e vërtetë që stabilitokracia i *mundëson Perëndimit që t'i qëndrojë besnikërisht retorikës së tij* të promovimit të demokracisë, zgjedhjeve të lira, të drejta, e transparente, gjyqësorit të pavarur, parlamentit të fortë, sundimit të ligjit, mbrojtjes së të drejtave të njeriut, si dhe nevojës për të luftuar kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. Por në të njëjtën kohë, ajo i *mundëson dhe partnerëve lokalë ballkanikë që të krijojnë një demokraci fasadë* përmes zvogëlimit të rolit parlamentar, mbajtjes së zgjedhjeve të padrejta, kriminalizimit të arenës së brendshme politike, pretendimit për fuqi diktatoriale, miratimit të ligjeve grabitqare që synojnë eliminimin e konkurrencës politike, mbytjes së frymës së mospajtit, si dhe plaçkitjes së burimeve të vendit në favor të udhëheqësve politikë dhe bashkëpunëtorëve të tyre më të afërt (Pavolvić, 2017, f. 2). Në këtë kuptim, për sa kohë që të dy palët në fjalë nuk do të lehtësonin me përgjegjshmëri të barabartë barrën e mospërputhjes së lartpërmendur mes retorikës së jashtme perëndimore dhe realitetit të brendshëm ballkanik, atëherë kjo do të shkaktoje jo pak zhgënjim ndaj projektit të integritit evropian, që në tërësi ka humbur jo pak kohë gjatë rrugëtimit të vet për kurorëzim.

Përkrah tablosë së problematikave të lartpërmendura të karakterit politik dhe shoqëror, Ballkanit Perëndimor nuk i ka munguar as përballja sfiduese me realitetin e lëkundshëm ekonomik. Nga njëra anë, rajoni ka mundur që të integrohet me hapa pozitivë në tregti, energji, transport, dhe telekomunikacion (Minić, 2016, f. 5), ndërkohë që nga ana tjetër lë akoma shumë për të dëshiruar në eksporte, papunësi, investime të huaja, borxh publik dhe deficit buxhetor (Teokarević, 2016, f. 11). Kriza ekonomike globale filluar në vitin 2008-2009, i gjeti të papregatitur vendet e rajonit në fjalë, të cilët shënuan një periudhë recesioni ose stanjacioni të gjatë që vetëm vitet e fundit po tregojnë një rimëkëmbje të saj (Uvalić & Cvijanović, 2018, f. 1). Në kuadrin e eksperiencave të nxjerra prej krizës greke në BE, në prill 2014 Unioni prezantoi një paketë të re kriteresh lidhur me anëtarësimin e vendeve të Ballkanit Perëndimor, që synonte marrjen e masave mbi qeverisjen ekonomike, kontrollin e borxheve dhe të deficitit buxhetor përmes dorëzimit të programeve përkatëse (për reformat dhe konkurrencën) ekonomike paraprakisht në Union. Ndonëse këto masa janë ende të reja dhe me një

ndikim të kufizuar në rajon, ato synojnë shmangien e papërgjegjshmërive qeverisëse dhe ndërtimin e një efijense ekonomike. Në këtë kuptim, përderisa në të shkuarën problemet ekonomike kanë qenë gjithmonë në hije të çështjeve politike, hedhja e një hapi të tillë prej BE-së dëshmon mbi rëndësinë e madhe që paraqet perspektiva ekonomike lidhur me të ardhmen europiane të 6 vendeve ballkanike.

Edhe pse politikat e BE-së kanë shërbyer për lehtësimin e rimëkëmbjes ekonomike në Ballkanin Perëndimor, gjithsesi vlen për t'u theksuar se në këndvështrimin e mirëfilltë zhvillimor, 6 vendet përkatëse të rajonit në fjalë vijojnë që të mbeten në rreth 30% të mesatares së Bashkimit Europian (Romei, 2018). Aktualisht, ato *nuk* konsiderohen akoma si ekonomi të mirëfillta funksionale tregu që të mund të përballonin me sukses konkurrencën brenda BE-së. Thënë këtë, edhe në rast të një rritjeje ekonomike që do ta tejkalonte mesataren e vendeve aktuale europiane, Ballkanit Perëndimor do t'i duheshin ende rreth 15-20 vjet për të mbërritur në mesataren e tyre (O'Brennan, 2018, f. 7-8). Kësisoj, domosdoshmëria për ta zhvilluar më tej ekonominë e brishtë ballkanase mbi një trase *jo fort* të sigurtë e të qëndrueshme, – falë kapaciteteve të ulta shtetërore, burokracisë dekurajuese për investime, trashëgimisë së dobët të mirëqenies së brendshme, etj. – natyrshëm që nuk do ta bëjë aspak të lehtë dhe të shpejtë arritjen e objektivave të dëshiruara edhe në rast zbatimi rigoroz të politikave integruese respektive.

Vështrim analitik mbi kontekstin e jashtëm karshi Ballkanit Perëndimor

Ndërsa anëtarësimi i mundshëm në strukturat e përbashkëta europiane pritet që t'i japë përgjigje problematikave të tejzgjatura të fragmentarizimit të spikatur ballkanik, ekzistojnë edhe disa arsye të jashtme që vijojnë të ngjallin jo pak shqetësim. Duke pasur parasysh natyrën e çështjeve të sektorit të gjeo-politikës në tërësi, arritja e pikëtakimeve dhe përputhshmërisë kërkon jo vetëm kohë dhe përkushtim nga ana e vendeve ballkanike, por gjithashtu edhe mbështetje të vazhdueshme dhe të vendosur nga ana e BE-së, së cilës nuk i mungojnë as problemet e saj. Kështu, gjatë viteve të fundit Unioni është gjendur vazhdimisht në një situatë kritike, pasi *nga njëra anë* i është dashur që të vendosë kushte të vazhdueshme sa të përgjithshme aq edhe specifike ndaj çdo vendi aspirant ballkanik që kërkon të bëhet pjesë e këtij forumi përbashkues, ndërkohë që *nga ana tjetër* BE po përballon njëkohësisht edhe me shumë sfida të tjera të brendshme tipike lidhur me konsolidimin e ardhmërisë së anëtarësisë së vet ekzistuese.

Kështu, ngurrimi ndaj përshpejtimit të zgjerimit të BE-së konstatuar rreth një dekadë më parë, ka shënuar një kurbë shqetësuese ngjitjeje me luhatje të herëpashershme të saj. Ekzistojnë shpjegime të ndryshme lidhur me një konstatim të tillë, që pikë së pari ka të bëjë me merakun e përbashkët europian mbi kontekstin e brishtë ekonomik të evidentuar në disa prej shteteve të “vjetra” anëtare (si psh. Greqia, Irlanda, Portugalia, Spanja), që hasën jo pak probleme gjatë dekadës në fjalë (Nugent, 2018, f. 55). Në përgjithësi, edhe pse politikat e Unionit kanë shërbyer për lehtësimin e rimëkëmbjes

ekonomike ballkanike, rritja e bashkëpunimit mes tyre ka bërë që ekonomitë e 6 vendeve respektive të BP-së të jenë gjithnjë e më të prekshme prej efekteve të jashtme, duke bërë që në periudha begatie boshti qëndror europian të eksportojë mirëqenie drejt periferisë së vet në Ballkan, ndërkohë që në periudha krize të eksportojë edhe paqëndrueshmëri (Bechev, 2012, f. 1).

Ndërkohë, përsa i takon çështjes që lidhet me menaxhimin e krizës së emigrantëve dhe refugjatëve, BE dëshmoi jo pak anomali dhe divergjenca në qëndrimet e veta të brendshme përderisa shumë prej shteteve të saj anëtare (si psh. grupi i Visegradit) treguan mungesë të theksuar solidariteti dhe aq më pak uniteti (Ibid, f. 58). Vetë Presidenti i KE, Junker në shtator 2016 do shprehej për një mungesë të paparë bashkimi brenda vendeve anëtare, udhëheqësit e të cilëve flasin vetëm për problemet e shteteve të tyre, ndërkohë që i përmendin veç kalimthi ato europiane (European Commission (c), 2016). Në të vërtetë, menaxhimi i qindramijëra emigrantëve dhe refugjatëve, koordinimi i transportit dhe ndihmës humanitare të të cilëve përfshiu dhe vendet ballkanike gjatë krizës 2015-2016, praktikisht dëshmoi se kur bëhet fjalë për probleme madhore *pan-europiane*, nuk ka dhe nuk duhet që të ketë diferencë mes vendeve që janë apo jo anëtare (Teokarević, 2016, f. 14-15). Një situatë e tillë ngre pyetjen retorike sesi duhet mbrojtur dhe forcuar projekti i përbashkët europian për sa kohë që ka pamjaftueshmëri energjish dhe udhëheqësish për të përmbushur *finalite Europeen*, e cila në thelb nuk ka të bëjë me pamjen e jashtme në tërësi, por me përballimin e sfidave të ndryshme që shfaqen në vazhdimësi.

Në një kohë që klima e zgjerimit është karakterizuar nga tipare paqëndrueshmërie përgjatë viteve të fundit, është me interes të nënvizojmë se në shumë vende të Bashkimit Europian është konstatuar gjithashtu një rritje domethënëse e mbështetjes për segmente dhe parti politike populiste e/ose nacionaliste. Këto formacione shpeshherë etiketohen me të drejtë si "euroskeptike", për sa kohë që aty ushqehen dhe rrezatohen shqetësime lidhur me volumin e konsiderueshëm të sovranitetit kombëtar që është transferuar sistematikisht prej vendeve anëtare drejt kryeqytetit europian. Ndonëse në thelbin e vet këto qëndrime nuk përbëjnë një fenomen krejtësisht i ri për Unionin, rritja graduale e mbështetjes së tyre është një përgjigje domethënëse kundrejt vështirësive ekonomike të Europës, masave shtrënguese respektive si dhe krizës së eurozonës (Archick, 2018, f. 7; Hix, 2018, f. 74). Për disa votues jo të paktë europianë, trajtimi tipik *alla-brukselian* i rasteve si kriza e disa vendeve të eurozonës, do të çonte në ringjalljen e shqetësimeve mbi deficitin e theksuar demokratik të vendimeve të BE-së, që praktikisht nuk varen drejtpërsëdrejti prej qytetarëve të saj respektivë.

Përkrah tablosë së problematikave të përmendura më lart, edhe referendumi i qershorit 2016 pro daljes së Britanisë nga Unioni si dhe përshtjellimet e papritura të një vendimi të tillë, kanë çuar akoma më tej drejt zbehjes së axhendës politike zgjeruese, që tradicionalisht është mbështetur prej trupës së Komisionit Europian. Në BE, pasojat e një ndodhie të tillë mbeten ende të paqarta për vitet në vazhdim, por vlen për t'u nënvizuar se ajo ka shkaktuar padyshim duartrokitje dhe kënaqësi mes

euroskeptikëve jo të paktë anti-unionistë. *Nga njëra anë* ekziston një mendim sipas të cilit largimi i Britanisë prej Unionit do të çojë drejt konsolidimit të mëtejshëm të familjes europiane si pasojë e nxitjes së detyruar për reforma të reja e të pashmangshme, ndërkohë që *nga ana tjetër* gjithashtu mendohet se Brexit në fakt shënon veç fillimin e shkrirjes së Bashkimit European për sa kohë që një veprim i tillë i pa hasur më parë mund të shoqërohet me efekte domino tërheqjeje edhe prej shteteve të tjera anëtare (Minić, 2016, f. 5-6). Në fakt, nuk është diçka e re që BE të jetë një objektivi i lëvizshëm për sa kohë që ajo karakterizohet nga një dinamikë ndryshimesh të herëpashershme, por janë vërtet të paparashikueshme lëvizje kaq të forta shpërndarëse centrifugale brenda vetë anëtarësisë ekzistuese europiane, ndërkohë që të tjerë kandidatë të jashtëm si ato ballkanike, aspirojnë që të integrohen paralelisht.

Përsa i përket qasjes dhe politikave të ardhshme zgjeruese drejt Ballkanit Perëndimor, ndikimi i largimit të Britanisë në thelb mbetet ende për t'u parë, por për sa kohë që ajo ka qenë një shtet kontributor i fuqishëm ekonomie dhe sigurie në Union, mbështetja e saj stabilizuese padyshim që do të mungojë. Thënë këtë, artikulli i shtuar i të ashtuquajturës "lodhje nga zgjerimi" i BE-së, si dhe pikëpyetjet e vazhdueshme mbi "kapacitetin përthithës" të saj, janë reflektuar pashmangshmërisht drejt *shtrëngimit të mëtejshëm të kushteve* të anëtarësimit ndaj çdo kandidati të mundshëm të BP-së (O'Brennan, 2018, f. 2), ashtu sikurse dhe *fuqizimit të qëndrimeve skeptike* vendimtare të Këshillit European, përpos qëndrimeve sporadike të ngjashme të shteteve të veçanta anëtare të BE-së. Në kontekstin e një ekuilibri tashmë të cënuar mes aktorëve të fuqishëm europianë, roli dominues franko-gjerman do të jetë akoma edhe më i dukshëm në BE dhe sidomos në Ballkan. Thënë këtë, deklarata e Presidentit francez Macron, në samitin e Bullgarisë në 17 maj 2018, është provë e drejtpërdrejtë e ndikimit të këtij shteti të fuqishëm për moszgjerimin e mëtejshëm të BE-së pa ndërmarrjen e një reformimi paraprak, që do të mundësonte thellimin dhe mirëfunksionimin e brendshëm të saj (Sofia News Agency, 2018; Walker, 2018).

Në ndryshim nga filozofia e zgjerimeve të mëparshme, ku procesi në fjalë është karakterizuar nga një logjikë vendim-marrëse racionale dhe normative, zgjerimi drejt BP-së është bërë subjekt i politizimit të shtuar si dhe numrit të madh të kushteve të posaçme bilaterale që dikur do të ishin konsideruar si të papërshtatshme. Kështu, procedurat e ndjekura prej BE-së gradualisht kanë shënuar një zbehje të rolit dhe natyrës së tyre ndërqeveritare si dhe një theksim të ndërhyrjeve të shteteve të veçanta anëtare, përsa i takon aspekteve të ndryshme të procesit të zgjerimit (Balfour & Stratulat, 2015, f. xiii). Në këtë kuptim, injektimi i pakët me ide dhe energji të reja prej shumë kryeqyteteve europiane, e ka vështirësuar së tepërmi narrativën mbështetëse të integritetit, duke bërë që axhenda e zgjerimit të ndikohet jo pak herë prej situatave të pafavorshme. Kriza e pandalshme e azilantëve ekonomikë e politikë, lëkundjet sporadike të sistemeve sociale, mosmarrëveshjet dypalëshe mes shteteve të caktuara europiane dhe ballkanike, situata e çalë mbi njohjen unanime të statusit të Kosovës,

mosbesimi qytetar në rritje ndaj institucioneve të përbashkëta europiane, e të tjera si këto, përbëjnë një pengesë të shtuar në gardhin ekzistues mes BE dhe BP.

Brenda këtij konteksti disi të trazuar të zgjerimit të mëtejshëm të Bashkimit European, nuk kanë munguar as konkurentët e tjerë të gatshëm për të mbushur vakumin e mundshëm në Ballkan, që përmes përforcimit të interesave të tyre gjeo-strategjike, rrezikojnë të kenë efekte të drejtpërdrejta në ecurinë e proceseve integruese euro-atlantike. Kështu, pikë së pari, Rusia është pozicionuar goxha seriozisht në rajon përmes fushatave jo transparente të propagandës dhe mbështetjes ndaj forcave anti-europiane që kanë gjetur më shumë bazë politike në Serbi, Republikën Srpska në Bosnje-Herzegovinë dhe në Maqedoninë [e Veriut] falë edhe prirjeve tradicionale të shumë qytetarëve të tyre rusofilë (Bechev, 2015, f. 3). *Ekziston një interpretim* sipas të cilit, ndikimi në rritje i Ruisë është i orientuar kryesisht drejt pengimit të zgjerimit të mëtejshëm të NATO në Ballkanin Perëndimor, si dhe përfundimit të zgjerimit të mëtejshëm të BE-së në këtë rajon, (sikundër u demonstrua përmes grushtit të dështuar të shtetit në tetor 2016 në Mal të Zi (O'Brennan, 2018, f. 10), apo përpjekjeve për sabotimin e referendumit të 2018-s mbi marrëveshjen e emrit të ri të Maqedonisë (Tisdall, 2018). Ndërkohë, *një tjetër interpretim alternativ* thekson se Rusia nuk është as e aftë dhe as e gatshme për të ndaluar zgjerimin e BE-së në Ballkanin Perëndimor, pasi ndikimi i saj i dukshëm tek disa vende [mike] në rajon do ta ndihmonte atë vetë për të patur më shumë peshë dhe rol, pas anëtarësimit të ardhshëm të këtyre vendeve në Union (Teokarević, 2016, f. 15).

Në vijim të arsyetimit të mësipërm lidhur me konkurentët e tjerë të Unionit në Ballkan, vlejnjë për t'u nënvizuar edhe Turqia, Arabia Saudite e Kina për shkak të peshës dhe rolit të tyre konkret. Kështu, ndërsa *dy të parët* kanë fituar një pozicion të konsiderueshëm socio-ekonomik dhe kulturor në rajon kryesisht përmes ndikimit të popullatës vendase muslimane, që më së dukshmi i përket asaj boshnjake, e ca më pak dhe pjesës me kombësi shqiptare, *e treta* duhet vlerësuar akoma më seriozisht përse kohë që interesat dhe objektivat ekonomike dhe tregëtare kineze në Ballkan nuk janë çudi që të bien ndesh me axhendën respektive të zgjerimit europian. Në fakt, të tilla ndikime alternative janë evidentuar më së shumti gjatë dekadës së fundit në rajonin ballkanik, qysh pas rënies së entuziazmit të shteteve europiane për zgjerimin e mëtejshëm të BE-së drejt tij, falë krizës së tyre të brendshme që prej vitit 2008 (European Commission (d), 2018, f. 2-3; Shih edhe Hänsel & Feyerabend, 2018, f. 4-8). Thënë këtë, eksplorimi i alternativave të ndryshme prej elitave politike ballkanase përgjithësisht ka synuar maksimalizimin e interesave të tyre të brendshme (qoftë dhe personale), përmes rivalizimit të aktorëve të jashtëm, lidhur me përfitimet e mundshme prej ndihmave, huave dhe investimeve, lidhjeve infrastrukturore, mbështetjes ushtarake, e deri tek përkrahja diplomatike nëpër forume ndërkombëtare.

Përpos gjithçkaje nga sa u tha mbi tablonë e jashtme të sfidës së integritimit europian, kuptohet se çështjet që lidhen me politikat respektive zgjeruese të BE-së vijojnë që të mbeten ende të hapura dhe

objekt për diskutim. Pavarësisht ulje-ngritjeve jo pak çorientuese të kurbës në fjalë, është e nevojshme që të dy palët ndërvepruese t'i vijojnë përpjekjet e tyre të kombinuara e të bashkërenduara, përderisa ekziston interesi i përbashkët për zbatimin e reformave dhe për krijimin e një skeme stabiliteti afatgjatë, që do të garantonte neutralizimin e çdo tendence negative që mund të vinte nga mungesa e paqes, sigurisë dhe prosperitetit (Sabriu, 2013, f. 72). Përkundër çdo paqartësie dhe vështirësie ekzistuese lidhur me procesin e integritit evropian, ajo që ka më shumë rëndësi është fakti se ky proces në tërësi vijon që të mbetet i pakthyeshëm për gati dy dekada me rradhë. Nga njëra anë kjo do të thotë se anëtarësimi në BE vijon që të mbetet vizioni afatgjatë i mbarë vendeve të rajonit ballkanik, ndërkohë që nga ana tjetër zgjerimi i Unionit drejt BP-së është një nevojë e paevitueshme për sa kohë që ajo do të mund t'i shërbejë paralelisht interesit të përbashkët të dy palëve në fjalë.

Përfundime

Për sa u tha, duket qartë se trajektorja e rrugëtimit të Ballkanit Perëndimor për në BE është e lidhur ngushtësisht me tablonë e përgjithshme dypalëshe politiko-ekonomiko-shoqërore, brenda të cilës integrimi vijon që të jetë ende një proces dinamik dhe jo rezultat final. Nga njëra anë, transformimet e synuara mbeten ende në nivele relativisht modeste mes vendeve të rajonit, që herë pas here ngecin në një rreth vicioz vështirësish ekonomike, destabiliteti politiko-institucional, mërish etnike, etj. Ndërkohë që nga ana tjetër, edhe vetë Bashkimi Evropian gjendet në një situatë jo të favorshme për nxitjen dhe prirjen e duhur të proceseve integruese tek aspirantët fqinjë ballkanas, falë pranisë së një trysnie të kombinuar ekonomike, politiko-shoqërore, gjeo-strategjike me të cilën është duke bashkëjetuar vështirësisht vitet e fundit. Gjendur nën një sfond të tillë jo pak dinamik dhe pamjaftueshmërisht pozitiv, rrugëtimi i 6 vendeve të paintegruara ballkanike ka qenë dhe vijon të mbetet ende një sfidë, ndonëse po i afrohem fundit të dekadës së dytë, qysh prej zyrtarizimit të perspektivës europiane të Ballkanit Perëndimor gjatë *annus mirabilis* 2000.

Pavarësisht perceptimit të trajektores së integritit me ulje-ngritje të herëpashershme dhe pa nënvlerësuar qëndrimin, vullnetin dhe përkushtimin e aktorëve dhe faktorëve të ndryshëm politiko-ekonomiko-sociale, të cilët praktikisht kanë dëshmuar se kanë në dorë ta përafrojnë po aq sa dhe ta largojnë këtë vizion, herë duke iu dorëzuar “lodhjes prej reformave” (nga këndvështrimi i BP-së), e herë “lodhjes prej zgjerimit” (nga këndvështrimi i BE-së), nuk ka dyshim që integrimi evropian mbetet një objektivi i qëndrueshëm dhe vizioni afatgjatë i vendeve të Ballkanit Perëndimor. Gjithësesi, kjo çështje do vijojë që të ofrojë hapësirë të bollshme për diskutim, për aq kohë sa aty gërhëtohen problematikat e së kaluarës, me karakteristikat dhe sfidat aktuale, pa anashkaluar dhe ato të së ardhmes, ku hasja e dobësive dhe mangësive të brendshme, të bashkëshoqëruara me skepticizmin e jashtëm, vazhdon që të përcaktojë dinamikën dhe cilësinë e ritmit ende të papërfunduar të integritit të BP-së drejt Unionit.

Bibliografia

- Abazi, Enika. 'Albania in Europe: Perspectives and challenges', *Eurasian Files (Avrasya Dosyasi): International Relations and Strategic Studies*, 14 (1), 2008, f. 229-252. Burimi: <https://halshs.archives-ouvertes.fr/halshs-01142295/document>
- Archick, Kristin. 'The European Union: ongoing challenges and future prospects', Congressional Research Service, 15 nëntor 2018. Burimi: <https://fas.org/spp/crs/row/R44249.pdf>
- Bakota, Ivica. 'Kosovo-Montenegro border demarcation problem and its implications for Montenegro', weekly briefing, vol. 5, nr. 4, (ME), China-CEE Institute, 13 prill 2018. Burimi: <https://china-cee.eu/>
- Balfour, Rosa & Corina Stratulat. 'EU member states and enlargement towards the Balkans', (eds), EPC issue paper, nr. 79, European Policy Centre, 2015. Burimi: http://www.epc.eu/documents/uploads/pub_5832_eu_balkans_-_issue_paper.pdf
- Bechev, Dimitar. 'Russia in the Balkans: how should the EU respond?', European Policy Centre, 12 tetor 2015. Burimi: <http://www.epc.eu/>
- Bechev, Dimitar. 'The periphery of the periphery: the Western Balkans and the Euro crisis', policy brief, European Council on Foreign Relations, ECFR/60, gusht 2012. Burimi: <https://www.ecfr.eu/>
- Cabada, Ladislav. 'European Union and the Western Balkans: a problematic partnership', Politics in Central Europe, *The journal of the Central European political science association*, vol. 9, nr. 2, dhjetor 2013.
- European Commission (a). 'Ministerial meeting in the framework of the EU-Bosnia and Herzegovina Structured Dialogue', deklaratë, Brussels, 10 shtator 2015. Burimi: https://ec.europa.eu/commission/commissioners/2014-2019/hahn/announcements/ministerial-meeting-framework-eu-bosnia-and-herzegovina-structured-dialogue_en
- European Commission (b). 'Enlargement', European neighbourhood policy and enlargement negotiations. 06.12.2016. Burimi: <https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/countries/detailed-country-information/>
- European Commission (c). 'State of the Union address 2016: towards a better Europe – a Europe that protects, empowers and defends', speech/ 16/3043, Strasbourg, 14 shtator 2016. Burimi: http://europa.eu/rapid/press-release_SPEECH-16-3043_en.htm
- European Commission (d). 'Engaging with the Western Balkans: an investment in Europe's security', EPSC brief, European Political Strategy Centre, 17 maj 2018. Burimi: https://ec.europa.eu/epsc/sites/epsc/files/epsc_-_brief_-_engaging_with_western_balkans.pdf
- Hänsel, Lars & Florian C. Feyrerabend. 'The influence of external factors in the Western Balkans', (ed.), Konrad Adenauer Stiftung, 2018. Burimi: <https://www.kas.de/>

- Hix, Simon. 'Decentralised federalism. A new model for the EU', gjendur në: B. Martill & U. Staiger (ed.), *'Brexit and beyond. Rethinking the futures of Europe'*, kapitulli 7, UCL Press, 2018, f. 72-80.
- Kmezic, Marko. *'The Western Balkans and EU enlargement: lessons learned, ways forward and prospects ahead'*, Directorate general for external policies, Policy Department, AFET, European Parliament, Belgium, 2015.
- Minić, Jelica. 'The future of the EU and the Western Balkans – a view from Serbia', (ed), Foreign policy papers, Beograd, 03.2016. Burimi: <http://library.fes.de/pdf-files/bueros/belgrad/12943.pdf>
- Mirel, Pierre. *'The Western Balkans: between stabilization and integration in the European Union'*, Foundation Robert Schuman, European Issues, Nr.459, 23 janar 2018. Burimi: <https://www.robert-schuman.eu/>
- Nugent, Neil. 'Brexit: Yet another crisis for the EU', në: B. Martill & U. Staiger (ed.), *'Brexit and beyond. Rethinking the futures of Europe'*, kapitulli 5, UCL Press, 2018, f. 54-62.
- O'Brennan, John. *'EU enlargement to the Western Balkans: towards 2025 and beyond'*, Future of the EU 27, IIEA – Institute of International and European Affairs, Dublin, 2018. Burimi: <https://www.iiea.com/>
- Pavolvić, Srda. *'West is best: how 'stabilitocracy' undermines democracy building in the Balkans'*, LSE, the London School of Economics and Political Science, 5 maj 2017. Burimi: <http://blogs.lse.ac.uk/>
- Romei, Valentina. 'How far from EU admission standards are Western Balkan states', *Financial Times*, 26 mars 2018. Burimi: <https://www.ft.com/>
- Sabriu, Miranda. 'The integration of the Western Balkans – a need for stability and peace', *International journal of academic research in business and social sciences*, Vol.3, Nr.10, tetor 2013, f. 71-78.
- Sofia News Agency. *'Macron warns against hasty EU enlargement at the Sofia Summit'*, 18 maj 2018. Burimi: <https://www.novinite.com/>
- Teokarević, Jovan. 'Modest progress towards a less desirable European Union: European integration of the Western Balkans 2015-2016', në: *Western Balkans between geography and geopolitics*, Foreign Policy papers, (ed.), Milan Simurdic, Beograd, 01.2016, f. 7-16. Burimi: <https://library.fes.de/pdf-files/bueros/belgrad/12677.pdf>
- Uvalić, Milica & Vladimir Cvijanović. 'Towards a sustainable economic growth and development in the Western Balkans', *SOE Dialog Sudosteuroopa*, Friedrich Ebert Stiftung, Zagreb, mars 2018. Burimi: <https://library.fes.de/pdf-files/bueros/kroatien/14688.pdf>
- Tisdall, Simon. 'Result of Macedonia's referendum is another victory for Russia', *The Guardian*, 1 Tetor 2018. Burimi: <https://www.theguardian.com/>

Walker, Shaun. 'No time soon: EU dashes membership hopes of Balkan states', *The Guardian*, 18 maj 2018. Burimi: <https://www.theguardian.com/>

Zelyazkova, Asya, Ivan Damjanovski, Zoran Nechev & Frank Schimmelfennig. 'European Union conditionality in the Western Balkans: external incentives and europeanisation,' në: J. Džankić, S. Keil & M. Kmezic, (eds), *The Europeanisation of the Western Balkans*, kapitulli 2, Palgrave, Macmillan, 2019, f. 15-38.

LËNDËT NARKOTIKE DHE LEGJISLACIONI SANKSIONUES PËR TO NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Doc. Dr. Emin Huseini

e.huseini@eust.edu.mk

Bsc. Armand Braho

a.braho17@eust.edu.mk

Abstrakt:

Biznesi më fitimprurës dhe i jashtëligjshëm në Shekullin e XXI, pa dyshim është tregëtimi i lëndëve narkotike të llojeve të ndryshme. I kthyer si një trend, por negative për shoqërinë shihet një rritje e kërkesës për këtë mall të ndaluar. Nga ana tjetër institucionet ligj vënëse dhe ligj zbatuese krijojnë politika të ndryshme për reduktimin e kërkesës për lëndët narkotike.

Duhet pasur parasysh që mburoja e një shteti, për të evituar aktivitetet e jashtëligjshme është sanksionimi i ushtruesve të këtyre aktiviteteve. Duhet thënë se niveli ose forma e sanksionit mund të sielli një sensibilizim në masë, për mos përdorjen e këtyre lëndëve të ndaluara.

Nëse shohim vetëm në 10 vjeçarin e fundit, do të vërejmë se në Republikën e Shqipërisë, legjislacionet penale, kanë pësuar ndryshime të shumta, sidomos në ashpërsimin e ndëshkueshmërisë për veprat penale në fushat narkotike. Që do të thotë se tashmë ka një luftë tepër të egër ndërmjet asaj që është legale dhe asaj që nuk është legale.

Ndëshkueshmëria (Sanksioni) në bazë të ligjit është një nga elemnetet të cilat siellin atë që quhet “evitim” i një shoqërie të prirur drejt jo legales. Ku konkretisht, sanksioni do të sielli për kryesin e veprës penale (*jo domosdoshmërisht*), një mungesë të dëshirës për të kryer përsëri të njëjtën vepër penale. Që do të thotë se një tregëtues ose përdorues i lëndëve narkotike, nëse ndëshkohet për këtë vepër penale, ky i fundit ka mundësi të mos e përsëriti më të njëjtën vepër penale.

Fjalët Kyçe: Lëndë Narkotike, Drogra, Sanksion, Legjislacion, Jo Legal.

Hyrje:

Përdorimi i lëndëve narkotike dhe përdorimi i tyre, prej vitesh është kthyer një problem tepër serioz për shoqërinën. Edhe pse historikisht që nga shekulli i XX kjo supstancë psikotrope, është kthyer në një biznes te zi, i cili siell për prodhuesit dhe shpërndarësit fitime marramendeëse, gjiththmonë nga ana e qeverive të ndryshme janë ndërrmarë veprime konkrete, për konsiderimin e prodhimit dhe përdorimit të lëndëve narkotike si vepra penale.

Këto masa juridiko-penale për herë të pare në Shqipëri janë kodifikuar në 1 Janar 1928 nga qeveria e Ahmet Zogut në Republikën e Shqipërisë⁷⁴, ku mbiellja dhe përdorimi i tyre u klasifikua si një ndër veprat penale të asaj kohe.

Gjithsesi lëndët narkotike u klasifikuan si një fenomen tepër i rezikshëm dhe me karakter kriminal, ku dhe shtetet europiane në shekullin e XX, filluan që të ndërmerinin krijimin e dispozitave të posaçme, për këtë problem në kodet penale të tyre.

Por edhe pse u ndërmorën veprime konkrete juridike-penale, u saktësua që lloje të ndryshme të lëndëve psikotrope, të lejoheshin të përdorn në sektorin e mjekësisë. Si qetësues të rekumantuar nga mjekët.

Duhet pasur parasysh që tashmë dënimet të cilat implementohen tek kategoria e personave që kryejnë vepra penale në fushën narkotike, shkojnë në përpjestim të drejtë me rezikshmërinë apo dhe dëmin që shkaktohet nga kryerja e këtyre veprave penale.

1. LËNDËT NARKOTIKE

Me lëndë narkotike kuptojmë lëndë psikotrope apo depresate, ose çrregulluese për karakterin psikik të njeriut. Të gjitha drograt dehëse ose pijet narkotike, për krah origjina mund të jetë: natyrore dhe sintetike.⁷⁵

1.1 Drograt me origjinë sintetike

Me droga të cilat kanë origjinë sintetike do të kuptojmë të gjitha ato droga që në përbërje të tyre kanë karakter sintetik të cilat ndahen në: “ narkotikë, supstancë psikotrope, apo depresante, pije stimuluese dhe pije narkohalucino-gjene”⁷⁶

1.2 Drograt me origjinë natyrore.

Droga me origjinë natyrore janë të gjitha ato droga të cilat kultivohen dhe gjenden në natyrë. Ku ndër to mund të përmendim, “ Fleta Kanabis Sativa, Kokaina, Hashashi etj.”

Prodhimi, mbajtja, konsumimi dhe shitja e tyre përbën vepra penale të parashikuara në Kodin Penal. Duhet thënë se përdorimi i këtyrë drogave nga ana shëndetësore mund të silli pasoja të pa rikuperueshme për përdoruesit e tyre. Prandaj në kodin penal të Republikës së Shqipërisë ato quhen si lëndë helmuese.

2. KULTIVIMI I LËNDËVE NARKOTIKE ME DHE SANKSIONI JURIDIKO-PENAL

Në të njëjtin prizëm, vlen të theksohet edhe shkollimi i përshtatshëm për të rriturit që ju mungonte arsimit i detyruar bazë, si edhe më pas hapja e profileve profesionale, shkollës së natës, që në aktet e mëvonshme do të përsosen si terma 'arsim me kohë të pjesshme, arsim në distancë', deri në 'studime jouniversitare profesionale' dhe 'Master Profesional'.

U institucionalizua Arsimit Profesional dhe Arsimit i Lartë, i cili pavarësisht se u përdor nga sistemi komunist si një mundësi për të shpërndarë ideologjinë e luftës, apo më vonë atë Marksiste-Leniniste, sërish gjykuar në një hark kohor prej një dekade, këto reforma të njëpasnjëshme sendërtuan një sistem të strukturuar arsimor, me pjesëmarrje masive nëpër klasa apo auditorët e insituteve dhe shkollave të larta. Ngritja e pothuajse të gjitha niveleve studimore, në një afat kaq të shkurtër kohor, është një atribut që meriton të vlerësohet edhe në ditët e sotme, që prej 6 vitesh, ende nuk po definohet implementimi i akteve ligjore dhe përshtatja e tyre nëpër IAL, për rihapjen tërësore dhe meritokratike të aplikimeve mbi studimet e ciklit të tretë (doktoraturës).

¹⁰⁸ Ligji Nr. 69 2012 Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë (i përditësuar), Neni 22

2.2. Analiza e deformimeve reformiste për Arsimin Shqiptar

Në dekadën në vijim, vitet 60-70, pasoi ideologjizmi i tejskajshëm, politika e reflektuar edhe me Kushtetutën e kohës ‘Për Formimin e Njeriut të Ri’, përvijoi me edukimin gjithëpërfshirës të brezit të ri, nëpërmjet përvetësimit të njohurive shkencore të mentalitetit marksist-leninist dhe internacionalizmit të proletariatit; U implementua parimi marksist-leninist i lidhjes së të mësuarit me punën në prodhim në të gjitha kategoritë e shkollave; Politizimi i lëndëve u shtri pothuajse në të gjitha nivelet arsimore, pa kursyer të miturit dhe të rinjtë (duke i përfshirë ata edhe në punët në prodhim), si edhe aktet ligjore vijnë të prodhojnë raporte juridike dhe sanksione të mëtejshme në bazën e botëkuptimit marksist-leninist, duke kombinuar mësimin me punën prodhuese dhe me edukimin fizik e ushtarak.

Prof. Asoc. Dr. Anja Neundorf (University of Nottingham) në artikullin Demokracia në tranzicion: Një perspektivë mikro për ndryshimin e sistemit në shoqëritë post-socialiste, do të shprehet "Mund të supozojmë, për shembull, se "parimet demokratike" të mësuara nën regjimin socialist nuk mund të përputhen me funksionimin e demokracisë aktuale.¹⁰⁹ Këtë situatë e përshtjellon siç duhet kronologjia e krijimit dhe ndryshimeve të akteve themeltarë shtetërore, amendimet dhe ndryshimi Kushtetutave të Shqipërisë, nga ajo që daton në vitin 1914 dhe deri tek Kushtetuta aktuale.

Table 3 Kronologjia e ndryshimit të akteve themeltare¹¹⁰

19.04.1914	Statuti i Shqipërisë (Hartuar prej komisionit ndërkombëtar të Kontrollit)
31.01.1920	Statuti i Lushnjës
Viti 1922	Zgjerimi i Statutit të Lushnjës 1922
02.03.1925	Statuti Themeltar i Republikës Shqiptare
01.12.1928	Statuti i Mbretnis Shqiptare
03.06.1939	Statuti Themeltar i Mbretnisë së Shqipërisë
14.03.1946	Statuti i Republikës Popullore të Shqipërisë
05.07.1950	Kushtetuta e Republikës Popullore të Shqipërisë
28.12.1976	Kushtetuta e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë
29.04.1991	Për dispozitat kryesore kushtetuese
28.11.1998	Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë

¹⁰⁹ Anja Neundorf, Democracy in Transition: A Micro perspective on System Change in Post-Socialist Societies, *The Journal of Politics*, Vol. 72, No. 4 (Oct., 2010), pp. 1096-1108

¹¹⁰ <http://shtetiweb.org/2012/08/27/kushtetutat-e-shqiperise/>

Mjafton të trajtohet vetëm rasti i diskutimeve për ndryshimin e Dispozitave Kryesore Kushtetuese në Kuvendin Popullor të Republikës së Shqipërisë, i cili u fuqizua me Ligjin Nr. 7491, datë 29.4.1991, por përveç konstitucionalizimit, organizimit demokratik të shtetit dhe Rilindjes së Parlamentarizmit, një kthesë 180° për sa i takon rregullimit ligjor të një sistemi të ri qeverisës, sërish nuk prodhoi asnjë dispozitë rregulluese mbi arsimin, duke e shmangur madje edhe nga objektivi i kohës, për të prioritetizuar çështje të tjera, si kuadri i organizimit demokratik të shtetit dhe më pas miratimi i Kushtetutës së re tërësore më 21.10.1998, me ndihmën dhe asistencën teknike, ligjore dhe politike të organizmave ndërkombëtarë.

3. Përafrimi i legjislacionit kombëtar me aktet ndërkombëtare dhe problematika ligjore

Gjatë këtyre viteve roli i Kuvendit është rritur ndjeshëm në krijimin e një kuadri kushtetues e ligjor, si premisë për vendosjen e shtetit juridik. Ai është kthyer në institucionin më të rëndësishëm të zhvillimit të jetës politike në vend.¹¹¹ Veprimtaria legjislative është bërë një nga instrumentët më aktivë në konsolidimin e institucioneve të shtetit dhe të integritimit euroatlantik, duke ndjekur me përpikmëri rekomandimet nga partnerët strategjikë në marrëdhëniet ndërkombëtare, aktet ndërkombëtare të ratifikuara dhe marrëveshjet dy apo më shumë palëshe.

Arsimi është një nga fushat që njohu përshtatjen më të madhe gjatë viteve në vijim, duke inkorporuar pjesën më të madhe të parashikimeve në aktet ndërkombëtare, pikërisht në aktet e brendshme kombëtare, si në tabelën e mëposhtme:

Table 4 Kronologjia ligjore e përshtatjes së akteve kombëtare me aktet ndërkombëtare

Parashikimet në Legjislacionin e Brendshëm					
Nr.	Akti	Nr.	Data	Lënda	Ndikimi/Impakti
1.	Ligj	10221	2010	Për mbrojtjen nga diskriminimi	<ul style="list-style-type: none"> • Të gjithë kanë të drejtë të arsimohen • Të ndiqet arsimi i detyrueshëm • Arsim publik – falas
2.	Ligj	9970	2008	Për barazinë gjinore	<ul style="list-style-type: none"> • Trajtim i barabartë dhe shanse të barabarta
3.	Ligj	18	2017	Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës	<ul style="list-style-type: none"> • Krijim i kushteve të veçanta, sipas rastit • E drejta e Prindit për Edukimin

¹¹¹ <http://www.parlament.al/Kuvendi/Historiku>

4.	Ligj	37	2017	Kodi i Drejtësisë Penale për të Miturit	<ul style="list-style-type: none"> • Përfshirja dhe angazhimi në Komunitet * Prograne edukuese: * Kundër dhunës * Kundër diskriminimit * Kundër formate të EDH * Infrastruktura e përshtatshme arsimore
5.	Ligj	69	2012	Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë	
6.	Ligj	139	2015	Për vetëqeverisjen vendore	

Parashikimet në aktet ndërkombëtare

	Akti	Ndikimi/Impakti
7.	Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut	<p>Arsim fillor</p> <ul style="list-style-type: none"> • Falas • Obligativ • E drejta e prindit për përzgjedhjen e profilit <p>Arsimi profesional</p> <ul style="list-style-type: none"> • E drejtë për të gjithë • Kusht vetëm në bazë të aftësive • Zhvillimi i profileve <p>Arsimi i lartë</p> <ul style="list-style-type: none"> • E drejtë për të gjithë • Sis. i bursës dhe ekselencës • Kushte bashkëkohore • Njohja e dokumenteve. <p>Të tjera</p> <ul style="list-style-type: none"> • E drejta për të ndjekur ritet religjioze • Personat e dënuar
8.	Konventa e UNESCO-s Kundër Diskriminimit në Edukim	
9.	Konventa e OKB-së kundër Eleminimit të të Gjitha Formave të Diskriminit Racor	
10.	Pakti Ndërkombëtar mbi të Drejtat Civile dhe Politike	
11.	Pakti Ndërkombëtar mbi të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore	
12.	Konventa e OKB-së për Eleminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave	
13.	Konventa e OKB-së për të Drejtat e Fëmijës	
14.	Konventa e OKB-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara.	

Aktualisht, Ligji për Arsimin, edhe pse është produkt i një përshtatje të pasuruar me parashikimet dhe dispozitat që rrjedhin nga aktet ndërkombëtare të ratifikuara në Shqipëri, sërish kushtet dhe rrethanat ndryshojnë dhe e pozicionojnë aplikueshmërinë e ligjit në një terren të minuar nga plagë shoqërore, politike dhe ekonomike.

Duke ju referuar statistikave të regjistrimeve në arsim 2017-2018 nga INSTAT, dhe në krahasim me vitin e kaluar akademik, vlerësohet se ka një ulje të konsiderueshme të pjesëmarrjes së nxënësve dhe studentëve në studime, sipas niveleve të ndryshme të shkollimit, konkretisht:

- * Arsimi në total - ulje prej 3,8 %,
- * Arsimi Parashkollor – 1.2 %
- * Arsimi 9-vjeçar – 2.5 %
- * Arsimi Parauniversitar - ulje prej 2,9 %,
- * Arsimi i Lartë 7,3 %

Vlerësohet, gjithashtu, se gjatë vitit akademik 2016-2017, rreth 25 mijë studentë shqiptarë, studiojnë në vende të ndryshme të botës.

Këto statistika, tregojnë qartazi se qasja e politikës arsimore, nëpërmjet ligjit (sidomos atij mbi arsimin) nuk ka favorizuar të rinjtë për të qenë të përshtatshëm për të ndjekur studimet në vendin e tyre. Rasti më i fundit të cilit mund t'i referohemi është mbledhja e Këshillit të Ministrave në datën 10.05.2019, në të cilën përcaktohet se mesatarja e aplikimeve për studimet në ciklin Bachelor do të jetë 6.5, ndërsa për degën Mësuesi 7.5. Trajtimi i ligjit si një rregullator tregu, duke ndryshuar çdo vit kriteret, krijon konfuzitet dhe një pabarazi ndërmes IAL-ve që ofrojnë këto programe.

Problematika të tjera rezultojnë: bursa e ulët e akorduar nëpërmjet grantit për nivelet vendore; fazat e shkurtra të regjistrimit 48 orëshe; kosto të larta akreditimi për programe të reja dhe bashkëkohore, sipas kërkesës së tregut; ndalimi i këshillimit të karrierës dhe ofrimi i panairëve në zona larg lokacionit të universiteteve jashtë metropolit; mungesa e evidencave publike të studentëve që studiojnë jashtë shtetit dhe fiktiviteti i strategjisë për trajtimin e rikthimit të studentëve nga jashtë.

Përfundime dhe Rekomandime

Shqipëria është një vend që ka diktuar dispozita ligjore për motive politike të kohës, duke nisur nga propaganda dhe edukimi masiv me qëllim ideologji të tejskajshme në kohën e sistemit komunist dhe deri tek rregullimi ligjor i sotëm i arsimit, i paspecializuar dhe i pakonsultuar me katedrat universitare dhe shoqërinë civile, duke prodhuar pakënaqësi dhe duke nxitur emigrimin e studentëve dhe familjarëve të tyre jashtë vendit.

Përshtatja e akteve ndërkombëtare në legjislacionin e brendshëm duhet mbështetur me akte të tjera nënligjore dhe bashkë me to, duhen krijuar strategji implementimi në përputhje me kushtet dhe

rrethanat në të cilat ndodhet vendi, ndryshe ligji do të vijojë të jetë, jo vetëm abstrakt, por edhe i imponueshëm, jologjik dhe jokohorent.

Raportet ligjore ndërmjet Qeverive. IAL-ve dhe studentëve do të prodhojnë një përplasje ndërmjet limitimit të së drejtës kushtetuese për edukim dhe arsimim, nëse vijohet me këtë ritëm ndryshimi dispozitash që janë përjashtimore dhe jo favorizuese; mungesa e vullnetit politik për të krijuar një mekanizëm kontrolli mbi ndjekjen e cilësisë akademike, të profesoratit dhe të përgatitjes së studentëve, për të mos patur diplomime pa kriter, nuk duhet të prodhojë dispozita të reja ligjore që orvaten të ri-rregullojnë të njëjtin objekt dhe të njëjtat lëndë, por duhet të ndiqen rastet e shkeljeve dhe të vendosen përpara drejtësisë; të përsoset sistemi i përfshirjes së personave të kualifikuar dhe ekspertë pranë institucioneve vendimmarrëse mbi arsimin, në nivel qendror dhe lokal; të ristrukturohen mekanizmat e dështuar të kontrollimit të cilësisë akademike dhe të riformulohet strategjia e zhvillimit të arsimit në terma aktualë dhe koherentë, jo e trajtuar në kushte ideale.

Literatura e shfrytëzuar

- * Kuvendi i Shqipërisë, Zana Bufi, Marita Lamani, Legjislacioni Shqiptar 1945-1955, Tregues Bibliografik Alfabetik, Tiranë, 2010
- * H. Bejqja, “Në themelet e arsimit popullor”, Tiranë 1976
- * Sh. Osmani, Fjalor i pedagogjisë, Tiranë 1983
- * Kushtetuta e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, Tiranë, 1946
- * Kushtetuta e Republikës Popullore të Shqipërisë, Tiranë, 1950
- * Kushtetuta e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, Tiranë 1976
- * Ligji Nr. 7491, Datë 29.4.1991, Për Dispozitat Kryesore Kushtetuese, Kuvendi Popullor i Republikës së Shqipërisë
- * Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Tiranë 1998 (e ndryshuar)
- * Ligji Nr. 69/2012, Për Sistemin Arsimor Parauniversitar (i ndryshuar)
- * Lektor Dorian Leka, Ph.D. Cand, cikël leksionesh: Legal Issues in Education Module (MSc. Leadership & Assessment in Education), Nehemiah Gateway University, 2019
- * The Journal of Politics, Vol. 72, No. 4 (Oct., 2010) The University of Chicago Press
- * <http://www.doktoratura.unitir.edu.al/wp-content/uploads/2013/08/Doktoratura-Clirim-Duro-Fakulteti-i-Histori-Filologjise-Departamenti-i-Historise1.pdf>
- * <http://shtetiweb.org/2013/10/08/dispozitat-kryesore-kushtetuese-1991/>
- * <http://www.parlament.al/Kuvendi/Historiku>

SIGURIA NË RUAJTJEN E INFORMACIONIT

MSc: Juljana Bilbilaj

Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë

Abstrakt

Kuadri ligjor duhet të sjellë në vëmendje interesimin, seriozitetin dhe përgjegjshmërinë e strukturave shtetërore, të cilat duhet të vlerësojnë çështjet e sigurisë së jetës, pronës, informacionit, rendit kushtetues; duke garantuar mbrojtjen juridike kundër subjekteve të kriminit kompjuterik dhe individëve të përfshirë në to. Legjislacioni i ndryshuar në kohë, nëpërmjet ligjeve të posaçme, mund të rregullojë veprimtarinë e strukturave të sigurisë dhe të drejtësisë, mbi bazën e standardeve më të arrira ndërkombëtare. Trajtimi i konventave me karakter ndërkombëtar, që normojnë të drejtën penale juridike ndërkombëtare, të miratuara nga OKB, në kufizimin e veprimeve jashtëligjore, mund të garantojnë ruajtjen e informacionit, si element i rëndësishëm i sigurisë kombëtare.

Kjo mbështetje juridike orienton në rregullimin e legjislacionit në kushte konkrete, mbështetur në doktrinat më të rëndësishme të luftës kundër kriminit të organizuar vendor, rajonal dhe ndërkombëtar, sipas përvojës së dekadave të fundit, të koordinuara me legjislacionin penal.

Mbi këto konstatime, përpjekja për t'i përfshirë trajtesat në kontekst më të gjerë, sipas metodës analitike, krahasuese, con drejt përfundimeve mbi masat parandaluese me karakter unik, të mbështetura në hapësira ligjore për strukturat e sigurisë, me qëllim zbulimin, investigimin dhe ndëshkimin e sistemit kriminal. Kështu, tema merr rëndësi teorike dhe praktike në rekomandimet e ndërthurura me aspektin politik, juridiko-shkencor dhe penal, për vendimarrje alternative në interes të sigurisë dhe paqes rajonale.

Parashtrimi i disa tipologjive të reja të formave konkrete të shfaqjes dhe veprimit të këtij fenomeni kriminal me pasoja, mbi vet natyrën e kriminit të organizuar me përdorimin e mjeteve të sofistikuara, përfshin terminologjinë shkencore të fushës. Kjo mënyrë nuk e kufizon fenomenin brenda hapësirës doktrinare të sigurisë, por jep hapësirë dhe metodë alteranative për mundësitë e reformimit të akteve juridike, penale, kërkesave të konventave dhe bazës ligjore penale në luftën për parandalimin dhe goditjen e strukturave kriminale që veprojnë në keqpërdorimin e informacionit në dëm të jetës, pronës dhe sigurisë.

Në fund të temës janë bërë përpjekje për përfshirjen e një serë shpjegimesh plotësuese, mbi referencat dhe termat e veçanta që meritojnë vëmendjen studimore. Metodologjia studimore në shërbim të pyetjes kryesore me karakter kërkimor, shtron hipoteza, teza dhe përfundime, duke iu referuar

studimeve të reja të botimeve bashkëkohore, duke bërë përpjekje për të plotësuar thelbin e metodës studimore shkencore drejt një materiali interesant dhe me vlera. Këto rekomandime dhe përfundime janë një shtyese serioze për studime edhe më të thelluara në angazhimin institucional të luftës së gjatë e të vështirë në mbrojtjen e informacionit.

Hipoteza kryesore e temës:

- Sa është e përgatitur shoqëria dhe institucionet shqiptare në ruajtjen e informacionit dhe përballjen me efektet negative të krimit kompjuterik?

Fjalë kyçe: Informacion i klasifikuar; siguria kombëtare, krim kompjuterik, sekret shtetëror...

1. Hyrje

Në trajtimin e çështjeve të Strategjisë Kombëtare të Sigurisë (SSK), shpesh mbi abstraksionin formal të përmbajtjes së tyre, për pasojë të mosnjohjes dhe të ngurrimit për të depërtuar në problemet më të detajuara të saj, është i nevojshëm një informacion më i gjerë në shërbim të analizës dhe të përmbajtjes së ideve, që pasqyrojnë vlerat e elementëve të sigurisë në fushën e informacionit. Në këtë hapsirë të gjerë, nuk pretendohet të arrihet gjithçka. Ngjarjet kriminale dhe reagimi ndaj tyre, të cilat peshën e kalojnë mbi strukturat e sigurisë kombëtare, midis dilemës dhe realitetit, kanë shtruar problemin e zhvillimit të tyre, të kushtëzuara “nga efektet e reformave dhe garancitë e tyre në mjedisin shqiptar” (Sulejman Abazi, 2004:91). Realiteti ka dhënë herë herë pamje mosbindëse, të cilat i kanë bërë qytetarët të ndihen skeptik për përmbajtjen dhe të ardhmen e sigurisë së tyre.

Bërthama e mendimit filozofik të Strategjisë Kombëtare të Sigurisë, mbështetet në “*traditën konstitucionale*” (Sulejman Abazi, 2004:93), e hedh vështrimin në preambolën e Kushtetutës së Shqipërisë dhe periudha të ndryshme historike. Koha vërteton se, aftësitë intelektuale për t’i paraprirë procesit të vështirë të sigurisë, nuk kanë munguar. Në hapsirat shqiptare, duhet të vërshojnë mendimet dhe të shpalosen aftësitë potenciale të njerëzve të përkushtuar, me shkallë të lartë profesionalizmi në çështjet e sigurisë. Konteksti historik e imponon këtë, për shkak të pozitës strategjike, rrugëkalimeve të shkurtra Lindje – Perëndim, tendencave të krimit ndërkombëtar për të depërtuar nga të gjitha drejtimet, lehtësitë që mundëson terreni, popullsitë e shpërndara, të vijës bregdetare, pyllëzimeve, grykave malore të parrahura nga lëvizjet njerëzore, liberalizmi i strukturave të sigurisë të pas viteve 90-të, hapat e ngadalshëm në plotësimin e legjislacionit dhe të drejtës penale dhe një sërë faktorësh të tjerë, që kompromentojnë faktorin demografik shqiptar për shkak të varfërisë ekonomike dhe traditës fisnore e familjare, krijojnë mundësi të depërtimit të fenomeneve kriminale në këto hapësira.

Analizat studimore që janë bërë mbi rrjetet kriminale dhe grupet mafioze shqiptare, i shfaqin ato mbi bazë fisnore. Kjo vështirëson depërtimin brenda tyre për parandalimin e veprimeve kriminojane. Ky tipar dallues i bën të ashpra grupet kriminale shqiptare, duke vështirësuar punën e strukturave të sigurisë dhe të organeve ligjore të të drejtës penale. Grupet kriminale shqiptare orientohen drejt kërkimit financiar të skajshëm. Ato kërkojnë besnikërinë e anëtarëve të organizatës në shkallën më të lartë. Ato janë të orientuara “*drejt shtyrjes së korrupsionit tek zyrtarët e lartë të shtetit*” (Xhavit Shala, 2003:10) brenda elementëve të sigurisë. Në këtë veprimtari kanë të ngritura struktura hierarkike për të arritur me çdo kusht qëllimet e tyre. Brenda tyre nxjerr kokë fenomeni i “*diversitetit të krimit*”, (Xhavit Shala, 2003:10) duke u përfshirë në më shumë se sa një lloj krimi të organizuar me veprim rajonal dhe ndërkombëtar. Në tre dekada grupet kriminale kanë arritur “*pjesë organizative*”, duke vështirësuar luftën kundër tyre.

Grupet shqiptare të krimit të organizuar nuk janë të vetmit, të nisur nga parimi se, “*ka për të gjithë*”. Ato “*në heshtje respektojnë njera tjetrën*”, por “*nuk pranojnë hierarki në strukturën vertikale*”, (Xhavit Shala, 2003:11) për të pasur një kupolë të vetme brenda shtetit shqiptar, duke lëvizur sipas parimit “*kokë më vete*”. Mjaft prej tyre “*ndërrojnë padron*”, duke kaluar nga një grup tek tjetri. Të gjitha grupet kriminale shqiptare që veprojnë në perëndim, njihen si “*shumë të dhunshëm*”. Të ardhurat e krimit dhe të trafiqeve, grupet shqiptare parapëlqejnë t’i lëvizin “*kesh në dorë*”, duke shmangur depozitat bankare. Ata janë “*të pakujdesshëm në komunikimet e tyre telefonike*”, (Xhavit Shala, 2003:12) duke mos përdorur pseudonime. Kjo mënyrë veprimi ka lehtësuar goditjen e tyre në vendet perëndimore, ku mundësitë teknike të kontrollit janë më të mëdha.

Grupet kriminale shqiptare, shpesh të ndikuar nga përkatësia fetare, janë vënë në shërbim të lëvizjeve terroriste deri në pjesëmarrje direkte brenda tyre, duke keqpërdorur shkallën e informacionit individual dhe institucional. Është ky një problem i hapur në kohën që jetojmë, duke kërkuar vëmendjen e institucioneve të sigurisë në Republikën e Shqipërisë dhe të shteteve fqinje, për të minimizuar efektet negative të këtyre fenomeneve me pasoja për jetën sociale të popullsisë në Ballkanin Perëndimor.

2. Marrëdhëniet institucionale për mbrojtjen e përbashkët të informacionit.

2.1. E drejta ligjore e informacionit.

E drejta për t’u informuar; pra për të marrë informacion, është e drejtë universale e shtetasve dhe ajo garantohet me Kushtetutë. Në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, përcaktohet: “*E drejta e informimit është e garantuar. Kushdo ka të drejtë, që në përputhje me ligjin, të marrë informacion për veprimtarinë e organeve shtetërore, si dhe të personave që ushtrojnë funksione shtetërore.*” (Kushtetuta RSH, 1998:11) Gjatë veprimtarisë normale, ministrinë dhe institucionet e shtetit demokratik, prodhojnë kategori të ndryshme informacionesh, të cilat mund të jenë të hapura për të

gjithë, ose të kufizuara, për t'u bërë publike për një kohë tjetër. Në këtë rast, është e domosdoshme që të ekzistojë interesi publik, prej të cilit kërkohet që kategori të caktuara informacionesh, të jenë me qëllim të përcaktuar.

Ky kufizim është shprehur në nenin 17 të Kushtetutes ku është përcaktuar se: *"Kufizime të të drejtave dhe lirive të parashikuara në këtë Kushtetutë, mund të vendosen vetëm me ligj, për një interes publik, ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve"*. (Kushtetuta RSH, 1998:10) Mbi këtë të drejtë, për kufizimin e informacionit në Republikën e Shqipërisë, është miratuar ligji nr. 8457, datë 11. 2. 1999, *"Për informacionin e klasifikuar "sekret shtetëror"*, (Fletore Zyrtare, 1999) i ndryshuar me ligjin nr. 9541, datë 22. 5. 2006, *"Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8457, date 11. 2. 1999, "Për informacionin e klasifikuar "sekret shtetëror"*. (Fletore Zyrtare, 2006).

Duke u mbështetur në elementët e Sigurisë Kombëtare, sipas doktrinës së NATO-s, në Kapitullin e Katërt të Planit të Veprimit për Anëtarësim trajtohen *"Çështjet e Sigurisë së Informacionit"*, (Plani i VA RSH në NATO, 06:2006). ku parashikohen vlerësime dhe detyrime për ministritë dhe institucionet shtetërore, për të aplikuar masa dhe standarde, që kanë të bëjnë me sigurimin e informacionit të klasifikuar, të shkëmbyer apo të vënë në dispozicion nga kjo strukturë ushtarake.

Në këto kushte, sigurimi i këtij informacioni prej ndërhyrjeve të paautorizuara, të qëllimëshme, apo aksidentale, është një proces i rëndësishëm, që kërkon një konceptim dhe aplikim procedurash e standartesh mbrojtëse, të orientuara vetëm mbi kërkesa ligjore. Sot ekziston baza ligjore për ruajtjen e informacionit, e mbështetur në të drejtën ligjore penale për sigurimin e tij. Mbi këtë bazë janë formuar edhe konceptet teorike mbi informacionin, të mbështetura në parimet e sigurisë Kombëtare.

Kështu, janë bërë përpjekje të ndryshme në planin teorik për të dhënë një përkufizim mbi termin *"informacion"*. Në kuptimin e përgjithshëm, me informacion, do të kuptojmë çdo njohuri që mund të komunikohet, apo të dokumentohet, pavarësisht nga forma. Ndërsa me termat *"informacion i klasifikuar"*, do të kuptojmë ato kategori informacionesh, ekspozimi i paautorizuar i të cilit mund të rrezikojë sigurinë kombëtare. Që informacioni të quhet i tillë, duhet që në përmbajtjen e tij t'i japë përgjigje pyetjeve: "Kur?", "Ku?", "Kush?", "Si?", "Pse?", "Çfarë?". Ndërsa nga vendet anëtare të NATO-s, përfshirë dhe Republikën e Shqipërisë, për *"informacionin e klasifikuar"* është pranuar përkufizimi, sipas të cilit ky term, *"kupton informacionin ose materialet e përcaktuara, që kërkojnë mbrojtje kundër zbulimit të paautorizuar, i cili është përshkruar kështu nga klasifikimi i sigurisë"*. (SSK, 2006:49).

Institucionet vendimarrëse të sferave të sigurisë kombëtare, janë të interesuara për informacione që kanë profile të ndryshme, të hapura, ose edhe të klasifikuara. Sipas konceptit ligjor shqiptar, në vendin tonë, parimet kryesore të sigurisë së informacionit janë të klasifikuar sipas skemës, *"informacioni i klasifikuar"*, që prodhohet nga shteti, konkretisht nga të gjitha institucionet qendrore të

tij, informacioni i klasifikuar që është nën zotërimin e shtetit, i cili është “*pronar*” i këtij informacioni. Për të dy rastet, shteti ka përgjegjësi për sigurinë e këtij informacioni.

2.2. Klasifikimi i informacioneve

Vendimmarrja institucionale e një vendi ka nevojë për informacion të analizuar. Në këtë kuadër, informacioni preferencial për vendimmarrjen mund të kategorizohet e grupohet, parë nga këndvështrime të ndryshme. Në këtë kategori do të përfshihen informacione politike. Konsiderohen të tilla informacionet që u referohen mënyrës së funksionimit të qeverisë, politikave të brendshme e të jashtme, procesit zgjedhor, gjendjes së sigurisë në tërësi, kriminalitetit, funksionimit të pushtetit gjyqësor dhe institucioneve të tjera të rëndësishme, etj.

Në informacionin preferencial do të përfshihen edhe informacionet me karakter ushtarak. Konsiderohen të tilla të gjitha ato që u referohen çështjeve si, kuadri ligjor e kushtetues i forcave të armatosura, pozita e tyre kundrejt popullit dhe shtetit, strukturat organizative, organizimi ushtarak, komandat, numri i efektivave, hallkat drejtuese, etj. Pavarësisht se kjo kategori mbahet si informacion preferencial i klasifikuar, mënyra e përdorimit të këtyre forcave vlerësohet si informacion i rëndësishëm së veçantë.

Organizimi në kohë paqeje dhe lufte, teknika luftarake, sistemet e armëve, cilësia, sasia dhe efikasiteti i tyre, fuqia ushtarake, kazermat, bazat detare, ajrore, tokësore, sistemet e raketave, radarëve, mbështetja logjistike, buxheti vjetor dhe resurse të tjera jashtë tij, si ndihma nga vende të tjera, nga aleatët, etj. konsiderohen të tilla. Në këtë kategori futen edhe sistemet mbrojtëse dhe sulmuese, strategjia dhe taktikat e luftës, rregulloret, urdhrat e luftimit, pikat e forta dhe të dobëta, disiplina, morali, mënyrat e stërvitjes, informacione për numrin e njësisve ushtarake, llojshmërinë e armëve, përbërjen e forcave të armatosura, venddislokimet, misionin, objektivat dhe detyrat ushtarake etj.

Analiza e informacionit me karakter ushtarak u nënshtrohet të gjitha situatave që përfitohen dhe përvojave që sjell historia në këtë fushë. Dëshira e kombit për luftë, shkalla e demokracisë, natyra e shtetit, është një tjetër element shumë i rëndësishëm i analizave ushtarake. Në vendet me demokraci të zhvilluar, vlerë e qytetërimeve të avancuara, rezistenca pacifiste është më e fortë, kurse dëshira për luftë më e vogël.

Informacion i klasifikuar konsiderohen edhe të dhënat që kanë të bëjnë me Teknologjitë Ushtarake. Një informacion i saktë për qendrat shkencore, eksperimentuese e prodhuese të teknologjive ushtarake dhe të efektivitetit të tyre në praktikë, është me rëndësi. Por, jo të gjitha vendet janë në gjendje të prodhojnë teknologji ushtarake të avancuar e të sofistikuar, duke u përpjekur t'i sigurojnë ato në mënyra dhe rrugë të ndryshme.

Informacion i klasifikuar konsiderohen të dhëna që u referohen personaliteteve të spikatura të një vendi në të gjitha fushat, sidomos në atë politike. Interesi për këto të dhëna është i madh, sepse individët brenda apo jashtë sistemit të partive, dhe në pozicione ndërshtetërore kanë ndikim të madh dhe sipas rastit dhe ndonjëherë vendimtar në jetën politiko - shoqërore të një vendi.

Informacion i klasifikuar konsiderohen informacionet me karakter ekonomik. Të tilla konsiderohen ato që u referohen problemeve ekonomike, si politikat ekonomike të një vendi, niveli i prodhimit, shpërndarjes dhe përdorimit të burimeve ekonomike, cënueshmëria ekonomike, cilët sektor të ekonomisë janë më të prekshëm që me një ndërhyrje ose me operacione të posaçme, mund të shkaktojë tronditje të mëdha shoqërore, politike, etj.

Informacion i klasifikuar konsiderohen informacionet me karakter social. Kjo kategori kanë të bëjnë me elementë të tillë si popullsia, karakteristikat sociologjike, forcat e punës, kultura, traditat, arsimi, feja, shëndetësia dhe të tjera të kësaj natyre, të cilat lidhen me sigurinë e brendshme të një vendi.

Informacion i klasifikuar konsiderohen informacione me karakter gjeografik, në të cilat përfshihen të dhëna me karakteristika gjeografike, klimën, pasuritë natyrore, sistemet hidroenergjitike, terrenin, pyjet, pozita gjeografike në rajone e kontinent, etj. Gjithashtu, informacion i klasifikuar konsiderohen edhe informacionet për shërbimet sekrete, të cilat japin statusin ligjor të shërbimit inteligjent, strukturat e tij, vartësitë, personelin, hallkat drejtuese, shkallën e depërtueshmërisë, kriteret e rekrutimit, diagramat, organizimi i punës, rrjetet agjenturore, prioritetet e punës, kopetencat, qëndrat e teknologjisë etj.

Informacion i klasifikuar konsiderohen informacione tekniko – shkencore, të cilat kanë të bëjnë me mundësitë në fushën e zbulimeve shkencore dhe ekperimentuese, shkallën e zbatimit në praktikë dhe mundësitë për të ardhmen, programet shkencore dhe financimet, teknologji të veçanta, teknika, sistemet bërthamore, kimike, kozmike, bakteriologjike, etj. Po kështu, informacion i klasifikuar konsiderohen informacionet në fushën e transport – telekomunikacionit, ku përfshihen të dhënat mbi sistemin e rrugëve, superstradave, lundrimit, hekurudhave, sistemet e telefonisë, telegrafisë, radiotelevizionit, përforcuesit, sistemet satelitore, rrjetat informatike, etj.

I vlerësuar në të gjitha këto kategori, informacionet mund të grupohen në ato të karakterit statik, që u referohen kryesisht objektivave të palëvizëshme, të qëndrueshme, subjekteve të parashikueshme për të ndryshuar në periudha kohe shumë të gjata, të njësuar në vija të trasha me ato strategjike dhe përfshijnë dije enciklopedike si historia e një vendi, tradita, kultura, psikologjia, pasuritë natyrore, popullsia, gjeografia, regjimi politik, traditat dhe karakteri i një populli, infrastruktura, forcat e armatosura, etj.

Zotërimi i këtyre të dhënave është shumë i nevojshëm për analizë, sepse ato përbëjnë skeletin mbi të cilin vendosen, vlerësohen, integrohen dhe interpretohen të dhënat që i referohen atij vendi ose problemi. Rëndësia e këtyre të dhënave rritet shumë, sidomos në situata lufte, krizash, konfliktesh dhe acarimesh ndërshtetërore, rajonale dhe globale. Gjithashtu kemi kategorinë e informacioneve dinamike, të cilat u referohen dinamikës së zhvillimeve të brendshme e të jashtme, aktiviteteve të paparashikuara, atyre që janë në proces, por që pasurohen me elementë të rinj, etj. Të tilla mund të jenë të dhënat që i referohen një rebelimi, grushti shteti, veprimtarive të terrorizmit. Këto të dhëna ndihmojnë Qeverinë në marrjen e vendimeve të caktuara si dhe në vlerësimin e situatave që kalon vendi. Këto kategori informacionesh janë të mbledhura dhe të përpunuara nga burime dhe struktura të institucionalizuara.

Nga pikëpamja e burimeve, funksionojnë informacione të siguruar nga burime njerëzore, nga mjetet teknike (përgjimet fotografimet, filmimet, sistemet e radarëve), si dhe nga burimet e hapura (mediatike). Informacionet ndahen edhe duke u bazuar në nivelin e shprehur në përmbajtjen e tyre. Sipas kësaj ndarje, kemi, informacione të nivelit strategjik, që përfshijnë aspekte të përgjithshme (globale) të problemeve politike, ushtarake, ekonomike, shkencore, etj. me interes për sigurimin kombëtar. Gjithashtu, vlerësohen informacionet e nivelit operativ, të cilat shërbejnë për planifikimin e operacioneve që drejtohen kundër kërcënimeve të ndryshme, sidomos ato që kanë të bëjnë me fushën ushtarake. Së fundi, vijnë informacionet e nivelit taktik, të cilat lidhen me veprime, kombinacione e situata që shtrihen në periudha relativisht të shkurtra kohore. Ndërsa, bazuar në nevojën për sigurim me procedurë dhe standarte të veçanta, specifikohen të rëndësishëm, informacionin që me ligj është i klasifikuar “*sekret shtetëror*”.

Këto kategori informacionesh ndërtohen e përcillen tek strukturat vendimmarrëse, jo në trajtën “bruto”, por duke iu nënshtruar më parë një analize paraprake, që në vetvete përbën një veprimtari të pastër intelektuale, që kërkon aftësi dhe eksperiencë të madhe në fushën inteligjente, sepse nëpërmjet këtij procesi kompleks, arrihet kapja e hollësive të rëndësishme që mund të jenë element thelbësor apo kontradiktor në fatin dhe ardhmërinë e një vendi.

Përcaktimi i prioriteteve të asaj që duhet ditur në funksion të vendimmarrjes, arrin që të mos lejohen që të harxhohen energji të barabarta e të njëjta për probleme me rëndësi të ndryshme. Analiza shkencore e dialektike në këtë fushë, jo vetëm konturon fenomenin, rrezikun, zhvillimin, por jep dhe përmasat reale të tyre, vendin që ato zenë në sfondin e përgjithëshëm të shoqërisë, duke shmangur tendencat zmadhuese ose zvogëluese, mbivlerësuese ose nënvleftësuese me pasoja në fushën e sigurisë.

Kjo analizë shmang dizinformacionin që mund të “*prodhojë destabilitet*”. Dhënia e elementëve të parashikimit, prognozës për të ardhmen, skenarët e mundshëm të zhvillimeve të caktuara brenda dhe jashtë vendit, vënë në peshorë faktorët pengues, negativ, me tendencat e përgjithshme të zhvillimit apo me rrymat dominuese, duke dhënë në këtë mënyrë elementin e parashikimit. Kjo analizë ndihmon

vendimmarrjen institucionale shtetërore në hartimin e politikave të brendshme e të jashtme, sipas kërkesave që burojnë nga vetë Strategjia e Sigurisë Kombëtare.

3. Kërcënimet ndaj sigurisë së informacionit.

3.1. Metodat dhe standardet e sigurisë së informacionit në marrëdhëniet ndërkombëtare

Sigurimi i informacioneve përballë kërcënimeve duhet parë në kuadrin e një detyrimi për ruajtjen e balancave mes interesave kombëtare, të drejtës së individit dhe shoqërisë për t'u informuar dhe veprimtarisë normale të institucioneve të shtetit demokratik. Sigurimi i informacionit rrit mundësinë e përdorimit efikas të fuqisë së tij për sigurinë kombëtare me vendimmarrjen e shpejtë dhe të saktë dhe me veprimet në kohën e duhur, për të shmangur pasoja të caktuara në dëm të sigurisë kombëtare.

Dokumenti i Strategjisë së Sigurisë Kombëtare të RSH, *“e vlerëson informacionin si faktor gjithmonë e më shumë të rëndësishëm për forcimin e sigurisë kombëtare”*, (SSK, 2006:39) duke kërkuar *“ndalimin e përdorimit të informacionit për qëllime të manipulimit të ndërgjegjes së publikut. Po ashtu, do të kërkohet garantimi me ligje të veçanta i mbrojtjes së informacionit të klasifikuar shtetëror në fusha të veçanta si dhe ai ndërshetëror, apo me organizma ndërkombëtare që buron nga marrëveshjet midis palëve”*. (SSK, 2006:39) Rëndësia e sigurimit të informacionit nga kërcënimet e mundëshme të tij, diktohet edhe për faktin se ai është mjet i rëndësishëm *“për parandalimin e krimit e të krizave të brendshme”* për faktin se, *“nuk mund të përjashtojmë mundësinë e ekzistencës së grupeve kriminale dhe të trazirave publike”* (SSK, 2006:40).

Në këtë vlerësim është parë me rëndësi edhe *“funksionimi i një sistemi efektiv të informimit sekret”*, që natyrisht duhet siguruar e mbrojtur nga ndërhyrjet dhe përhapjet e paautorizuara. Thelbi i interesave në fushën e sigurimit të informacionit, përmban në vetvete respektimin me rigozitet të të drejtave e lirive kushtetuese të individit në fushën e të drejtës për t'u informuar, marrë, transmetuar e prodhuar, pa u penguar e me tërë format e ligjshme informacion publik real, duke krijuar kushte për respektimin dhe zbatimin e ligjeve përkatëse në fushën e informacionit të klasifikuar.

Kërcënimet e sigurisë së informacioneve në përgjithësi prekin fusha të ndryshme të veprimtarisë së institucioneve të një vendi. Presionet kërcënuese të sigurisë informacioneve në sferat ekonomike, kanë qenë dhe janë të pranishme në sistemin statistikave shtetërore, sistemin kredito - financiar; në sistemet e automatizuara të bazave të të dhënave, sistemet e kontabiliteteve, bursës, informacioneve doganore, etj. Kërcënime serioze për funksionimin normal tërësor ekonomik, paraqesin krimet në rrjetet kompjuterike, krime këto që kanë të bëjnë me infiltrimin kriminal të elementëve në sistemet kompjuterike dhe në rrjetet e bankave dhe organizatave të ndryshme të kreditit.

Kështu në sistemet e grumbullimit, përpunimit, ruajtjes dhe shpërndarjes së të dhënave të financave, tatim - taksave, të doganave, veprimet antiligjore me pasoja të rrezikshme, konsiderohen kopjimet e të dhënave (informacioneve) dhe ndryshimet e përmbajtjes së tyre nëpërmjet prishjes me paramendim apo të rastësishëm të teknologjisë së punës me informacionin, dhe përfitim të jashtëligjshëm të tij. Këto dukuri favorizohen nga mungesa e një baze ligjore të plotë në këtë fushë.

Kërcënimet ndaj sigurisë së informacioneve të klasifikuara, paraqiten në forma të ndryshme dhe në kuptimin e përgjithshëm, ato shihen në grumbullimin dhe shfrytëzimin e paligjshëm të tyre, me ndërhyrjet në sistemet e fjalëkalimeve që sigurojnë mbrojtje ndaj aksesit të paautorizuar, me ndërhyrje në paisjet e sigurimit kriptografik të informacioneve, me futjen e paisjeve elektronike të intercepimit të informacioneve (edhe nga distanca), në paisjet teknike të përpunimit, ruajtjes dhe transmetimit të informacionit, pra në kanalet e rrjetit të brendshëm ndërlidhës, me futjen e këtyre paisjeve të përgjimit në ambjentet, që veçanërisht kanë të bëjnë me informacionin e klasifikuar, me interceptimin e informacionit në rrjetet e transmetimit të të dhënave apo në linjat e komunikimit, deshifrimi i këtij informacioni, si dhe sajimi i informacionit të rreme, etj.

Në analizën e burimeve se nga vijnë këto kërcënime për sigurinë e informacionit, ndarjet dhe grupimet, mund të ishin të shumëllojshme, por me interes është të veçohen dy kategori kërcënimesh: kërcënime me burim nga jashtë vendit dhe burime me kërcënim nga brenda vendit.

3.2 Metoda e garantimit të sigurisë.

Zhvillimet politike shoqërore e ekonomike aktuale në vend, sjellin kundërshti mes kërkesave të shoqërisë dhe opinionit publik për zgjerimin e këmbimit të lirë të informacionit, me domosdoshmërinë nga ana tjetër, të sigurimit të mbrojtjes përmes rregullave ligjore kufizuese të përhapjes, apo ruajtjes nga dëmtimi dhe ndërhyrjet e paautorizuara mbi kategori të kufizuara informacionesh. Megjithëse vitet e fundit është shënuar progres në fushën e sigurisë së informacionit në aspektet ligjore, organizative dhe financiare, përsëri ka probleme.

Institucionet tona vuajnë nga dy tendenca; nga njëra anë vihet re tendenca e mbylljes dhe hermetizimit të pabazuar në ligj të informacioneve, pra e klasifikimit të tyre; dhe nga ana tjetër është prezent tendenca e shprehur në *“mospatjen e asnjë informacioni të klasifikuar”* në emër të shoqërisë së hapur, por përsëri pa u bazuar në legjislacionin përkatës.

Mungesat e specialisteve të kualifikuar dhe të informuar në fushën informacioneve të klasifikuara shtetërore, problemet financiare apo sëmundjet korruptive jo rrallë herë i detyrojnë institucionet

shtetërore që për krijimin e sistemeve informative, të ndjekin politikën e blerjeve apo “*dhurimeve*” nga jashtë, shumë herë në mënyrë të pakontrolluar e të pashoqëruar me dokumentacion garantues, duke u krijuar me këtë rast “*shanse*” dhe propabilitet për ndërhyrje të paautorizuara në informacionet e përpunuara dhe të analizuara që mbartin këto rrjete informatike. Duket, se në vendin tonë akoma nuk ka një perceptim të drejtë për realitetet e mundshme kërcënuese nga aplikimi i formave të “*luftës informative*” prej strukturave kriminale dhe elementëve terroristë.

Metodat e përgjithshme të sigurisë së informacioneve mund të grupohen në: ligjore, organizativo - teknike dhe ekonomike. Në garantimin ligjor të kësaj sigurie bëjnë pjesë, përpunimi i akteve ligjore normative, që përcaktojnë standardet e detyrueshme dhe dokumentacionin që ka të bëjë me çështjet e garantimit të sigurisë së informacioneve. Në këtë kuadër, është i nevojshëm rishikimi periodik me synim për të bërë ndryshime apo dhe plotësime në legjislacion, të cilat rregullojnë raportet e reja të marrëdhënieve në fushën e sigurisë së informacioneve. Është e rëndësishme të bëhet përcaktimi ligjor i kompetencave, në fushën e garantimit të sigurisë informative.

Gjithashtu është e domosdoshme të bëhet përpunimi dhe aplikimi i akteve normative ligjore që përcaktojnë përgjegjësitë që mbajnë personat juridikë apo fizikë në rastet e ndërhyrjes së paligjshme në informacion, (pavarësisht se ato mund të mos e përhapin), ose për raste si fotokopjimet e jashtëligjshme, (kur ndalohet riprodhimi për arsye sigurie), ose për shfrytëzimin për qëllime përfitimi e për qëllime kriminale të informacionit zyrtar, apo informacionit që përmban të fshehta komerciale.

3.3 Metodat organizativo - teknike.

Shteti, në proceset e realizimit të detyrave të tij funksionale për sigurinë informacionale duhet të zhvillojë analiza objektive në të gjitha drejtimet, dhe të parashikojë kërcënimet e mundshme në sferat e sigurisë informative. Mbi këtë bazë duhen përpunuar masat aktive me profil parandalues. Mospërdorimi i mjeteve informatike apo i programeve që përbëjnë rrezik për funksionimin normal të sistemeve informativo-telekomunikative. Vënia në punë e mjeteve kriptografike të mbrojtjes informative në procesin e akumulimit, përpunimit dhe transmetimit nëpërmjet kanaleve komunikative, të informacioneve që kanë nevojë për një masë të tillë, me përparësi informacionet e klasifikuara.

Standartizimi i mënyrave dhe mjeteve të mbrojtjes informative përmes sistemeve të çertifikimit të aparaturave telekomunikative dhe monitorimi i aftësive dhe veprimtarisë së personelit që merret sistemet mbrojtëse të informacionit, metodat ekonomike të garantimit të sigurisë së informacioneve, përfshijnë përpunimin e programeve të garantimit të sigurisë informative dhe përcaktimin e radhës për financimin e tyre. Gjithashtu këtu përfshihet edhe aspekti i trajtimit të lartë financiar për individët që kanë përgjegjësitë të admistrojnë rrjete informatike, baza të dhënash etj.

4. Kuptimi juridik – ligjor i informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror”.

Garantimi i të drejtës së informacionit dhe ruajtjes së tij, i është vënë në baza ligjore, që garantojnë standardet demokratike të funksionimit të elementëve të Sigurisë kombëtare. Kështu, ligji nr. 8457, datë 11. 2. 1999, “Për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror”, i ndryshuar me Ligjin nr. 9541, datë 22. 5. 2006 (Fletore Zyrtare, 06 :2006) “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8457, date 11. 2. 1999, “Për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror”, përcakton qartë, së pari, rregullat për klasifikimin, përdorimin, ruajtjen dhe deklasifikimin e informacionit për sigurinë kombëtare, i cili, me këtë ligj, do të konsiderohet « sekret shtetëror”. (Fletore Zyrtare, 06 :2006) Shteti dhe përfaqësuesit institucional të tij janë të vetmit zotërues të sekreteve shtetërore, duke e rregulluar këtë të drejtë me të drejtën e publikut për t'u njohur me veprimtarinë e tij.

Në kuptimin e këtij ligji, "sekret shtetëror" do të thotë informacion i klasifikuar, sipas këtij ligji, ekspozimi i paautorizuar i të cilit mund të rrezikojë sigurimin kombëtar. "Sigurim kombëtar" do të thotë « mbrojtja e pavarësisë, integritetit teritorial, rendit kushtetues dhe marrëdhënieve me jashtë të Republikës së Shqipërisë. (Fletore Zyrtare, 06:2006).

• "Klasifikim", do të thotë, akti apo procesi nëpërmjet të cilit një informacion përcaktohet si i klasifikuar. Në këtë kategori futen sekreti shtetëror, në bazë të përmbajtjes, të vlerave dhe interesit shtetëror klasifikohet në njerin nga nivelet e mëposhtme:

• "Teper sekret", kur ekspozimi i paautorizuar mund t'i shkaktojë dëme, veçanërisht të rënda sigurisë kombëtare.

• "Sekret", kur ekspozimi i paautorizuar mund t'i shkaktojë dëme serioze sigurisë kombëtare.

• "Konfidencial", kur ekspozimi i paautorizuar mund t'i shkaktojë dëme sigurisë kombëtare.

• "I kufizuar", kur ekspozimi i paautorizuar mund të dëmtojë veprimtarinë, ose efektivitetin e institucioneve shtetërore në fushën e sigurisë kombëtare.

Autoriteti klasifikues i informacioneve në këto kategori janë Presidenti i Republikës dhe Kryeministri i shtetit. Vetëm prej tyre mund të ushtrohet autoriteti për klasifikimin e informacionit duke j'u adresuar drejtuesve të institucioneve të autorizuara nga Kryeministri në Regjistrin Shtetëror të Informacionit të Klasifikuar, funksionarëve të lartë brenda këtyre institucioneve, që e marrin këtë autoritet me anë të delegimit nga autoriteti i klasifikimit origjinal. Kjo procedurë me bazë ligjore realizohet nëpërmjet procedurës së klasifikimit të informacionit në të gjitha institucionet shtetërore, të cilat krijojnë (prodhojnë) dhe administrojnë informacion të klasifikuar “sekret shtetëror”, që kanë të drejtë të bëjnë klasifikimin e tij, në mbështetje të nenit 6, të ligjit 8457, date 11. 02. 1999, “Për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror”, dhe në përputhje me të hartojnë listat e dokumenteve të

klasifikuara. Kjo procedurë miratohet nga titullari i ministrisë apo i institucionit që ka autoritetin e klasifikimit origjinal.

Pranë çdo institucioni, që ka të drejtën e klasifikimit origjinal, krijohet, me urdhër të titullarit Komisioni i shqyrtimit të informacionit të klasifikuar “*sekret shtetëror*”, me jo më pak se 5 anëtar, kryetar i të cilit është titullari. Ky komision shqyrton llojet e dokumentacionit që prodhon institucioni dhe propozon atë kategori dokumentesh që duhen klasifikuar, rivlerësuar, nivelin e klasifikimit dhe afatin e ruajtjes së këtij niveli. Në përcaktimin e afatit të ruajtjes së informacionit të klasifikuar merret për bazë ndjeshmëria e tij në lidhje me sigurimin kombëtar.

Klasifikimi i informacionit për herë të parë, bëhet për një kohë jo më pak se 10 vjet, për çdo nivel të klasifikimit, me përjashtim të rastit kur autoriteti klasifikues vendos ndryshe. (Këtu është fjala për informacione të niveleve “*i kufizuar*” apo edhe “*Konfidencial*”, ku klasifikimi bëhet për një afat më të shkurtuar). Për të lehtësuar procesin e klasifikimit origjinal institucionet, që bëjnë klasifikimin e informacionit, në përputhje me nenin 6 të ligjit, hartojnë listen e dokumenteve të klasifikuara, si dhe nivelet e klasifikimit dhe afatet e ruajtjes. Kjo listë miratohet nga titullari i institucionit.

4.1 Sigurimi i informacionit në marrëdhëniet ndërkombëtare

Vlerësimi i përgjithshëm. Me “*Informacion i qeverive të huaja*” duhet kuptuar, informacionin e siguruar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, nga qeveri të huaja, organizata ndërkombëtare apo ndonjë element tjetër, me kusht që informacioni dhe burimi i tij të mbahen në konfidencë. Informacioni i fituar si rezultat i një marrëveshjeje të përbashkët me qeveri të tjera apo me organizata ndërkombëtare, me kusht që, përkatësisht, informacioni apo marrëveshja apo të dyja, të mbahen në konfidencë.

Institucionet përkatëse e ruajnë informacionin e klasifikuar të shteteve të huaja apo organizatave ndërkombëtare sipas standardeve që sigurojnë një shkallë mbrojtjeje, të njëjtë me atë që kërkohet nga shteti apo organizata ndërkombëtare. Personat e ngarkuar me ruajtjen dhe administrimin e informacionit të klasifikuar, kur vihen në dijeni të faktit të vjedhjes, marrjes, dhënies dhe çdo mënyre tjetër të rrjedhjes së informacionit të klasifikuar, si dhe të objekteve të tjera që kanë të bëjnë me sekretin shtetëror, janë të detyruar të njoftojnë drejtuesin e institucionit përkatës, ndërsa jashtë shtetit drejtuesin e përfaqsisë diplomatike apo konsullore të Republikës së Shqipërisë.

Shkelja e rregullave për administrimin, ruajtjen, nxjerrjen dhe asgjësimin e informacionit të klasifikuar “*sekret shtetëror*” dënohet sipas ligjeve në fuqi. Të tilla informacione mund të jenë, korespondenca, informacione, udhëzime, analiza, prognoza, teza takimesh dhe çdo dokument tjetër i prodhuar në kuadrin veprimtarive ndërkombëtare të Republikës së Shqipërisë me qeveri e organizata

ndërkombëtare, ku trajtohen qëndrimet e politikës së jashtme të vendit, çështje të sigurisë kombëtare, ose aspekte të mprehta të konjunkturës ndërkombëtare.

Korespondenca dhe dokumentacioni shoqëruet gjatë shkëmbimit të Informacionit të Klasifikuar me NATO-n, vendet anëtare të NATO-s dhe të Pfp, apo organizata të tjera ndërkombëtare; ekstrakte të nxjerra nga informacioni i klasifikuar i NATO-s, vendeve anëtare të NATO-s e Pfp dhe organizatave të tjera ndërkombëtare, mbrojtja e të cilave është specifikuar në një traktat, marrëveshje, apo ndonjë obligim tjetër ndërkombëtar. Dhënia e aksesit personave shqiptarë për këto kategori duhet bazuar në parimin *“nevojë për njohje”* dhe vetëm për personat e pajisur me certifikatë sigurie të përshtatshme.

4.2 Marrëveshjet e përbashkëta për mbrojtjen e informacioneve të klasifikuara.

Është e rëndësishme të nënvizohet, se sigurimi i informacionit të klasifikuar në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare bëhet në bazë të marrëveshjeve të sigurimit të konceptuara nga Autoritetet e Sigurimit Kombëtar të vendeve palë në marrëveshje. Ministrinë dhe institucionet shtetërore kanë detyrimin ligjor, që përpara nënshkrimit të një marrëveshjeje ose protokollit teknik që përfshin shkëmbimin e informacionit të klasifikuar, të marrin më parë mendimin e Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, (DSIK).

Nga ana tjetër, përpara nënshkrimit të një marrëveshjeje ose protokollit teknik që përfshin shkëmbimin e informacionit të klasifikuar, duhet të jetë lidhur më parë Marrëveshja për Sigurimin e Informacionit të Klasifikuar ndërmjet Autoriteteve të Sigurimit Kombëtar të shteteve palë në marrëveshje. Në çdo rast shkëmbimi i informacionit të klasifikuar në mes dy vendeve duhet të bëhet vetëm në përputhje me marrëveshjen e nënshkruar.

Në bazë të VKM Nr. 377, datë 31.5. 2001, *»Për sigurimin e informacionit të klasifikuar në marrëdhënie ndërkombëtare“*, (Fletore Zyrtare, 06 :2001) në vendin tonë, DSIK, është Autoriteti i Sigurimit Kombëtar në fushën e informacionit të klasifikuar me NATO-n, me shtetet dhe me organizatat e tjera ndërkombëtare. Shkëmbimi i informacionit të klasifikuar ndërmjet NATO-s dhe RSH drejtohet nga DSIK-ja. Kjo do të thotë që informacioni i klasifikuar i NATO-s për Shqipërinë, dhe anasjelltas, shkëmbehet përmes Zyrës së Regjistrimit Shtetëror Qëndror që është ngritur në DSIK. Kjo Zyrë bën regjistrimin, shpërndarjen dhe dërgimin e ndërsjellë të informacionit tek i adresuari.

Në institucionin e Presidencës, Këshillit të Ministrave, Ministrisë së Mbrojtjes, Ministrisë së Jashtme, Ministrisë së Brendshme, në Misionin e Republikës së Shqipërisë në NATO, etj janë ngritur dhe funksionojnë Zyrat e Nënregjistrimit të informacionit të klasifikuar të NATO-s. DSIK - ja dhe ASK e shtetit janë palë në marrëveshje, kanë të drejtë të ushtrojnë kontrolle për mbrojtjen dhe sigurimin e informacionit të klasifikuar, në vendet respektive.

Aktualisht, vendi ynë shkëmbimin e informacionit të klasifikuar e realizon bazuar në disa marrëveshje ndërkombëtare, si me SHBA; Marrëveshje “*Per sigurimin e informacionit të klasifikuar "sekret shtetëror"*” ndërmjet RSH dhe NATO-s”, « nënshkruar më 26 Korrik 1994 dhe e ratifikur nga Kuvendi i Shqipërisë me ligjin nr. 8922, datë 22.7.2002 »; (Fletore Zyrtare, 2002). Marrëveshje me Poloninë, Maqedoninë e Veriut, Greqinë, Estoninë, dhe është në proces negociatash me Hollandën, Italinë, Kroacinë, etj.

Në thelb kjo marrëveshje parashikon, mbrojtjen dhe sigurimin e informacionit, informacioni të ruaje klasifikimet e sigurisë të burimit, informacioni të mos përdoret për qëllime të tjera, informacioni të mos i jepet Palëve të treta pa pëlqimin e burimit, personat që mund të kenë akses të jenë të çertifikuar. ASK-të janë Autoritetet përkatëse që përgjigjen për mbrojtjen e informacionit të shkëmbyer, dhe ky është detyrimi i Palëve për plotësimin e standardeve reciproke të sigurimit të informacionit të shkëmbyer etj.

4.3 Sistemi i regjistrimit dhe sigurimit të informacionit “të klasifikuar” të NATO - s.

Në nenin 27 të Ligjit nr. 8457, datë 11. 02. 1999, “*Për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror”*” ndryshuar me Ligjin nr. 9541, datë 22. 05. 2006 “*Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8457, date 11. 02. 1999, “Për informacionin e klasifikuar ”sekret shtetëror”*”; (Fletore Zyrtare, 06 :2006) jepet përcaktimi i Sistemit të Zyrave të Regjistrimit përmes të cilave qarkullon informacioni i klasifikuar i përfutur në kuadrin e marrëdhënieve ndërkombëtare. Kështu, sistemi i zyrave të regjistrimit të informacionit të klasifikuar të NATO-s, përbëhet nga Zyra e regjistrimit Qëndror në DSIK, zyrat e nënregjistrimit të informacionit të klasifikuar të NATO-s dhe pikat e kontrollit që krijohen në ministri dhe institucione shtetërore.

Ky sistem është përgjegjes për regjistrimin, shpërndarjen dhe administrimin e informacionit të klasifikuar të shkëmbyer në kuadrin e bashkëpunimit me NATO-n. Ndërmjet sistemit të zyrave të regjistrimit qarkullon edhe informacioni i klasifikuar i shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare. Ministrinë dhe institucionet shtetërore mbrojnë informacionin e klasifikuar të NATO-s, shteteve të tjera dhe organizatave ndërkombëtare sipas standardeve që sigurojnë shkallë të njëjtë me atë që kërkohet nga NATO, shteti, ose organizata ndërkombëtare. Me ligjin nr. 8922, datë 22. 07. 2002 “*Për ratifikimin e “Marrëveshjes për sigurimin e informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror” ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe NATO-s*”, (Kuvendi i RSH, 07:2002) vendi ynë është Palë që mbart të drejta dhe detyrime në kuadrin e mbrojtjes së përbashkët të informacionit të klasifikuar të NATO-s.

Informacioni i klasifikuar i NATO-s i adresuar për Shqipërinë është vetëm për përdorim zyrtar. Ai do të shpërndahet vetëm tek individët në bazë të parimit “*nevoje-për-njohje*”. Ministrinë dhe institucionet tona shtetërore janë të detyruara të respektojnë standartet minimum të përcaktuara në

Dokumentin e Politikës së Sigurisë së NATO-s. (DPS). Në nenin “1” të marrëveshjes me NATO-n thuhet: Palët, do të mbrojnë dhe sigurojnë informacionin dhe materialin e Palës tjetër; do të bëjnë çdo përpjekje që, në qoftëse ai është i klasifikuar, ky informacion dhe material do të ruajë klasifikimet e sigurisë të vendosura nga ndonjë Palë, në përputhje me origjinën e informacionit dhe materialit të asaj Pale dhe të sigurojnë informacionin dhe materialin sipas standarteve të aprovuara; të mos e përdorin informacionin dhe materialin e shkëmbyer për qëllime të tjera, përveç atyre të vendosura në kuadrin e programeve respektive, vendimeve dhe rezolutave që i referohen këtyre programeve; të mos ia japin këtë informacion dhe material Palëve të treta pa miratimin e prodhuesit origjinal.

Ndërsa në nenin 2, thuhet: Qeveria e Republikës së Shqipërisë pranon angazhimin që të gjithë personat e nacionalitetit të saj, të cilët në kryerjen e detyrave të tyre zyrtare kërkojnë ose mund të kenë akses në materialin apo informacionin e shkëmbyer sipas programeve të NACC apo PFP të jenë të çertifikuar përpara se atyre t’u jepet akses në këtë material dhe informacion. Procedurat e çertifikimit duhet të jenë të tilla që të përcaktojnë se kur një individ, duke patur parasysh besnikërinë dhe besueshmërinë e tij mund të ketë akses tek informacioni i klasifikuar pa rrezikuar sigurinë e këtij informacioni.

Pra, këtu shikojmë disa detyrime të rëndësishme që duhen aplikuar nga Sistemi i Regjistrimit dhe të gjitha strukturat e individët, që veprimtarinë e tyre zyrtare e kanë të lidhur me informacionin e klasifikuar të NATO-s. Zhvillimet e vrullshme në fushën e kibernetikës kanë bërë të mundur që informacioni tepër i shpejtë të jetë i pranishëm jo vetëm në çdo pikë të tokës dhe hapësirës, por të prekë gjithë aspektet e jetës dhe të veprimtarisë të individit dhe të shoqërisë njerëzore në tërësi. Ndërkohë, sot asnjë degë e shkencës nuk mund të zhvillohet pa qenë e lidhur me kompjuterin. Nevojat në rritje të shkencës, të ekonomisë dhe në tërësi të shoqërisë njerëzore për të mbledhur një numër të madh të dhënash dhe për t’i përpunuar e analizuar ato, mund t’i bëjë vetëm kompjuteri dhe në një interval kohor të paimagjinueshëm në të milionat e sekondës.

Pra siç shihet, me anë të sistemit kompjuterik drejtohen sektorë të rëndësishëm të ekonomisë, financave si edhe struktura që merren me rendin publik apo sigurinë kombëtare. Por nga ana tjetër, janë të paparashikueshme pasojat katastrofike që do të sillte një ndërhyrje sado e vogël, ose siç mund ta quajmë një “shkëndijë”, në këto sisteme. Në këtë kuptim kompjuteri, ky mjet që ka përshpejtuar zhvillimin ekonomik e social të shoqërisë njerëzore në këta 10-vjeçarët e fundit, mund të shndërrohet në një armë shumë të rrezikshme në duart e individeve apo grupeve kriminale.

Pirateria nëpërmjet internetit përbën sot një shqetësim global dhe me pasoja ekonomike në shkallë shqetësuese. Edhe në Shqipëri krimi kibernetik nuk mund të quhet më sporadik. Ai po gjen përhapje graduale dhe po kthehet në një kërcënim serioz dhe real. Vjedhjet nëpërmjet internetit dhe veçanërisht vjedhja e llogarive bankare apo kartave të kreditit, kanë gjetur terren të përshtatshëm.

Në vitin 2008 janë të regjistruara mbi 23 milion e 508 mijë raste të sulemeve të drejtuara nga burimet e internetit në mbi 126 shtete anembanë botës. Kjo vërteton se krimi kompjuterik është kthyer në një fenomen global dhe në mënyrë virtuale çdo shtet në botë sot preket nga programet keqberëse të sistemit kompjuterik. Sipas të dhënave, mbi “99 për qind e sulmeve e kanë burimin nga 20 shtetet më të zhvilluara të botës”. (Veton G. Vula, 2010:136).

Kriminaliteti kompjuterik, për shkak të karakterit të tij specifik, të rrezikshmërisë së lartë dhe shkallës së tij në rritje, në një masë të madhe po bëhet një problem i vërtetë shoqëror, jo vetëm në përmasa kombëtare, por dhe ndërkombëtare. Në studime bashkëkohore janë të paraparë mjaft dukuri të sistemeve kompjuterike, të cilat përdoren në hapësira të gjera në krimin kompjuterik. Në këto studime, janë të vlefshme njohja e faktorëve objektiv të zhvillimit të kriminalitetit kompjuterik, duke dhënë një pasqyrë të qartë edhe të vetë sistemeve institucionale të organizuara të mbrojtjes prej tij. Në të gjashtë pikat e referencës në botimin “*Kriminaliteti Kompjuterik*”, (Veton G. Vula, 2010:143). ky fenomen i ri në veprat penale përcaktohet si, “*kriminalitet i shoqërisë bashkëkohore*”, “*i mjedisëve urbane*”, “*kriminalitet global*” që nuk njeh kufij, “*kriminalitet i njerëzve të arsimuar*” me shkallë të lartë dijesh në këtë fushë, “*i pamundësisë së kundërvënies*” ndaj tij pasi mjetet e sofistikuara nuk japin garanci kundër tij, dhe së fundi si “*kriminalitet i shekullit të 21*”, që do të shtojë në çdo kohë kryerësit e veprave të tilla penale.

Shtrirja e rrjetit kompjuterik edhe në të gjithë Shqipërinë rrit potencialisht mundësinë për të ndërhyrë në mënyrë të paligjshme në këtë sistem, për të marrë, ndryshuar ose hequr informacione të klasifikuara, të cilat do të sillnin shumë pasoja. Kështu psh: nxjerrja e një informacioni të klasifikuar të policisë do të sillte pasoja mjaft të rrezikshme jo vetëm në drejtim të ruajtjes së integritetit të hetimit, por ajo që është më kryesorja, do të rrezikonte jetën e persnave të përfshirë në hetim, në mënyrë të veçantë të dëshmitarëve e viktimave të trafikut. Gjithashtu, Sistemi Bankar Shqiptar, nga sistemet e para të kompjuterizuar plotësisht në vend, është nga sistemet më të rrezikuara, pasi edhe përfitimin nga ndërhyrja në këto lloj sisteme janë shumë të mëdha.

Mbrojtja juridike nga ndërhyrjet e paautorizuara në sistemet kompjuterike, qofshin këto në rrjetet bankare apo të sistemeve institucionale, nuk ka mundur të sigurohet me rregulla ndëshkuese të formës tradicionale brenda Kodit Penal, për shkak të natyrës së ndërhyrjeve, të cilat nuk kanë karakter fizik, por virtual, dhe vështirësive për të përcaktuar kohën e saktë të realizimit të aktit kriminal. Mosmarrëveshjet brenda sistemit ligjvënës “*për të përcaktuar momentin se, kur një ndërhyrje përbën veprë penale dhe duhet të trajtohet si e tillë*”, (Veton G. Vula, 2010:39). është një nga vështirësitë e plotësimit të legjislacionit dhe vetë dispozitave të Kodit Penal.

Në Republikën e Shqipërisë është saktësuar në bazë të ligjit nr. 8888, datë 25. 04. 2002, “*Për ratifikimin e “Konventës për krimin në fushën e kibernetikës*”, në mbështetje të neneve 78, pika 1, 81 pika 1, 83 pika 1 dhe 121, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave, ratifikimi i

“Konventës për krimin në fushën e kibernetikës”, me rezervën e parashikuar në këtë ligj. Në mbështetje të nenit 42 të “Konventës për krimin në fushën e kibernetikës”, RSH rezervon të drejtën për të mos parashikuar përgjegjësi penale, në rrethana të kufizuara, sipas paragrafëve 1 dhe 2, të nenit 10, me kusht që të parashikohen zhdëmtime të tjera, të cilat nuk shmangin përgjegjësinë ndaj dëmit të shkaktuar dhe nuk e shmangin Republikën e Shqipërisë nga detyrimet ndërkombëtare të parashikuara në instrumentet ndërkombëtare.

Në shtetin e Kosovës, Kodi Penal ka hyrë në fuqi në 6 prill të vitit 2004, i cili ka paraparë edhe “inkriminimin e veprës penale në fushën e kriminalitetit kompjuterik”. (Veton G. Vula, 2010:49). I përmirësuar në nenin 264 përcaktohet: “Kushdo që në mënyrë të paautorizuar dhe me qëllim që vetes ose personit tjetër t’i sjellë dobi pasurorë të paligjshme apo ti shkaktojë dëme personit tjetër, ndryshon, publikon, shlyen, asgjëson a shkatërron të dhëna kompjuterike, programe kompjuterike apo në çfarëdo forme tjetër hyn në sistemin kompjuterik, ai dënohet me gjobë apo me burgim deri në tre vjet”. (Kodi Penal i RK, neni 264).

Në përfundim, Strategjia e Sigurisë duhet të minimizojë dëmet e shkaktuara prej keqpërdorimeve kompjuterike, të cilat nuk kanë qenë të mundshme të rikthehen në gjendjet e mëparshme. Brenda kësaj kategorie rekomandimesh, është e nevojshme që masat siguruese të plotësohen edhe me masa dhe kërkesa të caktuara juridike. Kjo mënyrë mbështetëse është një nga përgjigjet ndaj keqpërdorimeve të sistemeve kompjuterike. Mbrojtja juridike, e veçanërisht ajo juridike – penale, merr karakter preventive, “e drejtuar në parandalimin e kryerjes së veprave penale” (Veton G. Vula, 2010:49), nga fusha kriminogjene kompjuterike.

Edhe pse kjo bazë ligjore është e pranishme dhe funksionale, në aspektin e përgjithshëm të veprimit të elementëve të terrorizmit rajonal dhe të krimit të organizuar, Shqipëria nuk është e përjashtuar nga mundësia e ndikimit të këtyre faktorëve, që kanë dëshmuar se shteti dhe shoqëria shqiptare, asnjëherë nuk kanë qenë të përjashtuar nga synimet dhe tendencat e veprimit të strukturave kriminogjene në rrejetet vendore, rajonale dhe ato ndërkombëtare.

5. PËRFUNDIME

Baza e ndërtimit dhe e përmbajtjes së filozofisë së Strategjisë Kombëtare të Sigurisë, sot duhet të mbështetet plotësisht në shqetësimet madhore, që realisht ekzistojnë përpara nevojës së stabilitetit në Ballkanin Perëndimor.

- Bërthama e mendimit filozofik të Strategjisë Kombëtare të Sigurisë, duhet të mbështetet në “traditën konstitucionale”, e cila hedh vështrimin në elementët juridik Kushtetues të ndërthurura me prurjet e periudhave të ndryshme historike të vendit.

- Objektivi themelor i filozofisë së Strategjisë Kombëtare të Sigurisë të kombit shqiptar, duhet të dalë me synime të qarta në planin kombëtar dhe rajonal, duke parashikuar faktin e efekteve dhe të reagimeve të saj në të gjitha drejtimet, veçanërisht atje, ku shteti shqiptar në kufijtë e tij kufizohet po me shqiptarë.

- Strategjia e Sigurisë Kombëtare pësoi evolucionin e vet mbi standardet demokratike përëndimore të ruajtjes dhe vlerësimit të informacionit me futjen e Republikës së Shqipërisë në NATO.

- Kuadri ligjor për organizmin ushtarak, marrjen dhe ruajtjen e informacionit, përsosja e paisjes luftarake dhe mbështetjes logjistike, e ka orientuar strukturën e Sigurisë Kombëtare në rrugën e reformimit dhe transformimit të plotë drejt një strukture moderne bashkëkohore.

- Përe shkak të problemeve politike të periudhës kalimtare të pambyllur, Shqipëria mbetet e rrezikuar dhe e ekspozuar ndaj fenomeneve të krimit të organizuar, trafikeve dhe të gjitha pasojave negative që burojnë prej tyre.

- Për shkak të problemeve etniko fetare rajonale, ku përfshihet edhe kombi shqiptar, Shqipëria mbetet e ekspozuar dhe e rrezikuar ndaj penetrimit dhe aktivizimit të strukturave terroriste, të cilat mund t'i kapërcejnë kufijtë shtetërore dhe rajonale.

- Shteti dhe shoqëria shqiptare ndjen nevojën e transformimit me të thellë të mentalitetit dhe psikologjisë individuale e kolektive, për të shmangur pasojat negative të fenomeneve kriminale dhe trafikeve, keqpërdorimeve të informacioneve, të cilat deri tani kanë dhënë pasojat negative të karakterit politik, ekonomik e psikosocial.

- Në këto kushte, Shqipëria ndjen nevojën e shtetit ligjor të së drejtës, ku të respektohen standardet demokratike, drejt një zhvillimi progresist, që do ta integronte atë plotësisht në shoqërinë evropiane.

Referencat

- Dr. Abazi Sulejman, Botim “Toena”, Strategjia e Sigurisë në Filozofinë e Bashkimit Kombëtar, Tiranë 2004, f. 91, 93.
- Shala Xhavit, Siguria Kombëtare dhe Sfidat e Integritimit. Botim Qendra Studimore për Sigurinë Kombëtare, Tiranë 2003, f. 10, 11, 12.
- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, f. 11, neni 23, Tiranë, 1998.
- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, f. 10, neni 17, Tiranë, 1998
- Fletore zyrtare e Këshillit të Ministrave të R. SH, Tiranë, shkurt 1999.
- Fletore zyrtare e Këshillit të Ministrave të R. SH, Tiranë, qershor 2006.
- Plani i Veprimit për Anëtarësimin e Republikës së Shqipërisë në NATO, Tiranë, qershor 2006.
- Strategjia e Sigurisë e Republikës së Shqipërisë, Tiranë 2006, f. 49.

- Dokumenti i Strategjisë së Sigurisë Kombëtare, kapitulli 3, faqe 39, 40.
- Në fletoren zyrtare të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, qershor 2006.
- Ligjin nr. 9541, datë 22. 5. 2006 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8457, date 11. 2. 1999, Tiranë, fletorja zyrtare e Këshillit të Ministrave, viti 2006.
- Ne fletoren zyrtare të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, Tiranë qershor 2001.
- Fletore zyrtare e Këshillit të Ministrave, Tiranë 2002.
- Fletore zyrtare e Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, Tiranë qershor 2006.
- Fletore zyrtare e Kuvendit të republikës së Shqipërisë, Tiranë korrik 2002.
- Dr. sc. Vula Veton G., Kriminaliteti Kompjuterik, botim Prishtine 2010, f. 39, 49, 136, 143, 156.
- Kodi Penal i Republikës së Kosovës, neni 264.

MARRËVESHJA E PRESPËS, SFIDAT QË E PRESIN MAQEDONINË E VERIUT

Msc.Senada LAÇKA

International University of Struga

s.laçka@eust.edu.mk

Msc.Rudina KAJA

International University of Struga

r.sela@eust.edu.mk

Abstrakt

Maqedonia e Veriut, për të ecur përpara duhet ti bashkohet me domosdoshmëri Bashkimit Europian. Lidhur me këtë çështje, Maqedonia po rishikon konfliktet, problematikat dhe po mundohet të hartojë zgjidhje në bashkëpunim me fuqitë ndërkombëtare .

Një nga problematikat kryesore që ka pasur Maqedonia që nga themelimi i shtetit të pavarur maqedonas, ka qënë konflikti shumëvjeçar me Greqinë. Kontesti i vjetër 27 vjeçar mes Maqedonisë dhe Greqisë u zgjodh si rezultat i vullnetit politik dhe angazhimit personal të politikanëve nga dy vendet, me çka, hodhën poshtë debatet dhe qëndrimet nacionaliste të dy vendeve duke e ratifikuar Marrëveshjen e Prespës të dy Parlamentet nacionale, në Shkup dhe Athinë.

Zgjidhja e konfliktit diplomatik është shembull tipik për tejkalim paqësor të pengesave mes partnerëve të ardhshëm euroatlantik, me çka, Maqedoninë e presin sfida të reja, me të mëdha për avancimin dhe integrimin e vendit nën emrin e ri-Maqedonia e Veriut.

Fjalë Kyçe: *Maqedonia e Veriut, Greqia, integrim, sfida.*

HYRJE

Marrëveshja e Prespës, ofron një model të qëndrueshëm për të zgjidhur mosmarrëveshjet edhe në vendet tjera të Evropës dhe më gjërë sepse ajo përmban një qasje gjithëpërfshirëse për të zgjidhur konfliktet në bazë të një premtimi të përfitimeve të përbashkëta afatgjata. Kjo marrëveshje e palëve me një mosmarrëveshje të gjatë është një frymëzim për një rajon që mbetet i ngatërruar në mosmarrëveshjet e bllokuara mbi identitetet etnike dhe kombëtare. Ballkani – dhe jo vetëm Ballkani –

ka nevojë për një narrativ të ri të bazuar në prioritetet e vërteta të popullit, pikërisht atë që parashikon Marrëveshja e Prespës.

Sa më pozitivisht pranohet marrëveshja nga qytetarët e të dy vendeve, aq më shumë vullnet politik do të kenë politikanët e të dy vendeve për ti dhënë një kthesë globale situates të tensionuar të marrëdhënieve mes dy vendeve fqinje. Kjo marrëveshje është një fitore historike dhe në fitore ndaj shovinizmit dhe konflikteve që kanë ndjekur historikisht të dy vendet. Është për tu përshëndetur udhëheqja dhe guximi i dy kryeministrave, Zoran Zaev dhe Aleksis Cipras duke pasur parasysh se ata të dy përballen me sulme të forta nga opozita vendase dhe nga ndenjat nacionaliste të qytetarëve të tyre.

1.MARRËVESHJA E PRESPËS, HAP I GUXIMSHËM PËR INTEGRIMIN EUROATLANTIK TË MAQEDONISË (SË VERIUT)

Në 17 qershor të vitit 2018, në prezencën e komunitetit ndërkombëtar të përbërë nga mediatori shumëvjeçar I konfliktit Greqi-Maqedoni, Matthew Nimetz, si i dërguar i Sekretarit gjeneral të Kombeve të Bashkuara dhe pëfaqësuesja e lartë e Komisionit Evropian, kryeministrat e dy shteteve Alex Tzipras dhe Zoran Zaev dhe nënshkruetit e marrëveshjes në nivel të ministrave të punëve të jashtme të dy palëve, Gjatë firmosjes së marrëveshjes Nikos Kotzias dhe Nikola Dimitrov. Marrëveshja u emërua si marrëveshja përfundimtare për zgjidhjen e dallimeve të përshkruara në rezolutat 817 (1993) dhe 845 (1993) të këshillit të siguri mit të kombeve të bashkuara, për shfuqizimin e marrëveshjes së përkohshme të vitit 1995.

Duke e pasur parasysh Marrëveshjen e përkohshme, Memorandumin e 13 tetorit 1995 për masat praktike të lidhura me Marrëveshjen e përkohshme, Memorandumin për vendosje të ndërsjellë të zyrave për lidhje në Shkup dhe Athinë të 20 tetorit 1995, si dhe procesin e Masave për ndërtimin e besimit, Duke e marrë parasysh Rezolutën e Asamblesë së Përgjithshme 47/225 të 8 prillit 1993,dy vendet angazhohen që të përforcojnë dhe zgjerojnë bashkëpunimin e vet bilateral dhe ta mbindërtojnë në nivel të partneritetit strategjik, në sferat e bujqësisë, mbrojtjes civile, mbrojtjes, ekonomisë, energjisë, mjedisit jetësor, industrisë, infrastrukturës, investimeve, marrëdhënieve politike, turizmit, tregtisë, bashkëpunimit tejk ufitarë dhe transportit, duke i shfrytëzuar pastaj përfitimet nga Masat ekzistuese për ndërtimin e besimit,¹¹²

¹¹² Preambula e Marrëveshjes së Prespës, 17 qershor 2018

Pala e pare (Greqia) do ta zbatojë këtë marrëveshje në pajtim me obligimet e saja të cilat rezultojnë nga anëtarësimi i saj në Bashkimin Evropian dhe anëtarësimi i saj në institucione ose organizata tjera ndërkombëtare, multilaterale ose rajonale si dhe në pajtim me instrumentet tjera ndërkombëtare. Në mënyrë të ngjashme, Pala e dytë (Maqedonia) do ta zbatojë këtë marrëveshje në pajtim me obligimet e saja të cilat rezultojnë nga anëtarësimi i saj në Bashkimin Evropian dhe anëtarësimi i saj në institucione ose organizata tjera ndërkombëtare, multilaterale ose rajonale si dhe ato në lidhje me Bashkimin Evropian, pas propozimit për anëtarësimin e saj. Dispozitat e kësaj marrëveshjeje mbesin në fuqi në periudhë të papërcaktuar dhe janë të përvokueshme. Nuk lejohet asnjë ndryshim i dispozitave nga neni 1, paragrafi (3) dhe paragrafi (4) i kësaj marrëveshjeje. Kjo marrëveshje do të regjistrohet në Sekretariatit e Kombeve të Bashkuara në pajtim me nenin 102 të Kartës së Kombeve të Bashkuara, nga momenti i hyrjes në fuqi. NË DËSHMI TË KËSAJ, Palët nëpërmjet përfaqësuesve të tyre të angazhuar kompetentë, i kanë nënshkruar tre ekzemplarët e kësaj marrëveshjeje finale, në gjuhën angleze.”

Thelbi i marrëveshjes ishte ndryshimi i emrit të Maqedonisë nga “Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë” në “Republika e Maqedonisë së Veriut”¹¹³ i cili do të jetë emër Kushtetues i Maqedonisë dhe do të përdoret *erga omnes*¹¹⁴, siç është paraparë me këtë marrëveshje. Emri i shkurtër i Maqedonisë do të jetë "Maqedonia e Veriut". Shtetësia e Maqedonisë do të jetë maqedonase, qytetar i Republikës së Maqedonisë së Veriut, siç do të shënohet në të gjitha dokumentet e udhëtimit. Gjuha zyrtare do të jetë "*gjuha maqedonase*", siç është pranuar në Konferencën e tretë të KB-së për standardizimin e emrave gjeografike, e mbajtur në Athinë në vitin 1977 dhe siç është e përshkruar në nenin 7, paragrafi (3) dhe paragrafi (4) i Marrëveshjes së Prespës. Ndërsa, pikat e tjera të marrëveshjes kanë të bëjnë me gjuhën, nacionalitetin, ndryshimin e kushtetutës si dhe afatet kohore për këto ndryshime.

Disa nga pikat e tjera të marrëveshjes janë:
- Referenca "*të mbrohen pakica maqedonase*", hiqet nga Kushtetuta e vendit fqinjë. Ndërsa pjesa e hemogjenitetit të harmonizohet në mënyrë analoge me kushtetutën greke.

-Periudha e tranzicionit përcaktohet me ndryshime të dokumenteve të brendshme të vendit fqinjë dhe ky proces do të ndërlidhet me hapjen e negociatave paraqasëse me Maqedoninë e Veriut.

-Do të formohet Komision për përdorimin e termeve tregtare në të dyja vendet.

-Gjuha maqedonase është pranuar, me vërejtje se Maqedonia e Veriut pranon në marrëveshje se ajo gjuhë ka prejardhje sllave (ashtu siç është nënvizuar në kornizën e OKB-së).

¹¹³ Neni 1 I marrëveshjes së Prespës

¹¹⁴ Erga Omnes-Për përdorim gjithëpërfshirës

-Në pjesën e nacionalitetit, termi maqedonas / qytetar i Republikës së Maqedonisë së Veriut do të zbatohet me sqarimin plotësues se bëhet fjalë për popullatë të këtij vendi që nuk ka lidhshmëri me kulturën greke.¹¹⁵

Marrëveshja u firmos në Prespë, sepse Prespa ka doganat që lidh Maqedoninë me Greqinë dhe Shqipërinë. Marrëveshja u quajt “*Marrëveshja e Prespës*”, pra mori emrin e vëndit të nënshkrimit. Ky gjest i ndërmarrë nga të dy shtetet tregon përpjekjen e mirë për të harruar eksperiencën negative të të shkuarës dhe për të rregulluar të ardhmen. Tashmë, Maqedonia do të ecë drejt rrugës për të hapur bisedimet me Bashkimin Europian dhe për tu bërë pjesë e Aleancës Transatlantike .

2.REFLEKTIMI I MARRËVESHJES TË PRESPËS NË REFERENDUM

Referendumi perfaqëson zgjedhjet popullore dhe sovranitetin popullor lidhur me çështjet shtetërore. Referendumi në Maqedoni u mbajt në datë 30 shtator 2018 për ndryshimin e emrit të shtetit maqedonas, që njëkohësisht ishte objekti kryesor i marrëveshjes mes Athinës dhe Shkupit në Prespë. Pas Marrëveshjes së Prespës hapi i dytë për të cilin angazhohej Maqedonia (e Veriut) si pale e marrëveshjes, ishte zhvillimi i referendunit, i cili do ta legalizonte atë dhe do I jepte qeverisë dritën jeshile për vazhdimësinë e realizimit të detyrimeve që ka marrë përsipër nga Marrëveshja e Prespës.

Pyetja që u ngrit ne referendum ishte: “*Nëse jeni për anëtarësim në BE dhe NATO me pranimin e Marrëveshjes mes Republikës së Maqedonisë dhe Republikës së Greqisë?*” . Buxheti shtetëror siguroi rreth 3.5 milionë euro për realizimin e sukseshëm të referendunit.

Përsa ju përket rezultateve të dala nga ky referendum ato janë si vijon:

-Nga 1.8 milionë qytetarë morën pjesë vetëm 36.56 % qytetarë që do të thotë 623 990 qytetarë¹¹⁶ .

- Nga 623 990 qytetarë 570 365 (91.40%) kanë votuar “për”, ndërsa 35 570 (5.70%) kanë votuar “kundër”.¹¹⁷

Pjesëmarrja ka qënë e ulët, por gjithsesi mbetet për tu vlerësuar fakti që popuj dhe shoqëri në tranzicion si Maqedonia kanë treguar se marrin pjesë në qverisje nëpërmjet votës së tyre. Eventualisht, referendumi do të quhej i fituar nëse kishte mbi 50 % të votuesve, që në të vërtetë nuk i kishte. Referendumi doli i dështuar si pasojë e neglizhencës së qytetarëve për të votuar dhe ndoshta mosbesimit tek ai.

¹¹⁵ https://www.aies.at/download/2018/AIES-Fokus_2018-06.pdf

¹¹⁶ https://www.aies.at/download/2018/AIES-Fokus_2018-06.pdf

¹¹⁷ <https://www.gazetaexpress.com/lajme/rezultatet-perfundimtare-te-referendunit-ne-maqedoni-kane-votuar-666-743-qytetare-91-46-per-581069>

Ky referendum shkaktoi polemika nga më të ndryshmet. Kishte nga ata që e përkrahën dhe nga ata që i dolën kundër, por rëndësia kryesore qëndron tek fakti se në atë votues sa ishin, shumica ishin shqiptarë.

Referendumi pason marrëveshjen që kanë arritur Maqedonia dhe Greqia, më 17 qershor, në Prespë, për mbylljen e konfliktit 27 vjeçar për emrin. Zgjidhja parasheh që Maqedonia të ndërrojë emrin në “Maqedonia e Veriut”¹¹⁸. Veç kësaj, maqedonasit kanë pranuar se nuk kanë lidhshmëri me maqedonasit antik sikur edhe gjuha maqedonase e cila në bazë të marrëveshjes i takon grupit të gjuhëve sllave. Si këmbim, Greqia e cila supozonte se Maqedonia ka pretendime territoriale ndaj rajonit të saj verior me të njëjtin emër do të zhbllokoj procesin e anëtarësimit të fqinjët të saj verior në NATO dhe BE.

Sa I përket ndryshimeve kushtetuese, Procedurat për miratimin e shpejtë të amendamenteve kushtetuese të Maqedonisë, kanë për qëllim zbatimin e plotë të dispozitave të kësaj marrëveshjeje të cilat do të fillojnë pas ratifikimit të kësaj marrëveshjeje nga Kuvendi i saj ose pas referendumit. Emri dhe terminologjia e përmendura në nenin 1 të kësaj marrëveshjeje do të përfshihen në Kushtetutën e Maqedonisë (së Veriut). Ky ndryshim do të bëhet menjëherë me një amendament. Sipas këtij amendamenti, emri dhe terminologjia do të ndryshohen në të gjitha nenet e Kushtetutës. Më tej, do të nisë procedurën për miratimin e amendamenteve përkatëse të Preambulës, neni 3 dhe neni 49 të Kushtetutës, gjatë procedurës për ndryshimin e Kushtetutës. Secila nga Palët me këtë obligohet dhe deklaron solemnisht se asnjë dispozitë nga Kushtetuta e saj, siç është në fuqi ose siç do të ndryshohet në të ardhmen, nuk mund dhe nuk duhet të interpretohet në mënyrë e cila paraqet ose kurdo qoftë do të paraqesë bazë për përzjerje në punët e brendshme të Palës tjetër, në cilëndo formë ose për cilëndo qoftë arsye, duke përfshirë dhe për shkak të mbrojtjes së statusit dhe të drejtave të cilave do persona të cilët nuk janë qytetarë të saj.

Secili kontest që do të paraqitet ndërmjet palëve në lidhje me interpretimin ose zbatimin e kësaj marrëveshjeje dhe i cili nuk do të zgjidhet në pajtim me procedurat e theksuara në nenin 19, paragrafin (2), mund të ngrihet nëpërmjet Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë. Palët së pari duhet të insistojnë të arrijnë pajtim me qëllim që së bashku të ngritin kontest të tillë para gjykatës së lartpërmendur. Megjithatë, nëse nuk arrihet pajtim i tillë në afat prej gjashtë muajsh, ose për periudhë më të gjatë për të cilën në mënyrë të ndërsjellë do të pajtohen të dyja Palët, atëherë kontestin e tillë para gjykatës së njëjtë mund ta ngrit secila Palë veç e veç

¹¹⁸ <https://telegrafi.com/referendumi-ne-maqedoni-u-shpall-per-zbatimin-e-tij-funksionale-edhe-kshz-ja/>

Kjo marrëveshje do të regjistrohet në Sekretariatit e Kombeve të Bashkuara në pajtim me nenin 102 të Kartës së Kombeve të Bashkuara, nga momenti i hyrjes në fuqi që jep një garancion ndërkombëtar për respektimin e të njëjtes nga palët përkatëse.

3.SFIDAT EUROATLANTIKE QË E PRESIN MAQEDONINË (E VERIUT)

Maqedonia si shtet i Ballkanit Perëndimor duhet që në të mirë dhe interes të saj të marrë pjesë në Bashkimin Europian dhe NATO. Për tu antarësuar në to nuk është edhe aq e thjeshtë sa mund të duket. Maqedoninë tani e presin sfida, të cilat duhet të përmbushen me sukses me qëllim që një ditë të jetë antare e tyre.

Detyra e parë është zbatimi i reformave. Ato janë mjaft të domosdoshme për shtetin dhe popullsinë multietnike të Maqedonisë. Ndryshimet duhet të jenë thelbësore, sepse nëse nuk janë të tilla nuk konsiderohen si të vlefshme. Disa nga reformat kanë qënë ajo për Ministrinë e Punëve të brendshme, reforma për administratën, reforma për pensionet, reforma zgjedhore, reforma për drejtësi, etj.

Detyra e dytë është vendosja e një dialogu të brendshëm politik, i cili është katalizatori i qetësisë dhe stabilitetit shtetëror. Nëse kemi kuptim midis pozitës dhe opozitës, reformat do të kryhen më shpejt dhe cdo detyrë tjetër do të zhvillohet në kuadër të bashkimit me fuqitë euroatlantike.

Detyra e tretë është ulja e numrit të papunësisë dhe minimizimi i saj. Zbutja e këtij problemi mund të bëhet vetëm nëse Maqedonia tërheq sa më shumë investime të drejtpërdrejta dhe të huaja që të ndikojnë në rritjen e ekonomisë dhe zvogëlimit të numrit të individëve të papunë.

Detyra e katërt është zvogëlimi i nivelit të korrupsionit. Korrupsioni ka bërë që cdo instancë dhe cdo politikë shtetërore të bëhet ashtu si individë të caktuar duan dhe ashtu si atyre ju përshtatet. Ndaj, cdo gjë ka stopuar në vend dhe nuk ka ecur drejt zhvillimit.

Detyra e pestë është bashkëpunimi rajonal. Hapin më të madh Maqedonia e ka hedhur në vitin 2001 me Marrëveshjen e Ohrit lidhur me shqiptarët dhe të drejtat e tyre dhe këtë vit me Marrëveshjen e Prespës lidhur me emrin e Maqedonisë me Greqinë. E vetmja gjë që mbetet tani është zbatueshmëria e plotë e tyre.

Përfitimet që do të ketë Maqedonia nga antarësimi në BE pasi të përmbushë pesë detyrat e lartpërmendura kanë të bëjnë me rritjen e vazhdueshme të shtimit ekonomik, rritjes së standardit dhe mirëqenies njerëzore, zvogëlimit të numrit të papunëve, reduktimit të varfërisë, transferimi i teknologjisë, etj.

Së fundmi, pritshmëria për ti kryer këto detyra janë optimiste, sepse pushteti aktual është më fleksibil për të ndryshuar gjendjen dhe prioritet edhe më tej mbetet integrimi euroatlantik.

KONKLuzion

Zhvillimet paqësore janë hapat nëpër të cilat duhet të kalojnë shtetet. Hapi i parë ishte Marrëveshja e Prespës, që i dha një shpresë marrëdhënjeve të lëkundura shumëvjeçare mes dy shteteve fqinje por sidomos qytetarëve të Maqedonisë të Veriut për shkak të vështirësive ekonomike dhe pozitës të vështirë dhe të pandryshueshme në raport me integrimin e vendit në strukturat më të rëndësishme ndërkombëtare.

Hapi i dytë ishte zhvillimi i një referendumi për të parë mendimin e popullit sovran. Pavarësisht se pjesëmarrja ishte e ulët dhe referendumi nuk dha impaktin që pritej nga elitat politike, ajo që është për tu vlerësuar është fakti se numri i votuesve me kombësi shqiptare ishte i madh. Kjo tregon se edhe shqiptarët duan që shteti në të cilin jetojnë dhe veprojnë të zhvillohet dhe të ecë përpara.

Hapi i tretë janë sfidat që duhet të ndërmerret Maqedonia për të hapur bisedimet me Bashkimin Evropian dhe për të kaluar fazën e ratifikimit të marrëveshjes me NATO në vendet anëtare të saj. Pa qënë Maqedonia e Veriut pjesë e NATO-s nuk do jetë mjaftueshëm e sigurtë dhe stabile për tu bërë pjesë e familjes evropiane.

Së fundmi, të gjitha këto hapa janë në process e sipër, dhe duhet të vazhdoen me përkushtim jo vetëm nga organet shtetërore por edhe vetë qytetarët e të gjitha etniteteve në mënyrë që Maqedonia të kalojë nga tranzicioni dhe të jetë një kandidate e denjë për të qënë pjesë e Bashkimit Evropian dhe NATO-s.

Referenca:

1. Marrëveshja e Prespës, 17 qëroshor 2018;
2. Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme 47/225 të 8 prillit 1993,
3. Memorandumi për vendosje të ndërsjellë të zyrave për lidhje në Shkup dhe Athinë të 20 tetorit 1995,
4. https://www.aies.at/download/2018/AIES-Fokus_2018-06.pdf,
5. <https://www.gazetaexpress.com/lajme/rezultatet-perfundimtare-te-referendumit-ne-maqedoni-kane-votuar-666-743-qytetare-91-46-per-581069> ,
6. <https://telegrafi.com/referendumi-ne-maqedoni-u-shpall-per-zbatimin-e-tij-funksionale-edhe-kshz-ja/>.

SVJEDOK SARADNIK U KRIVIČNOM POSTUPKU

Kenan IDRIZAJ, doktorant

idrizaikenan77@yahoo.com

ABSTRACT

Co-operating witness is accused or suspect, for which the indictment has not yet been read at the main trial, This means that an order for co-operating witness can be given at the preliminary stage of the criminal proceedings during the investigation and after the indictment is filed, provided that it is not read at the main trial. According to the LCPRK-a, in order to give an order for the cooperation of the witness, his testimony will probably prevent other crimes from other persons, his testimony will probably lead to the discovery of the truth if the court assesses him as a true truth, etc. The purpose of this study is to, inter alia, introduce procedures for the defendant to take over the order as a co-operating witness. It should be noted that modern laws use cooperative witness's different denominations. Thus, the German law for witness associates uses the term "Crown Witness", while in Italian and Croatian law it is a "repentant" as a witness. According to the B &H legislation on criminal proceedings, the witness is regulated within the provisions of the witness's right not to answer certain questions.

Key words: Associate, witness, procedure, criminal, defendant

Sažetak

Svedok saradnik je optuženi ili osumnjičeni, za koji optužnica još nije pročitana na glavnom sudskom postupku. To znači da se nalog za svjedoka saradnika može dati u preliminarnoj fazi krivičnog postupka tokom istrage i nakon podnošenja optužnice, pod uslovom da nije pročitana na glavnom sudskom postupku.

Na osnovu ZKPRK-e, da bi dali naredbu za saradnju svedoka, njegovo svedočenje će verovatno sprečiti druga krivična dela od drugih osoba, njegovo svedočenje će verovatno dovesti do otkrivanja istine ako sud ga ocjenjuje kao istinitu istinu, itd.

Svrha ovog rada studije je da, između ostalog, uvede procedure za okrivljenog da preuzme naređenje kao svedok saradnik.

Treba istaći da savremeni zakoni kooperativnim svjedocima koriste različite denominacije. Tako se u njemačkom zakonu za svjedoke saradnike koristi izraz "Krunski Svedoci", dok je u talijanskom i

hrvatskom pravu "pokajnik" kao svjedok. Prema zakonodavstvu Bosne i Hercegovine o krivičnom postupku, svjedok je reguliran u okviru odredbi prava svjedoka da ne odgovara na određena pitanja.

Ključne riječi: Saradnik, svjedok, postupak, kriminalac, okrivljenik.

1. OPŠTI PREGLED SVJEDOKA U KRIVIČNOM POSTUPKU

1.1. POJAM SVJEDOKA U KRIVIČNOM POSTUPKU

Svedok predstavlja veoma važnu temu, bez čijeg prisustva mnogi krivični postupci teško mogu zamisliti. To je zato što je svjedok osoba za koju se vjeruje da može pružiti mnogo informacija o krivičnom djelu, počinitelju i drugim važnim okolnostima vezanim za krivično djelo za koje se vodi krivični postupak. Prema tome, pojam i definicija svjedoka u krivičnom postupku je veoma vrijedno pitanje u smislu jasnije i konkretnije definicije ovog predmeta u krivičnom postupku.

U većini savremenih krivičnih postupaka u različitim zemljama, žrtve krivičnog djela također se pojavljuju kao svjedoci u ovom postupku. Pored žrtve, lica koja su prisutna na mjestu zločina ili su na neki način svjesna krivičnog djela, njegovog počinitelja i drugih okolnosti krivičnog djela, optuženi može svjedočiti i kao svjedok, ali samo u svoju odbranu. (Cryer, R., 2010:439). Bez obzira na sistem, žrtve igraju važnu ulogu kao svjedoci u krivičnom procesu, uloga koja može biti ugrožena, jer žrtva ima i nezavisnu funkciju u istom krivičnom postupku. Ali u nekim krivičnim procesnim sistemima, na primjer u Švedskoj, gdje optuženi ne može biti saslušan kao svjedok, izjava žrtve kao svjedoka također nije dopuštena zbog pravde. (Cryer, R., 2010:478). Prema tome, pojam svjedoka je predviđen u mnogim nacionalnim aktima različitih zemalja i drugim međunarodnim aktima. Dakle, ovaj pojam je predviđen zakonima o krivičnom postupku, međunarodnim konvencijama, posebnim zakonima o zaštiti svjedoka mnogih zemalja i drugim zakonskim aktima.

U tom smislu, prema publikaciji Kancelarije Ujedinjenih nacija za zločin i drogu (United Nations Office on Drugs and Crime, 2008:4) u okviru definicija svjedok je tako određeno : "Svako lice, bez obzira na njegov pravni status (Obavijestilac , svjedok, sudski službenik, tajni agent ili na drugi način), koji ima pravo prema zakonu ili politici određene zemlje koja je uzeta u obzir za prijem u program zaštite svjedoka". Ova definicija u vezi sa svjedokom u krivičnom postupku je manjkava, jer uključuje samo neke elemente koje ovaj subjekt posjeduje u krivičnom postupku, odnosno svjedok ima neke druge osobine koje ga razlikuju od drugih subjekata u ovom postupku.

Tako, Zakon o krivičnom postupku Republike Kosova¹¹⁹ (ZKPRK), sa Zakonom o zaštiti svedoka Republike Kosovo¹²⁰ (ZZSRK), ne predviđa izričito definiciju svedoka. To je ono što smatramo među definicijama ZKPRK -a i definicijama ZZSRK -a.

¹¹⁹ Kodi Nr. 04/L-123 i procedurës penale i Republikës së Kosovës, miratuar më 13/12/2012 dhe hyrë në fuqi më 01/01/2013.

Međutim, prema članu 124 stav. 1 ZKPRK-a za svedoka može se pozvati lice za koje se veruje da je u stanju da pruži informacije o krivičnom delu, učiniocu i važnim okolnostima krivičnog postupka (Sahiti, E.& Rexhep, M., 2013:265). Dakle, kao što se vidi iz odredbi ZKPRK u vezi sa svjedočenjem svjedoka, definisan je krug ili grupa osoba koje mogu svjedočiti, čime se indirektno definiše pojam svjedoka u krivičnom postupku.

Takva stvar unutar nacionalnog zakonodavstva su učinile mnoge države u regionu i šire, uključujući i definiciju o vezi svjedoka. Prema tome, član 3 (2) Zakona o zaštiti svjedoka i pratećeg pravosuđa Republike Albanije predviđa pojam svjedoka navodeći ga u ovom obliku: "svjedok pravde je osoba koja je, u svojstvu svjedoka, ili o oštećenom licu, daje izjave i dokaze o činjenicama i okolnostima koje predstavljaju dokaze u krivičnom postupku i koje su, zbog ovih izjava ili dokaza, u opasnom stanju" (Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, 2009: 1).

Takođe, Zakon o zaštiti svedoka Severne Republike Makedonije, odnosno člana 2 tačka 1 definiše definiciju svedoka na ovaj način: "svedok je svako lice koje, prema Zakonu o krivičnom postupku, ima ulogu svedoka i poseduje informacije za krivično djelo, počinitelj i druge relevantne okolnosti, itd. informacije od značaja za krivični postupak, koji su neophodni i odlučujući za utvrđivanje krivičnog djela kojim se otkriva život, zdravlje, sloboda, fizički integritet ili vlasništvo svjedoka koji je izložen opasnosti" (Собрание на Северна Република Македонија, 2005:1)

To je učinjeno iu mnogim proceduralnim krivičnim djelima i stručnoj literaturi, u kojima se predviđa definicija svjedoka među njihovim odredbama.

1.2. ULOGA SVJEDOKA KAO KRIVIČNOG SUBJEKTA

U krivičnom postupku, osim izjave okrivljenog, izjava veštaka, podaci koji proizilaze iz različitih dokumenata, različiti zapisi, mnoga pitanja, kao dokazi se takođe smatraju svjedočenjem svedoka. Na ovaj način ovom pitanju, odnosno svjedoku u krivičnom postupku, treba dati posebnu važnost u razjašnjavanju konkretnog krivičnog slučaja.

U različitim proceduralno-krivičnim zakonima postoje pravila koja određuju da li su potencijalni svedoci sposobni i obavezni da svedoče na suđenju. Pitanje "kompetentnosti" odnosi se na to da li će svedoku biti dozvoljeno da svedoči ili ne. "Odgovornost" se odnosi na činjenicu da svjedok koji je nadležan za svjedočenje može biti prisiljen da prisustvuje sudu kako bi dao iskaz (Sharpley, D., 2010:323). Dakle, svjedočenje svjedoka u krivičnom postupku smatra se, između ostalog, odgovornošću i kompetencijom, a ne samo kao obaveza.

Što se tiče odgovornosti ili kompetentnosti svjedoka da svjedoči u krivičnom postupku, treba reći da je to pitanje u načelu pretpostavljeno. Većina dilema povezanih sa kompetencijom nastaje u

¹²⁰ Ligji Nr. 04/-I-015 për mbrojtjen e dëshmitarëve të Republikës së Kosovës, miratuar më 29/07/2011 dhe hyrë në fuqi më 01/09/2012.

odnosu na maloljetnike i mentalno hendikepirane svjedoke. Nadležnost ovih svjedoka bi trebala biti određena na pojedinačnoj osnovi, a često i na osnovu sudijskog ispitivanja svjedoka ili psihijatrijskih procjena. (Bačgal J, Ronald, 2009:289).

Kao što se dokazuje postupanjem datim svedočenju svedoka i njegovom nadležnošću da se pojavi pred sudom da izloži svoje percepcije i procene u vezi sa konkretnim pitanjem, ovaj procesni subjekt i njegova odgovornost da dokažu su osetljivi i kao takvu treba platiti neophodnu važnost.

S tim u vezi, svjedok kao probni rad i učesnik u krivičnom postupku, i njegovo svjedočenje kao dokaz, prisutni su u svim krivičnim postupcima sa racionalnim sudskim sistemom. Svedočenje svedoka je korišćeno u ranim fazama društvene reakcije da bi se rasvetlili i razotkrili ekscesi i njihovi počinioci, dok se prisustvo svedoka u probnoj proceduri može, u maloj ili većoj meri, pratiti na svim spomenicima zakonski, pošto je krivični postupak donesen, zakonski regulisan.

Svedok i njegovo svedočenje još uvek su prisutni u krivičnom postupku, kako za teoriju i zakonodavstvo, tako i za sudsku praksu. (Sahiti, E., R., Murat& Xh., Elshani, 2014:342-343). Stoga je važnost iskaza svjedoka i samog svjedoka kao dokaza u krivičnom postupku očigledna i neosporna i često se predstavlja kao dokaz, a rijetko se predstavlja kao jedini dokaz za rasvjetljavanje konkretnog krivičnog predmeta (Ibid, 343).

Takođe, ako vidimo ko može biti svjedok u krivičnom postupku prema odredbama KZPRK-a, takva osoba može biti pozvana za koju se vjeruje da je u stanju dati obavijest o krivičnom djelu, njegovom počinitelju i drugim okolnostima. važni za vođenje krivičnog postupka. (Sahiti, E.& Rexhep, M., 2013:265). Zaista, svjedočenjem svjedok izražava svoje viđenje činjenica koje su važne za iluziju krivičnog postupka (Ibid). Iz ovoga se vidi da svjedok sa svojim svjedočenjem u krivičnom postupku, prema odgovarajućim načelima i odredbama, može dovesti do otkrivanja konkretnog krivičnog djela, datog u odnosu na počinitelja i njegov doprinos drugim okolnostima u krivičnom postupku.

Dakle, konstruktivna uloga i konkretan značaj svjedočenja svjedoka kao predmeta krivičnog postupka je evidentan i neosporan.

2. POLOŽAJ SVEDOKA SARADNIKA U KRIVIČNOM POSTUPKU

2.1. DEFINICIJE ZA SVEDOKA SARADNIKA

Sa odredbama opšteg dela Zakona o krivičnom postupku Republike Kosovo, svedok saradnik je sistematizovan u okviru alternativnih procedura, koje se sprovode u okviru ove procedure.

S tim u vezi, svjedok saradnik je reguliran članom 235. ZKPRK -a, koji navodi da "svjedok saradnik" znači osumnjičeni ili okrivljeni za koga se optužnica još nije pročitala u glavnom sudskoj sjednici i koja se očekuje da svedoči na sudu kada:

- 1) verovatno je da će sprečiti druga krivična dela od druge osobe; verovatno će dovesti do pojašnjenja istine u krivičnom postupku;
- 2) učinio dobrovoljno i uz punu saglasnost da dokaže istinu na sudu :
- 3) sud ga smatra i istinitim i potpunim
- 4) može dovesti do uspješnog krivičnog gonjenja drugih počinitelja.

U zakonodavstvu Republike Albanije, svedok saradnik se naziva "saradnik pravde". Prema Zakonu o zaštiti svjedoka i saradnika pravosuđa, član 3, tačka 3 navodi da je "saradnik pravde lice koje izdržava krivičnu kaznu ili je okrivljeni u krivičnom postupku za zločin počinjen i zbog saradnje sa pravdom, deklaracija ili svedočenja o činjenicama i okolnostima koje predstavljaju dokaze u istom krivičnom postupku ili u povezanom postupku". (Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, 2011:2)

Shodno odredbama ZKPRA-e, izreke ili izjave saradnika pravosuđa se ocenjuju u skladu sa kriterijumima utvrđenim u ovom kodeksu u vezi sa procenom dokaza Član 152 "Preliminarni dokaz", tačka 3, respektivno, ocenjuje se u jedinstvu sa drugim dokazima koji potvrđuju autentičnost njegovih izjava (Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, 1995:41).

Kao i u zakonodavstvu Republike Albanije i u zakonodavstvu Severne Republike Makedonije, svedok saradnik se naziva "saradnik pravde".

Për njëqind vjet më radhë, elementët gjeografik, demografik, kulturor dhe politik, përbënin karakteristikën e ndryshimeve të vazhdueshme nga forcat mbisunduese në hapësirat e popullit shqiptarë. Megjithatë, karakteristikat e veçanta kombëtare, kulturore, demografike e gjeografike shqiptare, pati ndikime transformuese në procesin e vetëkorrigjimit gjeografik në fillim të shekullit XXI. Ky proces vetëkorrigjues filloi me Pavarësinë e Republikës së Kosovës, fuqizimin shqiptarë në Maqedoninë Veriore, dhe tani po ri-konstruktohen zonat e Sanxhakut të Pazarit të Ri, Luginës së Preshevës, Malit të Zi dhe Çamërisë, brenda një procesi fare të natyrshëm të **"vetëkorrigjimit gjeografik ballkanik"**.

Prirjet e shekullit XXI, mbeten të karakterit gjeopolitik, gjeostrategjik, demografik, kulturore, ushtarake e teknologjike. Brenda këtyre dimensioneve, orientimi unifikues i politikës së jashtme mbarëkombëtare brenda rritjeve të ndërveprimeve kulturore dhe ekonomike mbetet një domosdoshmëri nga e cila ndihmohet, lehtësohet dhe këshillohet orientimi strategjik i procesit të vetëkorrigjimit të ardhshëm ballkanik me objektiv shqiptarët.

Si përfundim, duhet kuptuar se gjatë dy shekujve të kaluar (shek. XIX dhe XX), forca ekuilibruese dhe vendimtare ishte ajo ushtarake. Në shekullin XXI, forca e këtij përcaktimi strategjik dhe objektiv mbetet ajo ekonomike dhe kulturore. Sot këto forca veprojnë në nivele globale dhe rajonale, të cilat domosdoshmërishtë prekin dhe zgjerojnë raportet ndërvepruese shumëdimensionale të popujve e shteteve përtej linjave kufitare shtetërore.

E tashmja është vulosur përmes elementëve të pandryshueshmërisë shekullore. E ardhmja përcaktohet nga objektivizmi strategjik brenda konceptit të shekullit XXI për shqiptarët.

Fjalë kyçe: *Shqiptarët Ballkanik, Vetëkorrigjimi gjeografik, Shekulli XXI.*

Hyrja

Përlllogaritjet e zhvillimeve gjatë shekullit të kaluar brenda objektivit gjeostrategjik e gjeopolitik ballkanik, qojnë kah përfundimet objektive strategjike drejtë së ardhmes së shekullit XXI për popujt e kombet e Ballkanit, duke rivendosur edhe njëherë vullnetin e popullit për vetëvendosje të lirisë e sovranitetit. Ndryshimet e hartës gjeografike ballkanike gjatë shekullit XX, për shumë nga popujt e këtij rajoni ka qenë mjaftë dinamike në raport me dy shekujt para tij, kur u shfaqën shtetet kombëtare moderne, dhe kur pjesës më të madhe u imponua sistemi kolonial evropian.¹²²

Kalimet nga periudhat perandorake drejt shteteve të sapoformuara kolonialiste, brenda secilës disa nga popujt autokton gjendeshin të privuar nga e drejta për vetëvendosje në kuadër të vendosjes së kombeve, për shqiptarët paraqiti sfidat e mëdha të shekullit XX. Ata u ballafaquan me sfidën e madhe të ndarjeve kombëtare, ndryshimeve demografike, kulturore e gjeografike.

Ballafaqimi përskaj këtij itinerari të ri gjeopolitik në Ballkan, pati ndikime negative shumëdimensionale për shqiptarët dhe Boshnjakët. Në gjysmën e dytë të shekullit XIX dhe në fillim të shekullit XX u zhvillua një garë e ashpër me qëllim drejtimin e Ballkanit në procesin e ardhshëm ndërmjet Beogradit si vend Ortodoks pro strategjisë ruse dhe Zagrebit si vend Katolik pro strategjisë Evropiane. Krahas këtyre ideve mbi drejtimin dhe të ardhmen e Ballkanit, i paraprin projektet nga më të ndryshme për transformimin e pjesës jugore të Evropës Qendrore dhe Ballkanit. Këto projekte mbanin "autorësinë" e forcave të ndryshme politike të frymëzuara nga konceptet e idetë ideologjike.¹²³

Brenda gjithë këtyre përpjekjeve për vendosjen e paqes dhe sistemit politik social ekonomik në Ballkan përmes ish-Jugosllavisë, Shqiptarët e Boshnjakët ishin ndër popujt më të shtypur brenda këtyre përlllogaritjeve, përjashto Shqipërinë aktuale. Uniteti dhe tërësia e federatës jugosllave filloi për herë të tretë të sfidohet që në vitet e 60-ta. Ana zyrtare e këtyre luhatjeve të mëdha politike në ish-Jugosllavi mbante logon socio-ekonomike. Por që në fakt nuk ishte e tillë. Ajo ishte një lëvizje gjeopolitike rajonale përkrah një zone sizmike gjeostrategjike ndërmjet Paktit të Varshavës njëren anë dhe NATO-së anën tjetër.

Neutraliteti i Jugosllavisë ndërmjet këtyre dy forcave globale të periudhës së Luftës së Ftohtë, përcaktohej jo nga vullneti i grupeve etnike ortodokse në Ballkan, por nga vullneti i elementëve Katolik dhe Islam në rajon si forca properëndimore. Konfiguracioni i këtyre zhvillimeve ndahej

¹²² Saul Bernard Cohen, "Gjeopolitika". Tiranë, 2016. Fq. 7.

¹²³ Bashkim Rama, "Ballkani pas rënies së Murit të Berlinit". Tiranë 2013. Fq. 61.

njërën anë ndërmjet Serbisë, Maqedonisë, Malit të Zi dhe anën tjetër ajo ndahej ndërmjet Kroacisë, Sllovenisë, Vojvodinës me popullsi katolike dhe Kosovës, Sanxhakut të Pazarit të Ri dhe Bosnjës si vende Myslimane properëndimore dhe antisovjetike. Prandaj si përfundim, brenda këtyre dy grupeve nën ombrellën e Jugosllavisë, përcaktohej edhe pozicioni i kësaj të fundit si një vend neutral karshi pozicionit me fuqitë botërore të kohës gjatë Luftës së Ftohtë.

Përkufizimi i Vetëkorrigjimit Gjeografik

Vetëkorrigjimi gjeografik i një kombi brenda një hapësire demografike, mbetet i parapëlqyer si term, por që të jetësohet praktikisht, nevojitet përmbushja e disa kriterëve paraprake përgjatë dekadash. Fillimisht, vetëkorrigjimi gjeografik nënkupton fillimin e një procesi korrigjues brenda hapësirave gjeografike të një vendi, prej cilave korrigjimi prodhon një gjendje të re etnike brenda një realitetit të dimensionit modern të zhvillimeve në shekullin XXI. Ky dimension mund të përkufizohet mbi parimin e lirive e të drejtave të njeriut, e deri tek njohja e identitetit të saj mbi parimin demografik, kulturor dhe shtrirjes gjeografike si një vlerë e përbashkët kolektive.

Korrigjimi gjeografik me objektiv shqiptarët, mund të përkufizohet përmes elementëve siç theksuam mësipërm mbi bazën e shtrirjes gjeografik, rritjes demografike dhe ruajtjes kulturor. Ruajtja e këtyre tre elementëve dhe zhvillimi i tyre përgjatë dekadave, pa asnjë dyshim sjell vetëkorrigjimin gjeografik në terren brenda një hapësire gjeografike rajonale. Shembulli i Kosovës, tashmë argumenton këtë fakt dhe këtë sukses në sajë të ruajtjes së këtyre elementëve përgjatë dekadave.

Siç e dimë, Kosova ishte aneksuar nga Serbia për mese një shekull. Gjatë kësaj periudhe, ajo ishte nën presione të ndryshimeve demografike, kulturore e gjeografike, përmes politikave asimiluese e standardeve të dyfishta në raport mes shqiptarëve e serbëve. Megjithatë, shqiptarët nga Kosova arritën suksesshëm të ruanin substancën përcaktuese që përkufizon vetëkorrigjimi gjeografik, atë të popullatës, shtrirjes territoriale dhe asaj të ruajtjes kulturore. Fal këtyre ruajtjeve nga popullata vendase, Kosova arriti afirmimin e saj në arenën ndërkombëtare përmes secilës realizoi shpalljen e Pavarësisë së saj më 2008, si një vend i lirë e demokratik në rajon.

Gjithashtu, duhet kuptuar se e njëjta gjë e vetëkorrigjimit gjeografik të grupeve etnike nuk mund të thuhet se funksionon për gjitha vendet. Shembull, për rajonin e Vojvodinës, një krahinë autonome brenda Serbisë, njësoj siç ishte Kosova gjatë Jugosllavisë nuk mund të funksionoj.

Rajoni i Vojvodinës, konsiderohet aktualisht si grupi më i madh etnik në Serbi. Hapësira gjeografike e Vojvodinës përfshinë 1/4 e territorit të Serbisë apo 21.506 km². Dikur ky rajon, dominohej nga Hungarezët me 71% të popullsisë së përgjithshme dhe se brenda rajonit ekzistonte një laramani e theksuar minoritetesh, e që serbët gjithashtu në këtë rajon ishin grupi i dytë etnik pas atij hungarez.

Realiteti i kësaj krahine për t'i paraprirë një procesi vetëkorrigjues gjeografik kishte stagnuar fillimisht mbi aspektin e rënies së natalitetit në këtë rajon deri në vitet e 90-ta. Faktori i dytë, lidhet me presionin politik gjatë viteve 90-99 për detyrim të rinisë për tu bërë pjesë e ushtrisë serbe në luftërat e Kroacisë, Bosnje e Hercegovinës dhe Kosovës. Si rrjedhojë e këtyre presioneve, rreth 150.000 mijë Hungarez u larguan nga Vojvodina vetëm gjatë viteve 90-99.¹²⁴ Faktori i tretë i ndryshimeve të mëdha demografike në Vojvodinë ishte edhe vendosja e kolonëve serb të zhvendosur nga zonat e luftës në Kroaci e Bosnje, ku mbi 50% e refugjatëve të ish-Jugosllavisë ishin vendosur deri më 2001 në rajonin e Vojvodinës.¹²⁵

Sot realiteti demografik në Vojvodinë është krejtësisht i përmbysur për një vend autonom siç ishte dikur. Sipas regjistrimeve të vitit 2002, serbët përbëjnë 65% të popullsisë së rajonit ndërsa Hungarezët tashmë janë minoritar me vetëm 14%, dhe pjesa tjetër është e grupeve më të vogla etnike.¹²⁶ Në këtë rast, vetëkorrigjimi gjeografik bëhet i pamundur derisa ka ndryshuar struktura thelbësore demografike, kulturore e gjeografike brenda vendit.

Prandaj, prirjet e shekullit XXI mbeten të karakterit gjeopolitik, gjeostrategjik, demografik, kulturore, ushtarake e teknologjike. Brenda këtyre dimensioneve, orientimi unifikues i politikës së jashtme mbarëkombëtare brenda rritjeve të ndërveprimeve kulturore dhe ekonomike mbetet një domosdoshmëri nga e cila procesi i vetëkorrigjimit në trevat shqiptare ndihmohet, lehtësohet dhe këshillohet orientimi strategjik i procesit të ardhshëm ballkanik me objektiv shqiptarët.

Si përfundim, duhet kuptuar se gjatë dy shekujve të kaluar (shek. XIX dhe XX), forca ekuilibruese dhe vendimtare ishte ajo ushtarake. Në shekullin XXI, forca e këtij përcaktimi strategjik dhe objektiv mbetet ajo ekonomike dhe kulturore. Sot këto dy forca veprojnë në nivele rajonale dhe globale, të cilat domosdoshmërishtë prekin dhe zgjerojnë raportet ndërvepruese shumëdimensionale të popujve e shteteve përtej linjave kufitare shtetërore.

Vetëkorrigjimi objektiv i shqiptarëve të shekullit XXI

Rrugëtimi i trevave shqiptare në ish-Jugosllavi duhet kuptuar brenda dy pikëpamjeve zhvillimore përgjatë shek. XX. *E para*, në rrafshin rajonal, ato duhet shikuar përmes elementëve të ndryshimeve demografike, kulturore e gjeografike. *E dyta*, në rrafshin kontinental e global, ato duhet shikuar nën prizmin e interesave globale ndërmjet SHBA-ve dhe Evropës-Gjermanisë njëri-anë, anën tjetër

¹²⁴ <http://users.jyu.fi/~aphamala/pe/issue3/vajdasag.htm> (12.04.2019)

¹²⁵ <https://www.refworld.org/docid/3ae6ad7c9c.html> (01.05.2019).

¹²⁶ <https://pesd.princeton.edu/?q=node/245> (02.05.2019).

brenda fushëveprimit zonal strategjik të Anglisë/Francës, Gjermanisë dhe Rusisë dhe krejt në fund edhe ndërmjet organizatave ndërkombëtare me bosht forcën.¹²⁷

Elementi i parë: zhvillimet rajonale ballkanike pas rënies së Jugosllavisë, gjendja në terren i është kthyer normalizimit me hapa mjaftë dinamik drejt ruajtjes së kohezionit të saj demografik, kulturor e gjeografik, me objektiv shqiptarët. Këta tre element (demografik, kulturor e gjeografik), përcaktuan ndryshimet e mëdha në Ballkan përmes ndërhyrjeve ushtarake të NATO-së dhe partnerëve të saj, fal cilëve edhe sot po zhvillohet ky koncept me plotë të drejt.

Elementi i dytë: Interesat gjeopolitike e gjeostrategjike nga forcat mbisundues në rajonin e Ballkanit siç janë nga SHBA-të, vendet e BE-së dhe Rusia, përcaktojnë rivlerësimin e ardhshëm strategjik me objektiv shqiptarët. Përlllogaritja e drejt e këtyre elementëve jo vetëm që ndihmon procesin e vetëkorrigjimit të ardhshëm gjeografik shqiptar në rajon por të njëjtën kohë edhe mbron politikat e saja objektive.

Kjo ndodh për faktin e interesave të ndërsjella ndërmjet interesave globale nga fuqitë mbisunduese rajonale, këtë rast partnerët strategjik të shqiptarëve dhe nevojës së rritjes demografike rajonale brenda hapësirave gjeografike. Pa një mbështetje të brendshme të rritjes demografike, kulturore e gjeografike, interesat e fuqive mbisunduese globale mbesin të pakuptimta në rajon.

Si përfundim, procesin e vetëkorrigjimit gjeografik me objektiv shqiptarët e shekullit XXI, interesat e përbashkëta rajonale të partnerëve strategjik të shqiptarëve dhe interesave jetik të fuqizimit të elementit shqiptar në Ballkan përcaktojnë variablën e elementëve të përbashkët strategjik në procesin e ardhshëm të këtij fuqizimi. Të gjitha kombet kanë strategji të mëdha, megjithatë kjo nuk do të thotë se të gjitha kombet mund t'i arrijnë qëllimet e tyre strategjike.¹²⁸

Prandaj ky rivlerësim i drejtë shqiptarët duhet orientuar drejt strategjive të përbashkëta krahas forcave mbisunduese globale me objektiva e strategji të përbashkëta rajonale. Disa nga to mund të ndajnë nga rëndësia influencën rajonale strategjike ushtarake, disa nga to anën ekonomike e disa nga to edhe fuqizimin rajonal. Megjithatë, të gjitha këto kanë emërueset dhe qëllimet e përbashkëta, koordinim, unifikim, veprim.

Literatura:

1. Saul Bernard Cohen, "*Gjeopolitika*". Tiranë, 2016. Fq. 7.
2. Bashkim Rama, "*Ballkani pas rënies së Murit të Berlinit*". Tiranë 2013. Fq. 61.
3. <http://users.jyu.fi/~aphamala/pe/issue3/vajdasag.htm> (12.04.2019)
4. Ahmet Davutogllu, "*Thellësia strategjike*". Shkup, 2010. Fq. 355.

¹²⁷ Ahmet Davutogllu, "*Thellësia strategjike*". Shkup, 2010. Fq. 355.

¹²⁸ George Friedman, "*100 Vitet e ardhshme*". Tiranë 2010. Fq. 75.

5. George Friedman, "*100 Vitet e ardhshme*". Tiranë 2010. Fq.
6. <https://wwrefworld.org/docid/3ae6ad7c9c.html> (01.05.2019).
7. <https://pesd.princeton.edu/?q=node/245> (02.05.2019).

DALLIMET DHE NGJAJSHMËRITË NDËRMJET TË DREJTËS TRASHËGIMORE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT, REPUBLIKËN E SHQIPËRISË DHE REPUBLIKËN E KOSOVËS

Msc.Emine Musa

NPN Proaqua Srugë , Sektori për punë të përgjithshme , juridike dhe burime njerëzore

Trashëgimia paraqet kalimin me ligj ose me testament të pasurisë prej tek trashëgimlënësi deri tek një ose më tepër persona që në rastin konkret janë trashëgimtarët sipas rregullave të përcaktuara me Ligjin për trashëgimi.

1. PËRBËRJA E MASËS TRASHËGIMORE

Në objektin e trashëgimit hyjnë si sendet e luajtshme ashtu edhe ato të paluajtshme që i kanë takuar trashëgimlënësit në kohën e vdekjes së tij , pa marrë parasysh vlerën apo sasinë e sendeve . Trashëgohen vetëm të drejtat pasurore të cilat vazhdojnë e nuk shuhet pas vdekjes së trashëgimlënësit e jo edhe të drejtat personale të lidhura ngushtë me personalitetin e personit , të cilat shuhet me vdekjen e trashëgimlënësit .

Të përshtatshme për trashëgimi konsiderohen këto të drejta :

- **Të drejtat reale** (e drejta e pronësisë , servitutit , pengut , posedimit etj);
- **Të drejtat e detyrimeve** (kontrata e shitblerjes , shperblimi i dëmit , pasurimi pa bazë etj) ;
- Objektin e pasurisë trashëgimore e përbejnë edhe **e drejta e autorit dhe e drejta e pasurisë industriale** .

2. TRASHËGIMLËNËSI

Si trashëgimlënës mund të paraqitet secili person fizik . Si kushte që një person fizik të konsiderohet si trashëgimlënës janë që ai të ketë vdekur dhe të ketë lënë pas vetes pasuri trashëgimore , sepse nëse ai pas vetes nuk ka lënë pasuri trashëgimore atëherë personat të cilët do të paraqiteshin si trashëgimtar nuk do të kenë çfarë të trashëgojnë .

3. TRASHËGIMTARËT

Ligji për trashëgimi i Republikës së Maqedonisë të Veriut , i Republikës të Kosovës dhe i Republikës të Shqipërisë si trashëgimtar konsiderojnë :

„ personin i cili në kohën e hapjes së trashëgimisë është gjallë ose është zënë para vdekjes së trashëgimlënësit dhe ka lindur i gjallë . Konsiderohet se ka qënë zënë në kohën e hapjes së trashëgimisë ai person që ka lindur i gjallë brenda 300 ditëve nga vdekja e trashëgimlënësit „ .

i129

4. KOHA DHE VENDI I HAPJES SË TRASHËGIMISË

Si Ligji i Republikës të Maqedonisë të Veriut , i Republikës të Kosovës dhe i Republikës të Shqipërisë parashohin se trashëgimia hapet kur vdes trashëgimlënësi .

Në rastin e shpalljes së personit të vdekur , trashëgimia hapet ditën kur , sipas vendimit gjyqësor , personi konsiderohet i vdekur.

Trashëgimia hapet në vendin ku e ka pasur trashëgimlënësi vendbanimin e tij të fundit . Kur vendbanimi i fundit i trashëgimlënësit nuk dihet , trashëgimia hapet në vendin ku ndodhet e gjithë pasuria e tij ose pjesa kryesore e saj .

5. BARAZIA NË TRASHËGIMI

Të gjithë personat fizik në kushte të njejta janë të barabartë në trashëgimi .

Fëmijet e lindur jashtë martese , kur atësia është njohur rregullisht ose është vërtetuar me vendim të gjykatës apo të organit kompetent si dhe fëmijet e adoptuar barazohen me fëmijët legjitim .

I adoptuari nuk trashëgon në familjen e origjinës së tij dhe as kjo nuk e trashëgon atë .

Të huajt janë të barabartë në trashëgimi me shtetasit e Republikës të Maqedonisë të Veriut , me kusht reciprociteti .

6. BAZAT E THIRRJES NË TRASHËGIMI

Kryesisht si baza kryesore ligjore për të trashëguar konsiderohen :

- Ligji ;
- Testamenti .

¹²⁹ Neni 320 i Kodit civil të Republikës të Shqipërisë , neni 7 i Ligjit për trashëgimi të Republikës të Kosovës (nr. 2004/24).

6.1 **Trashëgimia ligjore** – zbatohet atëherë kur trashëgimlënësi nuk ka lënë testament ose ka lënë testament vetëm për një pjesë të pasurisë së tij përkatësisht në atë situatë kur testamenti është tërësisht ose pjesërisht i pavlefshëm .

6.2 **Trashëgimtarët ligjor** – Neni 360 i Kodit Civil të Republikës të SHqipërisë ,neni 11 i Ligjit për trashëgimi të Republikës të Kosovës dhe neni 12 i Ligjit për trashëgimi te Republikës të Maqedonisë të Veriut si trashëgimtarë ligjor konsiderojnë :

- Fëmijët e trashëgimlënësit , të adoptuarit e tij dhe pasardhësit e tyre , bashkëshorti , prindërit , vëllezërit e motrat dhe pasardhësit e tyre , gjyshi e gjyshja dhe pasardhësit e tyre .

Këto persona trashëgojnë sipas rrethëve trashëgimore . Trashëgimtarët e rendit më të afërm të trashëgimisë i përjashtojnë nga trashëgimia personat e rendit më të largët të trashëgimisë .

6.3 Rendet ligjore të trashëgimisë

6.3.1 **Radha e parë e trashëgimisë** – në bazë të nenit 13 të Ligjit për trashëgimi të Republikës të Maqedonisë të Veriut si trashëgimtarë të rendit të parë janë fëmijet e trashëgimlënësit dhe bashkëshorti/ja e tij/saj .

Ata trashëgojnë në pjesë të barabarta . Si trashëgimtar të radhës së parë këto persona paraqiten edhe në Kodin Civil të Republikës të Shqipërisë edhe në Ligjin për trashëgimi të Republikës të Kosovës .

E drejta e përfaqësimit – kur një nga fëmijët ka vdekur para trashëgimlënësit , është bërë i padenjë për të trashëguar , ka hequr dorë nga trashëgimia ose është i përjashtuar nga trashëgimi në vend të tij hyjnë me zëvendësim fëmijët e tij dhe kur për shkaqet e mësipërme nuk mund të jenë trashëgimtarë , vijnë në trashëgimi të paslindurit e tyre pa kufizim.¹³⁰

Në këtë rast pjesa e prindit që nuk trashëgon , ndahet ndërmjet të paslindurve në pjesë të barabarta .

Në kodin civil të Republikës së Shqipërisë per dallim nga Ligji për trashëgimi i Republikës së Kosovës dhe Republikës së Maqedonisë së Veriut kur përmendet radha e parë trashëgimore , në nenin 137 rregullohet edhe çështja se si ndahet masa trashëgimore kur trashëgimlënësi nuk ka fëmijë por ka vetëm bashkëshortin pasjetues .

Në këtë situatë , kur përvec bashkëshortit nuk ka trashëgimtarë të tjerë të radhës së parë , në trashëgimi thirren ata të radhës pasardhëse (prindërit e trashëgimlënësit) dhe kur nuk ka të tillë thirren trashëgimtarët e radhës tjetër pasardhëse .

¹³⁰ Neni 361 i Kodit civil te Republikes te Shqiperise .

Në çdo rast bashkëshorti merr ½ pjesë të trashëgimit .¹³¹
Nga ky nen mund të kuptojmë se bashkëshorti në asnjë radhë trashëgimore nuk mund të paraqitet si trashëgimtar i vetëm .

6.3.2 Radha e dytë ligjore e trashëgimisë

Në bazë të nenit 16 të Ligjit për trashëgimi të Republikës të Maqedonisë të Veriut dhe nenit 14 të Ligjit për trashëgimi të Republikës të Kosovës si trashëgimtarë të rendit të dytë paraqiten prindërit e trashëgimlënësit dhe bashkëshorti i tij.

Për dallim nga kjo në Kodin Civil të Republikës të SHqipërisë në nenin 363 si trashëgimtarë të rendit të dytë të trashëgimisë parashihen : Prindërit e trashëgimlënësit dhe personat e paaftë për punë , të cilët të paktën 1 vit para vdekjes së trashëgimlënësit , bashkëjetonin me atë si antëarë të familjes dhe në ngarkim të tij .

Rendi i dytë trashëgimor trashëgon në atë mënyrë që gjysma e masës trashëgimore trashëgohet nga ana e prindërve të trashëgimlënësit kurse gjysma tjetër e masës trashëgimore trashëgohet nga bashkëshorti.

Në qoftë se njëri prej prindërve të trashëgimlënësit ka vdekur para trashëgimlënësit masën trashëgimore që do ti takonte atij do ta trashëgojnë të paslindurit e tij , në qoftë se prindi ka vdekur dhe nuk ka lënë pasardhës masën trashëgimore që do ti kishte takuar po ta kishte mbijetuar trashëgimlënësin e trashëgon prindi tjetër , dhe nëse edhe ky ka vdekur trashëgimtarët e këtij prindi e trashëgojnë atë që do ti kishte takuar edhe njërit edhe prindit tjetër .

Nga ana tjetër kur të dy prindërit e trashëgimlënësit kanë vdekur dhe nuk kanë lënë pasardhës masën trashëgimore do ta trashëgojë vetëm bashkëshorti pasjetues i trashëgimlënësit .

6.3.3 Radha e tretë trashëgimore

Me Ligjin për trashëgimi të Republikës të Maqedonisë të Veriut dhe Kodin Civil të Republikës të SHqipërisë kur përmendet radha e tretë e trashëgimisë thuhet :

„ Masën trashëgimore të të vdekurit që nuk ka lënë as pasardhës , as prindër , dhe as këto nuk kanë lënë ndonjë pasardhës , as bashkëshort , e trashëgojnë gjyshërit dhe gjyshet e tyre „.

¹³¹ Neni 361 i Kodit civil të Republikës të Shqipërisë .

Njërën gjysëm të masës trashëgimore e trashëgojnë gjyshi dhe gjyshja nga ana e babait ndërsa gjysmën tjetër gjyshi dhe gjyshja nga ana e nënës .

Nga ana tjetër Kodi civil i Republikës të SHqipërisë në pjesën për trashëgimtarët e radhës së tretë të trashëgimisë thekson :

„ në radhë të tretë thirren në trashëgim personat e paaftë për punë në ngarkim të trashëgimlënësit , kur nuk ka trashëgimtarë të tjerë të radhës së dytë , gjyshi e gjyshja , vëllezërit e motrat si dhe fëmijet e vëllezerve dhe të motrave të paravdekur . Të sipërmit trashëgojnë në pjesë të barabarta , pa u bërë dallimi ndërmjet vëllezërve dhe motrave të një ati ose vetëm të një nënë , ndërmjet gjyshit e gjyshes nga ana e babës ose e nënës .

Për radhën e tretë trashëgimore është karakteristikë se si trashëgimtarë konkurojnë në trashëgimi vetëm trashëgimtarët ligjorë që thirren në trashëgimi sipas faktit të lidhjes së gjinisë të gjakut , kjo nuk është karakteristikë për dy radhët e tjera të trashëgimisë , sepse aty kemi edhe trashëgimtarë që kanë lidhje me trashëgimlënësin në bazë të gjinisë civile (birësimit) dhe sipas faktit të lidhjes të martesës (bashkëshorti) .

- **E drejta e gjyshit dhe gjyses të trungut të njejtë**

Gjyshi dhe gjyshja nga trungu i njejtë trashëgojnë pjesë të barabarta .

Nëse ndonjëri nga paraardhësit nga njëri trung ka vdekur para trashëgimlënësit , pjesën e masës trashëgimore që do ti kishte takuar po ta kishte mbijetuar trashëgimlënësin e trashëgojnë fëmijët e tij , nipat dhe pasardhësit e mëtutjeshëm të tij ,¹³² nëse gjyshi dhe gjyshja nga njëri trung kanë vdekur para trashëgimlënësit dhe nuk kanë lënë asnjë pasardhës , pjesën e masës trashëgimore që do ti kishte takuar po ta kishte mbijetuar trashëgimlënësin e trashëgojnë gjyshi dhe gjyshja e trungut tjetër , fëmijet e tyre , nipat dhe pasardhësit e tyre të mëtutjeshëm.¹³³

- **Kur bashkëshorti e humb të drejtën në trashëgimi -**

E drejta në trashëgimi në mes të bashkëshortëve ndërprehet me shkurorzim të martesës dhe me anulim të martesës.

Bashkëshorti nuk ka të drejtë në martesë nëse :

¹³² Neni 21 i Ligjit për trashëgimi të Republikës të Maqedonisë së Veriut (gazeta zyrtare e RMV nr. 47 prej 12.09.1996) .

¹³³ Neni 22 i Ligjit për trashëgimi të Republikës të Maqedonisë së Veriut (gazeta zyrtare e RMV nr. 47 prej 12.09.1996) .

- Trashëgimlënësi ka parashtruar padi për shkurorzim të bashkëshortësisë , ndërsa pas vdekjes së trashëgimlënësit vërtetohet se padia ka qënë e bazuar , ose nëse bashkëshorti dhe trashëgimlënësi kanë parashtruar propozim për shkurorzim me marrëveshje , ndërsa deri në vdekjen e trashëgimlënësit procedura e atij propozimi nuk është mbaruar;
- Martesa e tij me trashëgimlënësin anulohet pas vdekjes së trashëgimlënësit , për shkaqe për të cilat bashkëshorti pasjetues ka ditur në kohën e lidhjes së martesës dhe
- Bashkësia e tij e jetesës me trashëgimlënësin ka mbaruar vazhdueshëm me fajin e tij ose me marrëveshje me trashëgimlënësin .¹³⁴

6.2 Trashëgimia testamentare

Testamenti paraqet një veprim juridik të njëanshëm të trashëgimlënësit , nëpërmjet të të cilit veprim ai disponon me pasurinë e tij për kohën pas vdekjes .

Si vecori kryesore të testamentit mund të përmenden :

- **Testamenti është akt rigoroz personal** – thuhet se testamenti është akt rigoroz personal sepse kërkohet që vullnetin e fundit ta shpreh personalisht trashëgimlënësi në mënyrën e përcaktuar me dispozita ligjore . Por shtrohet pyetja se si do të veprohet me ato persona të cilët nuk janë në gjendje ta shprehin vullnetin e tyre të fundit ?

Personat të cilët nuk janë të aftë të shprehin personalisht vullnetin e tyre të fundit nuk mund të lënë testament .

- **Testamenti është punë juridike mortis causa** – edhe pse trashëgimlënësi e përpilon testamentin derisa ai është gjallë testamenti nuk prodhon efekte juridike prandaj thuhet se gjithnjë derisa është gjallë trashëgimlënësi trashëgimtari nuk mund të trashëgoj masën trashëgimore , pra testamenti prodhon efekt juridik vetëm pas vdekjes së trashëgimlënësit , pra pas vdekjes do të ndahet masa trashëgimore në mënyrën e paraparë në testament .
- **Testamenti është punë juridike bamirëse** – testamenti konsiderohet si punë juridike bamirëse sepse është punë pa shpërblim .
- **Testamenti është punë juridike e njëanshme** – testamenti konsiderohet si punë juridike e njëanshme sepse formohet vetëm me shprehjen e njëanshme të vullnetit të fundit të trashëgimlënësit , por testamenti do të prodhoj efekt juridik vetëm nëse vullneti i fundit i

¹³⁴ Neni 26 i Ligjit për trashëgimi të Republikës të Maqedonisë të Veriut (gazeta zyrtare e RMV nr. 47 prej 12.09.1996).

trashëgimlënësit është shprehur pa ndikimin e dhunës , kanosjes, lajthimit, mashtrimit pra vullneti i fundit duhet të jetë i vërtetë dhe real dhe i shprehur në mënyre të lirshme .

- **Testamenti është akt juridik formal** – testamenti konsiderohet si akt rigozorisht formal sepse ai prodhon efekt juridik vetëm nëse është përpiluar në formën e paraparë me dispozita ligjore .

6.2.1 Zotësia për të përpiluar testament

Me Ligjin për trashëgimi të Republikës të Maqedonisë të Veriut është paraparë se aftësi për të përpiluar testament ka secili person i cili është i aftë për gjykim dhe i cili ka mbushur moshën 15 vjet .

Nga ana tjetër me Kodin civil të Republikës të SHqipërisë dhe me Ligjin për trashëgimi të Republikës të Kosovës nuk është e paraparë e njejta situatë , me Kodin civil të Republikës të SHqipërisë është paraparë se aftësi për të përpiluar testament ka cdo person që ka mbushur moshën 18 vjet si dhe gruaja nën këtë moshë kur është e martuar , i mituri nga 14 deri 18 vjet mund të bëjë testament vetëm për pasurinë që ka fituar me punën e tij .

E drejta trashëgimore e Republikës të Kosovës thekson se testament mund të përpiloj secili person që ka zotësi për të vepruar dhe i cili ka mbushur 18 vjet , testament mund të bëjë edhe personi që ka zotësi për të vepruar e i ka mbushur 16 vjet dhe është i martuar .

Në Ligjin për trashëgimi kur flitet për zotësinë për të përpiluar testament thuhet se humja e zotësisë për të vepruar pas përpilimit të testamentit nuk ndikon në pavlefshmërinë e testamentit .

6.2.2 Përmbajtja e testamentit

Më anë të testamentit trashëgimlënësi cakton një ose më tepër trashëgimtarë , i cili apo të cilët do të trashëgojnë një pjesë të pasurisë së tij ose të gjithë pasurinë e tij .Si trashëgimtar testamentar konsiderohet edhe ai person të cilit me testament i janë lënë një ose më shumë sende ose të drejta te caktuara , nëse dëshmohet se vullneti i trashëgimlënësit ka qënë që ai person të jetë trashëgimtar i tillë . Trashëgimlënësi mundet që ta ngarkoj me ndonjë obligim personin të cilit i lenë ndonjë interes nga masa trashëgimore . Ai mundet që me anë të dispozitave të vecanta në testament të parasheh kushte apo afate.¹³⁵

6.2.3 Forma e testamentit si kusht për vlefshmërinë e tij

¹³⁵ Neni 100 i Ligjit për trashëgimi të Republikës të Maqedonisë të Veriut (gazeta zyrtare e RMV nr. 47 prej 12.09.1996).

E drejta trashëgimore e Republikës të Maqedonisë të Veriut parasheh se :

„ I plotëfuqishëm është ai testament i cili është përpiluar në formën e përcaktuar me ligj dhe sipas kushteve të parashikuara me ligj „.¹³⁶

Nga ana tjetër e drejta trashëgimore e Republikës të Kosovës parasheh se :

„ Testamenti është i vlefshëm nëse testatori e ka shkruar atë , datuar dhe nënshkruar me dorën e vet ose ka vënë gishtin e vet . Data e testamentit duhet të tregojë ditën , muajin dhe vitin . Nënshkrimi duhet të përmbajë mbiemrin e testatorit si dhe të paktën njërin prej emrave të tij dhe duhet vënë në fund të testamentit „ .¹³⁷

Ligji për trashëgimi i Republikës të Maqedonisë të Veriut njih këto lloje të testamentit :

- **Testamentin e shkruar me dorë** – ky testament është i plotëfuqishëm nëse e ka shkruar trashëgimlënësi me dorën e vetë dhe nëse e ka firmosuar ai personalisht .
- **Testamenti gjyqsor** – testamentin e trashëgimlënësit në bazë të fjalëve të trashëgimlënësit mund ta përpiloj gjykatësi i gjykatës themelore , i cili paraprakisht do ta vërtetoj identitetin e trashëgimlënësit . Nëse trashëgimlënësi nuk di shkrim dhe lexim , gjykatësi do tia lexojë trashëgimlënësit në praninë e dy dëshmitarëve dhe pastaj trashëgimlënësi në praninë e dy dëshmitarëve të njëjtë do ta firmos testamentin .
- **Testamenti i përpiluar në kohë lufte** – është i plotëfuqishëm testamenti i përgatitur në kohë të gjendjes së luftës sipas dispozitave që vlejné për përgatitjen e testamentit gjyqsor të personave në shërbim ushtarak nga ana e komandantit të cetës ose të ndonjë eprori tjetër të rangut të tij ose të ndonjë rangu më të lartë ose ndonjë person tjetër në prani të ndonjërit nga këto epror si dhe nga secili epror tjetër të njësisë të caktuar.¹³⁸
- **Testamenti ndërkombëtar** – testamenti i përpiluar në formë të testamentit ndërkombëtar është i plotëfuqishëm në aspektin e formës , pa marrë parasysh vendin ku është përpiluar , ku gjindet pasuria , shtetësia ose vendbanimi përkatësisht vendqendrimi i trashëgimlënësit .
- **Testamenti gojor** – trashëgimlënësi ka mundësi që të deklaroj vullnetin e tij të fundit para 2 dëshmitarëve vetëm nëse për shkak të rrethanave të jashtëzakonshme nuk ka mundësi të

¹³⁶ Neni 65 i Ligjit për trashëgimi të Republikës të Maqedonisë të Veriut (gazeta zyrtare e RMV nr. 47 prej 12.09.1996).

¹³⁷ Neni 74 i Ligjit për trashëgimi të Republikës të Maqedonisë të Veriut (gazeta zyrtare e RMV nr. 47 prej 12.09.1996).

¹³⁸ Neni 73 i Ligjit për trashëgimi të Republikës të Maqedonisë të Veriut (gazeta zyrtare e RMV nr. 47 prej 12.09.1996).

përpiloj testament të shkruar , me kusht që testamenti gojor pushon që të vlej pas kalimit të 30 ditëve nga dita e pushimit të egzistimit të rrethanave të jashtëzakonshme.

Nga ana tjetër e drejta trashëgimore e Republikës të SHqipërisë njeh këto lloje të testamentit :

- **Testamentin olografik ;**
- **Testamenti me akt noterial ;**
- **Testamente të posaqcme :** - në vendet ku nuk ka noter testamenti mund të vërtetohet nga ana e kryetarit të bashkësisë ose komunës;¹³⁹
 - testamenti i një personi që ndodhet në shërbim ushtarak mund të vërtetohet nga komandanti i njësisë ushtarake në të cilën ai bënë pjesë dhe kur është shtruar në spital nga drejtori i spitalit.¹⁴⁰
 - testamenti i një personi që ndodhet në një anije shqiptare në lundrim ose që ka qëndruar në një liman të huaj , mund të vërtetohet nga kapiteni i anijes.¹⁴¹

Si dhe e drejta trashëgimore e Republikës të Kosovës njeh këto lloje të testamentit :

- **Testamentin olografik ;**
- **Testamentin gjyqësor ;**
- **Testamentin në rrethana të jashtëzakonshme ;**
- **Testamentin gojor .**

¹³⁹ Neni 399 i Kodit civil te Republikës te Shqiperise .

¹⁴⁰ Neni 400 i Kodit civil te Republikës te Shqiperise .

¹⁴¹ Neni 401 i Kodit civil te Republikës te Shqiperise .

6.2.4 Revokimi i testamentit

Trashëgimlënësi ka mundësi në çdo kohë të bëjë revokimin e testamentit . Revokimi i testamentit mund të jetë i pjesshëm atëherë kur trashëgimlënësi revokon vetëm një pjesë të testamentit dhe revokim në tërësi atëherë kur trashëgimlënësi revokon në tërësi testamentin .

Që revokimi i testamentit të jetë i plotëfuqishëm trashëgimlënësi në kohën e revokimit duhet të ketë aftësi për të vepruar .

Revokimi i testamentit mund të bëhet me shkrim ose me asgjësimin e dokumentit (djegjen ose grisjen e testamentit) .

Në literaturën trashëgimore nihen kryesisht tre mënyra kryesore të revokimit :

- E para testamenti i mëvonshëm mund ta lë pa fuqi juridike testamentin e mëparshëm ;
- E dyta testamenti i ri mund ta lë pa fuqi juridike testamentin e mëparshëm vetëm pjesërisht jo plotësisht ;
- E treta testamenti mund të revokohet , përkatësisht të lihet pa fuqi juridike edhe me një deklaratë të dhënë nga ana e trashëgimlënësit përpara noterit.

6.2.5 Pavlefshmëria e testamentit

Për pavlefshmërin e testamentit janë të njohura kryesisht tre shkaqe kryesore :

- Kanosja , shtrëngimi , mashtrimi , lajthitja mbi shkaqet që kanë shtyrë trashëgimlënësin të bëjë testament ;
- Mungesa e formës së kërkuar me ligj ;
- Mungesa e lirisë së vullnetit të trashëgimlënësit ose bërja e testamentit në çfardo mënyre tjetër pa vullnetin e trashëgimlënësit .

Pavlefshmëria mund të jetë Absolute dhe relative .

- Pavlefshmëria absolute e testamentit egziston atëherë kur testamenti është në kundërshtim të plotë me dispozitat imperative ligjore , me rendin juridik dhe me rregullat e moralit .
- Pavlefshmëria relative e testamentit – egziston atëherë kur me anë të testamentit çënohen interesat e personave të caktuar . Për këtë lloj të pavlefshmërisë gjykata nuk kujdeset në bazë

të detyrës zyrtare por vetë personat interesi i të cilëve është cënuar mund të kërkojnë pavlefshmërin e testamentit .

7. PADENJËSIA PËR TË TRASHËGUAR

I padenjë për të trashëguar si në bazë të ligjit ashtu edhe në bazë të testamentit si edhe të fitojë dicka në bazë të testamentit , është ai që :

- Me paramendim e ka privuar nga jeta apo ka tentuar ta privoj nga jeta trashëgimlënësin ;
- Me dhunë apo kanosje e ka detyruar apo me mashtrim e ka shtyrë trashëgimlënësin të bëjë apo të revokoj testamentin apo ndonjë dispozitë të testamentit , apo e ka ndaluar ta bëjë atë ;
- E ka shkatërruar apo fshehur testamentin nga trashëgimlënësi me qëllim që të pengojë të realizohet vullneti i fundit i trashëgimlënësit si dhe ai që e falsifikon testamentin e trashëgimlënësit ;
- E ka shkelur rëndë obligimin për mbajtjen e trashëgimlënësit ndaj të cilit ka pasuar obligim ligjor për mbajtje si dhe ai që ka dashur ti jap trashëgimlënësit ndihmën e domosdoshme .¹⁴²

8. HEQJA DORË NGA TRASHËGIMIA

Trashëgimtari mund të heqë dorë nga trashëgimia me deklaratë para gjykatës deri në përfundim të kontestit mbi masën trashëguese . Kjo dorëheqje vlenë edhe për pasardhësit e atij që heqë dorë , nesë nuk deklaron shprehimisht se heqë dorë vetëm në emër të vetë .

Nëse pasardhësit janë të mitur për këtë dorëheqje nevojitet edhe pëlqimi i organit të kujdestarisë . Trashëgimtari i cili heq dorë vetëm në emër të vetë llogaritet se asnjëherë nuk ka qënë trashëgimtarë.

Nëse heqin dorë nga trashëgimia të gjithë trashëgimtarët që i takojnë rendit më të afërm të trashëgimisë në momentin e vdekjes së trashëgimlënësit në trashëgim thirren trashëgimtarët e rendit pasues të trashëgimit .¹⁴³

¹⁴² Neni 123 i Ligjit për trashëgimi të Republikës të Maqedonisë të Veriut (gazeta zyrtare e RMV nr. 47 prej 12.09.1996) .

¹⁴³ Neni 128 i Ligjit për trashëgimi të Republikës të Maqedonisë të Veriut (gazeta zyrtare e RMV nr. 47 prej 12.09.1996) .

Trashëgimtari që ka hequr dorë nga trashëgimia mund të kërkojë anulimin e deklaratës së tij për heqje dorë nga trashëgimi vetëm në ato situatë kur deklarata e tij është dhënë nën ndikimin e kanosjes, dhunës, lajthimit dhe mashtrimit . E drejta e kërkesës për anulimin e deklaratës pushon me skadimin e afatit prej një viti nga dita e kuptimit të shkaqeve në bazë të të cilave mund të kërkohej anulimi i deklaratës gjegjësisht nga nderprerja e kanosjes .

9.PËRJASHTIMI I TRASHËGIMTARËVË TË DOMOSDOSHËM NGA TRASHËGIMIA

Trashëgimlënësi mundet ta përjashtojë nga trashëgimia trashëgimtarin i cili ka të drejtë në pjesën e domosdoshme nëse :

- Ka gabuar rëndë ndaj trashëgimlënësit me lëndim të ndonjë detyrimi ligjor ose moral dhe
- Me qëllim ka bërë ndonjë vepër të keqe më të rëndë ndaj tij ose bashkëshortit të tij , fëmisë ose prindit të tij ¹⁴⁴.

Përjashtimi nga trashëgimia mund të jetë i plotë ose i pjesshëm me kusht që shkakun për përjashtim të trashëgimtarit nga trashëgimia duhet të egzistoj në kohën e përpilimit të testamentit .

Më përjashtim nga trashëgimia ai trashëgimtar e humb të drejtën për të trashëguar masën trashëgimore e cila i takon atij , ndërsa të drejtat e personave të tjerë të cilët kanë të drejtë ta trashëgojnë trashëgimlënësin përcaktohen sikur trashëgimtari i përjashtuar të ketë vdekur para trashëgimlënësit .

10. TË DREJTAT TRASHËGIMORE TË GJINISË FEMËRORE NË TË DREJTËN ZAKONORE DHE NË BAZË TË LIGJIT PËR TRASHËGIMI

Pozita e gjinisë femërore në lidhje me të drejtën e tyre për të trashëguar ka kaluar një rrugë të gjatë duke u përballur me pengesa të shumta sociale , ligjore dhe institucionale .

Edhe pse me Ligjet për trashëgimi të të gjithë shteteve thuhet se :

„ të gjithë personat fizik në kushte të njejta janë të barabartë në trashëgimi „,

ajo që zbatohet në praktikë është krejtë e kundërta .

¹⁴⁴ Neni 46 i Ligjit për trashëgimi të Republikës të Maqedonisë të Veriut(gazeta zyrtare e RMV nr. 47 prej 12.09.1996) .

Edhe pse Ligji për trashëgimi , kushtetuta e shteteve si dhe Konventa për eliminimin e të gjithë formave të diskriminimit ndaj gruas parashohin barazi të plotë ndërmjet gjinisë mashkullore dhe femërore , femra duke filluar nga e kaluara të drejtat e saj trashëgimore janë bazuar jo në Ligj po në Kanunin e Lekë Dugagjinit apo edhe në të drejta zakonore të tjera ku thuhej se masën trashëgimore mund ta trashëgoj vetëm mashkulli jo edhe femra .

Për një kohë shumë të gjatë , bashkëshortja është konsideruar si person i huaj në familje , si rrjedhojë e egzistimit të këtij parimi bashkëshortja thirrej në trashëgimi vetëm në ato situata kur trashëgimlënësi nuk kishte të afërm të tjerë .


Zanafilla e problemeve të ndeshura në praktikë në lidhje me të drejtat trashëgimore të gjinisë femërore lidhen kryesisht me dy institute juridike edhe atë :

1. Heqjen dorë nga trashëgimia – ky veprim ka për pasojë daljen nga rrethi i trashëgimtarëve dhe ndarjen e pjesës së tij nëpërmjet trashëgimtarëve të tjerë . Heqja dorë nga trashëgimia nën presionin e trashëgimtarëve meshkuj për të arritur shmangien e femrës nga trashëgimia realizohet me mjete të lejuara ligjore por shpesh herë në kundërshtim me ligjin . Thuhet në kundërshtim me ligjin duke pasur parasysh raste kur gratë heqin dorë nga trashëgimia në emër të harmonisë familjare apo vllazërore , në emër të zakonit apo edhe për shkak të mashtrimit , frikës ose dhunës nga anëtarët meshkuj përfitues të trashëgimisë . Heqja dorë e trashëgimtarit femër nga trashëgimia nënkupton edhe heqjen dorë nga trashëgimia të pasardhësve të saj përveç nëse shprehimisht ka deklaruar se heqë dorë vetëm në emër të vet.
2. Shmangia nga trashëgimia – egziston atëherë kur me vdekjen e trashëgimlënësit dhe nisjen e procedurës për hapjen e trashëgimisë hartohet aktvdekja me të cilën caktohen trashëgimtarët sipas radhëve të trashëgimit , nëse në këtë fazë të procedurës nuk depozitohen certifikatat e lindjes së trashëgimtarëve femër , kto të fundit mund të shmangen nga trashëgimia duke mos u shënuar në aktvdekje . Edhe pse egziston një institut i tillë Ligji parashih të drejtën e parashtrimit të ankesës si një garancion për të mbrojtur gratë në të tilla raste .

Në vazhdim po ju ilustruj disa informata konkrete në lidhje me atë se si disa trashëgimlënës kanë ndarë masën trashëgimore :

1. „ M.B tregon se në familjen e saj janë gjashtë fëmijë, por pasurinë e familjes ajo tregon se është e ndarë në mënyrë të barabartë vetëm ndërmjet 3 vëllezërve të saj,, .
2. „ SH.SH thotë se ndarjen e trashëgimisë e ka bërë në bazë të Kanunit të Lekë Dugagjinit , ai thekson se ka vepruar në mënyrë të tillë pasi vajza pasi të martohet ta ketë më të lehtë të vijë për vizita te vëllezërit e saj .

Real Estate registered to women



Zakonet e trashëgimisë ende favorizojnë në masë të madhe mashkullin në raport me pasardhëset femra. Pas vdekjes së babait apo bashkëshortit vajza/gruaja është shpesh në rrezik për mos marrjen e pjesës së saj të ligjshme të pasurisë , përfshirë pasurinë e paluajtshme . Gratë që nvaren nga të afërmit e tyre meshkuj për sigurinë ekonomike janë vecanërisht të cënueshme dhe janë në rrezik të lartë të vihen para presionit familjar që të heqin dorë nga të drejtat e tyre trashëgimore dhe të lejojnë vijën mashkullore të trashëgimisë të pronave familjare.

Tek ne edhe ditëve të sotme problem është se gratë nuk e kërkojnë trashëgiminë e vetë , gjithmonë kur vijnë puna tek trashëgimia thonë së do t'ia lënë vëllait , sepse na hidhërohet vëllai , e nuk kemi ku të shkojmë . Pra pavarësisht të gjithave është femra ajo që në të shumtën e rasteve ajo që heqë dorë nga trashëgimia familjare vetëm e vetëm për ti ruajtur raportet e shëndosha brenda familjes.

Si përfundim do thoja pavarësisht të gjithave ajo që vlenë të theksohet është se :

„ në bazë të Ligjit për trashëgimi , e drejta në pronë , e drejta në trashëgimi është e barabartë dhe e pakontestueshme „ .

PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

1. Kushtetuta e RMV përcakton qartësisht barabartësinë ndërmjet mashkullit dhe femrës , duke përjashtuar cdo lloj diskriminimi ndërmjet tyre.
2. Pengesa bazë në drejtim të të drejtave trashëgimore te gratë është besimi ende i madh tek normat patriarkale dhe normat zakonore .
3. Rritja e kapaciteteve të juristëve dhe zyrtarëve me qëllim eliminimin e zbatimit të praktikave të dyfishta , keqinterpretimin e ligjeve dhe uljen e nivelit të burokracisë në përmbushjen e detyrimeve të tyre , për gratë kjo do të nënkuptonte rritje të besimit se do të përfitojnë të drejtat që u takojnë dhe rritjen e rasteve kur gratë pretendojnë realizimin e këtyre të drejtave pronësorë .
4. Ndryshimi i dispozitave ligjore kur gruaja paraqitet si trashëgimtare e vetme e radhës së parë .

LITERATURA E SHFRYTËZUAR

- 1.Kodi civil i Republikës të Shqipërisë , Tiranë Mars 2017 ;
- 2.Ligji për trashëgimi I Republikës të Maqedonisë së Veriut (Gazeta zyrtare e RMV nr. 47 prej 12.9.1996)
- 3.Ligji për trashëgimi I Republikës të Kosovës (nr. 2004/24) ;
- 4.E drejta trashëgimore , Tiranë 2006 , Hamdi Podgorica ;
- 5.Të drejtat e trashëgimisë pronësore të grave në Kosovë (Mars 2011) Qendra Kosovare për studimet gjinore ;
- 6.Institut for Habitat Development Annual Report , 2003 ;
- 7.Konventa Evropiane për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut .

Thank You for participating in the International Scientific Conference “New Emerging Trends In Western Balkan – NETWB19”, held in International University of Struga

18 May 2019, Struga